



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS



**Tezë në kërkim të gradës shkencore
“DOKTOR”**

APOLLONIA

***Studimi historik e arkitektonik i rilevimeve dhe
tipologjive ndërtimore – bazë për restaurim e
rikonstruktion virtual të qytetit antik***

Autor

MSc. Ark. Loreta ÇAPELI

Udhëheqës Shkencor

Prof. Dr. Neritan CEKA

TIRANË, 2016

JURIA

1. Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA Kryetar

**2. Prof. Dr. Agron LUFİ Anëtar
Oponent**

3. Prof. Dr. Andrea MALIQARI Anëtar

**4. Prof. Dr. Pirro THOMO Anëtar
Oponent**

5. Prof. Dr. Stavri LAMI Anëtar

Tiranë, më 23 /12 / 2016

MIRËNJOHJE

Për familjen time, për inkurajimin, durimin dhe sakrificat e bëra, për të më mbështetur në këtë iniciativë.

FALENDERIME

*Falenderim e mirënjohje të sinqertë për udhëheqësin shkencor, **Prof. Dr. Neritan CEKA** i cili me eksperiencën dhe profesionalizmin e tij ka kontribuar e më ka mbështetur në realizimin e këtij punimi.*

Falenderim për kolegët studentë të shkollës së Doktoraturës së Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, me të cilët kaluam shpesh orë të gjata diskutimesh mbi probleme strukturore e metodologjike të temave studimore.

*Falenderim e mirënjohje të veçantë për të ndjerin **Prof. Dr. Enver Faja** me të cilin ideuam e strukturuam këtë studim në fillimet e tij.*

Abstrakt

Apollonia- Studim historik e arkitektonik i rlevimeve dhe tipologjive ndërtimore – bazë për restaurim e rikonstruksion virtual të qytetit antik.

Studimi, ka si objekt qendrën shoqërore të qytetit antik të Apollonisë - Agoranë e periudhës klasike dhe helenistike. Ai ndahet në katër pjesë kryesore që trajtojnë: Qendrën e publike apo Agoranë; Monumentin kryesor të Agorasë Eklesiasterion / Bouleuterion; Stoa - Portik i madh, si dhe Nymfeun, apo Fontanën e Apollonisë. Kapitulli i parë trajton Agoranë e Apollonisë duke e krahasuar me agoratë e së njëjtës epokë të botës antike duke vënë në dukje parimet arkitektonike nga të cilat ka marrë formë hapësira publike në Apolloni. Ajo rezulton e zhvilluar në katër periudha kryesore, me agoranë që zhvendoset nga zona klasike në atë romake në një hark kohor prej 8 shekujsh (nga shek. VI p.e.s. në shek II e.s), duke marrë formën e forumit me ndërtimin e Odeonit, Bouleuterionit dhe Bibliotekës. Një trajtim krejt të ri përbën analiza hapsinore e vendosjes së monumenteve, duke marrë si një shembull të ruajtjes së harmonisë zgjidhjen që i ka qenë dhënë vendosjes së Harkut të Triumfit, si monumenti i fundit i ndërtuar në forum. Në procesin krahasues janë marrë në shqyrtim edhe zgjidhjet hapsinore të Agorave të qyteteve ilire të prapatokës: Dimal, Bylis, Klos, Foinikes, Antigonesë (me hipotezën interesante se Agoraja e zbuluar nuk është ajo kryesorja). Kapitulli i dytë trajton tipet arkitektonike të Eklesiasterionit dhe bouleuterionit, si monumente që kanë përcaktuar edhe zhvillimin planimetrik dhe hapsinor të Agorasë. Duke pasur si qëllim vendosjen e një lidhje kronologjike, tipologjike dhe funksionale midis Eklesiasterionit dhe Buleterionit të Apollonisë, në disertacion shqyrtohen shembujt nga Athina, apo Magna Grecia (Metapont, Pestum, Akragas) dhe në bazë të tyre identifikohet si eklesiasterion një ndërtim i periudhës arkaike në formë gjysëm rrethore, i zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike shqiptare - franceze në sheshin midis dy kodrave të Apollonisë. Forma dhe diametri prej 16m japin mundësi të paraqesë edhe hipotezën për identifikimin e tij si Bemë e Eklesiasterionit të hershëm të qytetit. Kapitulli i tretë i disertacionit i kushtohet Stoave. Rivlerësimi i studimeve të mëparshme dhe i rikonstruksionit hipotetik të monumentit shërben si pikënisje për të zhvilluar pikëpamjen për zhvillimin e mëtejshëm të hapësirës së Agorasë në Apolloni, të lidhur me ndërtimin e Portikut njëkatësh në zonën midis dy kodrave të Apollonisë. Konsiderohet si i pabazuar interpretimi i arkeologëve për formën e Stoas vetëm me një rradhë kolonash, dhe studimi i referohet një numri të konsiderueshëm të stoave, klasifikimit të tyre në pesë tipe planimetrike, si dhe trajtimit volumetrik Vitruvian. Mbi këtë bazë, dhe duke ju referuar të dhënave nga kërkimet gjeofizike, bëhet rikonstruksioni virtual 3D i Stoasë së madhe që ka formë 'U'-je me një kat dhe dy rradhë kolonash. Kapitulli i katërt i disertacionit trajton Fontanën, apo nymfeun e Apollonisë, si një monument i një hapësire të tretë publike, të vendosur në periferi të qytetit. Analizohet zhvillimi i këtij tipi arkitektonik në Greqinë e lashtë dhe identifikohet me tipa të ngjashëm, afërsisht të njëkohshëm. Duke vënë në dukje dy elemente themelore të përbashkët, që janë krijimi i një fasade monumentale dhe mbështetja në faqen e kodrës, studimi e kërkon origjinën e tipit Apolloniat të Fontanës tek tipet e trevës korintase në Peloponez (Messene, Megara). Edhe në zgjidhjen grafike rikonstruksioni virtual në 3D i Fontanës shënon një kontribut tjetër origjinal të disertacionit dhe përfaqëson provën më të sukseshme në këtë drejtim.

Fjalë kyç: Apollonia, Agora, Stoa, Bouleuterion, Fontanë, Virtual, 3D

Abstract

Apolonia – Historic and architectural study of surveys and building typologies as a base for the restoration and virtual reconstruction of the antique city.

This study is focused on the civic center of the ancient city of Apolonia – the Agora from the classic times and that of helenistic one. The body of work is divided in four main parts which elaborate the Civic Center or the Agora, the main Monument of the Agora – the Eclesiasterion / Bouleuterion, the Stoa and the Nymphaeum or the Fountain. The first chapter is about the Agora of Apolonia which is confronted and compared to similar Agora's of the same period of time of the antique world putting in evidence the architectonic principles, by which, the public space was shaped in Apolonia. It was developed in four distinctive periods of time, with the Agora migrating from the classic era civic center to the more recent roman forum in a timeframe of 8 centuries (from the 6th Century B.C. to 2nd Century A.D.), taking the shape of a forum with the construction of the Odeion, the Bouleuterion, and the Bibliotheque. A new approach was the space analysis about the distribution of the monuments, taking as an example the preservation of the harmonies of the built space, the solution given by the positioning of the Triumph Arch, which is also the last monumental structure built in the Forum. During the comparative process were examined the spatial solutions in the Illyrian cities of the hinterland as Dimal, Bylis, Klos, Foinike, Antigonea (with an interesting hypothesis that the newly found Agora is not the main one). The second chapter is about the architectural types of Eclesiasterion and Bouleuterion, which are monumental buildings that have determined the plan and the spatial development of the Agora. The objective is the establishment of a chronological, typological, and functional link between the Eclesiasterion and the Bouleuterion of Apolonia. Comparative examples are taken from Athens, or Magna Grecia (Metapont, Paestum, Akragas) and the process helped to determine as an Eclesiasterion a structure from the archaic era with a semicircle plan, found during the archeological excavations run by a joint team of French and Albanian specialists, in between the two hills of Apolonia. It's shape, and diameter of 16 m, allows for the hypothesis that the semicircle represents just the bema of the early Eclesiasterion of the city. The third chapter is about the Stoa. The re-evaluation of the previous studies and the hypothetical reconstruction of the building serves as a starting point for the development of the concept about the agora spatial arrangement, which is linked to the construction of the portico in the area between the two hills of Apolonia. The study claims as not founded the proposed shape of the Stoa with a single row of columns, backed by the archeologists. In order to back her claim she refers to several other stoas, their classification into 5 different plan shapes and the Vitruvian volumetric description. Based on this and referring to the data obtained by on-site geophysical surveys, a 3D virtual model of the stoa was built, showing a single floor, 'U' shape, and with double row colonnade. The fourth chapter treats the Fountain, or the Nymphaion, which is a monumental structure of another public space established in the outskirts of the city. The architectural typology development is analysed with regard to the ancient Greece's similar sites and close time periods to the Apolonia fountain. By pointing out two basic elements that are in common, which are the creation of monumental façade and the development onto the hill slope, the study finds similarities of the Apolonian fountain to the Corinthian ones in Peloponesus (Messene, Megara). The virtual reconstruction of the fountain in 3D is an original contribution to the better understanding of the structure.

Keywords: Apolonia, Agora, Stoa, Bouleuterion, Fountain, Virtual, 3D

TABELA E PËRMBAJTJES

0. _ HYRJA

fq. 1

-
- 0.1 - Fusha e studimit
 - 0.2 - Rrethanat teorike të studimit
 - 0.3 - Arsytet e studimit dhe përzgjedhjes së temës
 - 0.4 - Qëllimi dhe objektivat e studimit
 - 0.5 - Pyetjet e hipotezat që shtron studimi dhe pritshmëritë e tij.
 - 0.6 - Metodologjia e studimit.
 - 0.7 - Struktura e punimit.

Chapter 1 . _ BAZA TEORIKE

fq. 12

-
- 1.1 - Rëndësia që ka studimi tipologjik për rikonstrukcionin tredimensional
 - 1.2 - Teoritë kryesore mbi kompozimin urban të qyteteve

Chapter 2 . _ TRAJTIMI ARKITEKTONIK I AGORAVE

fq. 24

-
- 2.1 - Organizimi urban i qyteteve në Greqinë e lashtë
 - 2.2 - Teoritë e formimit të parcelave të shenjta dhe Agorave në Greqinë antike.
 - 2.3 - Metodologjia e studimit
 - 2.4 - Agoratë në Apolloni.
 - 2.4.1 - Etapat kronologjike të evolucionit të Agorave në Apolloni
 - 2.4.2 - Agoraja e vjetër mes dy kodrave
 - 2.4.3 - Agoraja – Forum
 - 2.4.4 - Analizë hapësinore e vendosjes së objekteve
 - 2.4.5 - Karakteristikat kompozicionale
 - 2.5 - Agoraja në Dimal
 - 2.5.1 - Karakteristika kompozicionale

- 2.6 - Agoraja në Bylis
 - 2.6.1 - Karakteristika kompozicionale
- 2.7 - Agoraja në Klos
 - 2.7.1 - Karakteristika kompozicionale
- 2.8 - Agoratë në Butrint
 - 2.8.1 - Karakteristika kompozicionale
- 2.9 - Agoraja në Antigóné
 - 2.9.1 - Karakteristika kompozicionale
- 2.10 - Agoraja në Phoinike
 - 2.10.1 - Karakteristika kompozicionale
- 2.11 - Konkluzione

Chapter 3 - EKLESIASTERIONI DHE BOULEUTERIONI

fq. 79

-
- 3.1 - Eklesiasterioni në Agoranë mes kodrave, ndërtesa në formë patkoi
 - 3.2 - Shembuj të Eklesiasterionëve në qytetet helene
 - 3.3 - Bouleuterioni në Agoranë – Forum
 - 3.4 - Studimi tipologjik
 - 3.4.1 - Analiza teorike e tipologjisë
 - 3.4.2 - Shembuj botërorë para dhe gjatë shek. VI – V p.e.s.
 - 3.4.3 - Shembuj botërorë gjatë shek. IV – III p.e.s.
 - 3.4.4 - Shembuj botërorë gjatë shek. II – I p.e.s.
 - 3.4.5. Shembuj botërorë gjatë shek. I – II e.s.
 - 3.5 - Trajtimi e analiza tipologjike
 - 3.6 - Analizë krahasuese e Bouleuterionit të Apollonisë
 - 3.7 - Konkluzione dhe diskutime

Chapter 4 - PORTIKU I MADH NË AGORANË HELENISTIKE

fq. 119

-
- 4.1 - Stoaja me nikje
 - 4.2 - Portiku i madh në agoranë mes kodrave.

4.3 - Studimi tipologjik

4.3.1 - Analiza teorike e tipologjisë.

4.3.2 - Evidentimi i rasteve më të njohur.

4.3.3 - Formulimi proporcional i Stoave

4.4 - Përlllogaritja proporcionale e Stoasë –Portiku i madh

4.5 - Konkluzione

Chapter 5 - FONTANA E APOLLONISË

fq. 146

5.1 - Burime literature për Fontanën e Apollonisë

5.2 - Studimi tipologjik kronologjik.

5.2.1 - Shembuj botërorë para dhe gjatë shek. VI p.e.s.

5.2.2 - Shembuj botërorë në shek. V p.e.s.

5.2.3 - Shembuj botërorë në shek. IV p.e.s.

5.2.4 - Shembuj botërorë në shek. III p.e.s.

5.3 - Trajtimi e analiza tipologjike

5.4 - Analizë krahasuese e Fontanës së Apollonisë

5.5 - Anlizë krahasuese e çisternë s në Apolloni dhe Bylis.

5.6 - Konkluzione

Chapter 6 - KONKLUZIONE dhe REKOMANDIME

fq. 177

BIBLIOGRAFIA

fq. 183

0. HYRJE

Ky dizertacion prezantohet në kuadrin e Doktoraturës në Arkitekturë të organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës e Urbanistikës të Universitetit Politeknik të Tiranës.

0.1 Fusha e studimit.

Dizertacioni shqyrton e hulumton në fushën e studimit arkitektonik e tipologjik të ndërtimeve antike të qytetit të Apollonisë duke u ndalur në trajtimin analitik e reflektiv të tyre, duke servitur kështu, nëpërmjet rasteve në studim, një shembull të mënyrës e metodologjisë studimore me të cilën mund të studiohet e trajtohet çdo vepër arkitektonike e qyteteve tona antike.

Studimi është një kontribut shkencor në fushën e historisë së arkitekturës, njohjes së tipologjive ndërtimore të periudhës së antikitetit, dhe të restaurimit të monumenteve e të vendeve arkeologjike.

Apollonia është një pasuri kulturore e trashëgimisë sonë dhe, në vetvete, është njëkohësisht një derivat i artit të të ndërtuarit të këtyre tipologjive në të gjithë zonën mesdhetare, duke patur ngjashmëri si edhe dallime nga ato, por duke qenë absolutisht e influencuar nga fryma projektuese që, si një “kod dizajni”, respektohej në vendet ku kultura Greko-Romake u përhap.

0.2. Rrethanat teorike të studimit.

Shqipëria, në territorin e saj administrativ, ka një seri qytetesh antike të ardhura që nga periudhat e shekujve para erës sonë. Të ndërtuar furishëm në periudhën Greko-Romake ato ishin pjesë e botës helene duke qenë disa qytete-koloni e, disa të tjerë, qytete të ndërtuar nga vendasit, por pjesë e të njëjtit sistem politik.

Këto qytete u bënë origjina e civilizimit të mëvonshëm dhe mbartën në vetvete një seri objktesh arkitektonike e ndërtimore. Dyrrahu, Apollonia, Bylisi, Klosi, Butrinti, Foinike, Antigonea, Amantia, Dimali, janë para-ardhës të qyteteve tona që, sot, shpalosin trashëgiminë tonë të pasur kulturore. Për arsye të shekujve që kanë kaluar, apo edhe të qyteteve që u ndërtuan kohë pas kohe në të njëjtin vend duke u mbivendosur mbi paraardhësit, apo edhe të rasteve kur qytetet e parë u braktisën apo u zhvendosën në teritore të reja, sot shumë prej këtyre ndërtimeve, monumentale ose jo, ruajnë vetëm pak nga gjendja e forma e dikurshme, duke qenë më shumë në forma gërmadhash arkeologjike.

Rasti i vazhdimësisë së qytetit në të njëjtin vend me para-ardhësin do të jetë vetëm për Dyrrahun - Durrësin e sotëm - ndërkohë që qytetet e tjerë që përmendëm do të braktisen pas shek. IV-V e.s.. Në Apolloni, braktisja e qytetit në mënyrë graduale, mungesa e

banimit dhe e qytetit të mëvonshëm që mund të mbivendosej mbi antikun duke e prishur atë, dhanë mundësinë e ruajtjes se gjurmëve urbane e arkitektonike të atyre qyteteve të vjetër.

Gërmimet arkeologjike në disa prej tyre, të filluara që prej viteve '20 të shekullit XIX e të vazhduara deri në ditët e sotme, kanë nxjerrë në dritë rrugë, objekte kulti e publike, banesa dhe vepra artistike. Nën drejtimin, shpesh të misioneve arkeologjike të huaja por edhe nën kompetencat e arkeologëve vendas (sidomos në periudhën 1945-90), e gjithë kjo pasuri objektesh, është studiuar hollësisht në kuadrin arkeologjik duke prodhuar kështu një seri veprash studimore, monografi, revista e konferenca shkencore.

Ajo që bie në sy është fakti se këto vepra kanë të gjitha karakter përshkrues apo publikues të rezultateve të gërmimeve për secilin vend arkeologjik, ndërkohë që mungon analiza krahasimore dhe nxjerrja e rezultateve nga raste të ngjashëm historikë e arkitektonikë.

Vihet re, pra, mungesa e studimeve në të cilat të bëhet trajtimi arkitektonik i këtyre objekteve të zbuluar dhe, sidomos, analiza tipologjike përkatëse, duke i parë ato të lidhura dhe të ndikuara nga ndërtime të tipologjive të ngjashme në zonat me kulturë helene.

Theksojmë se, të organizuar në formë vendesh apo parqesh arkeologjike, këto hapësira të qyteteve të dikurshme marrin përsipër sot të jenë pika të rëndësishme tërheqëse për turizmin kulturor dhe të bëhen rrëfyese të mrekullive ndërtimore e arkitektonike që dikur mbanin. Fatkeqësisht, mbetjet arkeologjike, janë shpesh të pakta dhe përfaqësojnë vetëm një pjesë fare të vogël ose vetëm fragmente të veprave monumentale që qyteti kishte dikur.

0.3 Arsyet e studimit dhe përzgjedhjes së temës

Dhjetëra mijëra turistë që vizitojnë çdo vit parkun arkeologjik të Apollonisë kanë formime të ndryshme kulturore. Ata shohin rrënoja dhe pjesë të mbetura të veprave arkitektonike, e shpesh, veç nëse janë arkitektë apo inxhinjerë, nuk ja arrijnë të imagjinojnë me sytë e mendjes, madhështinë e tyre të dikurshme. Kanë dëgjuar e lexuar mbi qytetin, shkojnë për ta vizituar, e gjenden vetëm para mbetjeve të vogla arkeologjike. Në morinë e fragmenteve, herë - herë pa kuptim, të kollonave, themeleve, gurëve të vendosur pa kuptim sa andej këndeje, nuk arrijnë të perceptojnë se si kanë qenë e çfarë formash kanë patur objektet. Dalin pothuaj të zhgënjyer nga vizita e qytetit. Një ciceron, apo një historian, nuk mjafton për të bërë të kuptueshme formën që kanë patur veprat arkitektonike të qytetit.

Humbet, në këtë mënyrë, thuhet e gjithë vlera arkitektonike e historike e qytetit, e për pasojë edhe një pjesë e krenarisë sonë për kulturën tonë kombëtare. Ajo që do të ndihmonte shumë në një përfytyrim të saktë të këtyre objekteve të vjetër, është ngritja

3Dimensionale e tyre në formën e nje maketi apo rikonstrukcioni dixhital, virtual “ex-novo”.

Raste të tilla, të ngjashme, njihen në historinë e arkitekturës e të restaurimit. Rikonstrukcione 3Dimensionale të veprave arkitektonike të qendrave historike apo dhe të vetë qyteteve antike u ndërtuan për Akropolin e Athinës e të Pergamos, për Forumet Imperiale të Romës apo Vila Adriana, apo edhe për qytete të tërë si Roma e Priena. Por për të arritur në rikonstrukcione të tilla duhet një studim i mirë historik e tipologjik i objekteve dhe i vetë qytetit, i rasteve e tipologjive analloge në qytetet e tjerë të Shqipërisë apo edhe me ato kronologjikisht bashkëkohore në botë. Vetëm pasi ai bëhet i plotë e i bazuar në të dhëna faktike materiale e historike, mund t’i lejojmë vetes të arrijmë në deduktime formale e arkitektonike për formën që objektet kanë patur.

Arsyeja tjetër është e lidhur me domosdoshmërinë për të studiuar më në thellësi aspektin arkitektonik të objekteve e sidomos të atyre që pak janë studiuar, për vetë faktin se janë zbuluar në dekadën e fundit.

Kështu, duke ndjekur këtë rrjedhë llogjike, gjetëm arsyen e një pune të thelluar kërkimore e krahasimore për të studiuar disa tipologji kryesore të ndërtuara në Apolloni e për të përcaktuar teorikisht parimet kompozicionale të përdorura në projektim e ndërtim si dhe format që objektet *duhet të kenë patur*. Nëpërmjet këtij studimi duam të tregojmë se studimi tipologjik i veprës arkitektonike duhet të paraprijë e të bëhet bazë për rikonstrukcionin virtual të tyre.

0.4 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Projekti studimor është një kontribut teorik në restaurimin arkitektonik të veprave në Apolloni.

Një projekt restaurimi ndjek këto faza studimore:

- Studimi historik
- Rilevimi arkitektonik e instrumental
- Përcaktimi i degradimeve dhe problemeve statike të ndërtesës
- Projekti i restaurimit.

Studimi ka për qëllim t’i shërbejë fazës së parë, së dytë e të katërt të restaurimit.

Kur *studion historikisht* një objekt arkitektonik duhet të njohësh e të organizosh mirë gjithë materialin bibliografik e arkeologjik që gjendet për të, të studiosh rastet e ngjashme që janë ndërtuar sipas së njëjtës tipologji, të shohësh qartë se çfarë mund të ketë ndikuar në formën që ka marrë objekti, t’a krahasosh me të tjerë objekte të ngjashëm, qoftë në morfologji, qoftë në teknika apo materiale ndërtimi. Ky studim jep një mënyrë konkrete

të studimit të disa prej objekteve më të rëndësishëm të qytetit të Apollonisë, ato më pak të studiuarit, të parë në kuadrin urban të qytetit antik.

Kur kryen një *rilevim arkitektonik* e instrumental, duhet që, më parë, të kesh studiuar e njohur teorikisht objektin, tipologjinë së cilës i përket, dhe sekretet morfologjike e proporcionale të tij, të cilat kanë fuqinë të të kthejnë, nga një lexues numrash mbi një metër, në një studiues që di se ku të masë dhe se çfarë të presë nga këto matje duke minimizuar, shpesh, edhe gabimet gjatë rilevimit. Tashmë studimi historik që duhet të paraprijë procesin e rilevimit të objekteve helenistiko-romake, apo edhe hulumtimin e mëtejshëm të të dhënave arkeologjike mund të mbështetet në analizën, që ky studim prezanton, dhe në metodologjinë studimore që propozon.

Kur përgatit një *projekt restaurimi* duhet të nisësh nga njohja e mirë e tipologjisë në mënyrë që të ruhen e të respektohen të gjitha format arkitektonike e proporcionale që objekti duhet të ketë patur (veçanërisht të rëndësishme për tu njohur kur bëhet restaurim nëpërmjet metodës së anastilozës). Veç kësaj, në histori njihen edhe raste në të cilat rilevimet dhe vizatimet 3 dimensionale, kanë shërbyer për të restauruar e rikonstruktuar objekte të vërtetë arkitektonikë. Kujtojmë rastin e Varshavës së paraluftës, e cila e vizatuar hollësisht në rilevime dy e tre - dimensionale prej studentëve të arkitekturës, pas Luftës së Dytë botërore, do të rikonstruktohet, apo më mirë të themi, rindërtohet në mënyrë identike duke i përdorur ato vizatime si një projekt i mirëfillte restaurimi. Kështu, edhe rikonstrukcionet 3dimensionale hipotetike të propozuara nga ky studim, mund të shërbejnë si një projekt restaurimi për rastin kur do të duam të “riprodhojmë” objektin antik apo edhe një miniaturë të tij.

Kështu, Dizertacioni do të analizojë objekte arkitektonike të ndërtuara në periudhat kohore nga shek. V p.e.s. deri në shek. II e.s., në Apolloni duke kontribuar në kuptimin e perceptimin e drejtë të arkitekturës së tyre e duke ndihmuar për një përfytyrim të saktë të shesheve të qytetit të vjetër.

Qëllimi i këtij studimi është të tregojë se studimi tipologjik i veprës arkitektonike duhet të paraprijë e të bëhet pikënisje për rikonstrukcion virtual të tyre.

0.5. Pyetjet e hipotezat që shtron studimi dhe pritshmëritë e tij.

Mbetje të pakta arkeologjike vetëm në formë rrënojash e fragmentesh të elementëve konstruktivë, apo edhe rikonstrukcione nëpërmjet proceseve të anastilozës mund bëhen shkas që të lindin dyshime e të vendosen pikëpyetje në proceset deduktuese. Si planifikohej Agoraja në një plan urban dhe, a kishte kushtëzime në dimensionet e format e tyre? Në cilat periudha janë ndërtuar Agoratë e Apollonisë dhe kur u shfrytëzua secila prej tyre? Pse objektet e Bouleuterionit dhe Odeonit janë aq pranë njeri - tjetrit dhe Harku i Triumfit aq pranë me to? Pse u përdorën nikjet cilindrike në Stoa e Apollonisë dhe, a

ka ndonjë lidhje ndërmjet mbulesave gjysmëkupolare të tyre dhe atyre të ndërtimeve në kulturën Mikenase apo Romake? Ç'rol luante Teatri në qytet dhe a ishte ai aq i rëndësishëm sa të përfshihej në skemën kompozicionale të Agorasë? A ishte Fontana e Apollonisë një rast i veçuar në eksperiencën e Fontanave në botë, apo diçka e ngjashme mund të gjendet edhe gjetkë? Ç'llogjikë morfologjike ka shtyrë arkitektin në vendosjen e nje Harku Triumfi në mesin e një Agoraje helenistike? Çfarë funksioni e forme ka patur objekti në formë patkoi që ndodhet në Agoranë mes kodrave, është ai një Eklesiasterion, siç e kanë përcaktuar arkeologët? A është i saktë një rikonstrukcion nëpërmjet anastilozës i bërë në Bouleuterionin e Apollonisë? Këto, dhe shumë pyetje të tjera, ngrihen në mendjen e një historiani të arkitekturës kur shikon një qytet antik e kur mundohet të kuptojë apo hipotezojë mbi format që ai ka patur.

Shumë studime të bëra deri më sot mbi Apolloninë mbeten vetëm studime evidentuese e përshkruese të gjërmimeve e mbetjeve të qytetit të vjetër apo edhe të fakteve historike, por asnjëri prej tyre nuk thellohet në një analizë arkitektonike mbi tipologjinë e objekteve, ndërkohë që, edhe aty ku bëhet, ajo është ilustrative e fakteve arkeologjike dhe jo deduktuese e rasteve anallogje në vende të tjera - bëjnë përjashtim këtu vetëm pak studime ndër të cilët ai i bërë për Stoa në me nikje nga Baçe & Ceka, në konkludim të të cilit propozohet edhe një rikonstrukcion hipotetik 3D.

Kështu, studimi ka për qëllim të zgjerojë këtë analizë përtej studimit të objekteve të ndërtuara në Apolloni duke i parë ato të lidhura me rastet e ngjashme tipologjike të qyteteve të tjerë në Ilirinë e jugut dhe ata të kulturës Greko-Romake. Pas krahasimeve përkatëse arrihet në karakteristika tipologjike për secilin tip ndërtimor, për të kuptuar elementët funksionalë, format kompozicionale e proporcionale, ngjashmëritë apo edhe ndryshimet stilistike me objektet e tjerë të periudhave të njëjta kronologjike e për t'i dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve të parashtruara. Këto karakteristika ndihmojnë për të propozuar format që veprat do të kenë patur në kohën kur u ndërtuan, forma që, në përfundim, na lejojnë të rikonstruktojmë virtualisht saktë objektet arkitektonikë.

Duke u nisur prej kësaj mund të themi se studimi përbëhet nga dy aspekte të rëndësishëm në trajtimin e qyteteve dhe tipologjive ndërtimore në to - i pari, i karakterit analitik-përshkrimor, dhe i dyti i karakterit interpretues-deduktues. Aspekti analitik-përshkrimor ka të bëjë me evidentimin, përshkrimin, studimin e objekteve më të spikatur të tipologjisë respektive të ndërtuar në qytetet helenistike-romake botërore, duke u bazuar në të gjithë faktet arkeologjike e bibliografike, të seleksionuara e përpunuara me kujdes, dhe të renditura kronologjikisht dhe sipas tipologjive. Ndërkohë që aspekti interpretues-deduktues ka të bëjë me analizën krahasimore të objekteve të secilës tipologji, interpretimit arkitektonik, stilistik e funksional, nga i cili do të arrihet në konkluzione deduktive të cilat bëhen pikënisje e studimit altimetrik e 3dimensional të tyre.

Ky studim i shërben njohjes së mëtejshme të këtyre ndërtimeve të Antikitetit e do të mund të përdoret si një “bazë të dhënash” analitike për çdo studim të mëvonshëm të lidhur me restaurimin dhe rivlerësimin e tyre.

Përveç profesionistëve, që do të përfitojnë të gjithë benefitet që përmendëm, studimi do t'i shërbejë edhe individëve laikë të fushës nëpërmjet dobisë komunikative që ai do të ketë. Në kohët moderne po mundohemi të bëjmë një ndërthurje efektive ndërmjet argëtimit dhe edukimit, elemente këto që janë në bazë të turizmit kulturor. Kështu, në një sfond argëtimi e relaksi, mund të jepet informacion e të edukohen progresivisht individët duke i servirur atyre saktësinë e asaj që imagjinojnë e mësojnë. Ky është një efekt i rëndësishëm që kanë të gjitha studimet me produkt rindërtimin virtual të objektit arkitektonik.

0.6 Metodologjia e studimit.

Puna studimore nisi nga studimi i plotë i të gjithë literaturës historike apo bashkëkohore mbi Apolloninë. Burimet kanë qenë vepra të shkruara në shqip, artikuj të revistave “Monumentet” dhe “Iliria”, artikuj të simpoziumeve dhe konferencave, shkrime të autorëve të huaj dhe relacione shkencore të zbulimeve arkeologjike, si edhe Atlasi i Apollonisë, Në to, vëmendja është fokusuar në sistemin urban në përgjithësi dhe në secilën vepër në veçanti.

Për të studiuar objektet historike është kaluar në katër Faza studimore që zhvillohen paralelisht me njëra tjetrën:

1. Studimi i literaturës dhe krijimi i skedave bibliografike;
2. Mbledhja e dokumentave vizivë – foto, vizatime, grafika, rëlvime, projekte, etj.;
3. Këqyrja në vend e veprës – vajtje në vend, foto të detajeve stilistike;
4. Analizimi në mënyrë krahasimore dhe arritja në konkluzione deduktive;

Studimi i literaturës dhe krijimi i skedave bibliografike.

Gjatë leximit janë krijuar skedat bibliografike përkatëse të cilat nuk bazohen, si zakonisht, mbi të dhënat e një libri por përmbledhin, sipas tipologjisë, të gjithë shkrimet e gjetura duke i renditur sipas autorit dhe kohës së shkrimit.

Këto skeda bibliografike përmbajnë kohën e ndërtimit sipas secilit autor, referencat e shkrimit, çfarë është shkruar për të dhe si e komenton secili autor veprën tipologjike, të dhëna kompozicionale apo konstruktive dhe çfarë kontributi origjinal sjell autori, të dhëna grafike të shkrimit (plan, altimetri apo skicim) të bërë në bazë të përshkrimeve të autorit.

Pas kësaj faze, duke u bazuar në materialet e gjetura dhe në analizën që ju bë secilës prej tipologjive, u vendos që studimi të përqëndrohet në analizën urbane kompozicionale të

shesheve për të parë mënyrat dhe veçantitë e projektimit të tyre si dhe në analizën tipologjike të tre objekteve që do të zgjidheshin nga objektet publikë që njohim për këtë qytet. Dy agora dhe tre objekte të tjerë: ndërtesa në formë patkoi - Eklesiasterioni, Portiku i madh në Agoranë mes kodrave dhe Fontana monumentale, u trajtuan hollësisht dhe përbëjnë thelbin e këtij studimi.

Seleksionimi u bë i lidhur me domosdoshmërinë për të kontribuar në njohjen e Agorasë mes kodrave, për të cilën nuk ka shumë studime për vetë faktin se është zbuluar vetëm prej një dekade. Në këtë agora u seleksionuan: Ndërtesa patkua dhe Portiku i madh si dy objekte për të cilat kemi informacionin më të madh arkeologjik, që gjithmonë duhet të bëhet themeli i një studimi tipologjik të objekteve “rrënojë arkeologjike”. Ndërkohë që Fontana monumentale u zgjodh për faktin që është një objekt i shumë-diskutar e studjuar por gjithmonë vetëm në kuadrin e një përshkrimi e publikimi të rezultateve të gërmimeve, pa u thelluar në analiza krahasimore tipologjike me rastet e tjerë në botën helene dhe njëkohësisht është dhe një objekt i veçantë e i pazakontë në sfondin e qyteteve antike në Shqipëri. Në zgjedhjen e Fontanës influençoi edhe fakti se ajo është një nga objektet që ka pësuar një anastilozë në vitet '70 e cila duhej të analizohet për të kuptuar nëse ka patur ndryshime të formës origjinale

Më tej puna vazhdoi në fazat e tjera të studimit tipologjik.

Mbledhja e dokumenteve pamore – fotografi, vizatime, grafika, rilevime.

Këto dokumente u siguruan në bazë të shkrimeve nga literatura, të botimeve, të librave e të artikujve shkencorë, të arkivës së Institutit të Monumenteve të Kulturës apo të atij të Parkut arkeologjik të Apollonisë, e më pas u sistemuan duke pasur parasysh:

- Përcaktimin e datës së bërjes së fotos, skicës apo rilevimit;
- Verifikimin, nëpërmjet shikimit direkt të veprës, për të hulumtuar ndryshime me gjendjen aktuale apo me dokumente të tjerë vizivë;
- Vendosjen sipas radhës kronologjike për të mundësuar rezultatet në evolucionin historik të tyre, nëse ka pasur apo jo ndryshime apo ndërhyrje në kohë, apo nëse ka pasur struktura para-ekzistuese në të njëjtin vend;

Këqyrja drejtpërdrejt e veprës – foto të detajeve stilistike e tipologjike.

Kjo këqyrje u bë disa herë dhe u dokumentua nëpërmjet fotove e skicave. Gjatë këtij vëzhgimi u dokumentuan:

- Fazat e ndërtimit të dallueshme në trupin e veprës;
- Gjendja e veprës në kohën e studimit;

- Materialet e përdorur për ndërtim të cilat duhet të dallohen nga ato të restaurimeve të mëparshme, për të kuptuar më mirë objektin;
- Detaje të vogla të arkitekturës së objektit e mënyra të punimit të materialit;
- Ndryshimi, ose jo, i formës kompozicionale apo stilistike gjatë restaurimeve të mëparshme, apo fazat e ndryshme të ndërtimit;

Krahas grumbullimit të këtyre materialeve, bëhet edhe studimi teorik i tipologjisë që bazohet në shembujt më të mirë të kulturës Greke, Helenistike e Romake që, të ruajtur akoma edhe sot në qytetet bashkëkohore, janë bërë shpesh objekt i studimeve të ngjashme të rikonstrukcionit virtual.

Këto objekte klasifikohen në mënyrë kronologjike dhe i bashkëngjiten skedave bibliografike që përmendëm, sëbashku me materialin grafik e vizual që gjendet dhe shërbejnë si bazë teorike për rikonstrukcion. Në këtë fazë kihet parasysh që:

siç ndodh gjithmonë në arkitekturë, ndërtimi i tipave të ndryshëm të objekteve bëhet duke respektuar kode të dizajnit, të traditave të përbashkëta të klasës sociale apo të traditës lokale. Kështu, në mënyrë krahasuese, është e lehtë të vendosim përballë njëra tjetrës mbetjet arkeologjike të Apollonisë me shembuj të të njëjtave tipologji nga të cilët mund të ruajmë vizatime apo përshkrime historike. Sidomos nëse bëhet fjalë për objekte të periudhës Greke apo Romake, si ato që u ndërtuan në Apolloni, na vijnë në ndihmë të gjitha njohuritë tona mbi format e rregullat arkitektonike, apo mënyrat e teknikat e ndërtimit si dhe materialet që u përdorën.

0.7 Struktura e punimit.

Ky punim prezantohet me Hyrjen, 5 Kapituj tematikë dhe Konkluzionet.

Kapitulli i parë trajton teorikisht dy koncepte:

- Rëndësinë që ka studimi tipologjik e rikonstrukcioni tredimensional si një fazë e domosdoshme e trajtimit teorik e arkitektonik të veprës - sidomos kur kemi të bëjmë me vepra të kthyer në gërmadha arkeologjike apo me vepra që duam t'i rikonstruktojmë virtualisht. Ai shqyrton detaje të Kartave të restaurimit të Venecias e të Athinës, për të kuptuar rregullat që duhen ndjekur në trajtimin ndaj veprave arkitektonike. Trajton aspekte teorike të rekomandura nga teoricienët e restaurimit, për të kuptuar fazat e studimore që duhen ndjekur gjatë një studimi tipologjik, historik e arkitektonik të veprës arkitektonike. Ai prezanton edhe rekomandimet e ICOMOS e të Kartës Charleston mbi interpretimin e prezantimin e veprave të trashëgimisë kulturore. Duke përdorur këtë bazë teorike bëhet reflektim deduktiv për çështjet përkatëse të lidhura me rastin e Apollonisë e të ndërtimeve në të.

- Teoritë kryesore mbi kompozimin urban të qyteteve në periudhën e antikitetit, për të kuptuar se si këto qytete u organizuan. Trajtohet parime të planifikimit të qyteteve që në fazat e para të krijimit të tyre në shek. VII-VI p.e.s., më tej në kohën e përhapjes së rregullave të sistemit Hipodamik në shek. V p.e.s. deri shek. III p.e.s. duke u bazuar në autorë klasikë të kësaj fushe si Grecco, Martin, Wycherley, Vitruvi për qytetet e Greqisë e të Magnia Grecia, apo në autorë si Cabannes, Ceka, Follain, Baçe, për qytetet Shqiptare e veçanërisht për Apolloninë. Kuptohet si përcaktohen drejtëmet e rrugëve në një qytet, nga se influencohen ato, si përcaktohen sheshet kryesore e funksionet e tyre që prej fillimeve deri periudhën helenistike, cilët janë objektet më të rëndësishëm që u ndërtuan fillimisht e cilat do të ishin ato të periudhës helenistike, çfarë marrdhënie kanë ato me njëri-tjetrin e cilat janë zonat ku do të preferohet të ndërtohen, etj. Përgjigjet ndaj gjithë këtyre enigmave ndihmuan për të lokalizuar se cilët do të jenë objektet e rëndësishëm në qytet e për të zgjedhur se cilët prej tyre do të bëheshin objekt studimi i thelluar në vazhdim.

Kapitulli i dytë, trajton Agoratë në Apolloni - atë mes kodrave dhe Agoranë-Forum, duke u ndalur në një hulumtim kryesisht kompozicional, planimetrik e perspektiv të tyre e duke kuptuar pse ato morën formën që paraqesin sot. Ky trajtim bëhet pasi studiohen teoritë kryesore mbi formimin e shesheve-Agora në Greqi të ilustruara edhe nga shembuj klasikë të Agorave e të skemave më të mirëformuara të tyre, e duke gjetur vazhdimisht referencat me rastin e Agorave të Apollonisë. Nëpërmjet analizës të këtyre teorive dhe sipas të dhënave arkeologjike për kronologjinë e objekteve në to, u lokalizuan periudhat në të cilat të dy Agoratë u shfrytëzuan si sheshe kryesorë. Pjesa më e gjerë i lihet studimit të Agorasë-Forum për vetë faktin se ajo është thujse tërësisht e zbuluar e paraqet sot edhe veçanti kompozicionale që bëhen shtysë për hulumtim të mëtejshëm. Kuptuam se ajo ruan parime kompozicionale që përdorshin në Greqinë e lashtë - siç është parimi i kompozimit polar e peizazhistik, por të influencuar edhe nga parime të kompozimit të shesheve-Forume Romakë (simetria dhe mbyllja e perspektivës) që pavarësisht se u vendosën, respektuan relativisht ato Greke. Ilustrimin më të mirë për këtë e bën pozicionimi i Harkut të Triumfit në fundin perspektiv të dy rrugëve (parim kompozicional Romak) por pa mbuluar fasadat e objekteve dhe duke lejuar që ato të duken nga pikat kryesore hyrëse në qytet, (parim kompozicional Grek).

Ky kapitull trajton edhe Agoratë e qyteteve të tjerë në territorin e Shqipërisë, me dëshirën për të gjetur dhe evidentuar karakteristikat kompozicionale arkitektonike e për të rezultuar në veçori që janë të përbashkëta pothuajse në të gjithë Agoratë e Shqipërisë. Forma të zgjatura planimetrike të influencuara nga terreni, konturime me Stoa e gjeometrizim të sipërfaqeve, tendencë për përfshirje të Teatrit në Agora, përdorimi të elementëve lokalë siç ishin nikjet e Stoave apo kollonave tetëkëndore do të jenë karakteristika që herë do t'i afrojnë këto sheshe me ato të qyteteve Greke, e herë do t'i largojnë prej tyre duke i kthyer në veçanti.

Kapitulli i tretë, trajton Eklesiasterionin dhe Bouleuterionin duke hulumtuar mbi objektin në formë patkoi, të quajtur si Eklesiasterion nga arkeologët. Këtu hidhet dyshimi, nisur nga përmasat e vogla të tij, se ai mund të mos ketë qenë një Eklesiasterion por një objekt tjetër që lidhej me të njëjtin funksion të mbledhjeve publike apo sociale. Për të mbështetur apo jo këtë dyshim, studimi thellohet në trajtimin teorik e tipologjik të ndërtesave Eklesiasterion e Bouleuterion për të kuptuar format kompozicionale të tyre dhe si evoluon nga periudhat e objekteve të parë deri në periudhat e vona helenistike; madhësitë e kapacitetet mbajtëse të njerëzve në brendësi, orientimin në lidhje me Agoranë e pozicionimin në relacion me të, organizimin e vendosjes së shkallares-cavea në brendësi e mënyrat e hyrjes e daljes në to. Gjatë hulumtimit të rasteve më të spikatur të botës Helene bëhet vazhdimish referenca me rastin e Apollonisë si për objektin-patkua, ashtu edhe për Bouleuterionin-tempull të Agonoteteve në Agoranë forum. Në përfundim deduktohet mbi këtë analizë duke nxjerrë si përfundim se ajo mund të ketë qenë fillimisht vetëm Bema e një Eklesiasterioni e ndoshta, më vonë, një Bouleuterion si sallë e mbyllur dhe e mbuluar për mbledhjet e Këshillit, e cila duhet të ketë funksionuar vetëm deri në shek. III p.e.s. kur, mbi të, u ndërtua Portiku i madh. Kështu, në konkluzion, propozohet që të kërkohet për një objekt Bouleuterion i cili duhet të shërbente si i tillë nga shek.III p.e.s. deri në kohën kur u ndërtua Tempulli i Agonotetëve në shek.II. e.s.. kohë që studimi e quan si një boshllëk funksional. Këtu bëhet edhe një ndarje në faza evolutive e jetës së kësaj Agoraje duke filluar nga fundshekulli VI p.e.s - deri në kohën kur ajo funksionoi si e tillë.

Kapitulli i katërt, trajton Portikun e madh në Agoranë helenistike. Studimi hulumton formën planimetrike të propozuar nga arkeologët Francezë, duke hedhur edhe dyshimet e veta mbi këtë formë. Baza teorike mbi të cilat do të ngrihet ky dyshim është studimi i hollësishëm që i bëhet tipologjisë së portikëve-Stoa të ndërtuara gjithandej në botën helene. Duke evidentuar rastet më të spikatura kuptohen skemat planimetrike e altimetrike të tyre dhe njëkohësisht edhe format që duhet të kenë patur. Ato shihen si një evolucion kronologjik i lidhur dhe i influencuar nga forma e sheshit-Agora në të cilin ndodhen. Në trajtim i kushtohet rëndësi tipeve planimetrikë që evidentohen, formës që merr fasada e tyre, orderat arkitektonikë që përdoren dhe proporcionet e tyre, mënyrat e mbulimit në rastet kur janë një apo dy katëshe. Analiza tipologjike bëhet baza për të kuptuar formën që portiku mund të ketë pasur e, për ta propozuar atë, si një rikonstrukcion virtual. Në fund rekomandohet të vazhdohet hulumtimi arkeologjik i cili do të gjejë pjesë të pa zbuluara të tij, ato që, sipas ngjashmërive tipologjike, duhet t'i ketë pasur.

Kapitulli i pestë trajton Fontanën e Apollonisë, një objekt që, edhe pse s'bën pjesë në sheshet-Agora, u përzgjedh si një rast për tu studiuar tipologjikisht për veçantinë e formës por edhe për faktin se është i vetmi ndërtim i këtij tipi në qytetet tona antike. Përzgjedhja u ndikua edhe nga fakti që ky objekt ka pësuar një anastilozë në vitet 1970, duke

ndryshuar, ndoshta, formën origjinale, pikëpyetje që duhet ta zgjidhte ky studim. Për të kuptuar nëse ajo ishte vërtetë një objekt i veçantë i botës helene, siç quhej shpesh, bëme një studim të detajuar të shembujve të kësaj tipologjie në qytetet e rëndësishëm të antikitetit. Hulumtimi zhvillohet përsëri në mënyrë kronologjike duke studiuar Fontana nga më të vjetrat - të shek. VII p.e.s. deri në ato të të njëjtës periudhë të shek. III p.e.s. Nga nëntipet planimetrikë e kompozicionalë, në të cilët i klasifikuam këto objekte, kuptuam se Fontana e Apollonisë i përket tipit më të zhvilluar të kësaj tipologjie si nga ana kompozicionale ashtu edhe nga ajo estetike. Ajo bën pjesë ndër dy shembujt më të bukur që bota helene ndërtoi dhe propozohet forma 3dimensionale që duhet të ketë pasur. Nga Studimi i tipologjisë dhe hulumtimi i periudhës para anastilozës rezulton se, ndër dy basenat e saj, vetëm i pari ka qenë i mbuluar ndërkohë që, i dyti, ka qenë i zbuluar - ndryshe nga çfarë supozohej deri më tani.

Kapitulli i gjashtë trajton konkluzionet e punës kërkimore. Dizertacioni mori përsipër të provojë se *Studimi historik e arkitektonik i tipologjive ndërtimore*, duhet të bëhet baza nga ku të ngrihet interpretimi dhe rikonstrukcioni virtual 3D.

Është e vërtetë se, rastet e marrë në studim, na bindën për këtë. Edhe në rastin e Portikut të madh, edhe në rastin e Bouleuterionit si edhe në atë të Fontanës, pas studimit tipologjik arritëm në rezultate dhe forma paksa ose tërësisht të ndryshme nga ato që pranoreshin deri sot.

Portiku i madh rezultoi *krejt i ndryshëm* me atë që arkeologët kanë propozuar duke dhënë edhe indikacione për të vazhduar studime e gjurmime të mëtejshme të pjesëve të pazbuluara.

Ndërtesa në formë Patkoi e supozuar si Eklesiasterion *nuk mund të jetë i tillë*, por veçse një Bemë apo një Bouleuterion i para shekullit III p.e.s. duke na dhënë edhe shenjat për të kërkuar Bouleuterionin e shek. III p.e.s. – II e.s. në një vend tjetër.

Fontana monumentale mori formë të plotë arkitektonike dhe sqaroi edhe fragmente të pasqaruara nga studimet e mëparshme - sidomos edhe disa gabime të anastilozës së dikurshme.

Fontana, ndërtesa Patkua ashtu dhe Portiku ilustruan rëndësinë dhe domosdoshmërinë e kryerjes së një studimi paraprak tipologjik, në trajtimin arkitektonik të objekteve që na arrijnë të shkatërruar, apo me formë të ndryshuar nga koha.

1. BAZA TEORIKE

1.1 Rëndësia që ka studimi tipologjik për rikonstruktimin tredimensional si një fazë e domosdoshme e trajtimit teorik e arkitektonik të veprës - sidomos kur kemi të bëjmë me vepra të kthyera në gërmadha arkeologjike ose me vepra që duam ti rikonstruktojmë virtualisht. Për të kuptuar rregullat që duhen ndjekur në trajtimin e veprave arkitektonike trajtohen aspekte teorike të rekomandura nga teoricienët e restaurimit Brandi, Carbonara, që ndihmojnë për të kuptuar fazat studimore që duhen ndjekur gjatë një studimi tipologjik historik e arkitektonik të veprës arkitektonike. Ai prezanton edhe rekomandimet e ICOMOS e të Kartës Charleston mbi interpretimin e prezantimin e veprave të trashëgimisë kulturore. Duke përdorur këtë bazë teorike bëhet reflektim deduktiv për çështjet përkatëse të lidhura me rastin e Apollonisë e të ndërtimeve në të.

Duke dashur të bëjmë një dallim të qartë mes qëllimit të restaurimit të veprës arkeologjike dhe restaurimit si koncept u desh të studiohen teoritë kryesore të restaurimit dhe njëkohësisht kartat kryesore të restaurimit, ajo e Venezas dhe e Athinës, e më tej e Amsterdemit apo Charleston-it. Secila prej tyre i sqaron këto koncepte qartë, dhe bën diferencat në kuptimin e disallojtë të termit restaurim dhe të fushave të ndryshme në të cilat mund të përdorim termin restaurim.

Brandi, në teorinë e tij të restaurimit në 1963 përcakton qartë: [...] *Restaurim përbën një moment metodologjik në njohjen e veprës së artit: të formës së saj fizike e njëkohësisht edhe të karakteristikave estetike dhe historike që ajo mbart, me qëllim trashëgimin e saj në të ardhmen.*[...] Kuptojmë, kështu, që njohja është një aspekt i rëndësishëm i restaurimit dhe aspekti historik e shoqëron atë vazhdimisht. Kështu, një njohje e mirë, bëhet me një studim historik të mirë që duhet të bëhet bazë për çdo restaurim të mirë. [...] Sipas tij mësojmë se [...] *me restaurim kuptohet çdo ndërhyrje për të vendosur në efikasitet një produkt të aktivitetit njerëzor*[...] ¹ e ndër këto ai dallon dy kategoritë: vepra industriale dhe vepra arti. Studimi ynë merret me objekte që kategorizohen në vepra arti, ato që quajmë në mënyrë specifike *vepra arkitektonike*. Kështu ,ajo që Brandi kupton si *vendosje në efikasitet*, është për ne një qëllim për ti bërë këto vepra, të kuptueshme e të perceptueshme, duke tentuar të mund ta quajmë këtë një *efikasitet turistik*.

Në të vertetë restaurim nuk do të thotë vetëm ndërhyrja fizike në vepër, për të konsoliduar apo përmirësuar atë.

¹ (Brandi, 2000)

Ai na mëson se [...] *restaurimi e konservimi, para se të jetë një proces teknik mbi objektin dhe materialet e tij, duhet të jetë një vlerësim kritik që duhet të identifikojë karakteristikat e tij; të përcaktojë e nxjerrë në pah vlerat specifike që e dallojnë, duke ndihmuar kështu që të përcaktohet objektivi dhe drejtimi që do të ndiqet në restaurim*[...]. Kështu, një studim i hollësishëm i objekteve të reduktuar në gërmadha arkitektonike do të na ndihmojë për të udhëhequr procesin e restaurimit e të konservimit të tyre.

Në „botën“ e madhe të restaurimit të ditëve të sotme, vlerë të pazëvendësueshme teoriko-ligjore do të kenë Kartat e Restaurimit, ndër të cilat më thelbësoret janë: Karta e Athinës dhe ajo e Venecias.

Karta e Athinës në 1931, si dokumenti i parë ndërkombëtar që do merret me pasuritë artistike e arkitektonike do të hedhë bazën ligjore për ruajtjen e monumenteve. Pavarësisht se tepër e varfër në terma e nocione, ajo do ti kushtojë vëmendje më tepër emergjencës për të vepruar, në kohën kur po gërmohej masivisht në vende arkeologjike, e kur objektet bëheshin shpesh pré e dëmtimeve dhe grabitjeve. Brenda saj kuptojmë se, për herë të parë, do ti jepet rëndësi aspektit historik të monumentit: [...] *Kur duhet të ndërhyet për të restauruar e konsoliduar veprën, rekomandohet të respektohet forma historike që ka patur*[...], na mëson Karta e Athinës, një formë historike që, shpesh, nuk e gjejmë pasi koha e ka shkatërruar, e për ta njohur e vlerësuar mund ti referohemi edhe shembujve të ngjashëm të periudhave kronologjikisht të njëjta apo të vendeve më status politik e social të njëjtë. Kjo vërejtje vinte pasi prej vitesh ishin ndërmarrë procese rindërtimesh integrale të objekteve të vjetër, të bërë me dëshirën për ta kthyer veprën siç ka qenë, por shpesh të nxituara e të pathelluara, po ndryshonin apo fallsifikonin historinë. [...] *së fundi po vërehet braktisja e idesë së rikonstruksionit integral e po i kushtohet vëmendje vendosjes në mbrojtje të objektit, me përmirësime e mirëmbajtje të shpeshta, për të siguruar ruajtjen e tij* [...]

Në procesin e njohjes dhe vlerësimit duhet, rekomandon ajo [...] *që arkeologu e arkitekti të bashkëpunojnë në procesin e gërmimeve por edhe të restaurimit* [...]

Në 1964, mëse 30 vjet pas Kartës së Athinës, do të aprovohet karta e Venecias, dokument që do të përcaktojë e përkufizojë nocione të qarta të lidhura me trashëgiminë kulturore. Ndër to: [...] *restaurimi duhet të ndalojë aty ku fillon hipoteza; çdo punë kompletuese mund të bëhet vetëm për arsye teorike apo estetike, por duhet të ruajë gjurmën e kohës sonë* . *Restaurimi duhet të shoqërohet gjithmonë nga studimi arkeologjik e arkitektonik i monumentit*[...] Kuptojmë kështu se ajo çfarë arrihet prej studimit do të duhet të mbetet në kuadrin e një gjetjeje e hulumtimi tipilogjik pa u tentuar të përdoret në riformulimin e veprës arkitektonike si ajo ka qenë.

Nga Cesare Brandi mësojmë se studimi i veprës duhet bërë edhe në aspektin e përgjithshëm hapësinor. Ai e përcakton atë si “*hapësirën e brendshme* “ të veprës së artit,

duke pasur parasysh vendin ku ajo ngrihet [...] *Hapësira arkitektonike nuk përbëhet vetëm prej mureve të ndërtesës që po shqyrtohet, por ajo përfshin edhe vëndin që zë kjo vepër në lidhje me ndërtimet e tjera të ndodhura aty pranë* [...] Duke u nisur prej kësaj kuptojmë se veprat e Apollonisë duhen studiuar në brendësi të Agorasë dhe shesheve publikë duke i parë si pjesë integrale të kompozimeve urbane të këtyre shesheve, si dhe të normave kompozicionale që mund të jenë përdorur për to.

Një tjetër kartë e rëndësishme për fushën e restaurimit do të jetë Karta Charleston, e cila përcakton disa koncepte të lidhura me interpretimin, prezantimin, publikimin paraqitjen e veprave - monumente të trashëgimisë kulturore që, sipas saj, janë të rëndësishme për propagandimin e tyre. Sipas saj:

Interpretimi nënkupton, ose tregon, tërësinë e aktivitetit, reflektimit, hulumtimet dhe kreativitetin që bëhet mbi një vend arkeologjik.

Prezantimi nënkupton një sistemim të planifikuar me kujdes të të dhënave dhe qasjen fizike në një vend që përmban trashëgimi kulturore dhe që bëhet, zakonisht, nga studiuesit, ndërmarrjet e projektimit dhe profesionistët e trashëgimisë kulturore.

Përfshirja e të gjithë vizitorëve, grupeve të komunitetit dhe aktorëve të tjerë me mosha dhe prejardhje të ndryshme kulturore, bëhet i rëndësishëm për interpretimin dhe transformimin e objekteve të trashëgimisë kulturore: nga monumente statike në vende dhe burime të informacionit mbi të kaluarën, si dhe në burime që vendasit mund ti përdorin për zhvillim të qëndrueshëm dhe për vendosje të një dialogu ndërkultural mes brezave. Ky do të ishte rasti ideal për çdo vend arkeologjik në Shqipëri, veçanërisht për qytete antike si Apollonia, Butrinti apo Bylis që ruajnë shumë prej formave urbane të epokës kur jetuan. Duke reflektuar mbi mbetjet arkeologjike, duke hulumtuar në bazë të një studimi tipologjik mbi format që mund të kenë patur e duke krijuar hipotetikusht ato, mund të kontribuojmë në informacionin mbi to, në njohjen e tyre, në evidentimin e vlerave që mbartnin e për pasojë në ruajtjen e tyre.

Në Kartën Charleston prezantohen Principet e interpretimit të trashëgimisë kulturore të cilat janë përgatitur nga ICOMOS² me qëllim që: **të ndihmojë në kuptimin dhe vlerësimin** e pikave të trashëgimisë kulturore si edhe të përforcojë vetëdijen e publikut mbi nevojën e ruajtjes së tyre. **Përçojë kuptimin** e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet njohjes së kujdesshme dhe të dokumentuar të vlerës së posaçme që ato kanë, duke përfshirë vlerat e prekshme e të pa-prekshme, mjedisin natyror, kulturor, situatën shoqërore dhe gjendjen fizike.³

² ICOMOS, Internacional Council On Monuments and Sites - organizatë botërore që merret me monumentet e kulturës

³ (US/ICOMOS, Maj 2005),

Ky interpretim grafik, kthehet kështu, në një nga mënyrat me të cilat vlerësohet e ruhet trashëgimia kulturore. Nëse do të fillojmë të studiojmë se cila ka qenë periudha kur është filluar të përdoret një interpretim i tillë grafik në studimet arkitektonike, koha do të na çojë në fund të shek. XVIII , kur lëvizja për nxitjen e zbulimeve kishte nevojë për ngritje institucionsh e krijim të mbështetjeve të ndryshme që do të mundësonin përcjellje më të mirë të njohurive arkitektonike dhe arkeologjike tek populli i thjeshtë. Kjo ishte, gjithashtu, koha e përpjekjeve të para të mëdha të masivizimit të kulturës dhe historisë nëpërmjet romaneve historikë dhe arkeologjikë me tituj të suksesshëm si “*Notre Dame de Paris*”.

Për sa i takon përhapjes dhe mjeteve të publikimit të trashëgimisë, mund të veçojmë suksesin që pati libri “*Fjalor i Arkitekturës*” i Viollet-le-Duc, i cili që ndër të parët që riprodhonte në bazë të studimeve historike edhe vepra të shkatërruara arkitektonike. Trajtimi i figurave prej tij, ishte një kontribut i rëndësishëm në njohjen e veprës arkitektonike. Ilustrimet e fjalorit u bënë me skica arkitektonike - tipike të studimeve arkitektonike dhe arkeologjike, pamje gjeometrike vetëm të një pjese të monumentit, krejt i shkëputur prej ambientit rrethues, me ndriçim ballor, plane të përgjithshme e detaje teknike, me një figuracion shprehës që pasurohej si në një skenografi me personazhe e detaje të materialeve.

Gabellone⁴, shkruan: [...]Pa asnjë dyshim, duke parë forcën komunikuese dhe sa të vërteta duken ato pamje të krijuara, deduktojmë se përpjekja që duhet për të paraqitur zgjidhje të tilla rikonstruktive është ndoshta, më e ndezur se kurrë. Renderimi përfaqëson realitetin si kurrë më parë dhe kjo është, në të vërtetë, pika e dobët e tij. Ajo që paraqitet është e besueshme deri në njëfarë mase, dhe mund të merret si i saktë rikonstruksioni i strukturës, por mund të mos jetë e saktë zgjidhja që jepet për parmakët ose për veshjen zburuese. Për çdo propozim rikonstruksioni do të ishte e nevojshme të vendosej në krah një ‘model korrespondues’, një grafikë që mat nivelin në përqindje të besueshmërisë së një rikonstruksioni. Kjo do ta bënte më të ndershme paraqitjen e tij, do të ndihmonte në shmangien e keqkuptimeve dhe, mbi të gjitha, do t’i lejonte studiuesve të tjerë të thelloheshin në studimin e atyre elementeve që janë pak të qartë[...] Kuptojmë kështu që, çdo tendencë për të bërë rikonstruksione virtuale apo grafike duhet të ruajë referimin ndaj reales e duhet të ballafaqohet vazhdimisht me të që të mund të lërë të dukshëm kufirin mes faktit dhe hipotezës. Në rrugën tonë studimore, aty ku tentohet të propozohet, do gjenden gjithmonë referimet me objektin arkeologjik për të mos u shkëputur kështu nga realiteti e duke mos rënë në grackën e “dhënies krahë” të fantazisë.

⁴ (Gabellone, Il santuario di Giove Anxur a Terracina: Una ricostruzione tipologica come ausilio alla visita in situ, 2013, 4(9)), f. 109

[...]Për keto arsye, në mungesë të të dhënave të qarta dhe të plota arkeologjike mbi pamjen origjinale të ndërtesave, vendoset që të përshtaten materiale veshës mjaft të zakonshëm, gjerësisht të përdorur në epokën e ndërtimit dhe zgjidhje rikonstruktive që rrjedhin nga një trajtim që mund ta përcaktojmë si “llogjik dhe anallogjik” së bashku. Ky reflektim që lind nga rregulla kompozicionale, të huaja për procesin rikonstruktiv dhe më të afërta me procesin krijues të projektimit dhe të ndërtimit nga e para. Në mendimin e Aldo Rossi-t koncepti i anallogjisë lidhet me tipologjinë dhe bëhet një mënyrë njohjeje dhe ndërtimi të realitetit urban. Anallogji, domethënë i ndërtuar mbi ngjashmërinë[...]⁵

Prej kësaj del rëndësia e një studimi arkitektonik e tipologjik që duhet të paraprijë çdo proces studimor me qëllim që çfarë rindërtojmë qoftë virtualisht e qoftë në anastilozë të jetë sa më afër reales.

Në hulumtimin e mëtejshëm në lidhje me këtë subjekt, ndjekim studimet e Gabellone⁶ që na mëson se në ditët e sotme, paraqitja duhet të jetë medoemos realiste dhe të përfshijë emocionalisht spektatorin, duke përdorur të njëjtat teknika me kinematografinë moderne. Duke krijuar një realitet virtual krijojmë një mundësi të mirë për studim por, mbi të gjitha, mundësojmë për publikun një mënyrë revolucionare për të kuptuar.

Në përpjekjet për të rindërtuar në formë një objekt “duhet të kemi gjithmonë një apo disa objekte reference” për të gjetur kështu anallogjitë në planimetri, morfologji ose tekniken dhe materialet e ndërtimit. Zakonisht, kjo ngjashmëri apo anallogji, gjendet në objekte bashkëkohës të së njëjtës periudhe kohore e me të njëjtin funksion.⁷ Objekte me të njëjtin funksion dhe formë arkitektonike përbëjnë një tip ndërtimor kështu del e domosdoshme që, për të arritur të krijojmë idenë e objektit tonë, duhet të mbështetemi në analizën e tipeve të ngjashëm, pra në analizën tipologjike. Për planimetri na shërbejnë gërmimet arkeologjike që japin gjurmë që, edhe pse të pakta, shpesh na trasojnë formën që objekti ka patur. Në rastin kur objekti ka vetëm themelet vështirësohet përcaktimi i saktë planimetrik i cili bëhet duke kërkuar anallogji tipologjike.

Për formën arkitektonike të ndërtesave shërbejnë fragmentet arkeologjike të zbuluara të cilët, duke qenë shpesh të pakët, duhen rikonstruktuar në përmasën e saktë që kanë patur vetëm në bazë të proporcioneve antike të objekteve të ngjashëm të trajtuar nga Vitruvi. Në Librin IV - Vitruvi na thotë se mund të gjejmë përmasën e kollonës nga përmasa e antablementit apo edhe nga një seri elementesh që përbëjnë orderin.

Në lidhje me metodologjinë e analizës historike e tipologjike të veprës arkitektonike, nga d'Ossat⁸ mësojmë fazat në të cilat duhet të kalojë një studim i një vepre arkitektonike:

⁵ Idem, f. 112

⁶ (Gabellone, The reconstructive study in archeology: case histories in the communication issues, 2011,1(1)), f. 62

⁷ (Brandi, 2000)

⁸ (d'Ossat, 1972), f. 25-30

A – Përgatitja dhe përdorimi i bibliografisë mbi çështjen në shqyrtim. Bibliografia, mundësisht sa më e plotë, përmbledh kontributet e shkruara ekzistuese. Çdo shkrim duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e autorit, titullin e shkrimit, vendin dhe kohën e botimit. Bibliografia vendoset sipas rendit kronologjik, ose sipas rendit alfabetik të emrave të autorëve.

B - Përgatitja, për çdo objekt, i një skede bibliografike për të lehtësuar ruajtjen, lëvizjen dhe konsultimin e tyre.

C - Vrojtimi i drejtpërdrejtë i veprës dhe i rievimeve të saj. Ky vrojtım i drejtpërdrejtë duhet të jetë i kujdesshëm dhe zbërthyes në të gjithë detajet e veprës duke përbërë kështu pjesën më të rëndësishme e të domosdoshme të kërkimit. Ai shtrihet në të gjitha pjesët e ndërtimit, por edhe në ato pjesë që nuk vihen re zakonisht me shikim të parë.

D – Krijimi i një kuadri përmbledhës i të dhënave “objektive” e “filologjike”. Duke pasur nën kontroll të dhënat e marra dhe, duke treguar qartë e saktë burimin e tyre, mund të përgatitet një kuadër i përgjithshëm i fakteve objektive në lidhje me veprën nën shqyrtim. Është e nevojshme që, me objektivitetin maksimal, të vihen në dukje faktet e paqarta, të dhënat kundërthënëse, çështjet e pazgjidhura, mangësitë e dokumentacionit, etj.

Në vazhdim të referimit të të dhënave të gjetura ngushtësisht tek objekti konkret, është rasti të nxirren në pah, nëpërmjet hartimit të grafikave, fazat e ndryshme të ndërtimit të veprës. Në disa raste mund të përgatiten hipoteza të kompletimit grafik të pjesëve të shkatërruara, ose të transformuara, ose të “rikthyer”, ose rikonstrukcione të vizatuara të veprës me formën e saj origjinale dhe në periudha të ndryshme.

E – Krahasimi i veprës, ose pjesëve të saj, me vepra të tjera është një mjet thelbësor njohjeje. Një ballafaqim i tillë mund të shtrihet në veprat para-rendëse ose të njëkohëshme, nga i njëjti vend, nga i njëjti “autor”, ose edhe për kohë dhe vende të largëta, me kushtin e pranuar, që këto vepra krahasuese të mund të njiheshin, në një farë mënyre, në kohën dhe në vendin ku u projektua dhe ndërtua vepra në shqyrtim. Këto ballafaqime duhet të synojnë gjetjen e ngjashmërive dhe të zbulojnë shtysat e mundshme që i janë dhënë arkitektit ose porositësit, por mbi të gjitha, dallimet që veçojnë veprën në shqyrtim prej çdo tjetre, megjithëse në dukje të ngjashme.

G – Shqyrtimi përshkrimor dhe kritika e veprës. Pozitat e ndryshme kritike janë, dukshëm, të ndryshueshme në kohë dhe janë objekt i sqarimit dhe studimit në “Historia e kritikës”. Sidoqoftë, kjo pjesë e studimit priret të gjejë veçoritë më të spikatura të veprës në shqyrtim, ta kuptojë atë, ta shpjegojë dhe përshkruajë duke e sqaruar historikisht dhe, në fund, duke nënkuptuar apo thënë qartë, të japë një gjykim kritik të vetëdijshëm.

Shqyrtimi kritik i këtyre pikave duhet të paraprijë metodologjinë e kërkimit dhe vrojtimit të veprës duke patur parasysh që të mos i veçojmë nga njëra-tjetra por ti përfshijmë në

tërësi. Mbi të gjitha, është themelore që, në çdo rast, të pyesim vehten dhe të përpiqemi të shpjegojmë me ndihmën e të dhënave të njohura, pse-të e çdo vendimi dhe të çdo zgjidhjeje, të investitorit, të projektuesit, të zbatuesve, etj, që gjejmë në vepër. Çdo zgjidhje, qoftë edhe e veçantë, përmban në vetvehte një zgjedhje, ka një arsye e, pse jo, edhe një histori të sajën.

1. 2. Teoritë kryesore urbane e kompozicionale të qyteteve dhe studimi i sistemeve urbane në periudhën e antikitetit, u studiuuan për të kuptuar se si këto qytete u organizuan. U trajtuan parime të planifikimit të qyteteve që në fazat e para të krijimit të tyre në shek. VII-VI p.e.s., më tej në kohën e përhapjes së rregullave të sistemit Hipodamik në shek. V p.e.s. deri shek. III p.e.s. duke u bazuar në autorë klasikë të kësaj fushe si Grecco, Martin, Wycherley, Vitruvi për qytetet e Greqisë e të Magnia Grecia, apo në autorë si Cabannes, Ceka, Follain, Baçe, për qytetet Shqiptare e veçanërisht për Apolloninë. U munduam të kuptojmë si përcaktohen drejtimitet e rrugëve në një qytet, nga se influencohen ato, si përcaktohen sheshet kryesore e funksionet e tyre që prej fillimeve deri në periudhën helenistike, cilët janë objektet më të rëndësishëm që fillimisht u ndërtuan e cilat do të ishin ato të periudhës helenistike, çfarë relacioni kanë ato me njëri-tjetrin e cilat janë zonat ku do të preferohen të ndërtohen, etj. Përgjigjet ndaj gjithë këtyre enigmave ndihmuam edhe për të lokalizuar se cilët do të jenë objektet e rëndësishëm në qytet e për të seleksionuar se cilët prej tyre do të bëheshin objekte të një studimi të thelluar në vazhdim.

Nga Wycherley⁹ mësojmë shumë mbi mënyrat se si grekët projektonin qytetet. Në shekujt VI dhe V p.e.s., kur qytetërimi Helen ishte mjaft i përparuar dhe rritja arkitektonike e Qytetit – Shtet kishte përfunduar, grekët vazhdonin të krijonin pandërprerje qytete të rinj - Koloni, Kryeqytete për Shtetet federative ose Lidhjet politike, si dhe qytete të rinj që zëvendësonin ata që ishin shkatërruar me themel prej persianëve ose të tjerëve. Nga shekulli V, nevojat praktike kishin parashtruar mënyrat e planifikimit të qytetit dhe, ndërkohë, arkitektët kishin pasur vizionet e tyre mbi formën ideale për Polis-in dhe po përpiqeshin ti vinin ato në jetë, megjithëse teoria estetike nuk u lejua kurrë të mbisundojë ndaj kërkesave funksionale.

[...]Arkitektët Ionianë arritën që, në mënyrë të pavarur, të përpunojnë një sistem që do të ishte në gjendje të kënaqte nevojat praktike si dhe idetë e tyre se si duhet të ishte një qytet. Parimi bazë ishte i thjeshtë, i kuptueshëm dhe praktik – në fakt ishte ndër planet më të thjeshta – i ashtuquajtur 'gridiron' ose 'tabelë shahu', me rrugë të drejta që kryqëzoheshin në kënde të drejta. Kjo metodë kishte sjellë më pak ngatërresa në ndarjen e tokës për kolonët në çastin kur përballeshin më problemin e ndarjes së tokës me sa më pak vështirësi dhe me sa më shumë leverdi. Krijimtaria më e madhe u tregua në

⁹ (Wycherley, 1962)

përshtatjen e qytetit grek, me gjithë pjesët e vjetra origjinale të tij, në këtë skemë të ngurtë dhe në përfitimin nga rasti për mundësinë arkitektonike që u paraqit gjatë procesit të përshtatjes[...] Hippodami - personaliteti më i famshëm grek në planifikimin urban ishte nga Mileti. Hippodami planifikoi Pireun për Athinotët në mesin e shekullit V p.e.s. dhe, me shumë mundësi, është ai që ka zhvilluar idetë mbi qytetin dhe i bëri ato të njohura botërisht.

Mileti u shkatërrua plotësisht prej persëve, njësoj si Athina, por, në ndryshim nga athinotët që e rindërtuan qytetin pak nga pak në formën e mëparshme duke shtuar disa tempuj të rinj, banorët e Miletit, të kthyer në qytetin e rrënuar, planifikuan një qytet të ri dhe modern pranë të vjetrit. Plani i ri kishte rrjetën kënd-drejtë të rrugëve dhe një zonë të gjerë në qendër krahasimisht e ulët në lartësi dhe të sheshtë që e ruajtën që në fillim për të ndërtuar Agoranë. Planifikuesit u treguan krijues në përshtatjen e teatrit, gjimnazit, stadiumit dhe ndërtesave të tilla në planin e qytetit.

[...]Sistemi me 'gridiron' është përdorur edhe në terren kodrinor, për të cilin një planifikues urban i kohëve të sotme do të ishte kundra, por kjo nuk do të thotë se leverdia praktike është sakrifikuar në mënyrë të verbër për hir të teorisë[...] ¹⁰ Për ta mjaftonte që të kishte sa duhej rrugë në nivel horizontal për trafikun e kufizuar të qytetit grek kurse, të tjerat, mund të ishin edhe thjesht shkallare.

Në Olynthus të Chalcidike në veri të Egjeut, pjesa më e vjetër e qytetit, që ndodhet në një kodër jugore, kishte formë të parregullt, por në fund të shekullit V p.e.s., kodra veriore, e cila ishte më e sheshtë dhe më ulët, u nda në forma të rregullta kënd-drejta me një numër rrugësh kryesore, që përshkonin në drejtimin veri-jug, dhe rrugë që kryqëzohen dhe që kanë rrugica paralele mes blloqeve.

Kur marrim në shqyrtim parimet bazë të planifikimit urban të polisit grek, shohim se ato janë të pakta dhe të thjeshta. [...] *Planifikimi i qytetit grek ishte krejt e kundërta e akademisë dhe, për aq sa dimë, nuk kishte ndonjë bazë të njohur teorike. Plato, te 'Ligjet' dhe Aristoteli te 'Politika' në përshkrimin e formës më të përshtatshme të qytetit e kufizojnë vehten në rekomandimet më të përgjithshme. 'Vështirësia me gjëra të tilla nuk është aq shumë në çështjet teorike por në ato praktike' thotë Aristoteli; çdo arkitekt ose planifikues duhet të përdorë zgjuarësinë e tij kur ndeshet me problemet e çdo vendi të veçantë'. Planifikimi i kujdesshëm pranohej si një gjë e mirë dhe vlerë për një qytet qysh në shekullin IV p.e.s.; gjëndja e rrëmujës në rrugët e Athinës dënohej nga disa shkrimtarë[...] ¹¹*

¹⁰ (Martin, L'urbanisme dans la Grèce antique, 1956)

¹¹ (Wycherley, 1962)

Grecco¹² na mëson: [...]Eksperimentimet e para në sisteme të rregullta dhe linja përpjendikulare, Grekët do ti bëjnë në kolonitë - qytete, të cilat, (sidomos ato të Magnia Grecia-s) shpesh u vendosën në toka aluvionale e lagunore të cilat, para se ti kultivonin, ju desh ti bonifikonin me kanale kulluese. Qytetet e ngarkuar me objekte, ndërtime e histori nuk do të jenë vendi i përshtatshëm për të aplikuar sisteme të rregullt urbanë, ndërkohë që, shpesh, kolonitë që krijonin një shkëputje gati totale nga qytetet mëmë do të mund të planifikoheshin me sisteme rrugorë e forma të gjeometrizuara që do ti ngjanin atyre të kanaleve bonifikues[...] Kështu, sistemi i rregullt rrugor do të njohë lindjen në kolonitë e shek. VI p.e.s.. Sipas Grecco-s, Selinute dhe, pak vite më pas, Metaponto ishin Poliset që aplikuan që në shek. VI sisteme rrugësh përpjendikulare gati dy gjenerata pas ardhjes së kolonëve të parë (rreth 50 vite më pas)

Duke i krahasuar kronologjikisht ato me Apolloninë, në të cilën kolonët e parë kishin ardhur në fillim të shek VI p.e.s., deduktojmë dhe llogarisim që gati 50 vjet më vonë, pra në mes shekullin VI duhet të jetë trasuar sistemi rrugor blu, i rregullt por që nuk ka lidhje me parimet hipodamike. Greco na përmend se aq i rëndësishëm ishte sistemimi i këtyre qyteteve në sisteme të rregullt gjeometrikë, saqë kur u rindërtua tempulli i Herës në Metaponto, u rrotullua me pak gradë në lidhje me të vjetrin vetëm e vetëm që të përputhej me sistemin rrugor. [...]Në këtë homogjenitet të ndërtimeve publike me ato të shenjta, do të kërkohej simbolika e Zotit që drejtonte orientimin e qytetit[...] Duke parë të dhënat arkeologjike për sistemin blu, i cili u ndërtua si i pari sistem i qytetit të parë, do të dallojmë se drejtimi i rrugëve të tij respekton drejtimin e tempullit në kodër, duke u orientuar saktësisht veri-jug, lindje-perëndim. Ndërkohë që sistemi i mëvonshëm i kuq do të trasohet sipas sistemit Hipodamik e do të rrotullohet gati 45° në lidhje me sistemin e parë blu.

Rrugët, përveçse ishin të drejta dhe paralele, nuk ndryshonin shumë nga ç'kishin qenë gjithmonë. Në përgjithësi ato tentonin të ishin pak më të gjera se në qytetet e stilit të vjetër por ende nuk mund ti quajmë 'të gjera'. Gjerësia e tyre ishte nga 3.5 m. deri 5.5 m. me pak përjashtime për rrugët kryesore që mund të ishin pak më të gjera, por ka thënie edhe për rrugë të veçanta me gjerësi 2 apo 3 herë më të gjera se kaq. Për aq sa faktet na mbështesin, nuk duket të ketë pasur ndonjë prirje për planifikim me hapsira të mëdha rrugore ose për një trajtim arkitektonik të kërkuar estetikisht të tyre. Rrugët e gjata me kollonada dhe pamjet e bukura mbi horizont nuk shfaqen deri në periudhën Helenistike dhe atë Romake.

Kryqëzimi i dy rrugëve kryesore thuhet asnjëherë nuk bëhet themeli për planin e qytetit grek. Sipas Martin¹³, rrugët kryesore planifikoheshin duke u nisur nga kërkesat praktike të

¹² (Greco, 1999), f. 86

¹³ (Martin, L'urbanisme dans la Grèce antique, 1956)

jetës qytetare, si-për-shembull për të përballuar trafikun që krjohej rrotull tregut ose në qendrën administrative dhe qeveritare.

Agoraja mbeti nyja kryesore e të gjithë strukturës duke i dhënë asaj vendin e duhur si qendra e madhe e jetës qytetare. Do të jetë përsëri Martin¹⁴ që, duke folur për Agoranë-qendrën e qytetit na mëson [...] *Një numër blloqesh kuadratikë në mes të qytetit ruheshin të pa-ndërtuar për ti lënë vend Agorasë dhe trajtimi arkitektonik i saj, në periudhën mes shekullit IV dhe asaj Helenistike, ishte rrjedhoja më interesante e planifikimit me sistemin Hipodamik. Faltoret shpërndahen gjithandej nëpër qytet por tashmë sistemohen pa vështirësi në një apo dy blloqe, kurse lagjet me banesa mbushnin pjesët e mbetura. Akropoli ishte bërë i parëndësishëm në qytetet e vjetra dhe mund të shmangej krejt në qytetin e ri me përjashtim kur një lartësi mund të përfshihej brenda mureve mbrojtës të qytetit. Planifikimi i zgjerimit të qytetit në të ardhmen e largët bënte pjesë në planin urbanistik të tij. Në periudhën Helenistike, gjatë sundimit të Aleksandrit të Madh dhe të pasuesve të tij, në Azi u ndërtuan në mënyrë masive qytete të rinj. Plani me formë si tabelë shahu ishte i zakonshëm dhe shihej njëlloj njëtrajtshmërie dhe standardizimi në çështje të tilla si proporcionet e blloqeve, gjë që ishte e panjohur në kohët e mëparshme [...]*

Nga Vitruvi për qytetin dhe drejtimin e rrugëve mësojmë se drejtimi i rrugëve përcaktohej sipas orientimit ndaj erës.

*Pas fortifikimit të qytetit, hapi tjetër është ndarja e parcelave për ndërtimin e shtëpive brenda mureve dhe shtrimi i rrugëve dhe rrugicave duke pasur parasysh kushtet klimatike. Ato do të caktohen drejt nëse është kryer një parashikim i mirë për shmangien e erërave prej rrugëve. Era e ftohtë është e pakëndshme, era e nxehtë nervozuese, era e lagësht e pashëndetëshme. Ne duhet, kështu, të shmangim gabimet në këtë çështje dhe të jemi të vetëdijshëm për përvojën e mëparshme të shumë bashkësive. Për shembull, Mytilene në ishullin e Lesbos është njëqytet i ndërtuar me madhështi dhe shije të mirë, por vend-ndodhja e tij dëshmon për një mungesë parashikimi. Në atë bashkësi, kur era vjen nga jugu, populli sëmuret; kur vjen nga veriperëndimi i bën të kolliten; me një erë nga veriu ata e marrin vehten e ngrihen në këmbë por s'mund të qëndrojnë në rrugë e rrugica prej erës tepër të ftohtë.*¹⁵

Së fundi, ajo që do të përmbledhë këto dy aspekte teorikë të studimit tonë, është bazuar edhe në konceptin relativisht të ri të “Arkeologjisë urbane”. Që prej viteve ’70, Biddle fut këtë koncept të ri në arkeologji duke na mësuar se arkeologjia urbane ka si pikë interesi qytetin në vetvehte, fenomenet urbane, si dhe më tepër sesa një periudhë urbane në histori. Kështu ajo ka për qëllim të na ndihmojë të njohim zhvillimin urban përgjatë

¹⁴ (Martin, recherches sur l'agorà grecque, 1951)

¹⁵ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910), f.132

shekujve (krijimi, rritja, rënia apo transformimi i tij) si një arkeologji e qytetit. Informacionet për hapësirat urbane dhe fazat e zhvillimit të qytetit vihen në dukje sipas rendit arkeologjik dhe integrohen me burimet e shkruara dhe të dhënat arkeologjike¹⁶. Gjithashtu, duke përdorur planet rikonstruktive sipas fazave historike, bëhet e qartë dhe e matshme historia e tij. Qëllimi është që të mos studiohet vetëm një fazë e zhvillimit të tij, por të njihen edhe fazat e tjera që duhet të kenë luajtur rol, me ndërtimet e tyre, në krijimin e morfologjive arkitektonike të mëvonshme.

Nisemi prej këtej për të kuptuar se qëllimi ynë do të jetë jo vetëm një fazë e zhvillimit të agorave në Apolloni, por disa, që nga momenti i krijimit të të parit shesh e deri në momentin që qyteti do të braktiset.

Works Cited

- Boato, A. (2008). *L'archeologia in architettura. Misurazioni, stratigrafie, datazioni, restauro*. Venezia: Marsiglio Editori.
- Brandi, C. (2000). *Il restauro, teoria e pratica*. Torino: Einaudi.
- d'Ossat, G. d. (1972). *Guida allo studio metodico dei monumenti e delle loro cause di deterioramento*. Roma: 25-30.
- Gabellone, F. (2011,1(1)). The reconstructive study in archeology: case histories in the communication issues. *SCIRES-IT: SCientific RESearch and Information Technology*, 53-78.
- Gabellone, F. (2013, 4(9)). Il santuario di Giove Anxur a Terracina: Una ricostruzione tipologica come ausilio alla visita in situ. *Virtual Archaeology Review*, 108-115.
- Greco, E. (1999). *La città greca antica: istituzioni, società e forme urbane*. Roma: Donzelli Editore.
- Manacorda, D. (2008). *Lezioni di Archeologia*. Laterza.
- Manacorda, D. (2010). Informatica sì, ma con metodo. *Archeo* 309, 82-85.
- Martin, R. (1951). *recherches sur l'agorà grecque*. Paris.
- Martin, R. (1956). *L'urbanisme dans la Grèce antique*. Paris.
- Martin, R. (1983). L'espace civique, religieux et profane dans les cités grecques de l'archaïsme à l'époque hellénistique. *Architecture et société*, fv. 9-41. Gjetur 4 2013, nga http://www.persee.fr/web/ouvrages/home/prescript/article/efr_0000-0000_1983_act_66_1_3195

¹⁶ (Manacorda, Lezioni di Archeologia, 2008)

US/ICOMOS. (Maj 2005). Charleston declaration on heritage interpretation. *8th International Symposium of US/ICOMOS, "HERITAGE INTERPRETATION"*. Charleston, South Karolina, USA.

Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky. (1859-1910). *10 books of architecture*. Cambridge: Harward University Press.

Wycherley, R. E. (1962). *How the Greeks Built Cities*. New York: Norton & Company.

2. TRAJTIMI I ARKITEKTONIK I AGORAVE

Iliria e mijëvjeçarit të parë p.e.s. shtrihej në territore të gjera të zonës së Dalmacisë e Shqipërisë së sotme. Vendbanime prehistorike të epokës së bronzit e të hekurit dëshmojnë nga zbulime arkeologjike të hershme në nekropole apo ndërtime primitive.

Qytetet e parë të tipit protourban, siç i quan Ceka¹, do të jenë në formë akropolesh, ose kështjella të tipit Gajtan², që rrethoheshin nga mure me gurë në forma të çrregullta e do të kishin sipërfaqe të vogla në 3 - 4 Ha.

Qytete të mirëfilltë, si një formë politike e qartë, do të formohen në shek. VI - IV p.e.s. në zonën e Kaonisë dhe në luginën e Aoos³. Të parët do të jenë Epidamnus, Buthrotos, Apollonia, Foinike, Amantia e Nikaja.

Disa do të jenë qytete të formuar nga kolonistët grekë - Apollonia e Epidamnus - e të tjerë nga banorët lokalë.

Pas viteve 350 p.e.s. formohen Bylis, Lisos, Skodra, Antipatrea, Selca e poshtëme, Antigonea, dhe zgjerohen duke dalë jashtë mureve, Butrinti, Foinike e Amantia. Tanimë ato kanë sipërfaqe 30 - 40 Ha⁴.

Të gjithë do të njohin zhvillim të vrullshëm urban në shek. IV - III p.e.s. duke ndërtuar rrugë e banesa të projektuara, në disa raste, sipas sistemit Hipodamik, e duke ngritur ndërtesa monumentale me karakter publik apo kult. Duke ndodhur këto zhvillime të njëkohshëm me ato të qyteteve të rajonit jugor të Evropës, kryesisht në Greqi e Itali⁵, ato do të karakterizohen shpesh nga ndërtime me të njëjtat rregulla arkitektonike si ato.

Influenca e arkitekturës Greke e helenistike do të duket qartë në qytete dhe objekte të shekujve VI-II p.e.s., ndërsa më vonë, lidhur edhe me ndryshimin politik të 229 p.e.s. kur Iliria humbi luftën me Romën⁶, do të perceptohen karakteristika të arkitekturës Imperiale Romake.

¹ (Ceka, La civilisation proto-urbaine illyrienne, 1985) f.111-150

² Gajtan quhej një qytezë 5km në jug lindje të Shkodrës. Muri me blloqe të çrregullt kufizonte një sip. 4-5 ha në majë të kodrës, ndiqte trajektoren e izoipseve, hapej në pak porta dhe hapësira brenda saj kishte thjesht rolin e një sipërfaqeje të mbrojtur. Qyteza të tilla të fortifikuara numërohen rreth 25 në territoret e shqipërisë së sotme, por duhet theksuar se brenda tyre nuk janë gjetur gjurmë ndërtimesh të rëndësishme e mbetet për tu diskutuar nëse ato mund të kenë qenë vetëm vend strehimi i popullsisë së zonave fushore. Dyshimin për këtë na e hedh (Cabanes, 1/1986)

³ (Cabanes, 1/1986) f.107-142

⁴ Ibidem

⁵ Ibidem

⁶ (Pierres Cabanes, Myzafer Korkuti, Apollon Baçe, Neritan Ceka, 2008), f. 99




Figure 1. Harta e Ilirisë dhe Harta arkeologjike e Shqipërisë

2.1 Organizimi urban i qyteteve në Greqisë e lashtë

Sistemi i parë i rregullt urban që do të përdoret në këto qytete antike do të jetë ai Hipodamik: një sistem që planifikon një organizim të rregullt të qytetit të ndarë qartazi në zona publike e lagje banimi⁷.

Rrugët kryesore do të ishin më të gjera ndërkohë që, ato sekondaret, më të ngushta. Nga Greco⁸ mësojmë se për Hipodamin duhet të kishte rëndësi edhe orientimi i këtyre rrugëve duke vendosur kryesoret, më të gjërat, lindje-perëndim, që dielli të mund të depërtojë e ngrohë shtëpitë, ndërkohë që më të ngushtat, sekondaret do të ishin veri-jug. Për Vitruvin, ndarja e parcelave për ndërtimin e shtëpive brenda mureve trasimi i rrugëve dhe rrugicave duhet të bëhet duke patur parasysh kushtet klimatike. Ato do të caktohen drejt nëse është kryer një parashikim i mirë për shmangien e erërave prej rrugëve. Era e ftohtë është e pakëndshme, era e nxehtë nervozuese, era e lagësht e pashëndetëshme⁹.

Sipas këtij sistemi rrugët do të trasoheshin përpjendikular me njëra-tjetrën në një rrjet ortogonal e do të kategorizoheshin në kryesore (*plateiai*) e skondare (*stenopoi*) duke u vendosur sipas drejtimeve kryesore të horizontit¹⁰.

⁷ (Ward-Perkins, 1974)

⁸ (Greco, 1999))

⁹ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910)

¹⁰ Në gjuhën Greke "*plateia*" është mbiemër që vendoset para fjalës "*odos*" dhe përdoret për të treguar një rrugë të gjërë, ndryshe nga "*stenopos*" që është një rrugë e ngushtë. Nga fjala "*plateia*" rrjedh



Figure 2. Pireu, zona e portit pranë Athinës, djathtas, Qyteti i Prienës projektohen me sistem Hipodamik

Hapësirat ortogonale si në një fushë shahu që do të formohen nga ky rrjet, *insulat*, do të kenë forma kuadratike apo drejtkëndore të zgjatura e do të bëhen qeliza formuese e vetë stofit urban të qytetit. Brenda tyre do të vendosen shtëpitë e banimit që, sipas madhësisë së insulave, mund të kenë 4-6 të tilla brenda çdo insule.

Ky sistem do të jetë i leverdisshëm për tu përdorur për mënyrën e shpejtë e të lehtë të komunikimit që siguron, për lëvizjen në qytet nga periferia në qendër apo anasjelltas, si dhe për lehtësinë e sistemeve të furnizimit e të shkarkimit me ujë të qytetit që mund të shfrytëzojë po të njëjtin rrjet të rregullt rrugor duke u vendosur poshtë tyre.

Interesante është të shohim se si është aplikuar sistemi Hipodamik që nga koha e krijimit për herë të parë si një sistem i rregullt urban prej Hipodamit, e të evidentojmë rastet kur ai u përdor në qytetet Greke dhe, paralelisht, edhe në qytetet Ilire.

Duhet theksuar se përdorimi më i hershëm i këtij sistemi njihet nëpërmjet planit urban të Pireut (portit të Athinës) në 451 p.e.s. e menjëherë pas tij në rikonstrukcionin e Miletit, në Azinë e vogël. Kuptohet që nuk mund të hipotezojmë për përdorim të këtij sistemi para vitve 470 p.e.s. (koha e fillimit të aktivitetit krijues të Hipodamit). Duke njohur periudhat e zhvillimit të sistemit Hipodamik për qytetet Greke që e aplikuan atë, do të mund të bëjmë një analizë krahasimore të sistemeve Hipodamike të qyteteve tona duke deduktuar se sa ato janë influencuar apo jo nga qytetet e tjerë jashtë Shqipërisë.

Objekt i studimit tonë janë qendrat e qyteteve që, në terminologjinë urbane të antikitetit Grek, i njohim si Agora¹¹.

“plateau” me të njëjtin kuptim në latinisht. Më vonë kjo fjalë do të transformohet gradualisht në *place*, *piazza*, *plaza*. (Maria Ananiadou-Tzimopoulou, Alexandra Yérolympos et Athina Vitopoulou, 14/2007),

¹¹ Fjala AGORA në greqishten moderne do të thotë vendi i pazarit, ndërkohë që në greqishten antike AGEREIN do të ishte vendi publik i ndodhur në qendër të qytetit, në të cilin mbledheshin qytetarët për të shkëmbyer opinionet e tyre në lidhje me çështje publike e private. (Maria Ananiadou-Tzimopoulou, Alexandra Yérolympos et Athina Vitopoulou, 14/2007)

Duke studiuar R. Martin¹² kuptojmë se ato do të shfaqen me morfologji të ndryshme në qytete të vjetër evolutivë, që formohen përgjatë shekujve si një konglomerat urban i tipit progresiv e pa sistem të studiuar urban, apo në qytete të krijuar rishtas si kolonitë, të cilat paramendohen me rregulla planifikuese të parapjektuara.




Figure 3. Majtas, qyteti i Miletit, Plan. 451 p.e.s. Djathtas Qyteti i Korinthit

Ndër Agoratë më të vjetra që njohim hyjnë ato të Korinthit dhe Athinës që sipas gjurmëve arkeologjike mund ti trasojmë që në shek. VII p.e.s. Pa dashur të evidentojmë të gjitha gjurmët arkeologjike e arkitektonike të tyre, ja vlen të theksojmë se në hapësirat publike të tyre, në shekujt VIII-VII p.e.s. shfaqen fillimisht ndërtimet e kultit dhe më pas, me fuqizimin politik shtohen edhe ndërtimet publike.¹³ Gjatë këtyre fazave do të zhvillohen paralelisht edhe lagjet e banimit dhe të punishteve dhe vetëm shek. VI do të sjellë zhvillim të vrullshëm që do të rimodelojë këto hapësira kultit e do të krijojë shpejt Agoratë duke ndërtuar rreth tyre objekte publike.

Edhe E. Greco¹⁴ na mëson se në qytetin arkaik hapësira e hapur e Agorasë do të jetë vendi kryesor themelues. Në periudhën arkaike ai do të jetë vendi i riteve religjioze dhe i gjykimit ndërkohë që, në periudhën klasike, do të transformohet në vendin e zhvillimeve politike, të takimeve e të shërbimeve.

¹² (Martin, L'espace civique, religieux et profane dans les cités grecques de l'archaïsme à l'époque hellénistique, 1983, fv. 9-41)

¹³ Jemi të interesuar për këtë qytet pasi kolonët e parë që do të formojnë Apolloninë do të nisen në vitin 588 p.e.s. nga ky qytet. Historikisht vërtetohet që ndërtimet e qendrës civike të qytetit Korinth, të filluara në mes të viteve 700 p.e.s. me Heroon-in (ndërtesa dedikuar heroit të qytetit), dhe do të evoluojnë shpejt deri në fund të shekullit të VII p.e.s. kur fillon formimi i Agorasë. Kështu është e drejtë të imagjinojmë që kolonët që u vendosën në Apolloni do të kishin parë paraprakisht ndërtimet e qendrës së qytetit të tyre e do të transmetonin eksperiencën vizuale e arkitektonike të tij.

¹⁴ (Greco, 1999)

Duhet pritur vetëm shek. V-IV p.e.s. për të parë qytete të projektuar me sistem urban të rregullt, e për të arritur në një përcaktim e kufizim të hapësirës publike nga portikë e kollonada që imponojnë strukturime pak a shumë artificiale të Agorave.

Të ndodhura brenda sistemit urban Hipodamik, që në vitet e periudhës klasike –shek. V p.e.s. në qytetet Greke si Mileti, Agora-ja ka fituar një formë të rregullt gjeometrike¹⁵, për t'u perfeksionuar edhe më tej në periudhën helenistiko-Romake, duke fituar morfologji të qartë kompozicionale. Paralelisht edhe Agoratë në vendet e Ilirisë së jugut do të marrin forma të ngjashme e do të kompozohen në parime të njëjta me ato të qyteteve simotra.

2.2 Teoritë e formimit të parcelave të shenjta e shesheve urbane në Greqisë antike.

Në Greqinë antike parcelat e shenjta e sheshet urbane ishin vendi ku, për arsye kulturi në të parat apo për arsye shoqërore, tregtare e politike në të dytat, do të kishte mbledhje të një numri të madh personash. Për qytetin këto ishin vendet e qëndrimit në shoqëri e për pasojë vendet më të rëndësishëm edhe nga ana e paraqitjes arkitektonike. Në studimet e bëra tashmë prej më shumë se një shekulli, janë kuptuar e hipotetizuar disa prej mënyrave me të cilat grekët i kompozonin këto sheshe.

Interesante është ta shqyrtojmë formimin e këtyre hapësirave në kuadrin e parimeve kompozicionale sipas sistemit polar që përdornin grekët e lashtë. Duke ju referuar Doxiadis¹⁶ mësojmë se grekët i poziciononin objektet në hapësirë sipas disa parimeve që duhet të rregullonin raportet proporcionale e hapsinore mes tyre. Ata nuk e njihnin sistemin koordinativ kënddrejtë, por i poziciononin objektet në varësi të pikëshikimit të njeriut. *[...]një njeri qëndron në hapësirë e shikon para tij. Ai i sheh objektet e veçanta si pjesë të një sistemi, qëndra e të cilit është ai vetë e në të cilin, të gjitha pikat në plan janë të përcaktuara në varësi të distancës prej tij. Kur ky njeri kërkon të përcaktojë pozicionin e objekteve, ai nuk përdor sistemin abstrakt koordinativ, por një sistem natyral koordinatash. Ky sistem do të njihet si “sistemi polar koordinativ” e do të jetë në bazë të planifikimit të hapësirave në Greqinë e lashtë[...]*¹⁷. Duke trajtuar më tej atë, Doxiadis liston edhe parimet që Grekët duhet të kenë ndjekur për të planifikuar hapësirat e tyre urbane, të tilla si parcela të shenjta apo Agora.

Linjat që dalin radialisht nga pika e privilegjuar (hyrja) do të përcaktojnë pozicionin e 3 prej këndeve të ndërtesës, duke u siguruar kështu që për çdo ndërtesë do të duket minimumi $\frac{3}{4}$ e vëllimit arkitektonik. Për ta, një ndërtesë e rëndësishme duhet të duket në tërësinë e vet nga pika kryesore e shikimit por, nëse kjo nuk është e mundur, një tjetër

¹⁵ (Martin, L'espace civique, religieux et profane dans les cités grecques de l'archaïsme à l'époque hellénistique, 1983) f. 2

¹⁶ (Doxiadis, 1972)

¹⁷ (Doxiadis, 1972)

ndërtesë mund ta mbulojë tërësisht atë - pra asnjëherë objekti nuk duhet të duket pjesërisht dhe i paplotë.

Pozicioni i ndërtesës do të përcaktohet jo vetëm nga këndi i shikimit, por edhe nga distanca nga pika e shikimit. Një kënd shikimi, zakonisht në qendër të fushës së shikimit, lihej i lirë nga ndërtesat e hapej direkt drejt hapësirës rrethepërqark. Ky përfaqësonte drejtimin që duhej të ndiqte një person për t'ju afruar vendit, dhe shpesh përbënte të ashtuquajturën “rrugë të shenjtë”. Shembujt e studiuar do të tregojnë që zakonisht kjo pikë e privilegjuar shikimi do të ishte në vendin ku aksi i propilejve¹⁸ ndërpret linjën e brendshme të ndërtesës, në hapin e parë para se të hysh në shesh dhe në një lartësi sa syri i njeriut. Ata nuk trembeshin nga pafundësia e gjithmonë parashikonin një rrugë që do të përshkonte tejprtej parcelën e do të përfundonte jashtë saj.




Figure 4. Parcela e shenjtë në Selinus ilustron teorinë e Doxiadis në planifikimin e hapësirave.

Ndërkohë, një tjetër autor, Patrick Nuttgens e sheh si të veçantë mënyrën me të cilën Grekët i vendosnin objektet në një parcelë¹⁹. [...] asgjë nuk është e drejtpërdrejtë, gjithçka është në perspektivë, e pjerrët apo e spostuar. Ata i vendosin objektet simetrike në parcela jo simetrike, të parregullta duke luajtur e manipuluar në nivelet e terrenit e duke na bërë t'a perceptojmë të tërën në mënyrë jo-statike, por vetëm pasi kemi lëvizur e rrotulluar përreth objekteve ashtu siç bënin procesionet ceremonial[...] ²⁰. Kjo vendosje jo simetrike shmanget pamjet e perceptimet statike të këtyre komplekseve, imponimin solemn e hierarkik që do të sillnin më vonë Forumet apo sheshet perandorake të Romës

¹⁸ Hyrje monumentale në një kompleks arkitektonik apo parcelë të shenjtë

¹⁹ Këto karakteristika ai i thekson pasi shqyrton kompozimin hapësinor të parcelave të shenjta.

²⁰ (Nuttgens, 2001) f.93

antike. Në lirshmërinë e vendosjes planimetrike të objekteve duket sikur perceptojmë demokracinë e poliseve grekë, të cilët nuk të imponojnë perceptimin arkitektonik si një pamje fikse e të pandryshuar të servitur nga arkitekti, por e bëjnë atë funksion të njeriut që lëviz dhe natyrshëm zgjedh vetë pikëshikimin e privilegjuar, më të bukur. [...] *Ata në pejsazhet e parcelat e shenjta nuk krijojnë kurrë simetri të thjeshta aksiale por llogaritin që në çdo kthesë të itinerarit brenda tyre, të të servirin një impakt të ndryshëm emotiv[...]*²¹.

Sipas Bruno Zevit kuptojmë se [...] *vizionit arkitektonik të vëllimeve të pastra e me ritme të rregullt hapësinorë që Grekët përdornin, i korrespondon një urbanistikë që nuk i mbyll, kufizon hapësirat, por i hap ato në infinit. Si tek Teatri, urbanistika Greke e periudhës klasike ka për skenar horizontin. Ky konceptim u vu në krizë nga ndërgjegjja peisazhistike e botës helenistike: në Pergamo ndërtesat do të mbivendosen për të krijuar një unitet të vetëm kompozicional apo teatrot do të ngrenë skenat e tyre[...]*²².

Një rregull më të ndryshëm do të ndjekin Grekët në krijimin e qendrave publike të qyteteve. Vërtet ato shpesh u nisën si parcela të shenjta të ndërtuara pranë tempullit apo faltore por shpejt u transformuan në Agora që do të luajnë jo më një rol kulturi por do të bëhen qendra e jetës politike e tregtare të qytetit. Parimet e kompozimeve të lira të parcelave të shenjta tashmë do të jenë të papërshtatshme për këto qendra që duhet të paraqesin me rregullsinë e tyre rritjen e fuqisë politike të Polisit. Një rrjedhë llogjike e kronologjike të këtyre ndryshimeve, deri në arritjen e gjeometrizimit të formave të Agorave, e mësojmë nga R. Martin që studion rast-pas-rasti krijimet e poliseve më të rëndësishëm grekë që prej atyre të shek. VIII p.e.s.

Duke u ndalur në analizën e hollësishme që ai bën për secilin polis, mund të evidentojmë këto faza shekull pas shekulli, për të gjetur më vonë reflektimin e tyre në fazat evolutive të Agorave të Apollonisë.

Në fillimet e formimit të këtyre Agorave, që vërtetohen që prej shek VII p.e.s. pozicionimi e forma e tyre do të varen nga karakteri ekonomik që ka qyteti, bujqësor apo tregtar. Në qytetet ku ekonomia ka karakter bujqësor gjejmë Agora të hapura e me siparfaqe të mëdha e të lidhura mirë me qytetin dhe sistemin rrugor të tij, ndërkohë që, në qytete ku ekonomia ka karakter tregtar, gjejmë Agora më të vogla e të pozicionuara pranë porteve apo skelave lumore. Ndërtimi më i hershëm që vendosej në këto Agora, është i tipit Stoa me dyqane e ambiente tregtarë, si dhe i tipit Heroon, ndërkohë që roli si një qendër politiko-religjioze ju dha që në fillim kësaj Agoraje.

Në shekujt VI- V p.e.s. me ndryshimin e organizimit social e politik të qyteteve do të shtohen edhe objekte të tjerë në Agora, ndër të cilët i pari që del si domosdoshmëri, do të

²¹ ibidem f.100-101

²² (Zevi, 2000) f.160

jetë Eklesiasterioni apo Bouleuterioni, si vendi ku bëheshin mbledhjet e asamblesë e të këshillit. Eklesiasterioni gjendet fillimisht në Agora, e më vonë mund të zëvendësohet nga Bouleuterioni më i vogël në madhësi, ndërkohë që Eklesiasterioni shpesh spostohet në Teatër, apo në një strukturë enkas të ndërtuar si një mbushje me dhë e shkallë guri si në rastin e Pnyx në Athinë.

Fundshekulli i V dhe ai i IV p.e.s. do të jetë edhe koha në të cilën do të shtohen funksionet tregtare të Agorasë e do të perfeksionohen format e saj edhe nën efektin e mësimave të Hipodamit që në atë kohë ishin përhapur e propaganduar. Kjo do të influencojë gjeometrizimin dhe rregullsinë e këtyre hapësirave, të cilat do të rrethohen me Stoa, ndërkohë që rrugët do të jenë pas këtyre ndërtesave e do ti anashkalojnë ato duke sjellë një shpërndarje dhe gati izolim të Agorasë nga pjesa tjetër e qytetit. Deduktojmë kështu që Agoratë kanë qenë sheshe të “mbyllur” që rrethoheshin me Stoa duke i “kthyer kurrizin qytetit”. Prej kësaj rrjedh edhe hipoteza që më pas gjatë studimit do të hidhet, për të kërkuar sheshin-Agora, aty ku zbulohet një Stoa, si në Antigone. Gjatë V - IV p.e.s. rrugët do të fillojnë të bëhen përpjendikulare, duke krijuar një rrjet kuadratik rrugor, ndryshe nga rrugët në formë linjash gjatësore të qytetit të mëparshëm.

Në periudhën helenistike do të kemi mbylljen totale të Agorasë si një hapësirë me Stoa e dyqane në të gjitha anët, si në një imazh që thuhet shpesh do të shihet si një fillesë e një Forumi²³ të kohës Romake. Në fakt do të fillojë në shekujt e mëvonshëm një transformim i Agorave dikur Greke në Forume Romake e do të krijohet një raport krahasimor që duhet parë jo vetëm në ndryshimin e teknikave të ndërtimit të tyre, po në radhë të parë në aspektet funksionale e sociale të ndryshme²⁴. Këtu ndalemi për të kuptuar se si Agoratë Greke do të transformohen në Forume Romake duke vendosur përsëri në anë të saj objekte të rëndësishme të ngjashme me Bouleuterionet e Eklesiasterionet, duke i shtuar aspektin ceremonial e monumental kësaj hapësire që, në Greqi, ishte kthyer pothuajse në një hapësirë me karakter vetëm tregtar. Thuhet gjithë Agoratë Greke u riadaptuan dhe u romanizuan duke theksuar më tepër se një kompozim qendror tashmë, një kompozim linear e aksial.

Kështu, në shembuj të projektuar në sistem Hipodamik, duket sikur rregullsia do të dominojë ndaj asimetrisë e lirshmërisë kompozicionale të vërejtur deri në atë kohë. Në qytete si Mileti apo Priena dallojmë të njëjtat parime projektuese me sistem rrugësh përpjendikulare ndër të cilat kryesoret dallohen nga sekondaret nëpërmjet gjerësisë së tyre. Insulat kuadratike do të përdoren për të organizuar zonat e banimit të cilat ndaheshin qartazi nga ato publike e civike. Agoraja në qendër do të përmbledhë objektet më të rëndësishme ndër të cilët, Stoa, Bouleuterion, Prytaneyon, e më rrallë Odeon, si një objekt që shtohet në periudhat e mëvonshme.

²³ Qendra e qytetit në periudhën Romake do të quhet Forum

²⁴ (Greco, 1999)




Figure 5. Qyteti i Prienës, plan, rikonstrukcion hipotetik dhe Agoraja.

Të tjerë qytete, edhe pse pa plan të mirëfilltë Hipodamik në organizimin e tyre, aplikojnë rregulla të përbashkëta në modelimin e Agorave - sheshe të mbyllur drejtkëndorë që përdorin Stoa-në si kufizuese të hapësirës arkitektonike. Në rastet kur është e pamundur të projektohet një formë e rregullt drejtkëndore për shkak të ndërtimeve para-ekzistuese, si në Athinë, Stoa-ja do të përdoret si një element kufizues. Vëllimi arkitektonik i saj, shtrirja e madhe gjatësore dhe ritmi i vazhduar i kollonadës, do të sjellin rregull e ekuilibër në kompozim.

Shpesh e quajtur si shëtitore ajo do të sigurojë ambientin e duhur në të cilin, duke shëtitur, mund të kalonim kohën në shoqëri duke diskutuar për probleme politike, art apo edhe letërsi. Me dyqane ose jo në njërin krah, ato do të karakterizohen nga një përsëritje ritmike kollonash në anë apo edhe në mes - të domosdoshme konstruktivisht për të mbajtur trarët e mbulesës.

Ritmi i bukur i kollonadës që mban sipër një antablement të dekoruar do të bëhet kufizimi perfekt arkitektonik për çdo Agora. Ato mund të jenë me një apo dy kalime gjatësore, mund të kenë dyqane në njërin anë por mund të jenë edhe pa ambjente tregtare (vetëm me një mur fundor) duke u bërë rasti i bukur i një shëtitoreje të mbuluar në formën e një portiku gjatësor. I projektuar në këtë formë, duket se do të kënaqë qëllimin e kufizimit të Agorasë nga pjesa tjetër e qytetit: një nga parimet fillestare që Hipodami vendosi në planifikimin urban ishte ndarja qartazi e zonave të banimit, nga ato publike apo të kultit, e Stoa-ja do të ishte korniza arkitektonike mbyllëse e saj.




Figure 6. Plane të Agorave, Mileti, Pergamon, Efes, Priena,

Këto sheshe të mbyllur do të lidhen me sistemin rrugor të qytetit vetëm në kënde, në përfundim të Stoave.




Figure 7. Agoraja e Athinës, plan.




Figure 8. Stoja e Atalës në Athinë, plan dhe pamje e fituar pas rikonstrukcionit të viteve 1960,

Agora-ja e Athinës e rikonstruktuar në vitet 1960 do të ilustrojë rolin e Stoaës si një vëllim arkitektonik i domosdoshëm. Kollonada do të shtrihet në dhjetëra metra gjatësi e do të bëhet vendi ku, në ditë me diell apo me shi, grekët do të kalojnë kohën duke biseduar apo duke bërë tregëti.

2.3 Metodologjia e studimit

Shqyrtimi i konceptit të Agorasë në qytetet greke na ndihmoi të kuptojmë format kompozicionale të tyre e të deduktojmë që në to janë përdorur rregulla të përbashkëta arkitektonike e urbane që, si një „kod dizajni“, u respektuan kudo në këta shekuj.

Pas analizës kompozicionale të Agorave botërore, studimi vazhdoi me qytetet Ilirike që sot i ndodhen në territorin e Shqipërisë. Janë marrë në shqyrtim qytetet në të cilat Agoratë janë zbuluar, (Apollonia, Bylis, Antigonea, Butrinti), por edhe ato ku elementë të tillë si Stoa apo Teatër na lenë të hipotezojmë se ato kanë ekzistuar (Phoinike, Dimal e Nikaia).

Metodologjikisht është ndjekur e njëjta mënyrë e studimit që do të ndiqet për objektet tipologjike (propozuar në fillim të studimit), që në këtë fazë ka të bëjë vetëm më tipologjinë e Agorasë, e jo me ndërtimet e veçanta brenda tyre.

- ✓ Shqyrtimi i Agorasë për secilin qytet, me objektet përkatës dhe kohët e ndërtimit të secilit.
- ✓ Shqyrtimi i vendosjes planimetrike rreth e qark sheshit dhe raporti proporcional i objekteve me njëri-tjetrin.
- ✓ Aspekti kompozicional i trajtuar si formë planimetrike, altimetrike e tipologjitë që gjenden në të dhe roli morfologjik që ato luajnë.
- ✓ Krahasimi në planimetri i të gjitha Agorave me njëra-tjetrën për të deduktuar karakteristika planformuese dhe stilistike.

Në përfundim, konkluzionet e nxjerra nga kjo pjesë e studimit do ti shërbejnë kapitujve në të cilët do të shqyrtohen hollësisht disa tipologji ndërtimore të Apollonisë dhe roli që ato luajtën në formimin e sheshit. Pritet që këto rezultate e karakteristika planformuese të na ndihmojnë për të kuptuar e përfytyruar format që duhet të kenë patur dy qendrat e Apollonisë në secilën nga fazat e zhvillimit urban e arkitektonik




Figure 9. Majtas, harta e qyteteve antike në Shqipëri. Me blu janë shënuar qytetet në të cilat nga gërmimet arkeologjike konfirmohet ekzistenca e Agorasë.

Figure 10. Djathtas, plani i bërë nga Praschniker ku paraqitet qyteti i shtrirë në dy kodrat dhe muret rrethuese të tij. Asklepos do të quhet kodra 104 ose Temenos dhe ka gjurmë të tempullit të parë, ndërkohë që në veri të saj është kodra e Akropolit.

2.4 Agoratë në Apolloni.

Apollonia themelohet në sh. VI p.e.s. nga kolonë prej Korinthit e Korkyrës që gjetën aty pak nga banorët lokalë. Fusha ku qyteti u shtri quhej Gylakeia sepse 200 Korintasit e dërguar atje në fillim udhëhiqeshin nga Gylaku, por shpejt ata do t'i japin vendit emrin Apolloni në nder të hyjnisë së preferuar Apollon – ashtu si shumë qytete të tjera me të njëjtin emër²⁵.

Apollonia, politikisht, qëndronte gjithmonë në krah të qytet-shteteve mëmë të saj – Kërkyra e Korinthi dhe vetëm në vitin 229 p.e.s., pas luftës së parë të Ilirisë me Romën, ajo, sëbashku me Dyrrahun dhe Korkyrën, do ti dorëzohen Romakëve²⁶. Kështu, e influencuar nga kushtet e ndryshimet politike, edhe arkitektura do të paraqitet në dy rryma aq sa të ngjashme edhe të ndryshme nga njëra-tjetra Ajo që do të presim të shohim

²⁵ (Ceka, Apollonia, 2005)

²⁶ (Pierres Cabanes, Myzafer Korkuti, Apollon Baçe, Neritan Ceka, 2008)

në arkitekturë do të jetë një frymë estetike e influencuar nga ajo e kohës: të cilat si një kod dizajni do të respektohen në të gjithë qytetet e zhvilluara të asaj kohe. Forma, dekoracione e tipologji të ngjashme me ato të arkitekturës Greke për periudhën para vitit 229 p.e.s., ndërkohë që, vetëm pas ndryshimit politik të këtij viti, do të mund të kërkojmë forma arkitektonike të influencuara nga Roma.

Qyteti fillimisht vendoset në dy kodra, Temenos (ose kodra 104) dhe Akropol, e më vonë zgjerohet drejt perëndimit në rreth 80 Ha duke zënë krejt zonën kodrinore deri në afërsi të fushës. Planin e parë topografik të kodrave e të mureve rrethuese të qytetit të vjetër do ta vizatojë arkeologu austriak Praschniker në vitet 1920. Ndërkohë që gërmimet e vazhdueshme për dekada me rradhë do të hedhin dritë mbi qytetin e zgjeruar tashmë në kufinj shumë më të gjerë se ato të skicës së parë.

Rezultat i këtyre gërmimeve do të jetë një hartë e azhornuar e përgatitur nga shkolla franceze e Romës në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Arkeologjisë ku reflektohen gjurmët e rrugëve të zbuluara.

Në shekujt VI-IV p.e.s. qyteti i vjetër do të përdorë një rrjet rrugor përpjendikular që njihet vende-vende e do të përcaktojë tre lagjet e qytetit. Nga Ward-Perkins²⁷ mësojmë se në periudhat e para të zhvillimeve të qyteteve në Greqi, lagjet ishin të ndara veçmas për artizanë, për ushtarakë e për aristokratë.

Sistemi rrugor i qytetit të vjetër, të quajtur qyteti i Lartë në hartë është shënuar me blu ndërkohë që një rrjet tjetër rrugor do të trasohet sipas rrjetit të kuq e sistemi i rregullt Hipodamik do ti korrespondojë qytetit të poshtëm.

Prej arkeologëve do të quhen përkatësisht qyteti i poshtëm dhe ai i sipërm. Mes dy kodrave dhe në perëndim të kodrës 104-ës do të ndërtohet Agoraja dhe qendra monumentale e mëvonshme. Monumentet më të hershme i takojnë shek. V-IV p.e.s. ndërkohë që, më vonë, qyteti do të shtrihej në anën perëndimore të kodrave në një sipërfaqe gati 81 ha e do të fortifikohej nga një mur 4km i gjatë. Insulat kishin një madhësi 120 x 60 m dhe secila përmbante 8 banesa²⁸.

Ajo që deri më tani është emërtuar si Agora, apo qendra monumentale Apollonisë, është vetëm një pjesë e shesheve publike të qytetit. E ndërtuar kryesisht në shek. II e.s. me Odeonin, Bouleuterionin, Bibliotekën, Prytaneionin e tempujt, ajo do të jetë një zgjerim i Agorasë së mëparshme të ndërtuar në shek. V-IV p.e.s. Nëse analizojmë kompozimin e saj, do të dallojmë që forma thuhet drejtkëndore do të ndërfutet në sistemin Hipodamik që, në hartën e përgjithshme, e dallojmë me vija të kuqe (të qytetit të poshtëm).

²⁷ (Ward-Perkins, 1974) f.14-18

²⁸ (Ceka, Apollonia, 2005) f.10-38




Figure 11. Plan topografik i vitit 2010, i përpunuar nga Shkolla Franceze e Romës.




Figure 12. Prerje në terren për të treguar ndryshimet e kuotave të relievit, viti 2010, përpunuar nga Shkolla Franceze e Romës. Vëmë re se ndërtimet e të dy qendrave Agora do të zgjedhin të vendosen në sipërfaqet më të sheshta, por edhe më panoramiket, që të ofrojnë pamje spektakolare mbi pejsazh.

Të gjitha ndërtimet e tjera të zbuluara në Parkun Arkeologjik respektojnë këtë sistem rrugor perpendikular por, në të vërtetë, vetë Apollonia na servir edhe një rrjet tjetër rrugor me drejtimin veri-jug e lindje-perëndim që në hartë trasohet nga vijat blu. Vitet e fundit, gjatë fushatave të gërmimeve arkeologjike, kanë dalë mbetje edhe nga objekte që respektojnë këtë rrjet të mëparshëm, siç janë ato në vazhdim të Agorasë në pjesën veriore të saj. Duke shfrytëzuar të dhënat e Shkollës Franceze të Romës, që bashkëkryeson misionin arkeologjik sëbashku me palën shqiptare, jemi në gjendje të bëjmë një renditje

kronologjike të ndërtimeve në këto dy qendra të qytetit, para-ardhëse e pas-ardhëse të njëra-tjetrës.

Hulumtimet gjeofizike të bëra në vitet 2004-05 do të japin të dhëna të pa kundërshtueshme mbi historinë kronologjike të qytetit. Fakte, si ai i ekzistencës së një qendre tjetër publike, që në të vërtetë ishin hipotezuar prej arkeologëve më parë, tashmë do të vërtetohen nga gjurmët në imazhet gjeofizike²⁹.

Fillimisht qyteti shtrihej pranë kodrave të akropolit dhe asaj 104, e kufizohej nga mure të mëdhenj fortifikues. I përbërë nga 3 lagje, ai do të organizohej me një sistem rrugor të rregullt (rrjeti blu) por që ndryshonte nga lagja në lagje me një rrotullim në pak gradë të drejtimit të rrugëve - ndoshta për arsye topografike. Ky qytet i sipërm do të fillojë të banohet në shek. VI p.e.s. - kohë në të cilën akoma nuk ka filluar të përdoret sistemi Hipodamik³⁰. Për të gjetur një shpjegim për këtë sistem rrugor të rregullt përpandikular, na ndihmon E. Greco i cili shpjegon se eksperimentet e para për sisteme të rregullt të linjave përpandikulare, Grekët do ti bëjnë në qytetet-koloni të cilat, të vendosura shpesh në toka lagunore, do ti duhej ti bonifikonin me kanale kulluese para se ti kultivonin [...] Qytetet të mbingarkuar me objekte, ndërtime e histori s'do të jenë vendi i përshtatshëm për të aplikuar sisteme të rregullt urbanë ndërkohë që shpesh, kolonitë, duke qenë të shkëputura qartazi nga qytetet mëmë, do të mund të planifikohen në sisteme rrugore e forma të gjeometrizuara që do ti ngjajnë atyre të kanaleve kullues[...]³¹. Vërejmë se edhe në Apolloni do të respektohet dëshira që sistemi rrugor të respektojë linjat e tempullit të Apollonit duke transmetuar simbolikën që drejtimi i rrugëve urbane është ai që diktohet prej hyjnive, e që “Zoti do të drejtonte orientimin e qytetit”³². Ky sistem urban zakonisht aplikohet rreth dy gjenerata (50 vjet) pas ardhjes së kolonëve të parë. Kështu, në Apolloni, sistemi rrugor blu vendoset saktësisht në drejtimin veri-jug e lindje perëndim duke respektuar tempullin që sipas tipologjisë Greke zgjidhte gjithmonë të kishte kthim të fasadës së hyrjes nga lindja. Duke u bazuar në faktin se kolonët e parë arritën aty në 588 p.e.s., sistemi urban blu i qytetit të sipërm duhet të ketë qenë i trasuar, përcaktuar rreth viteve 520 p.e.s., pra thuhet në fund shekullin VI p.e.s e fillimet e shek. V p.e.s.. Kjo periudhë kohore na koinçidon me periudhat në të cilat arkeologët kanë përcaktuar objektet e parë të ndërtuar.

²⁹ (Olivier DELOUIS, Jean-Luc LAMBOLEY, Philippe LENHARDT, François QUANTIN, Altin SKENDERAJ, Stéphane VERGER, Bashkim VREKAJ, 2007). f.37-53

³⁰ Hipodami, arkitekti që propozoi sistemin hipodamik do të jetojë në 498-408 p.e.s.

³¹ (Greco, 1999)

³² Nje karakteristikë të tillë në qytetet që paraprinë ato me sistem Hipodamik, do të na e vërtetojë E. Greco tek libri i tij „La citta greca antica: istituzioni, società e forme urbane“, op.cit., në të cilin sjell rastet e qyteteve Metaponto e Paestum në të cilët drejtimi i rrugëve do të rrotullohet me pak gradë për tju përputhur drejtimin të aksit gjatësor të tempullit të ndërtuar më parë. Vëmë re se sistemi blu i rrugëve në Apolloni do të respektojë aksin gjatësor të tempullit në kodër, sipas drejtimit lindje perëndim.

Qendra publike e tij, në shek. VI p.e.s., do të vendoset në hapësirën mes dy kodrave, Akropolit dhe kodrës 104, e do të arrihet nga porta lindore që hapej në murin rrethues. Prej saj sot na dokumentohen gjurmë të pakta nga objekte të vendosur në mënyrë të lirshme e pa kompozim të qartë gjeometrik në shesh. I vetmi objekt, që respekton me fasadën e tij rrjetin rrugor blu është një ndërtim me plan fragment rrethor me një diametër 16m, (ajo që më pas do ta quajmë si ndërtesa në formë patkoi) e cila mund të ketë shërbyer si një sallë mbledhje për Këshillin e qytetit. Shpesh këto objekte zgjidhnin planimetri të tilla duke vendosur në interior shkallë të drunjta në formë seksion rrethi³³.

Kjo qëndër do të vazhdojë të shfrytëzohet me disa ndërhyrje rindërtuese prej shek. III e.s. deri në periudhën Romake.³⁴ Objektet që do të ndërtohen do ti mbivendosen atyre të mëparshme shpesh edhe duke ripërdorur materiale të marra prej tyre.

Një kollonadë në mes dy linjash murale, e ngjashme me një Stoa, duket se ka qenë objekti që kufizonte pjesën veriore të Agorasë që shtrihej në luginën mes dy kodrave para se të fillonte pjerrësia e Akropolit. Ka hipoteza që, një e ngjashme, të ndodhej përballë saj në këmbët e Temenosit duke dhënë kështu Agoranë publike të qytetit të shekujve III p.e.s.. Ndërkohë në shekujt e parë të krijimit të kolonisë kjo hapësirë mes kodrave duhet të ketë patur rolin e një qendre publike, ndoshta kult³⁵. Në të vërtetë, kjo periudhë e shek. VI-V p.e.s. gati nuk ishte ravijëzuar tërësisht duke lënë një boshllëk arkitektonik në jetën e qytetit. Tashmë, sipas arkeologëve francezë³⁶, jemi të bindur që qyteti, qendrën e tij të parë arkaike, e kishte pikërisht në hapësirën mes dy kodrave dhe vazhdonte të shtrihej me lagje të banuara edhe në pjesën veriore.

Më vonë, në periudhën e vonë helenistike e Romake, qyteti do të zgjerohet në drejtim të perëndimit e të lindjes dhe do të aplikojë një sistem rrugor të rregullt Hipodamik, të njohur sot si “rrjeti i kuq” i qytetit të poshtëm.³⁷ Në këtë periudhë do të rimodelohet qendra monumentale në perëndim të kodrës 104, duke u bërë një qëndër publike e politike e denjë për një qytet të madh.

2.4.1 Etapat kronologjike të evolucionit të Agorave në Apolloni

Kështu, e ndarë në faza kronologjike, historia e këtyre shesheve Agora e Forum mund të ravijëzohet si vijon:

³³ (Greco, 1999), f, 195

³⁴ (Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj, 2004) f.10-184

³⁵ Gërmimet arkeologjike kanë evidentuar mbetje ndërtesash të sh. VI-V të vendosura lirshëm në këtë hapësirë, pa një kompozim të rregullt planimetik.

³⁶ (Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj, 2004), f. 180-184

³⁷ (Olivier DELOUIS, Jean-Luc LAMBOLEY, Philippe LENHARDT, François QUANTIN, Altin SKENDERAJ, Stéphane VERGER, Bashkim VREKAJ, 2007) f. 37-53.

- o Shek. VI-V p.e.s. qendra publike ndodhej mes dy kodrave e përbëhej nga ndërtime me vendosje të lirë planimetricke. Aty duhet të ketë qenë Eklesiasterioni me Bemën, (hipotezë që diskutohet në kapitullin ku flitet për këtë ndërtesë)
- o Shek IV p.e.s. formohet qendra në perëndim të Temenosit (kodra 104) e kufizuar nga Stoa të A dhe B me nikje.
- o Shek III p.e.s. rimodelohet Agoraja në hapësirën mes dy kodrave e ndërtohet një mur në rrënzë të Temenosit dhe një portik përballë tij, i cili i mbivendoset Eklesiasterionit- Bouleuterion. Më vonë mendojmë se kjo qendër duhet të ketë luajtur rolin e një hapësire të shenjtë³⁸.
- o Shek. II .e.s. qendra ritransferohet në perëndim të Temenosit dhe merr format e Forumit me ndërtimin e Odeonit, Bulesë, dhe Bibliotekës. Kjo qendër do të vazhdojë të funksionojë deri në shek. III e.s. kur, si pasojë e një tërmeti shkatërrimtar³⁹, do të fillojë braktisja e qytetit.

Duke ravijëzuar arkitektonikisht secilën fazë krijojmë ide të qarta se si këto sheshe mund të jenë paraqitur në shekujt përkatës.

2.4.2 Agoraja e vjetër mes dy kodrave

Qendra e parë, ajo e shek. VI-V p.e.s. duhet të jetë krijuar si një parcelë e shenjtë pranë tempullit në kodër tek i cili arrihej nëpërmjet një rruge që niste nga sheshi. Në ditët e sotme gjejmë gjurmë të qarta të një ndërtese me plan gjysëm rrethor me një diametër 16m që arkeologët e kanë identifikuar si një sallë mbledhjesh. Në fakt njihet një tipologji e tillë e hershme e ndërtimeve Greke e cila quhej Eklesiasterion⁴⁰ dhe si një strukturë e shek V p.e.s. parashikohej që, në të, të bëheshin mbledhjet e asambleve të poliseve. Me një plan rrethor apo seksion rrethi, ato kishin në brendësi shkallare të vendosura në struktura druri.⁴¹

Këto objekte do të ndërtohen në qytetet Greke para periudhës klasike, pasi më vonë këto mbledhje të asambleve do të bëhen në teatrot e poliseve.⁴² Theksojmë këtu edhe formën e dekoracionin që duhet të ketë patur ky Eklesiasterion. Prej tij, sot, njohim vetëm trajektoren e mureve perimetrale të reduktuar vetëm në një rradhë gurësh në bazë, por që na tregojnë të vetmin objekt të Apollonisë që ka patur formë të kurbëzuar planimetricke. Paralelisht, kujtojmë se një prej fragmenteve të frizave dekorative të ndodhura sot në

³⁸ Kjo hipotezë mund të mbështetet nga fakti se në shek. I p.e.s. aty u ndërtua një tempull në këmbë të pjerrësisë së kodrës 104, në krahun jug-perëndimor të sheshit.

³⁹ (Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saimir Shpuza,, 2014), f. 33

⁴⁰ (Greco, 1999) f. 85-87

⁴¹ Vëmë në dukje nga plani i strukturës rrethore të zbuluar në Apolloni, ka gjurmë të atyre që arkeologët i quajtën „kontraforca“, por që në fakt duhet të jenë fragmente muralë mbi të cilët mbështeteshin shkallët e drunjta.

⁴² Eklesiasterioni më vonë do të zëvendësohet nga Bouleuterioni, një tjetër strukturë me shkallare në brendësi që do të shërbejë për mbledhjet e këshillit të qytetit e që do të mbajë pak vetë në interior.

muzeun e Parkut Arkeologjik, ka formë planimetrike të kurbëzuar lehtësisht, dhe është e dekoruar me një bazoreliev me stil të vazhduar në anën e jashtme të rrethit. E gjetur në 1985 në muret e Manastirit ajo do të përcaktohet si një frizë e frymëzuar nga muzeu i Halikarnasit, e stilistikisht e ngjashme me frizat e Tarantos⁴³.



Figure 13. Friza e drejtë dhe Friza e kurbëzuar me motive amazonomike

Duke matur kurbat e fragment-rrathëve të këtij blloku monolit si dhe trashësinë e tij, jemi në gjendje të gjejmë gjeometrikisht diametrin e rrethit mbi të cilin ishte vendosur. Lind ideja se, nëse ai do të korrespondojë diametrin të Eklesiasterion-it, natyrshëm pra mund të lidhim të dy objektet me njëri tjetrin e të hipotezojmë se Eklesiasterioni duhet të ketë qenë i dekoruar në pjesën mbi arkitra, përgjatë të gjithë perimetrit të tij. Por pas saktësimeve të përmasave që duhet të ketë patur objekti me atë frizë dekorative, kuptuam që ai duhet të takonte një ndërtesë tjetër, me diametër gati 4m - shumë më të vogël se ai i Eklesiasterion-it. Për stadin e gjurmëve të zbulimeve të sotme akoma nuk kemi dëshmi nga një ndërtesë e tillë. Hipotezojmë nëse ky duhet të ketë qenë pjesë e një Heroon, që për qytete Greke ishte një monument i përmasave të vogla destinuar si një objekt përkujtimor, si pasojë, i dekoruar shpesh me Basorelieve. (Kujtojmë Heronin e Sagalassos) nuk mundet në këtë moment të kemi gjurmë të vendit ku duhej të jetë ndodhur objekti, por pozicionimi mbetet për tu përcaktuar në një shpat kodre apo në afërsi të njërit prej shesheve, ndoshta atij mes dy kodrave. Kujtojmë se, sipas analistëve si Martin e Grecco, në sheshet e parë të qyteteve arkaike ka patur gjithmonë një Heroon, një objekt që i dedikohej heroit të qytetit.

Kompozimi okazional i objekteve në këtë parcelë, (në Agoranë e parë në mes kodrave) i korrespondon karakteristikave që njohim sot nga parcelat e këtyre periudhave, të cilat në qytetet e hershëm akoma nuk e kishin fituar formën e rregullt. Të kompozuar me forma të çrregullta ato ishin të parat qendra, fillimisht kulti e shpejt publike, që u krijuan.

Priremi të bëjmë një analogji me qytetin e Korinthit që nga Grecco përmendëm më lart. Ndërtimi i parë, atje, kishte qenë një "Heroon" i vitit 750. P.e.s. i cili u vendos në veri të kodrës së Apollonit që, tempullin e parë të vjetër, e kishte që në vitet 800 p.e.s.. Në pjesën e sheshtë rezervuar Agorasë do të ndërtoheshin njëri pas tjetrit nga lindja në perëndim një

⁴³ (Vangjel Dimo, Philippe Lenhardt, François Quantin, 2007) f.120, në këtë vepër citohet edhe një tjetër frizë dekorative me motive amazonomike që datohet shek. V p.e.s.

strukturë tek burimi i shenjtë dhe sanktuari i Medesë pranë fontanës së Glauké-së. Në një stad të mëvonshëm do të jenë edhe ndërtimet administrative të pjesës jugore.



Figure 14. Agoraja e Korinthit në shekujt VI-IV p.e.s.

Ndërkohë edhe në Apolloni duhet të jetë ndërtuar fillimisht tempulli për Apollonin në kodrën 104, të quajtur Temenos dhe si për koinçidencë edhe ndërtimet menjëherë në veri të saj, në pllajën mes kodrave (shek. VI p.e.s.)⁴⁴ të cilat mund të ishin edhe kulti por edhe me funksion publik a memorial si nje Eklesiasterion apo Heroon. Duket sikur Korinthisit po ripërsëritnin të njëjtën skenë urbane që kishin lënë në qytetin e tyre kur u larguan prej tij. Si në Korinth edhe në Apolloni duhet pritur vetëm shek. IV-III p.e.s. për të parë Agora me forma drejtkëndore të kufizuara nga portikë e Stoa. (portiku mes kodrave do të cilësohet si ndërtim i shek. III p.e.s. ndërkohë që dy Stoa të me nikje në jug si objekte të shek. IV p.e.s.)

Po ti referohemi linjave të izoipseve për të parë ondulimet e terrenit, do të kuptojmë se Agoraja e parë u ndërtua në të vetmin vend të sheshtë që kishte qyteti i lartë, pavarësisht se kjo e detyroi këtë hapësirë publike të shtrihej në ekstremin lindor të tij, krejt ngjitur me muret rrethuese. Hyrja për në të bëhej nga porta lindore duke kënaqur kështu një aspiratë Apollinate për të patur një hyrje monumentale e ceremoniale si çdo qytet i madh⁴⁵. Gjithashtu autorët O. e N. Ceka, theksojnë si karakteristikë të Agorave në Ilirinë e Jugut,

⁴⁴ Këtë e dokumentojnë mbetjet arkeologjike të dërtesave që janë gjetur në hapësirën mes kodrave. Akoma nuk ka një funksion të percaktuar për to, duke qenë se të dhënat janë shumë të pakta, por arkeologët i lokalizuan ato si ndërtime të shek. VI p.e.s.

⁴⁵ (Cabannes, 1993) f.17

planifikimin e tyre pranë një porte për të qenë lehtësisht të arritshme edhe nga qytetarët e krahinës⁴⁶.




Figure 15. majtas, Restitucioni elektrik i viti 2010, jep ndryshime imazhi në vendin ku u zbulua portiku I madh.

Figure 16. djathtas, Plani i qytetit me impostimin grafik të portikut-Stoa dhe të murit në rrënzë të kodrës.

Në këmbë të kodrës së Akropolit gjejmë një portik tipik në formën e një shëtitoreje me një rrugë të krijuar nga një rradhë kollonash. Nuk e kemi trajtuar akoma pamjen altimetrike të tij por, në këtë fazë të trajtimit planimetrik të sheshit, veçojmë rolin e tij si një fasadë paralele me murin përballë, që tenton ti japë sheshit formën e rregullt drejtkëndore. (në fig. më lart, portiku i kuq dhe muri i verdhë përballë tij). Nga restitucioni elektrik që bënë arkeologët francezë, ai mur duket i vetëm, pa një artikulum arkitektonik me radhë kollonash, nikje apo kundraforca dhe duke parë që në shek. I p.e.s. do të ndërtohet tempulli në skajin perëndimor të tij, jemi gati të bindur që ai mund të ketë qenë vetëm një volum kufizues apo mbajtës i kodrës së temenosit.⁴⁷ Tërheqim vëmendjen se në vazhdim të studimeve mbi këtë Agora mund të diskutohet e hulumtohet me gërmime arkeologjike ideja nëse ai që Olivier & al. quajnë mur, mund të ketë qenë përsëri një portik i njëkohshëm me atë të gjeturin. Kujtojmë se tempulli i shek. I p.e.s ka një diferencë gati 2 shekulle nga ndërtimi i Portikut, e ndoshta deri atëherë ai mund të ishte prishur.

Kështu, kjo Agora me kompozim si një hapsirë e mbyllur, ndodhet në ekstremin lindor të qytetit dhe shumë pranë murit kufizues tej të cilit ndodhej Nekropoli. Forma drejtkëndore e saj përftohej nga dy paretet paralele - portiku dhe muri – dhe nga një strukturë tjetër e cila, e datuar në shek. IV p.e.s ndodhej poshtë asaj që sot njohim si ndërtesa me mozaik.

Kjo Agora helenistike zgjedh një formë të drejtkëndëshit të zgjatur që në brinjën e shkurtër ka gjerësinë e 3 insulave (një numër i ngjashëm me gjerësinë e Agorasë në Bylis), ndërsa në brinjën tjetër zgjatet shumë (4-5 Insula). Kujtojmë këtu se sipas Vitruvit

⁴⁶ (Olgita Ceka, Neritan Ceka, 2015)

⁴⁷ (Olivier DELOUIS, Jean-Luc LAMBOLEY, Philippe LENHARDT, François QUANTIN, Altin SKENDERAJ, Stéphane VERGER, Bashkim VREKAJ, 2007) f.37-53

për të kompozuar Agoratë, Grekët u bazuan në proporcionet 3:2 për të përcaktuar përmasat e drejtkëndëshit të sheshit⁴⁸. Duket kështu se portiku me 23 kollona, si ndërtim i shek III p.e.s. kërkon të respektojë këto rregulla që, tashmë në periudhën helenistike, duhet të ishin konsoliduar, duke u pozicionuar në vendin që e gjejmë sot.

Objekti i quajtur si faltore apo si 'Banesa me mozaik', duhet të ketë qenë aty prej shek. IV p.e.s.⁴⁹. Dy muret me blloqe të mëdhenj e të rregullt guri, të zbuluar poshtë dyshemesë së saj mund të jenë pjesë e një kufizimi të hershëm të Agorasë nga perëndimi, si një sistemim tarrace, duke parë edhe ndryshimin e menjëhershëm të terrenit në rënje në atë drejtim. Theksojmë se të nisur nga fakti që këto dy parete të më-hershëm futen në rrjetin blu të qytetit të parë, mund të hedhim hipotezën se ato janë pjesë e një ndërtimi më monumental, Stoa, apo më shumë propile. Këtë ide na e përforcon edhe mënyra e kujdesshme e ndërtimit me gurë të mëdhenj e të latuar, si dhe fakti që aty u gjenden edhe fragmente të një kollone Dorike dhe të një frize dekorative.

Këtë ide të një sistemimi në formë tarrace apo të përfundimit me një propile na e përforcon edhe pozicioni gjeografik i saj, në të cilin imagjinojmë që, po të qëndronim si Apollinatë të lashtë, do të kishim një hapje të bukur panoramike e perspektive mbi fushën përpara e më tej mbi detin deri në pafundësi. Duke ju referuar mënyrave se si Grekët e lashtë i orjentonin sheshet e tyre publike apo edhe vetë sistemet rrugore të qyteteve të tyre⁵⁰, kuptojmë se një pozicion i tillë panoramik do të ishte i preferuar për të vendosur aty një propile. Në momentin e daljes nga Agoraja të gjithë do të kishin një pamje spektakolare mbi fushë e det, të ngjashme me atë që shijonin edhe Athinasit e lashtë kur dilnin nga Akropoli.

Mbetet për tu diskutuar fakti i orderit me të cilin ishte ndërtuar pasi tamburi dorik dhe friza e dekoruar (karakteristikë jonike) na lenë të mendojmë për një ndërthurje dorik-jonik si në propilenë e akropolit të Athinës. Kjo mund të mbetet çështje e një hulumtimi të mëtejshëm jashtë këtij studimi, i cili nuk e trajton për arsye të pamjaftueshmërisë së mbetjeve arkeologjike. Mëgjithatë, duke ju referuar Propileve të thjeshta si ajo e parcelës së shenjtë në Selinus, (foto më lart) mund të propozojmë vetëm planimetrinë hipotetike, sa për të mbështetur idenë tonë kompozicionale për Agoratë.

Agoraja mes kodrave mund të "hapej" vetëm në perëndim në një Propile që siguronte hyrjen jo vetëm në të por, si një çernierë, të çonte edhe në pjesën tjetër, qendrën monumentale të mëvonshme të pozicionuar në perëndim të Temenosit. Kujtojmë që fillimet e qendrës së sotme monumentale Agorasë-Forum duhet të kenë qenë të njëkohshme me ato të Agorasë mes kodrave, me dy ndërtimet e Stoave me nikje të shek.

⁴⁸ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910) f.132

⁴⁹ (Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj, 2004) f.183

⁵⁰ (Urma, 2008-09) f.4-8

IV p.e.s. Kështu, ne mund të hipotezojmë një vendosje planimetrike të Agorasë së shek. V-IV p.e.s. si një shesh me hyrje aty ku sot është ndërtesa me mozaik.



Figure 17. Pamje ajrore e zonës së dy Agorave, Planimetri ku janë vendosur vetëm objektet e zbuluar deri më tani. Në dy pamjet poshtë djathtas bëjmë një krahasim të pamjes që duket nga propile hipotetike në drejtim të Fushës e detit, me atë që duket nga propilejtë e Akropolit në Athinë. Grekët preferonin dhe favorizonin pamje të tilla të pejsazhit.

Ndër dy Stoa të me nikje, ajo që është në rrëzë të kodrës 104 do të jetë në një drejtim të ndryshëm nga ai i sistemit rrugor blu, ndërsa tjetra, ajo që sot gjendet poshtë Bibliotekës do të përputhet tërësisht me sistemin e kuq të mëvonshëm rrugor.⁵¹

2.4.3 Agoraja - Forum

Ndërtimet e fazës së dytë dhe të katërt do të përkasin Agorasë në perëndim të Temenosit, e cila njihet më mirë - në këtu e quajmë Agoraja-Forum. Tek ajo vëmë në dukje Stoa të me nikje cilindrike në murin e pasëm të cilat u ndërtuan në shek. IV p.e.s. dhe duket se kufizonin një hapësirë publike të asaj kohe. Një mënyrë e tillë ndërtimi mbetet e veçantë për Apolloninë⁵². Duke parë pjerrësinë e terrenit kuptojmë që forma cilindrike e nikjeve dhe sidomos mbulesa e tyre gjysëm-kupolare do të ndihmonte në mbajtjen e kodrës duke kundërshtuar si kundraforsa rrëshqitjen e dherave. Ceka e quan përdorimin e harqeve e të

⁵¹ (Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saimir Shpuza,, 2014), f. 33

⁵² (Ceka, Apollonia, 2005) f. 10-38

qemerëve si një influencë të Epirit, Maqedonisë dhe Akarnanisë⁵³. Ndërkohë që, duke parë ndërtimin e tyre me gurë të mëdhenj, duket sikur na kujtohen forma nga ndërtimet megalitike të zonave të Europës apo me gurët ciklopikë të Mikenës së lashtë. Një hark të rremë e të ngjashëm me ato të periudhës arkaike e gjejmë edhe tek hyrja për në Temenos si edhe tek hyrja e kanalit pranë obeliskut.



Figure 18. Hyrja në Temenos, porta e luanit në Mikenë, hyrja në varrin e Agamemnonit përdorin hark të rremë që shkarkon vetëm vertikalisht në bazë të parimit të spostimit gradual të gurëve në formë trekëndëshi.

Kujtojmë që, në Greqinë e lashtë, ligji konstruktiv i sistemit trilitik tra – kollonë, ishte një rregull dominues estetik, e ato nuk ndërtuan asnjëherë harkun e gurtë, veçse në fillimet e periudhës helenistike. Një risi e tillë, sidomos brenda një tipologjie të mirëformuar, siç ishte Stoaja Greke, ishte një “guxim ilir” për të ndryshuar rregulla të ngurta e strikte të estetikës së qyteteve helenistikë. I përdorur edhe në Stoa të Dimalit (një qytet në prapatokën e Apollonisë) kjo veçori kompozicionale mund të quhet gjurma Ilire në arkitekturë. Në fakt duhet vënë në dukje fakti që këto “devijime estetike” ndaj rregullave do të “fshihen” në pjesët e brendshme të Stoave, duke treguar kështu edhe një prirje gati të imponuar për të respektuar në eksterier imazhin e rregullt e të bukur të një ndërtimi tipik Grek.

Tek Harta arkeologjike e Shqipërisë, N. Ceka⁵⁴ na e lokalizon kronologjikisht modelimin e Agorasë monumentale në shek. II e.s. dhe e cilëson si një rimodelim që e gjeometrizoi atë si një Forum Romak. Mbështesim këtë duke u bazuar edhe në njohjen e tipologjive urbane Romake, të tilla si Forumi, të cilat si sheshe të rëndësishëm të pushtetit perandorak kishin respektuar rregulla të një simetrie absolute të vendosjes së objekteve në lidhje me akset kryesore, simetri që, edhe pse jo e arritur tërësisht, duket se u kërkua edhe në Apolloni.

Në Agoranë perandorake do të mund të përdorim emrin Forum edhe për vetë prezencën e Odeonit dhe të Bouleuterionit por, mbi të gjitha, të Harkut të Triumfit. Kështu, për të bërë diferencimin me Agoranë mes kodrave, do ta quajmë Forum këtë qendër

⁵³ ibidem

⁵⁴ Op. Cit.

monumentale, duke ndihmuar edhe terminologjikisht diferencimin mes tyre. Pjerrësia e terrenit dhe sipërfaqja e pakët e sheshtë në dispozicion për të ndërtuar një shesh, duket sikur kushtëzojnë vendosjen e këtyre objekteve relativisht mjaft pranë njëri – tjetrit. Dy fasadat, gati paralele, influencojnë në mbylljen e perspektivës në skajin jugor që do të kufizohet me një tjetër objekt – Bibliotekën. E ndërtuar mbi nikjet cilindrike të Stoasë para-ardhëse, ajo do të na kujtojë tipologji të ngjashme me Forumet perandorake, si ai i Trajanit në Romë, në të cilat në fund të aksit të shikimit vendoset një objekt që mbyll perspektivën. Urma⁵⁵ dhe Nutgens⁵⁶ na theksojnë se kjo ishte një karakteriatikë tipike e Hapësirave publike në Romën e lashtë. Kështu, në këtë Agora gjejmë gjurmë të forta Romake në formulimin kompozicional por edhe në tipologjitë e përdorura.

2. 4. 4 Analizë hapësinore e vendosjes së objekteve

Tek Agoraja Forum do të kemi një dendësim objektësh monumentalë, ndër të cilët edhe Harku i triumfit, që na shtyn të bëjmë analizë kompozicionale e hapësinore më të thellë. Duhet të theksojmë se mbetet unike për Ilirinë rasti i përdorimit të një Harku triumfi brenda sheshit të qytetit. Ky objekt i mirëfilltë memorial, pa ndonjë rol utilitar, pozicionohet në pjesën fundore, dhe mbetet rasti i vetëm i ndërtimit të një Harku Triumfi në krejt territorin Ilirik. Ajo që na bën përshtypje është pozicioni i pazakontë i tij, i cili na krijon paqartësi e pyetje të lidhura me vendosjen dhe raportin kompozicional që ai ka me objektet e tjerë. Një vendosje e tillë, krejt ngjitur me fasadën e Bouleuterionit në një vend të ngushtë e që i kthen fasadën anësore aksit të simetrisë, nuk justifikon rëndësinë që duhet të ketë një Hark Triumfi.

I lindur si një tipologji memoriale, ceremoniale, ai u përdor në arkitekturën Romake si një objekt kyç në hapësirat e Forumeve apo në anë të rrugëve kryesore të qytetit. Të tillë e kujtojmë në Forumet në Romë, në atë Republikan e Perandorak, apo dhe në qytete të tjerë të Perandorisë, si në Tingad në shek. I e.s.. Në Agoranë e Apollonisë ai do të jetë objekti i fundit që do të ndërtohet në Forum, do të thotë në momentin kur kompozimi hapësinor i sheshit ishte kompletuar. Normalisht në princip do të preferohej që ai të ishte në hyrjen e Forumit apo në fundin e perspektivës së saj. Nëse i referohemi në planimetri mundësive të vendosjes së tij do të shqyrtonim alternativat kompozicionale që do të na ofroheshin. Tek hyrja nga veriu, do të ishte i papërshtatshëm pozicioni i tij pasi do të dublohej e djalizohej roli i Propilesë, tashmë ekzistuese, (asaj që hipotezuar si Propile mbi ndërtesën me mozaik), ose s'do të shënonte një pikë të rëndësishme që duhej të sillte nga qyteti, ashtu siç duhej të preferohej nga parimet e arkitekturës Romake. Nga gjërmimet e deritanishme nuk ka dalë një rrugë e gjërë apo kryesore në pjesën veriore të qendrës monumentale, që të mendojmë se ajo pikë privilegjohej si hyrje kryesore e Forumit.

⁵⁵ (Urma, 2008-09), f. 4-8

⁵⁶ (Nuttgens, 2001), f. 93

Ndërkohë, një rrugë e tillë është zbuluar në krah të kundërt, në anë të Bouleuterionit, çfarë tregon që ky drejtim përëndim lindje ishte hyrja e re e Forumit në momentin e riorganizimit të tij në shek.I-II e.s. kështu Harku vendoset në fund të perspektivës së kësaj rruge duke pozicionuar aksin e simetrisë së vet në trajektoren e saj (rrugës). Duket sikur këto rrugë do të trajtohen si nje Cardum e Decumanum Romake.

Pasi trajtuam këtë vendosje kompozicionale të objekteve në shesh, interesante është ta shqyrtojmë atë në kuadrin e parimeve kompozicionale sipas sistemit polar që përdornin Grekët e lashtë. Duke ju referuar Doxiadis⁵⁷, mësojmë se për Grekët kishin shumë rëndësi akset vizualë si dhe mundësia që objektet të mund të shihen të plotë e jo të pjesshëm.




Figure 19. Pozicionimi i Harkut të Triumfit në fund të dy rrugëve, do të favorizojë shikimin e tij në të dy momentet e hyrjes për në Agoranë-Forum. Me vija të ndërprera të kuqe tregohet mundësia e shikimit nga rrugët hyrëse.

⁵⁷ (Doxiadis, 1972)



Figure 20, Pamje nga rruga kryesore hyrëse ne Forum, Harku dhe Bouleuterioni perceptohen tërësisht, ndërkohë që vëllimi Harkut nuk e mbulon Bibliotekën.




Figure 21, Pamje nga rruga hyrëse në Forum, Harku (i ngjashëm me atë në figurën djathtas) pengon tërësisht Odeonin, po lejon të shihet hyrja e tij.

Nëse do të shqyrtojmë vendosjen planimetrike të objekteve në Forumin e Apollonisë para se të ishte ndërtuar Harku, do të kuptojmë që të gjithë objektet do të dalin me fasadën e tyre në shesh e secili do të perceptohet plotësisht nga pika e hyrjes-Propileja (banesa me mozaik).

Ndërkohë që Harku i Triumfit do të ndryshonte këtë situatë në çfarëdo pozicioni që do të vendosej – përveçse në atë që me kujdes duket se u zgjodh në atë kohë. Alternativat e vendosjes së tij në aspektin e perspektivave vizuale, mund ti shqyrtojmë në planet me pozicionet hipotetike.

Harku në hyrje do të mbulonte tërësisht pamjen e të gjithë objekteve tashmë të ndërtuara.

Harku në mes, sipas aksit të simetrisë së Forumit përsëri do të mbulonte objektet, pavarësisht se pjesërisht ato do të dukeshin, kjo do të ishte kundër parimit të grekëve që Doxiadis analizon, sipas së cilit objekti, prej akseve kryesorë vizuale përspektive nuk mund të dukej i pjesshëm⁵⁸.




Figure 22. Pozicionimet e mundshme të Harkut të Triumfit: Majtas në afërsi të Bouleuterionit dhe Odeonit, për të mbyllur sheshin para tyre si një drejtkëndësh; djathtas, në hyrje të Agorasë Forum si shpesh vendosej në Forumet Romakë. Zona gri mes rrezeve të shikimit nga propilejtë, tregon pjesën që ai do të mbulonte me volumin e tij.



Figure 23, majtas, Pamje nga ndërtesa me mozaik (Propile hipotetike) në drejtim të Agorsë mes kodrave, në mes: Pamje nga Agora mes kodrave në drejtim të Propilesë hipotetike, djathtas: Pamje nga Propileja hipotetike në drejtim të horizontit.

Duke parë planin e Forumit me pozicionin aktual të Harkut të Triumfit, kuptojmë se i vetmi pozicion në të cilin Harku nuk pengon shikimin e objekteve nëse hyjmë nga Propilejtë, është ai në të cilin Harku u ndërtua.

Vërejmë kështu se parimet Greke të kompozimit të hapësirave vazhdojnë të ruhen edhe në këtë rast, pavarësisht se në një kompozim të periudhës Romake.

⁵⁸ (Doxiadis, 1972)




Figure 24. Plani i Agorasë-Forum ku shihen kënd-shikimet nga pika të ndryshme të sheshit (majtas) dhe mundësia e shikimit nga hyrja veriore në shesh, ku dallojmë se Harku i triumfit nuk pengon fasadat e tre objekteve të rëndësishëm; Bouleuterionit, Odeonit dhe Bibliotekës.

Në këtë analizë duhet të kemi parasysh kohën në të cilën u ndërtuan të dy qendrat dhe lidhjen e tyre jo vetëm kronologjike por edhe kompozicionale, lidhje që arkitektonikisht bëhej nëpërmjet Propilejve që të fusin në qendrën Romake e që shërbenin si një nyje lidhëse me hapësirën helenistike.

Ndërkohë që po të arrijmë në Forum nga rruga në anë të Bouleuterionit, Harku do të mbulojë tërësisht Odeonin, e vetëm pasi të kalosh poshtë tij, do ta perceptosh atë, nën efektin e surprizës dhe monumentalitetit që Romakët parapëlqenin. Theksojmë se sipas Doxiadis, Romakët e konceptonin hapësirën si një interior skenografik, të mbyllur e që i kthente kurrizin qytetit, ndërkohë që sipas akseve ai duhet të perceptohet i plotë kur je brenda tij⁵⁹. Ndryshe prej tyre Grekët e perceptonin sheshin si pjesë të hapësirës së përgjithëshme të qytetit. Në këtë mënyrë, pozicionimi i Harkut aty ku e gjejmë sot do të kënaqë parimet Greke, kur vjen prej Agorasë helenistike, me të njëjtën frymë e parim kompozicional, por do të ofrojë tjetër spektakël të denjë për Perandorinë, kur arrin në Forum nëpërmjet rrugës perëndim-lindje, në krah të Bouleuterionit.

⁵⁹ (Doxiadis, 1972)



Figure 25, Pamje nga hyrja në Forum nga ana e porpilejve, Harku i Triumfit perceptohet në profil dhe lejon të shihet i plotë vëllimi i Bibliotekës



Figure 26. pamje nga Qyteti i Athinës së sotme⁶⁰, ku ilustrohet ideja e akseve rrugorë që kthehen në akse vizuale, duke hapur shikimin drejt horizontit e pejsazhit, pa e kufizuar atë. Edhe sistemi i rugëve të qytetit në Apolloni, i orientuar nga deti duket se është përcaktuar për të favorizuar pamje të tilla spektakolare.

2. 4. 5 Karakteristikat kompozicionale

- Fillimisht në shek. VI p.e.s. u formulua hapësira e Agorasë mes dy kodrave e cila në shek III p.e.s. u kufizua në veri e jug nga portikë.
- Nga gërmimet arkeologjike rezulton se objektet: tempull, magazina e strukturat në anën perëndimore të portikut të madh janë shtuar vetëm rreth shek I e.s duke na lënë të imagjinojmë që fillimisht Agoraja mes kodrave kishte një formë të

⁶⁰ (Urma, 2008-09) f. 4-8

rregullt drejtkëndore që përfundonte në perëndim në murin e shkallëzuar i cili në pjesën më të ulët të tij kishte të njëjtin nivel me atë të portikut me nikje⁶¹. Besojmë se ai shërbente si një vëllim lidhës mes nivelit të rrafshinës së Agorasë e atij të hapësirës para Portikut me nikje⁶².

- Kjo Agora arkaike mund të kishte si mbyllje perspektive strukturat murale që gjenden sot poshtë banesës me mozaik. Duke u gjetur aty edhe një fragmente të një kollone dorike e frize dekorative, duhet të imagjinojmë një strukturë monumentale apo edhe qoftë me kërkesa estetike si një propile apo edhe Stoa. Mund të mbështesim hipotezën e një Propileje duke qenë se në atë pikë mund të bëhej hyrja nga perëndimi, hyrje që bëhej në fundin e një ngjitjeje perëndim lindje që të sillte nga qyteti. (është e natyrshme të bëjmë një analogji pozicionale të saj me rrugën e Propilejtë e Akropolit të Athinës) Duke vazhduar më tej këtë ide kuptojmë se edhe pamja në drejtim të kundërt, pra nga deti duhet të këtë qenë spektakolare e mahnitëse ashtu si ajo prej Propilejve të Akropolit të Athinës.



Figure 27. Pamje e sheshit të Agorasë Forum nga shkallët e Odeonit. Odeoni dhe Bouleuterioni përballë njëri tjetrit dhe Harku i Triumfit në hapësirën mes tyre, por shumë pranë fasadës së Bouleuterionit.

- Të dy sheshet do të kufizohen nga Stoa të gjata me një radhë kolonash në mes, të cilat ngjajnë me ato të qyteteve helene.

⁶¹ (Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj, 2004) f. 180-184

⁶² Vëmë re se niveli i mureve poshtë banesës me mozaik i korrespondon nivelit të stilobatit të stoasë me nikje. Këtë të dhënë topografike e gjejmë tek: Les fouilles franco-albanaise d'Apollonia: 1994-2004, dhe na shtyn të mbështesim edhe më tej hipotezën e ekzistencës aty të një strukture të njëkohshme me stoatë me nikje, e cila të këtë shërbyer si hyrje për Agoranë mes kodrave por edhe si një çernierë lidhëse me sheshin para këtyre stoave .

- Në Agoranë e periudhës perandorake mund të përdorim emrin Forum, pra ti japim një konotacion Romak, për vetë prezencën e Odeonit dhe të Harkut të Triumfit. Këto dy objekte janë shpesh pjesë e Forumeve Romake duke perferuar që me fasadën e tyre të shohin në sheshin qëndror, ndërkohë që në Agoratë Greke ato do të ndodhen pranë sheshit por jo me dalje direkte në të.
- Pjerrësia e terrenit dhe sipërfaqja e pakët e sheshtë, kushtëzojnë vendosjen afër të fasadave të Odeonit e Bouleuterionit, të cilët të ndërtuar gati njëkohësisht e kanë të pamundur të distancohen më shumë nga njëri-tjetri. Përmasa e ngushtë e këtij sheshi në pjesën fundore do të theksojë edhe më shumë raportin jo të drejtë proporcional të tij.




Figure 28. Qendra monumentale dhe objektet që ndodhen në të, sëbashku me kohën e ndërtimit.

- Si një influencë Romake, mbetet unik për Ilirinë fakti i përdorimit të një Harku Triumfi brenda Agorasë, si një objekt memorial e pa rol utilitar. Mund të interpretojmë këtë fakt edhe në raport me Agoratë helene në të cilat në asnjë rast nuk gjejmë përdorimin e një monamenti të tillë perandorak. Duket sikur të qenurit larg e gati të distancuar nga traditat e mirëfillta helene do ti ndihmojë arkitektët të tolerojnë daljen nga rregulla strikte kompozicionale, vetëm e vetëm, për të arritur me çdo kusht monumentalitetin. Duhet të këtë qenë ky monumentalitet i kërkuar me çdo kusht që në një periudhë prosperiteti ekonomik e supermacie politike, u bë

shtysë për një ndërtim të tillë triumfal. Kujtojmë se Apollonia ishte për shumë kohë një qytet i pavarur e në marrdhënie të mirë me perandorinë Romake.

- Stoja me nikje e shek. IV p.e.s. është një veçanti konstruktive e kompozicionale e Apollonisë. “*Monumenti është konceptuar në një stil lokal, ekstremisht interesant e kurioz*“ shprehet Leon Rey kur i paraqet akademisë një plan të përgjithshëm të gërmimeve sëbashku me portikun dhe e datonte atë gabimisht si ndërtim të shek. I-II e.s. E pahatur në ndonjë qytet helen, ajo do të përdoret në të njëjtën kohë kronologjike edhe në një tjetër qytet ilir, në Dimal. Kujtojmë se sistemi tra-kollonë ishte ligj konstruktiv e estetik për arkitekturën Greke, e harku do të përdorej vetëm në periudhën e vonë helenistike. Ndërkohë në Apolloni mbulesa e kurbëzuar e nikeve do të shërbejë si kundraforcë për mbështetjen e kodrës – një mënyrë origjinale kjo për të përballuar një problem serioz gjeologjik.
- Në ndërtimin e Stoa së do të përdoren kollonat tetëkëndore si gjetje për të arritur rezultate minimale estetike me kosto sa më të ulët, ndërkohë që duhet të theksojmë rolin që luan ajo si një kufizuese gjatësore e ritmike e njërit krah të sheshit. I njëjti vëllim i ngjashëm me të do të jetë edhe në brinjën tjetër të ngushtë të sheshit, në fasadën anësore të Bouleuterionit. Të dyja këto Stoa do të kishin krijuar sfondin e bukur me kollonada si në Agoratë e qyteteve simotra helene.

2.5 Agoraja në Dimal

Ndërkohë karakteristika stilistike të ngjashme me Apolloninë do të duken në Dimal.

Dimali (apo siç njihet sot, Kalaja e Krotinës) ishte një qytet në prapatokën e Apollonisë, në shpatin e malit të Shpiragut, e lokalizohet në histori në shekujt V p.e.s. si koha kur u vendos vendbanimi i parë në Akropol, dhe në shek. IV – III p.e.s. si faza e ndërtimeve monumentale të qytetit⁶³. Banimi aty ka filluar me ndërtimin e Akropolit, që sot na prezantohet me kufizimin nga muri rrethues, ndërkohë që me zgjerimin e qytetit ai do të dalë jashtë mureve e do të ndërtojë një tjetër rrethim që sot njihet pjesërisht.

Prej këtij qyteti janë zbuluar dy Stoa, ndër të cilat njëra shfaq të njëjtën karakteristikë të vendosjes ritmike të nikjeve cilindrike. Ajo do të ndërtohet në të njëjtën teknikë të gurëve të mëdhenj të vendosur në të thatë të parë edhe në Apolloni, me të cilën, nëse bëjmë krahasim kronologjik do të dallojmë se është e njëkohshme.

Nuk ka të dhëna të ekzistencës së një rrjeti të rregullt rrugor, pavarësisht se ajo që bie në sy është përpindikulariteti gati i saktë gjeometrik i të dy Stoaëve. Duke qenë se ato janë zbuluar vetëm pjesërisht, e duke ditur se Stoa të zakonisht ishin struktura të gjata (gati 100m apo më shumë) konturuese të shesheve, mund të hedhim hipotezën se ato mund të

⁶³ (N. Fenn, M. Heinzelmann, I. Klenner, B. Muka, 2010), f. 5

kenë qenë pjesë e shesheve në formë Agoraje të vendosur në ato pak pjesë të sheshta që terreni ofronte.




Figure 29. Dimali, plan topografik, plan dhe pamje e Stoaës me nikje.

Duke parë izoipset e shpeshta të kodrës imagjinojmë se duhet të ketë qenë gati e pamundur për qytetin të aplikonte një sitem të rregullt ortogonal sipas atij Hipodamik. Kujtojmë se sipas Hipodamit drejtimi i rrugëve përpjendikulare nuk kushtëzohej nga terreni por nga drejtimet e horizontit, gjë që e bënte vështirësisht të përdorshëm këtë sistem në terrene të pjerrët, pasi rrugët shpesh ktheheshin në shkallare të pa kalueshme nga mjetet mbi rrota⁶⁴.

Megjithatë, në hapësirën ndërmjet Stoave, në vitin 2010 Arkeologët e Universitetit të Këlnit⁶⁵ lokalizuan Teatrin, si një strukturë që shfrytëzonte pjerrësinë e kodrës për të gdhendur shkallaren. Me teatronin (shkallaren) të orientuar drejt perëndimit, ai duhet të kishte skenën paralele me linjën e Stoaës pas saj. Teatri është prova e qartë e një qyteti me kërkesa të larta artistike e arkitektonike të dikurshëm, në të cilin në të ardhmen mund të gjejmë të tjera mbetje arkeologjike që do ta dëshmojnë këtë.

Nëse rindërtojmë në planin topografik linjat gjysmërrethore të kurbave të shkallares, do të imagjinojmë Teatrin si një strukturë që shihte me fytyrë nga Agoraja hipotetike.

Spektatorët në një Teatër grek kishin mundësi të shihnin përtej skenës së ulët duke shijuar plus spektaklit edhe një pamje të bukur panoramike⁶⁶.

Po ti referohemi planit topografik do të kuptojmë se kodra në shpinë të Teatrit, dikur e Akropolit, do të ishte pika më e lartë e qytetit e më pas terreni do të jetë në zbritje drejt pllajës në të cilën duhej të shtrihej pjesa më e rëndësishme e qytetit. Kjo pllajë mund të

⁶⁴ (Greco, 1999) f, 195

⁶⁵ (N. Fenn, M. Heinzelmänn, I. Klenner, B. Muka, 2010) f, 5

⁶⁶ (Urma, 2008-09), f. 4-8

ketë qenë pjesa e vetme ku mund të zbatohet sistemi Hipodamik i rrugëve e insulave katërkëndore.

2. 5. 1 Karakteristika kompozicionale

- Agoraja duhet të ketë qenë në formë kuadratike, të cilën nuk mund ta përcaktojmë tërësisht pa patur të dhëna të tjera nga zbulimet arkeologjike.
- Nga forma dhe orientimi i shkallares së Teatrit, jemi në gjendje të imagjinojmë e përfytyrojmë formën e skenës, duke e trasuar atë si një vëllim me bazë drejtkëndore e me brinjë gjatësore paralele me Stoaën para saj. Kujtojmë që kjo situatë e paralelizmit të mureve gjatësorë të skenës dhe atyre të Stoaës ishte një situatë e shpeshtë në morfologjinë e Agorave helene.




Figure 30. Plani i qytetit Dimal në të cilin janë trasuar linjat e Teatrit të zbuluar.

- Duke imagjinuar një Agora para Teatrit, duhet të theksojmë si karakteristikë të saj, afërsinë me Teatrin, apo dëshirën që në qendrën publike të qytetit të mund të inkludohet edhe Teatri. Agora e Teatër janë dy struktura që në qytetet helene pothuaj asnjëherë nuk gjenden pranë njëra-tjetrës.
- Stoja me nikje do të jetë një strukturë e ngjashme me atë të Apollonisë e do të përdoret përsëri si një strukturë mbajtëse për pjerrësinë e kodrës.

2. 6 Agoraja në Bylis

Duke u spostuar më në thellësi në prapatokë, gjejmë **Bylis** (shek. IV-III p.e.s.) i cili u ndërtua nga Bylinët të cilët banonin paraprakisht në Nikaia (Klos i Sotëm). Kur qyteti u

rrit, duke mos pasur vend në kodrën e vogël, ata e transferuan qytetin atë në një kodër pranë, vetëm 1 km larg, aty ku sot gjejmë parkun arkeologjik të Bylis⁶⁷. Një fakt i tillë na ndihmon të gjejmë arsyen e rregullsisë së qytetit i cili duket sikur është bërë me një plan të mirëfilltë urban të para konceptuar.

Qyteti rrethohet me mur fortifikues që kufizon një sipërfaqe prej 30 hektarësh. Formimi i qytetit zgjat rreth një shekull – kohë në të cilën u mbledhën mjetet financiare për të ndërtuar dhe organizuar sistemin urban dhe qendrën e tij monumentale⁶⁸.

Në mesin e shek. III p.e.s. u ndërtua sistemi rrugor i qytetit dhe Agoraja e tij. Plani i qytetit i zbuluar deri tani na jep ekzistencën e një rrjeti rrugor sipas Sistemit Hipodamik, në të cilin, rrugët kryesore e dytësore, të dallueshme nga gjerësia e tyre, vendoseshin përpjendikular njëra-tjetrës duke e ndarë sipërfaqen në insula, apo qeliza kuadratoke banimi.




Figure 31. Bylis, pamje ajrore, plani i qytetit, plani I Agorasë

Duke ju referuar një rikonstrukcioni planimetrik hipotetik të Agorasë⁶⁹, mund të reflektojmë mbi vendosjen kompozicionale të objekteve në të. E vendosur në pjesën më piktoreske të qytetit, Agoraja do jetë në skajin e tij dhe do të përfundojë e kufizuar nga muri i jashtëm rrethues. E konceptuar në një mënyrë të ngjashme me Agoratë e qyteteve

⁶⁷ (Cabanes, 1/1986) , f.107-142

⁶⁸ (Neritan Ceka, Skender Muçaj, 2004)

⁶⁹ Planimetrinë mund ta konsultjmë në , f. 28

helenistike, ajo do të kompozohet në formë të mbyllur e me sipërfaqe gati të rregullt drejtkëndore. Dy muret rrethues me kundraforsa, i gjejmë sot në krahët e jashtëm të saj dhe në origjinë, ishin edhe mur i jashtëm i dy Stoa kryesore - Stoa A dhe Stoa B. (stoatë mbështeteshin në murin rrethues të Agorasë) Nga N. Ceka⁷⁰ gjejmë kronologjinë e veprave brenda sheshit në të cilën diferencohet si pak më e vonë faza e Teatrit dhe e Stoa B pranë tij. (rreth viteve 250 p.e.s.).

E filluar me Stoa A në formë “L” (rreth viteve 270 p.e.s.), Agoraja parashikohej të kapte hapsirën e 3 insulave banimi. Bindemi më shumë për tendencën e respektimit të formës së rregullt drejtkëndore po të analizojmë pozicionin e Stadiumit. Shkallarja e tij shfrytëzon pjerrësinë e terrenit dhe vendoset si kufizuese e sheshit nga ana perëndimore; ndërkohë që hyrja pozicionohet në krah të tij.

2. 6. 1 Karakteristika kompozicionale

- Duke analizuar kompozimin e saj kuptojmë se ajo është konceptuar në një mënyrë të ngjashme me Agoratë e qyteteve helene, me formë të mbyllur e me sipërfaqe gati të rregullt drejtkëndore. Pozicioni i Stadiumit reflekton tendencën për të përcaktuar këtë formë të mbyllur katërkëndore të vetë Agorasë duke e kthyer atë si një qëllim kompozicional më vete. Shkallarja e tij shfrytëzon pjerrësinë e terrenit dhe vendoset si kufizuese e sheshit nga ana perëndimore; ndërkohë që hyrja pozicionohet në krah të tij.
- Stoa A e ndërtuar rreth vitit 270 p.e.s. në formë ‘L’ me dy kate me stilin dorik e jonik do të ketë kollonat e poshtme tetëkëndëshe si në Apolloni apo Klos e Dimal duke u bërë një karakteristikë e ngjashme me to, e do të bëhen gjurma Ilire e këtij ndërtimi.

*[...]Kollonat tetëkëndore ishin një formë e shpeshtë në qytetet apo kolonitë Greke. Në shekujt e periudhës arkaike ato gjenden në qytete të Greqisë kontinentale e më vonë, në periudhën klasike e helenistike, ato do të ndeshen edhe në lokalitete të tjera ndër të cilat edhe ato Ilirike të Apollonisë, Butrintit, Bylisit, Foinikes. Në këto qytete ato përdoren në oborre të brendshëm të tipit peristil apo në objekte publike e hidraulike, por asnjëherë në objekte kulti[...]*⁷¹. Të ndeshura që në kohën Egjiptit të vjetër dhe asaj së Mikenës, ato nuk janë aspak influencë e atyre kulturave por mendohen të kenë rrjedhur nga eksperiencia e ndërtimit me dru dhe nga domosdoshmëria për të arritur me një kosto të vogël një efekt minimal estetik në veprat e ndëruara. [...]Të presësh një kollone tetëkëndëshe është më e thjeshtë, më e shpejtë e, si pasojë, më ekonomike[...]⁷²

⁷⁰ Ibidem. f. 28-32

⁷¹ (Hellner, 2/2011) f, 246

⁷² (Hellner, 2/2011) f, 246

- Stoa B e Teatrit do të risë me qëllim sipërfaqen e sheshit me dëshirën për të futur në qendrën monumentale edhe Teatrin. Terreni do të mundësojë ndërtimin e Teatrit të tipit grek që këtu vërtet mbart karakteristikën e njohur të hapjes së shkallares drejt peisazhit. Një pejsazh të tillë me një shikim të tillë mbi luginën e Vjosës e në thellësi deri në reflektimin e detit në perëndim, do ta kishte zili çdo Teatër grek. Skena, me lartësinë e ulët, nuk pengonte syrin të përfshinte të gjithë pamjen e bukur të natyrës. E vogël në sipërfaqe e me lartësi dy katëshe, ajo do të jetë një volum i parëndësishëm në krahasim me shtrirjen gjatësore të Stoa B. Ritmi i vazhduar i vertikalisht të kollonave të saj që vendosen radhazi në një kompozim gjatësor paralel me aksin e simetrisë së Teatrit, do të zvogëlohej ndjeshëm nën efektin e perspektivës e do të ndihmonte si një shigjetë arkitektonike hedhjen e shikimit drejt luginës përballë. Stoa B përfundonte në Portën 5 që shërbente edhe si një propilë për banorët e qyteteve pranë si në Nikajë.



Figure 32. Bylis Pamje nga shkallarja e Teatrit sot.

Vërtet një Teatër grek ka karakteristikën që prej shkallares mund të shihet peisazhi, por mendoj se kjo vjen si një pasojë e morfologjisë së Teatrit. I gdhendur në shkëmb, me shkallare që ngrihen deri në lartësinë e kodrës, ky teatron (cavea) do të ishte gjithmonë një volum shumë i lartë në krahasim me ngritjen dy katëshe të skenës, duke u bërë arsyeja kryesore se pse një Teatër grek nuk arriti asnjëherë të krijonte idenë e një interieri të mirëfilltë arkitektonik. Në këtë rast, për Agoranë e Bylis-it kjo do të ishte fatale, pasi do të krijohet ideja e humbjes në zbrazëti e nuk do të perceptohej ideja e sheshit. Kjo “mangësi” duket sikur në Bylis do të mundohet të ekuilibrohet nëpërmjet Stoa B. Në të vërtetë, nëse do të ngrinin volumin dykatësh të Stoa B, do të përfitonim një objekt që kërkon të kufizojë pamjen drejt luginës e jo ta favorizojë atë.

Në të vërtetë, kjo vendosje e Stoa B do të bëhet me dëshirën për të kufizuar Agoranë drejt një forme të sheshit të mbyllur, tipike për Agoranë helenistike, por tashmë me një objekt që largohet nga Stoa A me qëllimin që në lojën kompozicionale të sheshit të fusë edhe Teatrin. Kujtojmë që në qytetet e mëdhenj grekë si në rastin e Miletit apo Prienës, Teatri

ishte gjithmonë i shkëputur nga sheshi, pasojë kjo e një domosdoshmërie teknike për të pasur një shkëmb ku të gdhëndet shkallarja.

Ndërkohë që vetëm arkitektura Romake do të mundë më vonë të përfshijë Teatrin në sheshet qendrore, pasi mënyra e ndërtimit të tyre si struktura që ngrihen mbi mure e korridore radiale të mbuluar me qemerë, do ti japë mundësi ti ngrejë teatrot edhe në vende të sheshta, pra pranë shesheve qendrorë.

Nga këto që përshkruam, mund të themi se në shekullin III p.e.s. Bylis kishte, ndoshta, Agoranë më të bukur të qyteteve helenistike, që kishte korrigjuar kësisoj edhe mangësi kompozicionale të të tjerëve. Kjo Agora do të ketë të përfshirë në vetvete edhe Teatrin duke ja ka arritur kështu qëllimit Hipodamik të të mbledhurit në të njëjtin vend të të gjithë objekteve publike.




Figure 33. Milet, plan i qytetit, dallojmë shkëputjen e Teatrit nga Agoraja

2.7 Agoraja në Klos

Vendbanimi i parë i Bylinëve, pra qyteti prej nga u nisën për tu transferuar në Bylis ishte Nikaia (Klosi). Ky qytet ruan sot muret me gurë poligonalë të Akropolit (shek.V p.e.s.), Agoranë me një Stoa njëkatëshe (sh. IV p.e.s.), një Stadium me një krah si ai në Bylis dhe një Teatër të vogël për rreth 800 spektatorë të shek.III p.e.s.

Duke i rikonstruktuar këto objekte në shek.III p.e.s.kuptojmë se qyteti kishte vazhduar të ruante rëndësinë e tij edhe pas largimit të një pjese të banorëve për në Bylis⁷³.

⁷³ (Neritan Ceka, Skender Muçaj, 2004), f. 83




Figure 34. Nikaia, (Klos) plan i qytetit. 1. Teatri, 2. Stadiumi, 3. Stoa.

2. 7. 1 Karakteristikat kompozicionale

- Në Stoa, tashmë të përmasave jo shumë të mëdha, të zbuluara aty, gjejmë përsëri gjurmë të kollonave tetëkëndore, karakteristike kjo e ngjashme me Bylisin, por që u vu re edhe në Apolloni e Dimal.
- Teatri ndodhet pranë tyre, me aks kompozicional planimetrik paralel me akset gjatësorë të Stoave. Ai edhe pse i vogël në përmasa, do të ndjekë modelet e zakonshme helenë: do të gdhendet në shkëmb e do të ketë skenë dykatëshe me kollonadë.
- Nga rievimet e gjetjeve arkeologjike dallojme një rregullsi përpjndikulare në vendosjen e Stoasë, stadiumit dhe skenës së Teatrit, por nuk kemi prova për ndonjë sistem të rregullt rrugor që mund të kushtëzonte edhe një shesh të rregullt në formë.
- Me zbulimet e deri tanishme nuk arrijmë të konfigurojmë tërësisht formën e Agorasë por njëkohësisht habitemi edhe nga fakti se Teatri i kthen kurrizin Stoave dhe atij që mund të ishte sheshi qendror. I vetmi justifikim që mund të gjejmë për këtë vendosje mund të jetë terreni me pjerrësinë e tij natyrale, dhe preferenca që teatroni, shkallat e Teatrit të shihet në drejtim të pejsazhit panoramik.

- Megjithatë vlen për tu theksuar përsëri afërsia e Stoasë me Teatrin, pra preferenca për të vendosur pranë këto dy objekte me karakter shoqëror.



Figure 35. Klos, Teatri dhe Rikonstrukcioni hipotetik nga L.Papajani

2.8 Agoratë në Butrint

Situatë të tillë në të cilën Teatrin e gjejmë pranë e thuajse edhe pjesë të Agorasë na paraqet edhe Butrinti. Pozicioni i favorshëm gjeografik e kishte bërë që herët, një qendër të banuar nga fise peshkatarësh që shfrytëzonin pasuritë e liqenit, e që sipas legjendës ishin pasardhës të Trajanëve të lashtë⁷⁴. Fillimet e tij na vijnë që në shek. XII p.e.s., kronologjikisht bashkëkohës me Mikenën e lashtë. Në fund të shek VI p.e.s. në librin Europa nga Hakateu i Miletit do ta përmendë sëbashku me Apolloninë e Orikun si qytet Ilir, polis. Ndërkohë nga Ceka do të quhet një qytezë protourbane deri në shek. VII-V p.e.s.. Mund të themi se historia e tij si qytet fillon në shek.V p.e.s. kohë në të cilën kulti i lidhur me Asklepin, birin e Apollonit që kishte aftësi shëruese, e kishte bërë të famshëm Butrintin si një destinacion i preferuar.

Jeta nis në Akropol, brenda mureve rrethues në fragmentet e mbetura të të cilëve dallojmë tipologjinë e mureve ciklopikë, me gurë të mëdhenj e të parregullt, të vendosur në të thatë. Ndër ndërtimet e para përmendim tempullin në Akropol, i ndërtuar për nder të kultit të Asklepit nga i cili na mbetet sot vetëm stereobati e një arkitra me një figurë luani, i ripërdorur më vonë në ndërtimin e njëres nga portat e qytetit pasardhës, në portën e luanit.

Tempulli i Asklepit ndodhej pranë Agorasë, në pikën më të lartë që e dominon atë, ndërkohë që vetë faltorja e Asklepit, më poshtë do të bëhet shtysa për rritjen e zhvillimin e vendbanimit drejt formimit të vetë qytetit. Në shek. IV p.e.s. qyteti do të zgjerohet e do të ndërtohen muret e rinj si dhe Agoraja. Të shekullit të III p.e.s. janë ndërtimi i Teatrit në funksion të riteve të kultit e të ceremonive, i Stoasë dhe i Prytaneionit.

Duke patur këto lokalizime kronologjike është krijuar nga arkeologët forma e plotë e Agorasë në periudhën helenistike, që duhet të theksojmë se do të na paraqitet me

⁷⁴ (Hodges, 2006)

një formë të kompletuar arkitektonike, e cila në periudhën Romake do të “mbingarkohet” me ndërtime të tjera që do të zvogëlojnë hapësirën e sheshit.




Figure 36. Butrint, Agoraja në shek. III p.e.s.

I famshëm për faltoren e Asklepit, Butrinti i do të ishte në ata shekuj destinacioni i shumë vizitoreve nga zonat përreth, duke krijuar kështu mundësinë që të ardhurat nga dhuratat të shfrytëzoheshin për të ngritur edhe Teatrin e Stoa në si shërbime në funksion të ritit⁷⁵. Kujtojmë se edhe Teatrot në origjinë lindën si struktura në afërsi të tempullit të Dionisit e shërbenin si vende ku mund të zhvilloheshin cermonitë me pjesëmarrës të shumtë. Më vonë ato do të kthehen në vende të mirëfillta shfaqjesh artistike, që nuk kishin lidhje me ritin por që ruanin, si një rudiment apo edhe në respekt ndaj Hyjit, vetëm altarin e Dionisit në qendër të orkestrës.

Destinacion i fushatave arkeologjike të vazhdueshme prej dekadash, tashmë Butrinti do të jetë një prej qyteteve që njihet më mirë në të gjithë fazat evolutive të tij. Nga një rikonstrukcion i arkeologëve anglezë mund të kuptojmë Agoranë e periudhës helenistike, që do të vazhdojë të ruajë formën kompozicionale edhe në periudhën Romake. Në fakt duhet theksuar se Richard Hodges mendon se asnjëherë Butrinti nuk qe një koloni Greke, por vetëm Romake⁷⁶, kështu kur përdorim termin helenistik për të, e bëjmë vetëm për të patur parasysh periudhën kronologjike të njëjtë. Në mënyrë të vazhdueshme, shekull pas shekulli aty do të ndërtohen: Tempulli dhe Faltorja e Asklepit në shek. IV p.e.s., e më pas Teatri, Stojaja dhe Prytaneioni në periudhën nga shek. III p.e.s. deri në shek. I p.e.s..

⁷⁵ Ibbidem

⁷⁶ (Inge Lyse Hansen, Richard Hodges, Sarah Leppard, 2013), f. 1-20

[illegible]

Është kjo arsyeja pse e cilësojmë si të mbingarkuar tashmë këtë Agora-Forum i cili duket se e ka humbur rolin e sheshit apo qendrës së qytetit e, si një kompleks arkitektonik, është vendosur vetëm në funksion të ritit të kultit. Duket sikur tashmë rolin e sheshit do ta luajë orkestra e, shpejt më vonë edhe skena e Teatrit që do të rindërtohet duke ndryshuar formë në shek. I e.s. Kjo hipotezë në lidhje me funksionin bëhet më bindëse po të marrim parasysh se ky rikonstruksion i skenës dhe ndërtimi i shtëpisë me peristil do të jenë të njëkohshëm në shek. I e.s.

Nga sa përshkruam më sipër, arrijmë në konkluzionin që për ta trajtuar këtë Agora në krahasim tipologjik me Agoratë tjera, do të duhet të marrim parasysh formën që ajo kishte në kohën helenistike në shek.III p.e.s..

- 66

- Forma e sheshit është përsëri drejtkëndore si në rastet e tjera, e ngushtë dhe e gjatë, duke u kufizuar nga një Stoa që luan edhe rolin e një muri mbështetës për kodrën pranë.
- Dallojmë se si në Apolloni, Prytaneioni ndodhet përsëri në hapësirën e Agorasë e orientohet edhe ai radialisht drejt orkestrës së Teatrit. Në të vërtetë Prytaneioni ndërtohet si një objekt për gjykatësin e krahinës e për rrjedhojë jo çdo qytet mund të ketë në brendësi të tij një objekt të tillë.
- Duke parë ndërtimet që shtohen më vonë, do të vërejmë se me transformimin në periudhën Romake do të humbë fizionomia e Agorasë e do të dendësohen objektet duke e transferuar sheshin larg Teatrit, në Forumin Romak.
- Pjesa Romake do reflektojë rregull kompozicional duke dominuar rastësinë e vendosjes së objekteve në Agoranë e mëparshme, por duke zvogëluar edhe më shumë hapësirën e lirë që duhet të shërbente si shesh.

2.9 Agoraja në Antigóné

Qyteti krijohet në fillim të shek. III p.e.s. dhe vazhdon deri në pushtimin Romak në vitin 167 p.e.s. kur shkatërrohet nga një zjarr masiv. Duke shfrytëzuar hapësirën mes mureve me sipërfaqe jo shumë të pjerrëta ai do të ndërtohet me plan Hipodamik të aplikuar në tarracime. Rrugët kryesore e sekondare krijojnë insula të rregullta banimi me sipërfaqe drejtkëndore.

Agoraja ndodhet pranë mureve rrethuese në zonën më të sheshtë e kufizohet në anë nga një Stoa në dy kate e me shtrirje të theksuar gjatësore. Larg saj është zbuluar Prytaneioni, si një objekt me oborr të brendshëm e me hyrje me portik. Në rastet e mëparshme këtë objekt e gjenim në afërsi të sheshit të Agorasë, ndërkohë që këtu ai do jetë dy izolate më larg prej tij. Duke trajtuar qytetin nga format rikonstruktive që jepen nga arkeologët grekë, kuptojmë se Agoraja e vendosur në skaj të qytetit akoma nuk na ka shfaqur tërësisht formën që ka pasur. Prej saj është zbuluar një Stoa që duhet të ketë qenë në dy kate e orientuar me fasadë nga jugu.

2.9.1 Karakteristikat kompozicionale

- Hapësira para Stoasë së zbuluar ka një shtrirje të theksuar gjatësore e kufizohet nga rrugët e insulave.
- Ekzistenca e Prytaneionit larg saj është e pazakontë e na lë të mendojmë se ndoshta ky objekt nuk ka qenë Prytaneion, (sepse Prytaneioni shpesh është pranë Agorasë) ose ajo që sot quhet Agora duhet të jetë shtrirë deri te kjo ndërtesë.
Po të mbështesim hipotezën e dytë se sheshi mund të jetë shtrirë deri tek Prytaneioni, do të kishim rastin e një Agoraje të gjatë, jo të pa parë më parë e të ngjashëm me formën e shtrirë gjatësore të Agorasë-Forum apo asaj që quajmë qendër monumentale të Apollonisë.



- Mendojmë se ndoshta Agoraja që përshkua nuk ka qenë sheshi i vetëm kryesor i qytetit dhe ai mund të ketë patur një tjetër Agora. Hipoteza e një Agoraje tjetër bëhet më bindëse nëse marrim parasysh Stoaën jashtë mureve të zbuluar së fundmi. Nëse ajo ndërtesë ka patur funksionin që arkeologët i kanë përcaktuar, ka shanse që pranë saj të ketë qenë një shesh tjetër i Antigonesë.
- Objekti tjetër mbi të cilin na duhet të reflektojmë është Teatri. Gjatë analizave të Agorave deduktuam se në qytete të madhësisë së Antigonesë, Teatri ndodhej pranë Agorasë. Akoma i pazbuluar, atë mund ta kërkojmë në pjerrësinë natyrale pranë Agorasë, por që në këtë rast do të ndahej prej saj nga muret rrethues e do të kthente shpinën sheshit duke mos patur lidhjen Teatr-Stoa që shpesh preferohej si në Bylis e Dimal.

2. 10 Agoraja në Phoinike

68

përshtatur me izoipset e terrenit. Pjesa më e rrafshët e qytetit, krejt pranë mureve rrethues e me shtrirje gjatësore përgjatë tyre, do të shfrytëzohet për të ndërtuar Agoranë, hapësirën publike të qytetit.




Figure 39. Phoinike, plan i qytetit dhe Agorasë si dhe ndërtimet në të.

2. 10. 1 Karakteristikat kompozicionale

Kjo Agora kompozohet në formë të lirshme gjatësore duke i pozicionuar objektet në rafshin e ngushtë të shpatit. Ajo nuk ka formë të rregullt gjeometrike e pothuaj nuk ka një shesh të mirëfilltë që të mund të bëhet qendër kompozicionale për objektet përreth. Prej saj janë zbuluar pak objekte, ndër të cilët, Teatri sh. III p.e.s., thesauri shek. III p.e.s., çisterna e fragmente të banesave të kohës Romake me oborr të brendshëm peristil, si dhe një sterë e banjë Romake.

Një rrugë gjatësore me trajektore të parregullt e përshkon Agoranë në të gjithë gjatësinë duke lidhur objektet me njëri-tjetrin.

Pjesë e kësaj Agoraje është edhe Teatri i cili, duke ju përshtatur terrenit të pjerrët, gjen mundësinë ta shfrytëzojë atë duke gdhendur në shkëmb shkallaren. Përsëri në këtë rast vëmë re përfshirjen e Teatrit në hapësirën e Agorasë që ka marrë në vetvete një formë tejet të zgjatur. Rasti i një sistemi organizativ të tllë të lirshëm për objektet e Agorasë na shtyn të kërkojmë analogjinë me Pergamon, qytetin që sistemin urban të qendrës publike e planifikoi të lirë, të përshtatur ndaj pjerrësisë së qytetit por të orientuar si në mënyrë radiale nga Teatri dhe skena e tij.




Figure 40. Pergamo, sistemi urban i qendrës së qytetit

rrafshët të qytetit duke qëndruar larg Teatrit. E vetmja ndërtesë publike që nuk mund të bashkohej me të tjerat në një qëndër të vërtetë publike apo civike në Greqi ishte Teatri, ndërkohë që këtu ai do të bëhet pjesë e qendrave të qyteteve.

- Reflektojmë se madhësia relativisht e vogël e qyteteve do të influencojë e do të kushtëzojë prezencën e Teatrit pranë Agorasë. Duket sikur mendohej fillimisht ku mund të ndërtohej Teatri, me morfologjinë e tij të gdhendjes në shkëmb e më pas planifikohej edhe sheshi pranë tij.




Figure 42. Dimali, Amantia, Antigonea. Sugjerime hipotetike për vendodhjene Teatrit apo Agorasë.

Kjo karakteristikë e vendosjes së Teatrit pranë Agorasë në qytetet ilire mund të ndihmojë arkeologët për të lokalizuar Agoranë, aty ku ato nuk janë zbuluar ende, si në Hadrianopoli e Dimal ku teatrot janë zbuluar, apo të ndihmojë për të lokalizuar Teatrin aty ku ai nuk është zbuluar ende si në Antigone e Amantia ku është zbuluar Agora apo Stoa dhe ai do të ketë shumë shanse të gjendet në afërsi të saj apo të një Stojë.

- Gjatë analizës u ndalëm edhe në faktin e Stojës me nikje në Apoloni e Dimal. Duke i krahasuar me raste Stojash në vendet helene konstatuam se atje ato janë inekzistente (mbisundon këndi i drejtë në planimetri) ndërsa duke kthyer sytë nga eksperiencia Romake, këto nikje mund ti krahasojmë me absidat. Të jetë influencë Romake?!...

Duke qenë të shek. IV p.e.s., para kohës kur Roma pushtoi Ilirinë, e duke parë format e ndërtimit në gur edhe të mbulesës absidale, (Roma ndërtonte me beton), e përjashtojmë këtë mundësi. Mendojmë se këto forma, gati megalitike, që mund të na kujtojnë fasadën shkëmbore të varrit të Selcës, janë një zgjidhje origjinale lokale.

- Absidat influencohen përsëri nga terreni – pa pasur lluksin e krijimit të Agorave të mëdha por vetëm me shtrirje gjatësore, ato u detyruan të afrohen maksimalisht me skarpatin e kodrës e të përdorin absidat si kundraforca për të penguar rrëshqitjen e saj. Një zgjidhje të tillë të ngjashme, në të cilën një kodër mund të sistemohet e të parandalohet rrëshqitja nëpërmjet ndërtimit pranë saj, do ta gjejmë në arkitekturën e Forumit të Trajanit në Romën e shek. II, në të cilin dyqanet, si një Stoa e kurbëzuar sipas trajektores së një harku të madh do ti afrohen kodrës duke u mbështetur por edhe duke e mbajtur atë.
- Elementi që Agoratë na shfaqën ishin edhe kollonat tetëkëndore që i interpretuam si një zgjidhje konstruktive që, me një kosto të vogël ekonomike, siguron një nivel minimal estetik. Por pyetja vjen natyrshëm: **A ishte orderi një rregull absolut në Iliri, apo i diskutueshëm?**

Në kulturën e antikitetit grek një kollonë orderi nuk mund të inkasohet sepse, e lindur si një element konstruktiv, ajo duhet edhe ta reflektonte këtë rol. Por, larg saj, në Iliri do të shfaqen këta elementë lokalë e do të arrihet deri në përdorim gjysëm-kolonash e gjysëm-kapitelesh si në Stoa në Apolonisë apo të Dimalit. Ky fenomen, që do të jetë karakteristik për Romën, do të parapëlqehet në kulturën Italice.

- Elementi tjetër që evidentojmë është përdorimi i Harkut të Triumfit në Agoranë e Apolonisë. Kjo tipologji Romake do të ndërtohet vërtet në kohën e perandorisë, por ajo që duhet vlerësuar është fakti i përdorimit të saj brenda një Agoraje.

A ka Agora Greke që e kanë pranuar një tipologji të tillë brenda tyre?

Nuk ndeshet në asnjë rast, as edhe në qytete të tillë si Pergamon që do rikonstruktohen në periudhën Romake. Një tipologji e mirëformuar, si Agoraja, nuk pranon influencë, e aq më tepër, një demokraci si ajo Greke e shprehur edhe në arkitekturë, nuk mund të pajtohet me një Hark Triumfi, simbol i hierarkisë perandorake. Nga pozicionimi i harkut të triumfit dhe analiza që bëjmë në lidhje me të kuptuam se edhe pse në një shesh të transformuar në kohe Romake, akoma vazhdojnë të ruhen rregullat e projektimit apo kompozimit polar që Grekët përdorin.

- Ndërkohë, në këto qytete, theksojmë si një vlerë të shtuar të arkitekturës fleksibilitetin për të pranuar gjithshka me një tipologji e një stil të suksesshëm që ndihmon të arrihen rezultate mahnitëse në monumentalitet. Vërtet, në qytete të krijuar si koloni, mund të gjejmë fillimisht elementë tipikë helenë, por me kalimin e kohës ato shfaqën e reflektuan edhe kulturën ndërtimore vendase. Bindemi edhe më shumë për këtë kur citojmë N. Cekën: “*vendet e prapatokës së Apolonisë, Amantët, Bylinët e banorët e Olimpé-s aplikojnë formulat urbanistike Greke, duke*

na shtyrë të përdorim epitelin helenizim. Por në të vërtetë në shek. IV-III p.e.s. vërejmë një koiné të vërtetë arkitektonike e urbanistike, të shtrirë nga Cassopé në jug, në Apolloni në veri, që dallohet për një repertor origjinal ikonografik e stilistik”⁷⁷

Works Cited

- Cabanes, P. (1/1986). Recherche archeologique en Albanie 1945-1985. *revue Archeologique*, 107-142.
- Cabannes, P. (1993). L'aport des sources littéraires à l'onomastique d'Epidamne-Dyrrhachion et Apollonia d'Illyrie. *Grecs et Illyriens dans les inscriptions en langue grecque d'Epidamne-Dyrrachion et d'Apollonia d'Illyrie. Actes de la table ronde internationale (Clermont-Ferrand 19-21 octobre 1989, (f. 17). Paris.*
- Ceka, N. (1985, 1). La civilisation proto-urbaine illyrienne. *Iliria*, 111-150.
- Ceka, N. (1993). La koiné illyro-épirote dans la domaine de l'architecture. Në P. Cabanes, *L'Illyrie meridionale et l'Epire dans l'antiquité* (fv. 123-133). Paris.
- Ceka, N. (2005). *Apollonia*. (migjeni, Ed.) Migjeni.
- Ceka, N. (2005). *Apollonia*. Tiranë: Migjeni.
- Doxiadis, C. (1972). *Architectural space i ancient Greece*. Cambridge: MIT Press.
- Greco, E. (1999). *La citta greca antica: istituzioni, societa e forme urbane*. Roma: Donzelli Editore.
- Grupico, T. M. (2008). *The Influence of Urban Planning on Temple Design in West Greece*. New Jersey: ProQuest LLC.
- Hellner, N. (2/2011). Remarks on octagonal supports in greek Architecture. *Revue archeologique*, 227-262. Gjetur 7 21, 2013, nga cairn.info/revue-archeologique.htm
- Hodges, R. (2006). *Butrinti i përjetshëm*. Tiranë: Toena.
- Inge Lyse Hansen, Richard Hodges, Sarah Leppard. (2013). *Butrint 4: The Archaeology and Histories of an Ionian Town*. Oxford, UK: Oxbow Books.
- Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj. (2004). Les fouilles franco-albanaise d'Apollonia: 1994-2004. (I. i. arkeologjisw, Ed.) *Iliria*, 1-2, 2003-2004, 180-184.
- Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saimir Shpuza,. (2014). Apollonia d'Illyrie (Albanie) Campagne de fouilles 2012. (É. f. Rome, Re.) *Chronique des activités archéologiques de l'École française de Rome*, 33. Gjetur 1 21, 2015, nga <http://cefr.revues.org/1040>

⁷⁷ (Ceka, La koiné illyro-épirote dans la domaine de l'architecture, 1993) , f. 127

- Maria Ananiadou-Tzimopoulou, Alexandra Yérolympos et Athina Vitopoulou. (14/2007).
L'espace public et le rôle de la place. (A. P. Belon, Re.) Gjetur në
<http://etudesbalkaniques.revues.org/227>
- Martin, R. (1951). *recherches sur l'agorà grecque*. Paris.
- Martin, R. (1956). *L'urbanisme dans la Grèce antique*. Paris.
- Martin, R. (1983). L'espace civique, religieux et profane dans les cités grecques de l'archaïsme à l'époque hellénistique. *Architecture et société*, fv. 9-41. Gjetur 4 2013, nga
http://www.persee.fr/web/ouvrages/home/prescript/article/efr_0000-0000_1983_act_66_1_3195
- Mertens, D. (2006). *Città e monumenti dei greci d'occidente: dalla colonizzazione alla crisi di fine V secolo a.C.* L'ERMA di BRETSCHNEIDER.
- N. Fenn, M. Heinzelmänn, I. Klenner, B. Muka. (2010). *Report of the first season 'Dimal in Illyria'*. Gjetur në <http://archaeologie.uni-koeln.de/files/Heinzelmänn Dimal 2010.pdf>
- Neritan Ceka, Skender Muçaj. (2004). *Bylisi : historia dhe monumentet*. Migjeni.
- Nuttgens, P. (2001). *Storia dell'architettura*. (C. Rodriguez, Përkth.) Milano: Bruno Mondadori.
- Olgita Ceka, Neritan Ceka. (2015). L'Illyrie méridionale et l'épire dans l'antiquité. Në A. L. classique (Re.), *Actes du VIe colloque international de Tirana, 20-23 mai 2015*.
- Olivier DELOUIS, Jean-Luc LAMBOLEY, Philippe LENHARDT, François QUANTIN, Altin SKENDERAJ, Stéphane VERGER, Bashkim VREKAJ. (2007). La ville haute d'Apollonia d'Illyrie: étapes d'une recherche en cours. *Épire, Illyrie, Macédonie. mélanges offerts au professeur Pierre Cabanes*, 37-53.
- Pierres Cabanes, Myzafer Korkuti, Apollon Baçe, Neritan Ceka. (2008). *Harta arkeologjike e Shqipërisë*. Pegi.
- Urma, M. (2008-09). The perspective in ancient greece. An original way of constituting the spatial composition. *Anistoriton Journal In Situ*, 4-8. Gjetur shtator 2014, nga
www.anistor.gr/index.html
- Vangjel Dimo, Philippe Lenhardt, François Quantin. (2007). *Apollonia d'Illyrie, Atlas archeologique et historique*.
- Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky. (1859-1910). *10 books of architecture*. Cambridge: Harward University Press.
- Ward-Perkins, J. B. (1974). *Cities of ancient Greece and Italy, Planning in classical antiquity*. (C. U. George R. Collings, Re.) New York.
- Zevi, B. (2000). *Saper vedere l'architettura*. Torino: Einaudi.

TABELA E FIGURAVE

Figure 1. Harta e Ilirisë dhe Harta arkeologjike e Shqipërisë	25
Figure 2. Pireu, zona e portit pranë Athinës, djathtas, Qyteti i Prienës projektohen me sistem Hipodamik	26
Figure 3. Majtas, qyteti i Miletit, Plan. 451 p.e.s. Djathtas Qyteti i Korinthit	27
Figure 4. Parcela e shenjtë në Selinus ilustron teorinë e Doxiadis në planifikimin e hapësirave. .	29
Figure 5. Qyteti i Prienës, plan, rikonstrukcion hipotetik dhe Agoraja.	32
Figure 6. Plane të Agorave, Mileti, Pergamon, Efes, Priena,	33
Figure 7. Agoraja e Athinës, plan.	33
Figure 8. Stoja e Atalës në Athinë, plan dhe pamje e fituar pas rikonstrukcionit të viteve 1960,	34
Figure 9. Majtas, harta e qyteteve antike në Shqipëri. Me blu janë shënuar qytetet në të cilat nga gërmimet arkeologjike konfirmohet ekzistenca e Agorasë.	35
Figure 10. Djathtas, plani i bërë nga Praschniker ku paraqitet qyteti i shtrirë në dy kodrat dhe muret rrethuese të tij. Asklepos do të quhet kodra 104 ose Temenos dhe ka gjurmë të tempullit të parë, ndërkohë që në veri të saj është kodra e Akropolit.	35
Figure 11. Plan topografik i vitit 2010, i përpunuar nga Shkolla Franceze e Romës.	37
Figure 12. Prerje në terren për të treguar ndryshimet e kuotave të relievit, viti 2010, përpunuar nga Shkolla Franceze e Romës. Vëmë re se ndërtimet e të dy qendrave Agora do të zgjedhin të vendosen në sipërfaqet më të sheshta, por edhe më panoramiket, që të ofrojnë pamje spektakolare mbi pejsazh.	38
Figure 13. Friza e drejtë dhe Friza e kurbëzuar me motive amazonomike	42
Figure 14. Agoraja e Korinthit në shekujt VI-IV p.e.s.	43
Figure 15. majtas, Restitucioni elektrik i viti 2010, jep ndryshime imazhi në vendin ku u zbulua portiku I madh.	44
Figure 16. djathtas, Plani i qytetit me impostimin grafik të portikut-Stoa dhe të murit në rrënzë të kodrës.....	44
Figure 17. Pamje ajrore e zonës së dy Agorave, Planimetri ku janë vendosur vetëm objektet e zbuluar deri më tani. Në dy pamjet poshtë djathtas bëjmë një krahasim të pamjes që duket nga propile hipotetike në drejtim të Fushës e detit, me atë që duket nga propilejtë e Akropolit në Athinë. Grekët preferonin dhe favorizonin pamje të tilla të pejsazhit.	46
Figure 18. Hyrja në Temenos, porta e luanit në Mikenë, hyrja në varrin e Agamemnonit përdorin hark të rremë që shkarkon vetëm vertikalisht në bazë të parimit të spostimit gradual të gurëve në formë trekëndëshi.	47
Figure 19. Pozicionimi i Harkut të Triumfit në fund të dy rrugëve, do të favorizojë shikimin e tij në të dy momentet e hyrjes për në Agoranë-Forum. Me vija të ndërprera të kuqe tregohet mundësia e shikimit nga rrugët hyrëse.	49

Figure 20, Pamje nga rruga kryesore hyrëse ne Forum, Harku dhe Bouleuterioni perceptohen tërësisht, ndërkohë që vëllimi Harkut nuk e mbulon Bibliotekën.....	50
Figure 21, Pamje nga rruga hyrëse në Forum, Harku (i ngjashëm me atë në figurën djathtas) pengon tërësisht Odeonin, po lejon të shihet hyrja e tij.	50
Figure 22. Pozicionimet e mundshme të Harkut të Triumfit: Majtas në afërsi të Bouleuterionit dhe Odeonit, për të mbyllur sheshin para tyre si një drejtkëndësh; djathtas, në hyrje të Agorasë Forum si shpesh vendosej në Forumet Romakë. Zona gri mes rrezeve të shikimit nga propilejtë, tregon pjesën që ai do të mbulonte me volumin e tij.	51
Figure 23, majtas, Pamje nga ndërtesa me mozaik (Propile hipotetike) në drejtim të Agorsë mes kodrave, në mes: Pamje nga Agora mes kodrave në drejtim të Propilesë hipotetike, djathtas: Pamje nga Propileja hipotetike në drejtim të horizontit.	51
Figure 24. Plani i Agorasë-Forum ku shihen kënd-shikimet nga pika të ndryshme të sheshit (majtas) dhe mundësia e shikimit nga hyrja veriore në shesh, ku dallojmë se Harku i triumfit nuk pengon fasadat e tre objekteve të rëndësishëm; Bouleuterionit, Odeonit dhe Bibliotekës.	52
Figure 25, Pamje nga hyrja në Forum nga ana e propilejve, Harku i Triumfit perceptohet në profil dhe lejon të shihet i plotë vëllimi i Bibliotekës	53
Figure 26. pamje nga Qyteti i Athinës së sotme, ku ilustron ideja e akseve rrugorë që kthehen në akse vizuale, duke hapur shikimin drejt horizontit e pejsazhit, pa e kufizuar atë. Edhe sistemi i rrugëve të qytetit në Apolloni, i orientuar nga deti duket se është përcaktuar për të favorizuar pamje të tilla spektakolare.	53
Figure 27. Pamje e sheshit të Agorasë Forum nga shkallët e Odeonit. Odeoni dhe Bouleuterioni përballë njëri tjetrit dhe Harku i Triumfit ne hapësirën mes tyre, por shumë pranë fasadës së Bouleuterionit.	54
Figure 28. Qendra monumentale dhe objektet që ndodhen në të, sëbashku me kohën e ndërtimit.	55
Figure 29. Dimali, plan topografik, plan dhe pamje e Stoasë me nikje.	57
Figure 30. Plani i qytetit Dimal në të cilin janë trasuar linjat e Teatrit të zbuluar.....	58
Figure 31. Bylis, pamje ajrore, plani i qytetit, plani i Agorasë.....	59
Figure 32. Bylis Pamje nga shkallarja e Teatrit sot.....	61
Figure 33. Milet, plan i qytetit, dallojmë shpërndarjen e Teatrit nga Agoraja	62
Figure 34. Nikaia, (Klos) plan i qytetit. 1. Teatri, 2. Stadiumi, 3. Stoa.	63
Figure 35. Klos, Teatri dhe Rikonstrukcioni hipotetik nga L.Papajani	64
Figure 36. Butrint, Agoraja në shek. III p.e.s.	65
Figure 37. Butrinti, Agoraja plan, shek II e.s. Objektet kryesore: Faltore e Asklepit shek. IV p.e.s., Tempulli Asklepit Shek. IV p.e.s., Teatri, Stoa, Prytaneion, Shtëpia me peristil (shek.III p.e.s.)	66
Figure 38. Antigoneja, sistemi Hipodamik i qytetit dhe ndërtimet në të. Në afërsi të Stoasë jashtë mureve mund të mendojmë se duhet të ketë qenë Teatri i qytetit.	68

Figure 39. Phoinike, plan i qytetit dhe Agorasë si dhe ndërtimet në të.....	69
Figure 40. Pergamo, sistemi urban i qendrës së qytetit	70
Figure 41. plane të Agorave (në radhë nga lart poshte). Apollonia, Bylis, Butrinti, Phoinike	71
Figure 42. Dimali, Amantia, Antigonea. Sugjerime hipotetike për vendodhjene Teatrit apo Agorasë.	72

3. EKLESIASTERIONI DHE BOULEUTERIONI

Sallat e Këshillave në Greqinë e lashtë do të fillojnë të përmenden në shek.VI p.e.s. si vende ku bëhej mbledhja e Këshillit të qytetit. Fillimisht, Asambleja (eklesia), ishte një mbledhje e qytetarëve që bëhej në Agora por që shpejt do të kishte një ambient të njohur si e Eklesiasterion¹. Ndërkohë që mbledhja e Këshillit të qytetit – Boulé – do të zhvillohej më vonë në Bouleuterion.

3.1 Eklesiasterioni në Agoranë mes kodrave, ndërtesa në formë patkoi

Një Eklesiasterion mendohet të ketë patur edhe në Agoranë arkaike të vendosur në mes dy kodrave. Ndërtesa me formë patkoi ruan kundraforcat që mbanin shkallaren e drunjte dhe ka një diametër 16m.² Fasada e saj jugore përputhet me drejtimin e rrugëve sipas të parit sistem rrugor që u përdor në Apolloni në dekadat e para të formimit të qytetit në shek. VI-V p.e.s. që, sipas arkeologëve (mbështetur në të dhëna arkeologjike), ishte i ngjashëm me sistemin hipodamik të rrugëve përpjendikulare me njëra-tjetrën.

E zbuluar vetëm në nivelin e një shtrese të themelit (pasi duhet të jetë prishur për të ndërtuar një Stoa të mëvonshme), ajo ruan sot vetëm formën e asaj që arkeologët e përcaktojnë si planimetri të saj. Duke përcaktuar fazat kronologjike të kësaj pjese, arkeologët mendojnë se gjurmët e para i takojnë mureve të blloqeve të banimit të cilat gjenden deri në shtresën e gërmuar, si të shekullit V p.e.s., pa përjashtuar mundësinë që pjesë më të vjetra, të mund të gjenden në shtresa më të thella. Menjëherë të mëvonshme janë fragmentet e themelit të ndërtesës gjysmërrethore e cila, për ta, është një objekt i periudhës helenistike që duhet të jetë dëmtuar gjatë ndërtimit të një pjese të blloqeve të banimit. Ndërkohë që portiku, që më lart e kemi quajtur Portiku i madh, përcaktohet si një ndërtim i para shek II p.e.s., i cili prish ndërtesën gjysmërreth dhe i mbivendoset rrugëve të mëparëshme.

Këto të dhëna të saktësuar edhe nga gërmimet arkeologjike (2012), shpesh kërkojnë mbështetje në studimet tipologjike për të bërë të mundur vërtetimet e hipotezave si dhe në

¹ Eklesiasterion është një ndërtesë publike për mbledhjen e popullit, zakonisht e hapur; ndërkohë që një Bouleuterion, apo Salla e Këshillit, është një ndërtesë për mbledhjen e gjyqtarëve dhe anëtarëve të Këshillit. Bouleuterioni ishte një ndërtesë e mbuluar në të cilën bëheshin mbledhjet e Këshillit dhe përgatiteshin çështjet që do të diskutoheshin në Eklezia. Eklezia ishte Asambleja e gjithë qytetarëve të lirë, me përjashtim të të huajve, femrave dhe atyre që s'kishin të drejtë vote, ndërsa Buleja ishte Këshilli i qytetit që përbëhej nga njerëz të zgjedhur.

² (Jean-Luc Lamboley, F. Drini, F. Quantin, S. Shpuza, S. Verger, A. Skenderaj, E. Follain, MH. Barrière, P. Lenhardt, V. Bereti, A. Islami, 123-1 | 2011), f. 242-262

rastin më të mirë, propozimin e formës që duhet të ketë patur objekti që arkeologët e kanë përcaktuar si një Eklesiasterion.



Figure 1. Gjurmë të ndërtesës në formë patkoi në Apolloni, të quajtur nga arkeologët si një Eklesiasterion. Objekti ndodhet në Agoranë në mes kodrave.

3.2 Shembuj të Eklesiasterionëve në qytetet helene

Nga Angelos Chaniotis³ mësojmë se, nga qytet Greke, kemi pak raste të zbulimit të Eklesiasterionit, pasi Eklesia nuk mbledhej në çdo qytet ngaqë kjo varej nga ligjet dhe kushtetuta e çdo polisi. Shpesh mungesa e një Eklesiasterion-i monumental në shumë qytete Greke është pasojë e mos mbledhjes së shpeshtë dhe mospasjes rëndësi të saj në jetën politike të vendit. Në shumë raste të tjerë, rolin e një Eklesiasterioni për mbledhje e luante vetë sheshi Agora apo edhe Teatri, si dy ambjente ku mund të mbledheshin shumë më tepër njerëz. Kështu, për objektin e Apollonisë, e kemi të vështirë të gjejmë shumë raste të ngjashëm që mund të na ndihmonin për të kuptuar formën që duhet të ketë patur.

Megjithatë duhet marrë për bazë hipotezimi i arkeologëve për të quajtur Eklesiasterion atë objekt. Për të hulumtuar në një mënyrë krahasimore, mund të na shërbejnë si shembuj disa prej Eklesiasterionëve të mbetur sot si trashëgimi e kësaj tipologjie në Metapontum

³ Angelos Chaniotis tek parathënia e (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994), f. 25-29

(pranë Tarantos - Itali) në Poiseidonia (Paestum) dhe në Akragas (Agrigento), qytete të rëndësishëm të Magnia Grecia-s.




Figure 2. Eklesiasterioni në Metapontum

I ardhur nga fundshekulli VII p.e.s., Eklesiasterioni në Metapontum, u transformua më vonë në një Teatër deri në shek IV p.e.s.. Forma e tij rrethore shënohet nga muri mbajtës me dhe të ngritur në pjerrësi ku do të mbështeteshin shkallët dhe ndenjëset prej druri.

Ai kompozohet rreth një vëllimi drejtkëndor 19x12,8m dhe arrinte gjerësi deri në 62m. Kishte dy hyrje të gjëra në të dy anët diametralisht të kundërta të rrethit planimetrik.

Ndërkohë Eklesiasterioni në Paestum (480-470 p.e.s.) ka një strukturë rrethore me shkallë e cila me $D=55m$ duhet të zinte 1,300-1,400 pjesëtarë të asamblesë politike⁴

Me përmasa të mëdha mendohet të ketë qenë edhe Eklesiasterioni i Akragas-it: $\frac{3}{4}$ e rrethit me diametër të jashtëm 48m dhe me diametër të brendshëm 15,6m të orkestrës - vendit ku qëndronte oratori. E mbështetur në mbushje dheu me një pjerrësi 7-8°, shkallarja do të mbante nga 2750 deri 3000 vetë⁵

Në Athinën e lashtë, që ishte shembulli më i hershëm i poliseve Greke, Asambleja mbledhej në sheshin Pnyx pranë Agorasë që, e përshkruar nga Wycherley, kishte pasur 3 faza zhvillimi.

Ajo ishte nisur nga një shesh me sipërfaqe të vogël që ishte zhvilluar, më pas, në një shesh të madh me sipërfaqe gati gjysmë rrethore me një bemë në qendrën kompozicionale. Ajo kishte pamje nga toka e nga deti dhe ishte vendi më perfekt ku oratori, i cili drejtonte Asmblenë, të mund të qëndronte, të fliste e krenohet me fraza esklamative që i drejtoheshin popullit dhe mbartnin krenarinë Athinase⁶.

⁴ (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994) flet për Eklesiasterionin në Paestum si një ndërtim i Agorasë Greke.

⁵ Ibbidem, f.55

⁶ (Wycherley, 1962), f. 125




Fig. 1. Akragas. The eklesiasterion. Plan and section.

Figure 3. majtas, Eklesiasterioni në Paestum, (Poisedonia)

Figure 4. djathtas, Eklesiasterioni në Akragas, (Agrigento, Siçili)

E ngjashme me Pnyx në Athinë na paraqitet edhe Eklesiasterioni në Kassopé, që në dimensione të mëdha vendoset përballë Agorasë duke u organizuar si një Teatër.

Në skicën planimetrike dallojmë edhe një eksedër në Stoanë e Agorasë. Një rast i ngjashëm edhe me *bemat* që shpesh haseshin në Agoratë e tjera e që mund ta trajtojmë si një karakteristikë të përbashkët të tyre.

Duke kërkuar krahasim me rastin e Metapontos, tek gjurma e harkuar e rradhës së gurëve në Apolloni, mund të përfytyrojmë themelet e murit mbajtës të dheut që ngrihej për të krijuar pjerrësinë e nevojshme për shkallaret e drunjta, por na bën përshtypje diametri relativisht i vogël i objektit në Apolloni, i cili arrin vetëm në 16m, ndërkohë që ai i Metapontos është 62m. Njëkohësisht përmasat ndryshojnë në mënyrë drastike edhe me Eklesiasterionin e Akragas, që llogaritet 48 m në diametër apo ai në Paestum rreth 55m.

Duket pra se, objekti në Apolloni, duhet të ketë pasur kapacitet të vogël për të qenë një vend për mbledhje të asamblesë - Ekklesia. Mos, ndoshta, ka qenë ai një Bouleuterion?

Në llogaritjen e kapacitetit të Eklesiasterionit apo Bouleuterionit mund të ndjekim formulën e propozuar nga Sear⁷ $\frac{\pi(D^2-O^2) \times K}{8 \times 0.333}$ =kapacitet në të cilën, D = diametri i jashtëm, O = diametri i orkestrës, K = koeficienti i zënies së caveas (shkallares) nga ndenjëset.

Nga kalkulimi në një D = 16m, O =3,5m del se, brenda atij që supozohej si Eklesiasterion mund të kenë qëndruar rreth 230 këshilltarë.

Duke ndjekur arsyetimin e mësipërm për madhësinë e një asambleje Ekklesia e të një Këshilli Bulé, kapaciteti mbajtës i Eklesiasterionit duhet të jetë shumë i madh (tek ai i Metapontos mendohej të qëndronin rreth 7,500 vetë). Ndërkohë që, përmasat e atij të supozuar të Apollonisë, mbanin shumë më pak. Si një ndërtim i shek V p.e.s. ky kapacitet mbajtës mund të justifikohet i përshtatshëm për një Eklesiasterion vetëm për kohën kur qyteti nuk kishte shumë banorë, në të kundërt ai mund të ketë qenë një Bouleuterion.





Figure 5. Eklesiasterioni Athinës i emërtuar si Pnyx, i paraqitur në të tre fazat e evolucionit vëllimor

Duke ju referuar gjurmëve arkeologjike në Apolloni shohim se përveç murit rrethues, mund të dallojmë edhe fragmente muresh që në mënyrë radiale vendoseshin në pjesën e brendshme dhe që, nga arkeologët, janë quajtur si kundraforsa për të ndihmuar mbajtjen e tij e ndoshta edhe të shkallareve prej druri në brendësi. Duke qenë se dy shekuj më vonë ai do të prishej për të ndërtuar Stoa e madhe, aty nuk gjejmë sot dheun që duhet të ketë shërbyer si mbështetje për shkallët. Objekti, sipas arkeologëve, paraprihej nga një vëllim

⁷ (Sear, 2006) f.42, Sear na propozon këtë formulë të G. Forni, si një mënyrë për të llogaritur kapacitetet në Teatro.

drejtëndor, ndoshta ajo që në Metaponto ishte tribuna, i cili kishte gjerësi sa gjerësia e bllokut të banimit.



6. Kassope. The *eklesiasterion* facing the agora bordered by the west- and north-stoa, and the *prytaneion*.

Figure 6. Agoraja në Kassope e ka Eklesiasterionin të përfshirë në shesh

Duke studiuar Eklesiasterion tek Hansen & Fischer-Hansen⁸ mësojmë se shpesh, si Eklesiasterion shërbenin Teatrot të cilët, duke patur një kapacitet mbajtës të madh, kishin mundësi të mblidhnin në shkallët e tyre të gjithë anëtarët e asamblesë. Në fakt, Teatrot u bënë fillimisht vendi i ceremonive të kultit apo atyre politike e më pas u transformuan në vendin ku zhvilloheshin shfaqje të mirëfillta artistike⁹. Edhe Sear na flet për Teatro, që si në traditën e atyre Greke, mund të përdroreshin si vende për mbledhje politike. Si të tillë ai dokumenton Teatrot në Korinth, Messene, Ephesus, Miletus, Rhodes, Samos, Sicyon që prej shek. IV p.e.s. deri shek. I e.s.¹⁰ kështu eksperiencia e këtyre qyteteve na sugjeron idenë se vërtetë ndërtesa në formë patkoi mund të ketë shërbyer si Eklesiasterion në kohën kur qyteti nuk ishte i madh në numër, e më pas, me ndërtimin e Portikut të madh, Eklessia duhet të jetë transferuar me bledhjet e saj në Teatrin, jo larg saj, i cili që në shekullin e III p.e.s.¹¹ duhet të ketë shërbyer si Eklesiasterion. Hipotezën mund ta mbështesim edhe në faktin se kronologjikisht kemi përputhje të kohës kur Teatri u ndërtua dhe të kohës kur Portiku i madh u ndërtua (datuar si ndërtim i shek. III p.e.s.)¹²

3.3 Bouleuterioni në Agoranë - Forum

Gjatë shqyrtimit të ndërtesës në formë patkoi në Agoranë helenistike të Apollonisë hodhëm dyshimin se ajo mund të ketë qenë një Bouleuterion - prej përmasave të vogla e të pamjaftueshme për të zhvilluar Asamblenë e banorëve të një qyteti, por për të sqaruar këtë, na u desh të shqyrtonim tipologjinë e sallave të Këshillit, Bouleuterioneve, që njihen nga antikiteti grek. Ky informacion analitik i shërben edhe trajtimit të formës së Bouleuterionit (tempullit të Agonotetëve) që Apollonia e pati në Agoranë-Forum e që, sipas arkeologëve, duhet të jetë ndërtuar në shek. II e.s.

Përshkrimet e para të tij i gjejmë tek Leon Rey që në vitet 1930 e më pas në një analizë të gjerë formale nga arkeologët që përgatitën restaurimin dhe anastilozën e fasadës kryesore. Nga Baçe & al.¹³ gjejmë një paraqitje përshkruese të hollësishme: [...] *Ai gjendet në anën jugore të sheshit të qendrës së qytetit, me ballin e orientuar nga lindja. Monumenti, me planimetri drejtkëndëshe me përmasa 14,4x 19,2 m, përbëhet prej portikut dhe sallës në të cilën veçohen vestibuli, orkestra dhe shkallarja. Shkallarja e ndërtuar me tulla dhe e veshur me mermer, ka pasur 10 rreshta, 0,4m të lartë, që i përshtateshin në formë patkoi konturit drejtkëndësh të sallës. Në anën e pasme ajo përshkohej prej një galeri e mbuluar me qemer rrethor. Galeria të çonte te kafazët e shkallëve. Prej këtej shkallë druri të ngjishnin sipër, në sheshin që krijohet ndërmjet rradhës së fundit të shkallares dhe konturit*

⁸ (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994) f. 23-90

⁹ Ibidem, f. 45

¹⁰ (Sear, 2006) f. 38

¹¹ (Ceka, 2005). f. 82, (Vangjel Dimo, Ph. Lenhard, F. Quantin, 2007)

¹² (Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saïmir Shpuza,, 2014) f.33

¹³ (Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karaickaj, Pirro Thomo, 1976) f.167

të brendshëm. Para shkallares gjendet orkestra po në formë patkoi (6x6m). Afër buzës së saj gjendej një banko paralele me rreshtat e shkallares dhe me lartësi dhe gjerësi të njëjtë me to, që duket se shërbente për qëndrimin e personave më në zë të Këshillit. Vestibyli që vijon para shkallares dhe orkestrës, në tërë gjerësinë e sallës, e ka pasur dyshemenë të shtruar me pllaka drejtkëndëshe guri. Muret anësorë dhe i prapëm të ndërtesës, 0,8-1m të gjerë ngrihen mbi themele guri dhe janë punuar me muraturë të derdhur ndërmjet dy pareteve me tulla trekëndëshe.¹⁴ Përjashtim bëjnë antet dhe muret anësorë të fasadës të punuar me blloqe të mëdhej guri si në kulturën Greke. [...] lart muret kanë qenë suvatuar dhe pikturuar me afresqe. Muret kanë qenë të suvatuar edhe nga jashtë. Monumenti që arrinte rreth 10m lartësi ka qenë mbuluar me një çati druri dhe i pajisur me fronton në ballët e ngushtë[...] Në përcaktimin si lartësi të monumentit, përmasën 10m, duhet të japim edhe hipotezën tonë. Duke lexuar Vitruvin për përshkrimet që ai bën për sallat e këshillit në qytetet helenistike, kuptojmë se lartësia e tyre varej nga dimensionet e Agorasë, por dhe kishte një lidhje proporcionale me dimensionet e bazës së katërkëndshit planimetrik në të cilin insertoheshin.




Figure 7. Bouleuterioni ose tempulli i Agonoteteve në Apolloni, plan e fasadë propozuar nga rievimet e L. Rey

Sipas Vitruvit [...]Në një planimetri katrore, lartësia do të jetë sa 1,5 e gjerësisë, ndërkohë në një plan drejtkëndësh, mblidhet gjerësia më gjatësi dhe gjysma e saj do

¹⁴ Një mënyrë e tillë ndërtimi në *opus testaceum*, ishte tipike Romake, dhe justifikohet me faktin që koha në të cilën u ndërtua ky objekt, ishte një periudhë e rëndësishme për mardhëniet e mira Romë-Apolloni. Mënyrat ndërtimit të Romës kanë influencuar mënyrën e ndërtimit në Apolloni, lidhur kjo edhe me disponibilitetin e materialit tullë qeramike për ndërtim, e cila, siç mësojmë nga Ceka, prodhohej nga vetë Apollonatët e qytetet e prapatokës së saj.

përcaktojë lartësinë e tavanit me kasetone[...] ¹⁵ Sipas kësaj dhe përmasave të jashtme 14,4x19,2 m të ndërtesës mund të llogarisim $\frac{14,4+19,2}{2} = 16,8\text{m}$

Supozojmë kështu se niveli i tavanit me kasetone në interior do të jetë në 16,8m lartësi. Tek përshkrimi i mësipërm ¹⁶, gjejmë përcaktimin se lartësia duhet të ketë qenë 10m, mendojmë tëpër e ulët për një madhësi tipike Romake.

[...]Portiku është trajtuar me ante, të cilët vazhdojnë me kthesë dhe në skajet e ballit. Në hapësirën ndërmjet tyre mbi stereobatin gjenden dy pilastra, të mbështetura tek muret e mësipërm dhe katër kolona mermeri mbi 7m të larta [...] Mbi bazamentet antike vijon trupi i kolonës, i lëmuar në 1/3 e poshtme dhe me kanelyra lart, [...] një mënyrë kjo, tipike e përpunimit të kollonës në periudhën helenistike, sidomos në objekte publikë. Aty ku kanelyrat e kollonave mund të konsumoheshin nga fluksi i njerëzve, kursehej kostoja e të bërit, dhe ato gdhendeshin vetëm në 2/3 e lartësisë së sipërme të trungut.

3.4 Studimi tipologjik kronologjik

Duke patur parasysh kohën e ndërtimit të Bouleuterionit të qendrës Forum, shek. II e.s., mund të presim që tek ai të kemi edhe influenca tipologjike prej sallave të mbyllura të Romës antike. Për këtë na shërben një studim i dyfishtë i Bouleuterioneve të periudhës Greko-Romake dhe Romake.

3.4.1 Analiza teorike e tipologjisë

Informacion të gjërë mbi Bouleuterionet na jep Sear, tek “Roman Theatres. An Architectural Study” ¹⁷ si dhe Hansen & Fischer-Hansen ¹⁸, apo edhe Wycherley tek “How the greeks built cities”. Studimi i tyre tregon se ato dallojnë nga njëri-tjetri në bazë të formës planimetrike dhe të mënyrës së vendosjes së ndenjësve në to. Përpjekja për të gjetur ngjashmëritë, apo dhe veçantitë, e këtyre ndërtesave me ato të Apollonisë, përfshin edhe shqyrtimin e flukseve të lëvizjes në to, të mënyrës se si organizohet hyrje – dalja e publikut, nga cilat anë të sallës, si dhe të mënyrës se si këto objekte do të paraqiteshin në fasadën kryesore që shihe në Agora.

Në shumë qytete salla e Këshillit ka qenë një prej objekteve më të hershëm publikë në një polis grek. Ky përcaktim i Wycherley, si edhe fakti që objekti shihe në Agora ¹⁹, na bën të mbështesim idenë se ndërtesa në formë patkoi në Apolloni, mund të ketë qenë një sallë Këshilli apo Asambleje, duke u bazuar në afërsinë me atë që është përcaktuar si Agoraja e parë në mes të dy kodrave.

¹⁵ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910) f.137

¹⁶ (Apollon Baçe, Aleksander Meksi, Emin Riza, Gjerak Karaiskaj, Pirro Thoma, 1976) f.167

¹⁷ (Sear, 2006)

¹⁸ (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994)

¹⁹ Sipas (Wycherley, 1962) sallat e këshillit, bouleuterionet apo Eklesisterionet kishin dalje direkt në Agora ose ishin krejt në afërsi të saj.

Sallat e Këshillit, Bouleuterionet dhe Prytaneionet u bënë trashëgues të holleve mbretërore. Të dy u bazuan në traditën e “dhomës së Këshillit” ku mbreti konsultohet me këshilltarët e tij. Ngjashmëria duket në faktin se, ndërsa tek Prytaneioni ndodhet “vatra” – “zemra e shenjtë” e qytetit, tek ndërtesa e këshillit kishte një altar të Hestias – hyjnia që ruante vatrën. Duket sikur nuk bëjmë dot një dallim të qartë midis ndërtesave për Asamblenë e Përgjithshme dhe Bouleuterionit veçse në faktin nëse është një ndërtesë me çati apo jo.²⁰

Në trajtimin kronologjik të kësaj tipologjie jemi në gjendje të perceptojmë fazat e zhvillimit të formës planimtriqe, të mënyrës se si ndenjset u vendosën brenda hapësirës, të hyrjeve në ndërtesë dhe të fluksit të lëvizjes në brendësi. Duhet theksuar se Bouleuterionet e parë u ndërtuan nga arkitektura Greke, e më pas ajo Romake, e cila mori bazat morfologjike të tyre dhe i zhvilloi në përshtatje me kushtet e tyre. Një nga ndryshimet që do të bjerë në sy tek Bouleuterionet Romake do të jetë përmasa e vogël e tyre, e cila kushtëzohej nga fakti se në periudhën e aplikimit të administratës Romake, bie rëndësia e këshillave “Boulé” lokalë, të cilët në atë kohë do të jenë me 80-100 vetë, e jo më me 300, 450 apo 600 vetë si më parë²¹. Ky autor, duke bërë një listim të Bouleuterioneve dhe kapacitetit të tyre e përcakton atë të Apollonisë si me kapacitet 250-300 vetë.

3.4.2 Shembuj botërorë para dhe gjatë shek. VI - V p.e.s.

Lindja e këtyre ndërtesave si salla këshilli të qytetit do ti takojë shek VI – V p.e.s.

Shembulli më arkaik është ai i Olympias. Ndërtim i shek. VI p.e.s. ai filloi si objekt drejtkëndor 30,7 x 13,7m me një absidë në fund, por do të shtohet me një ndërtim të njëjtë në formë më pas, të vendosur simetrikisht kundrejt një oborri kuadratik, ku do të ndërtohet një sallë me përmasa 14,2 x 14,2m me një altar në mes.




Figure 8. Olympia, plani i Agorasë dhe skemë planimtriqe e Bouleuterionit

²⁰ (Wycheley, 1962) f.125

²¹ (Sear, 2006) f.38

Të tre volumet paraprihen nga një portik kollonash dorike që krijonin fasadën e bukur nga ana e Agorasë. Hapsirat absidale me diametër 13m janë përdorur si arkiva apo zyra dhe, me formën e tyre, na kujtojnë ndërtesën në formë patkoi të Apollonisë, gati edhe në përmasa diametrale të përafërta - 16m në Apolloni dhe 13m në Olimpia. Deduktojmë pra, që kjo formë gjysmë-rrethore nuk paska qenë e panjohur për kohën, por është përdorur edhe në ndërtimet e tipologjive të ndryshme nga Teatri.

Në Delos 590-550 p.e.s. Bouleuterioni i përket fillimit të shek. VI p.e.s. dhe përbëhej nga dy salla drejtkëndore në komunikim me njëra tjetrën, ndër të cilat, ajo më e madhja duhet të ketë shërbyer si salla e mbledhjes së Këshillit. Në ngjashmëri me rastin e Olimpias, salla është e ndarë në dy nefe prej një radhe me kollona dhe ka hyrje nga brinja gjatësore. Nuk dihet pozicionimi i ndenjësve që, sigurisht, duhet të kenë qenë të drunjtë pasi nuk kanë lënë gjurmë të ngritjes në terren.

I të njëjtës periudhë, në gjysmën e parë të shek VI (590-550 p.e.s.) është edhe Bouleuterioni i Delphit me formë drejtkëndore e përmasa të reduktura në gjerësi, aq sa mund të lejonte mbulimi me tavan të sheshtë të drunjtë. Salla hapet në të tre anët me nga një portë dhe nuk paraprihet nga kollona apo portik.




Figure 9. Skema planimetrike të Bouleuterioneve në Delos, Delphi, e Olynthos.

Bouleuterioni në Ayia Pelagia (Kretë) i 590-550 p.e.s. do të kishte përsëri një formë drejtkëndore 15 x 6.3 m por mbetjet e tij nuk na lejojnë të hulumtojmë më shumë për interiorin e mundësinë e lëvizjes në të.

Pak e mëvonshme është në Olynthos ndërtesa drejtkëndore e supozuar të jetë një Bouleuterion²² dhe i datuar si fillim i shek V p.e.s.. Gjatë kësaj periudhë Olynthos lulëzoi si qendër politike e Lidhjes Kalkidike – një aleancë e qyteteve të Kalkidisë. Ndërtesa përbëhej nga salla plenare që kishte një formë gati kuadratike dhe me ndenjëset të

²² (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994), f. 23-90

vendosura në formë gjysmërrethi. Në këtë sallë gjejmë edhe një kollonadë të brendshme, një altar në qendër dhe një eksedër (podium) përballë altarit.

Kjo sallë plenare paraprihet nga një sallë kuadratike me tre nefe. Në hyrje të kompleksit, në dy anët e korridorit hyrës gjenden dy dhoma, një në çdo anë, me shumë mundësi të përdorura si arkiva dhe zyra. Të gjithë ambientet kanë ngjashmëri të fortë me pjesët arkitektonike të Bouleuterionëve të tjerë të mëvonshëm. Ndenjëset e drunjta siguronin vende për 250 vetë.

Në Argos Bouleuterioni i ndërtuar rreth 450 p.e.s. ka plan kuadratik dhe ndodhet në anën perëndimore të Agorasë, nga e cila orienton fasadën e tij lindore me një rresht kollonash që përcaktonin hyrjet. Çatia mbahej prej 16 kollonave jonike dhe kishte një hapje qendrore për ajrosjen e ambientit dhe ndriçimin e tij. Një stol druri në formë U-je shtrihej përgjatë tre anëve të mureve të brendshëm kufizues. Sot ruhen vetëm themelet dhe një pjesë e asaj që mendohet të ketë qenë kollonada e hyrjes në anën lindore.




Figure 10, Argos, Agoraja dhe Bouleuterioni,

Bouleuterioni i vjetër në Athinë datohet në shek. V p.e.s. kishte formë katërkëndore me ndenjëse në të tre anët dhe paraprihej nga një portik me 5 kollona në fasadë.

Bouleuterion




Figure 11, Bouleuterioni i vjetër në Athinë, plan dhe rikonstrukcion hipotetik i fasadës

Vëmë re se kemi një numër tek kollonash në fasadë, të cilat kushtëzojnë hyrjen në aksin e simetrisë duke e penguar nga një kollonë, një anomali kjo në projektimet e veprave të arkitekturës Greke, të cilat gjithmonë përcaktonin aksin e simetrisë si aks kalimi për në ndërtesë duke shmangur kollonën e mesit. Salla me kapacitet 500 vetë kishte në brendësi 5 kollona që, të vendosura në formë U-je, shërbenin për të mbajtur mbulesën.

Bouleuterioni i Ri në Athinë - fund shek. V p.e.s. (415 BC – 406). Ai kishte një plan drejtkëndor që, në shek. III, u shtua me një portik në rolin e fasadës. Në formë drejtkëndore me 6 kollona në ballë ajo duket sikur kujton portikun e Bouleuterionit të Apollonisë.




Figure 12. Athinë, Bouleuterioni i ri, Planimetri dhe Planvendosja brenda Agorasë.

Në brendësi kishte stola të drunjtë që mendohet të jenë vendosur në formë U-je me pamje nga hyrja, ndërkohë që kollonat shërbenin për mbajtjen e mbulesës së drunjtë. Duhet theksuar se, duke qenë se mbetjet arkeologjike janë të pakta e sidomos mungojnë tërësisht ato të ndenjesve të drunjtë, ka një dyshim nëse skallarja ka qenë e orientuar nga jugu apo nga lindja. Mbështetësit e hipotezës se ato mund të kenë qenë të orientuara nga lindja, bazohen në faktin se thuhet në çdo Bouleuterion, orientimi i caveas (shkallares) bëhej nga lindja apo juglindja. Një orientim nga lindja shohim edhe në Bouleuterionin e qendrës Forum në Apolloni, ndërkohë që nëse ndërtesa në formë patkoi duhet të ketë qenë e orientuar nga jugu duke patur shikim mbi Agora.




Figure 13. plan I Agorasë në Athinë. Dallohet se Bouleuterioni është propozuar me një vendosje të shkallares të orientuar nga lindja

3.4.3 - Shembuj botërorë gjatë shek. IV – III p.e.s.

Gjatë shek IV- III p.e.s. do të vazhdojnë të ripërsëriten të njëjtat skema planimetrike.

Në Sikyon, Bouleuterioni ishte një ndërtesë e madhe e shek.IV p.e.s., që përbëhej prej një auditoriumi kuadratik me radhë ndenjësesh të vendosura paralel me muret e me dy kollonada të brendshme jonike.




Figure 14, Sycon, Bouleuterion, plan e mbetjet arkeologjike të ditëve tona.

Në brendësi, shkallët për ndenje vendosen në kënd të drejtë në të tre anët e kuadratishtit ndërkohë që një portik zbkuronte hyrjen kryesore në anën veriore dhe e lidhte atë me Agoranë. Objekti ka vetëm dy hyrje në fasadën kryesore, dhe shpërndarja e njerëzve nëpër shkallë bëhej nga korridoret në anët e tyre. Nga mbetjet e sotme të tij shohim se shkallët kanë qenë të gurta, duke sjellë kështu një rast të parë të përdorimit të shkallëve të gurta në interior.

Bouleuterioni në Mantineaia ndodhej në Stoa në jug të Agorasë, dhe në shek. IV p.e.s. u bë vendi i mbledhjeve të parlamentit vendor Boulé. Me stola druri përgjatë mureve, fillimisht ndërtesa kishte një plan në formën e shkronjës 'U' ku përfshiheshin tre krahë dhe një kollonadë që hapej drejt Agorasë.

Në kapërcyell nga shek IV p.e.s. në shek. III p.e.s., një Stoa e re j'u shtua, në një nivel më të ulët, në jug duke u lidhur me shkallë me të vjetrën. Një dhomë e shtuar në anën lindore gjatë shek II e.s. ka mundësi të ketë qenë caktuar për adhurimin e perandorëve romakë. Bouleuterioni i Mantineas është një shembull i rrallë i një Stojë të përdorur si seli për mbledhje.

Në Soluntum (Palermo) Bouleuterioni i shek IV p.e.s. ka plan katërkëndësh të përmasave të vogla 11,2 x 7,3m me ndenjësë të vendosura në gjysmëharku e të kthyer nga lindja me kapacitet 90-115 vetë. Diskutohet nëse mund të ketë qenë Boulé apo Odeon, pavarësisht se Sear²³ e interpreton Bouleuterion për shkak të mungesës së paraskenës. Në formën e tij gjejmë një ngjashmëri me Bouleuterionin e vjetër të Athinës në vendosjen e shkallares me orientim nga brinja e gjatë e drejtkëndëshit planimetrik, veçse ndryshe nga ai nuk do të ketë portik ballor.




Figure 15. Bouleuterionet në Mantinea, Soluntum dhe Dodona,

Në Dodona Bouleuterioni është një ndërtesë drejtkëndore pranë Prytaneionit dhe, sipas mbishkrimeve, themelimi i saj daton në fillimet e shek. III.

23 (Sear, 2006)

Ndërtesa u restaurua për herë të parë në vitin 219 p.e.s. pas shkatërrimit të saj prej pushtimit Aetolian dhe, herën e dytë, pas pushtimit romak në 167 p.e.s.²⁴ Pas portikut me kollona, i cili formon fasadën, dy hyrje të drejtonin menjëherë në auditorium, i cili duhet të ketë qenë i drunjtë e sot nuk ruan gjurmë të tij. Çatia mbahej prej 6 kollonave në sallën e auditoriumit. Shkallë të ngushta anësore të çonin në rradhët më të larta. Sot gjenden vetëm themelet, një kollonë e brendshme, një altar dhe një bazë statuje. Na bëjnë përshtypje pilastrat në muret e jashtëm që duket sikur duhet të kenë qenë të lidhura me anën dekorative të paretve gjatësorë, duke përdorur në ta dekoracion të bazuar në order arkitektonik. Një mënyrë të tillë dekorative e gjejmë të përshkruar tek Sear, apo dhe Hansen & Fischer-Hansen si një formë që përdorej për të rritur vlerën arkitektonike të këtyre objekteve edhe në eksterier.




Figure 16. Bouleuterionët në Morgantina, Thasos dhe Miletus,

Bouleuterioni në Morgantina (Siçili) e shek. III p.e.s., kishte dy salla ndër të cilat njëra ishte pjesa e auditorit ku bëheshin mbledhjet me përmasa 10,9 x 12,6 m. Anëtarët e Këshillit uleshin në Stolat e drunjtë të cilët mbështeteshin në një strukturë drejtkëndore të gurtë. Stukturë të drunjtë për ndenjëset kanë supozuar edhe arkeologët francezë për Eklesiasterionin që ata shohin tek ndërtesa në formë patkoi.

Bouleuterioni në Thasos, ishte një ndërtesë kuadratike që daton prej shek. III p.e.s.. Në mes të anës veriore, një portik dorik tregon hyrjen për në auditorium. 16 kollona jonike të organizuara në formë kuadratike në mes të sallës, mbanin çatinë, e cila kishte një hapje për ajrosje dhe për dritë. Në të tre anët kishte stola të drunjtë që ishin vendosur për ndenjen e përfaqësuesve. Ndërsa në anën e portës kishte një portik me kollona.

²⁴ (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994) f.29-30




Figure 17. Hartë e qyteteve antike në Siçili në të cilën dallojmë ato që përmenden në studim

Figure 18. Skemë planimetrike e Bouleuterionit në Akrai.



Akrai (Siçili), teater e bouleuterion,



Figure 19. Pamje Ajrore e grupit Teatër e Bouleuterion në Akrai në Siçili

3.4.4 Shembuj botërorë gjatë shek. II - I p.e.s.

Bouleuterion në Miletus i viteve 175-164 p.e.s. ndërtohet me një plan drejtkëndor 34.8 x 24.2 m, i paraprirë nga një oborr peristil dorik 34,8 x 31.6 m në të cilin hyet nga një Propilë me kollona korintike²⁵. Sipas Sear, në brendësi duhet të jenë përdorur katër pilastra për të ndihmuar mbështetjen e mbulesës. Kjo skemë planimetrike na kujton Bouleuterionin e Olynthos, me ndryshimin që atje, salla e mbledhjes, paraprihej nga një sallë kuadratike e ndarë në tre nefe ndërsa, këtu, nga një oborr peristil me kollona. Në brendësi të sallës, 4 kollona jonike mbajnë trarët e mbulesës së drunjtë, ndërkohë që ndenjësjet e gurta janë vendosur në kënd të drejtë përgjatë tre anëve të drejtkëndëshit.

Bouleuterioni në Assos është një strukturë kuadratike në cepin veri-lindor të Agorasë. Sipas formës dhe tipologjisë arkitektonike, objekti është ndërtuar, me shumë mundësi, mes 200 – 150 p.e.s., kur qyteti i Assos i takonte mbretërisë së Pergamos. Arkitektura ndiqte standardet e periudhës klasike. Fasada kryesore nga Agoraja përbëhej prej pesë kollonash ndërmjet muresh anësore. Salla kryesore ishte një ambient katror, i sheshtë, me karrike druri përgjatë tre mureve anësore. Katër kollona masive të stilit jonik që formonin një katror në qendër, mbanin ngarkesën e çatisë. Bouleuterioni i Assosit, bashkë me atë të Miletus, Athinës dhe të Herakleia-s, i takojnë një grupi të ri ndërtesash me hapësirë të brendshme të madhe të mbuluar nga çati që mbështeten mbi një numër të vogël kollonash.




Figure 20. Bouleuterioni në Assos, Heraklea në Lantum dhe Notium

Bouleuterioni në Heraklea në Latmum (Kapikiri) e shek. II p.e.s. është një ndërtesë e vogël drejtkëndore 21x15,6m e mbuluar me çati në qendër të qytetit në lindje të Agorasë së Herakleias. Dy hyrjet në anën e gjatë jugore të çojnë drejtpërdrejt në auditorium. Në brendësi të tij, një shkallare prej mermeri në formën e germës “π” me gjashtë rradhë ndenjësesh, rrethonte një “orkestër” pothuaj kuadratike. Një kollonadë e brendshme²⁶, pas rradhës më të lartë të ndenjësëve, mbante çatinë, ndërsa një korridor kalonte mes kollonave dhe mureve të

²⁵ (Sear, 2006)

²⁶ Tek (Sear, 2006) planimetria jepet vetëm me katër kollona të brendshme që mbanin mbulesën.

jashtëm. Vend-ndodhja dhe forma e ndërtesës na kujtojnë Bouleuterionin e Prienës, por këtu kapaciteti i ndenjësive është vetëm për 300 vetë, një numër i kufizuar ky, pasi Heraklea nuk ishte qytet shumë i madh.

Bouleuterion në Prienë 150 p.e.s. ka një planimetri drejtkëndore 20 x 21m me shkallë të vendosura në kënd të drejtë në disa radhë përgjatë tre anëve të sallës. Mendohet të ketë patur një kapacitet për 550-680 vetë. E gdhendur në kodër, kishte hyrje ballore në nivelin e ulët dhe një dalje nga pas në lartësi që, për të të çuar direkt në nivelin e lartë të *caveas*, shfrytëzonte lartësinë e kodrës. Për të, nga Sear²⁷ gjejmë përcaktimin se mund të ketë qenë edhe Eklesiasterion.

I të njëjtës periudhë shek. II p.e.s. është Bouleuterioni në Notium (Azi) me një plan drejtkëndor 27x22.5m, me radhë të drejta ndenjësesh në tre anë e me një radhë kollonash pas tyre, që pranë mureve të brendshme, ndihmonin të shkarkohej mbulesa. Plani i tij na kujton atë të Bouleuterionit në Heraclea në Latium, duke dhënë shembullin e një organizimi hapësinor nga më të thjeshtit e më efikasët.

Bouleuterioni Alabanda datohet në shek. II p.e.s. nga (Lauter) e në shek II e.s. nga (Balty), e paraqitet me shkallë të vendosura në formë gjysmërrethi brenda sipërfaqes drejtkëndore 26x36m. Dy hyrje anësore do të çojnë nëpërmjet shkallëve në korridore të mbuluar me qemer, *Crypta*, në nivelin e lartë të *caveas* (si në Apolloni)




Figure 21. Pamje dhe plan i Bouleuterionit në Prienë dhe plan i atij në Alabanda

Në Mesenë Eklesiasterioni i shek. II p.e.s. (3 shekuj më parë se ai i Apollonisë), ishte një ndërtesë e ngjashme me një Teatër, me “*cavea-n*” e saj të përmbyllur në një strukturë drejtkëndore 21x34m dhe me një orkestër gjysëm-rrethore²⁸. Skena (gjerësia: 21m) kishte një *proscenium* me tre hapje në ballë dhe një shkallë dalje në anën lindore të saj. Cavea, paksa më e madhe se një gjysëm rrethi, ndahet me anë të një korridori në pjesën më të lartë dhe më të ulët. Pjesa e ulët e *cavea-s*, që është ruajtur më mirë, përfshin 11 rreshta me ndenjësive dhe ndahet në tre sektorë prej dy korridoresh me shkallë. Dy shkallë të tjera zbritëse gjenden nga fundi, afër *parodoi-t*. Gjenden dy hyrje në lindje, në anë të rrugës që

²⁷ (Sear, 2006)

²⁸ www.ancientmessene.gr

ngjitet lart, njëra të çon tek orkestra me anë të shkallëve zbritëse, dhe tjetra të lidh drejt e me korridorin ndarës mes pjesës së sipërme dhe asaj të ulët të caveas. Ajo rrethohet me një mur mbajtës të fortë. Një kafaz shkalle i mbuluar me çati, i ndodhur në cepin V-P të murit mbajtës, i jep hyrje nga veriu në korridorin më të lartë të cavea-s.




Figure 22. Eklesiasterioni i Messenës në Plan e në pamje ajrore ashtu siç paraqitet sot.

Kjo sallë Teatri elegante duket se është përdorur, si për mbledhje të natyrës politike, duke shërbyer si Bouleuterion apo Eklesiasterion²⁹ ashtu edhe për shfaqje artistike Teatrorë dhe muzikore për nder të Messene dhe Asklepius që nderoheshin sëbashku në Asklepieion, pra si Odeon³⁰. Propyloni të drejton nga rruga në ngjitje e kodrës në lindje të faltores deri poshtë tek Asklepeioni. Në gjysëm të rrugës gjendet një mur tërthor me tre hapsira për dyer – një qendrore më e madhe dhe dy anësore më të vogla. Në anën lindore të murit kishte një portik që përbëhej prej katër shtyllave katrore që mbajnë kollona jonike. Portiku perëndimor u riparua pa shumë kujdes në antikitetin e vonë (shek. IV – III e.s.).

Bouleuterioni i Messenës (shek. II p.e.s.) ndodhej në Asklepieion dhe shërbente si ambienti kryesor i mbledhjeve për *Synedroi*³¹ që përfaqësonte qytetet e Mesenias së pavarur dhe federale. Salla ka një formë kuadratike me përmasa 20.80 x 21.60 m., e mbulohej nga një çati të pjerrët katër ujëse të mbështetur në katër kollona të brendshme. Tre nga anët

²⁹ (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994) f. 25-29

³⁰ (Sear, 2006) f. 401

³¹ Këshilli i krahinës në Greqinë e lashtë

(veriore, lindore dhe jugore) qenë mbyllur nga mure 1.20m të trashë të ndërtuar prej blloqesh të mëdhenj prej guri, ndërkohë që hyrja e vetme ishte në anën perëndimore e përbërë prej dy dyersh të mëdha me tre pjesë, shihte në Stoa.




Figure 23. Mesenë. Bouleuterioni tregohet me kuadrat të kuq në krah të sheshit të Asklepion-it,

Në tre anët e mbyllura është ruajtur një stol guri i vazhduar me shpinore dhe i dekoruar në dy ekstremitetet me forma që imitojnë putrat e luanit. Gjatësia e plotë e këtij stoli ishte 56 metra, ku mund të uleshin rreth 76 synedroi – numri i përfaqësuesve të qyteteve që përbënin Këshillin Federal të Messenias.

Shek. I p.e.s i përket edhe Bouleuterioni në Iassos. Ndërtesë drejtkëndore në anën jugore të Agorasë. U ndërtua në kohën kur Iasos ishte nën sundimin e Miletus e prej kësaj rrjedh ndoshta edhe ngjashmëria planimetrike me Bouleuterionin e Miletus.



Iassos bouleuterion, www.histolia.de




Figure 24. Iassos, Bouleuterion, vëmë re hyrjen anësore dhe kalimin poshtë caveas si në Apolloni

Salla e mbledhjeve mund të arrihet përmes dy hyrjeve në anën veriore të ndërtesës dhe të hapura në anët e katër kollonave duke zburuar murin ballor; gjendeshin edhe dy hyrje anësore me shkallë. Rradhët e ndenjësive ishin të llojit amfiteatër të ndara në tre pjesë nga shkallaret. Salla lidhej me anë të një korridori të ngushtë me dhomat e Stoa së lindore në Agora dhe që përdorehin si Arheion (arkivë). Forma përfundimtare e Buleuterionit, që imiton atë të Miletus, u përcaktua gjatë periudhës së sundimit romak. Sot gjenden mbetje të mureve të ndërtesës dhe pjesë të nën-strukturës së ndenjësive dhe të korridoreve të mbuluar që na kujtojnë nënkalinin poshtë ndenjësive të Bouleuterionit në Apolloni.

Sagalasos shek. II p.e.s. (125-100p.e.s.) me plan drejtkëndor 21x22m do të jetë ndërtuar si në rastin e Prienes me radhë ndenjësive të drejta të vendosura në tre anë të drejtkëndëshit e që përfundonin në *analema*³² të pjerrëta. Hyrja bëhej përsëri nga tre porta të vendosura në ballë.

Më Korinth në shek. I p.e.s. Bouleuterioni u rikonstruktua si një ndërtesë Romake me një formë eliptike. Ajo u ndërtua për të mbajtur mbledhjet e Boulé-së vendore të qytetit. Ngritja e Kuria-s³³ ishte një pjesë e projektit më të madh të rindërtimit të qytetit pas vitit 44 p.e.s. – vit kur qyteti u rithemelua nga Çezari si një koloni Romake. Ndërtesa ndahej në sallën kryesore të konferencave dhe një paradhomë. Salla kryesore, e mbuluar me çati, përbëhej prej dy muresh të drejtë dhe dy të kurbëzuar përgjatë të cilëve kishte stola guri. Një ose tre dyer të shpinin në parasallën e stërgjatur me anët e ngushta të kurbëzuara. Fasada veriore e ndërtesës zbukurohej me portik ballor. Forma arkitektonike e kësaj ndërtese është e pazaontë në Greqi, por ajo ka disa ngjashmëri me disa ndërtesa Romake në Itali.

³² Muri kufizues i shkallares aty ku ajo afrohet me skenën.

³³ Kuria (curia) ishte salla e senatit në epokën Romake




Figure 25. Bouleuterion në Sagalassos, Korinth dhe Ariassus

Ariasos (Turqi) më parë i njohur si Cretopolis – pati një Bouleuterion të shek. 1.p.e.s.

Ndërtesa kishte formë katërkëndëshe 14x14,5m , me katër hyrje – dy në fasadën e hyrjes, një në anë dhe një nga mbrapa - që të çonin në sallën e mbledhjes që, nga ana e tij, mund të mbante rreth 350-400 vetë. Cavea gdhendej në shkëmb ndërkohë që një ambient katërkëndësh me një radhë kollonash si një portik, i cili ndodhej pas shkallares lidhej me auditorin me anë të një apo tre dyerve të ngushta që të çonin në hyrjen e pasme të ndërtesës. Nuk e kemi të qartë nëse aty ka patur shkallë për tu ngjitur në nivelin e lartë të caveas dhe ku kanë qenë ato. (ngjashmëri me Apolloninë tek hyrja e prapme por pa *crypta*) Ndërtesa mbart ngjashmëri të madhe me Odeumin e Agrippa-s në Athinë. Mbetjet e tij janë vetëm në lartësinë e themeleve.




Figure 26. Bouleuterioni në Cyrene dhe në Nysa

3.4.5. Shembuj botërorë gjatë shek. I – II e.s.

Në Cyrene Bouleuterioni i shek I e.s. ka plan trapezoidal 19,8 x 8,8m me një orkestër eliptike në dy anët e të cilës qëndrojnë ndënjëset në formë harku në të cilat mund të qëndronin 300-400 vetë. Hyrja hapej në një nga faqet gjatësore e dy kollona krijojnë tre porta që të fusnin direkt në orkestër.

Bouleuterion në Nysa ndërtohet në shek. I p.e.s. e rindërtohet mes shek. II e.s. Në një sipërfaqe drejtkëndore 27,4x23,5m vendosej cavea me shkallë në formë gjysmërrethi e ndarë në 4 pjesë nga korridoret mes tyre 580-715 vete. Nga forma drejtkëndore e objektit, mendojmë se duhet të ketë qenë i mbuluar me strukturë druri e çati me tjegulla. Për këtë

objekt Diskutohet nese është një boule apo odeon pasi në rastet kur ka një Stage-si je paraskene Teatri, konfirmohet rasti që objekti të jetë odeon, në të kundërt Bouleuterioni nuk ka nevojë për një stage³⁴.

Nw Schythopolis (Izrael) Bouleuterioni i shek II e.s. (195-235) ka një plan gjysmërrethor me diametër 24,4m të kufizuar nga mur 1,2 m. Ruhen sot një pjesë e *cavea*-s me 8 rradhë ndenjësesh që shohin nga lindja si dhe dy mure paralele të proskenës. Në gjerësinë e mureve anësore dhe në orientimin nga lindja dallojmë edhe këtu ngjashmëri me Apolloninë.

Në Ptolemais (Libi) Bouleuterioni ose Odeoni i fillimit të shek. III e.s, ka një plan interesant që na kujton Apolloninë në korridoret me qemer poshtë *cavea*-s të quajtura *crypta*. Një volum drejtkëndor mban në brendësi cavean me 32,5m që duhet të ketë mbajtur 1250-1350 vetë. Rradhët e fundit të caveas mbështeteshin në qemerin e një *crypta* që si një korridor shoqëronte të gjithë diametrin e jashtëm të caveas. Një hyrje nga lindja te fuste në një kafaz shkallësh që të ngjitet në rradhët e sipërme të caveas, ndërkohë që një hyrje nga ana e proskenës, në anë të analemës, të fuste në *crypta* dhe në një të tretën e gjatësisë së kurbës së saj, në lindje futeshe në një korridor me shkallë që të ngjisinin në rradhët e sipërme të caveas. Një skemë komplekse qarkullimi që kujton Apolloninë

Bouleuterioni në Serdica (Sofie, Bullgari) në shek. II e.s., e rikonstruktuar në shek. III-IV e.s. do të ketë një plan 25x23.7m brenda të cilit vendosej *cavea* në formë gjysmërrethi. Rradhët e fundit të saj do të mbështeteshin në korridoret *crypta* të mbuluara me qemer. Dallojmë një ngjashmëri gati identike me Apolloninë por pa ditur nëse ekzistojnë shkallët në anën e prapme që do të ndihmonin në ngjitjen në nivelin e lartë të *caveas*.

Në Seleucia (Sihlar, Turqi) Bouleuterioni i ndërtuar në një periudhë të pacaktuar do të ketë formë të caveas të kurbëzuar brenda mureve që formojnë një katërkëndësh 22x23m. Katër hyrje në pjesën e orkestrës. Edhe këtu kemi gjurmë të dritareve në pjesën e lartë të mureve por pa ditur nëse do të kenë qenë me arkitra apo me hark si propozon E. Follain tek rikonstrukcioni për Bouleuterionin e Apollonisë.




Figure 27. Bouleuterioni në Scythopolis, Ptolemais, Serdica

³⁴ (Sear, 2006)

Bouleuterioni në Cnidus (Tekir) i shek. II e.s. me një plan drejtkëndor 10x20m, kishte një shkallare cavea të ndarë në dy pjesë nga shkallë që të ngjisin në nivelin e lartë. Mbulesa e drunjtë duhej të mbahej nga kollona që ruajnë sot vetëm bazat e tyre.




Figure 28. Bouleuterion në Seleuca, Cnidus, Ephesus,

Në Ephesos (Kusadasi-Turqi) në shek. III p.e.s. duhet të ketë patur një Bouleuterion që përmendet nga Hansen & Fischer-Hansen³⁵ por që duhet të jetë rikonstruktuar në 150 e.s. si një Bouleuterion / odeon duke marrë formën që ka sot. Sear³⁶ na e prezanton si një ndërtesë në formë patkoi që në anën e prapme ruan gjysmëcilindrin e imponuar nga forma e auditorit. Shkallarja cavea me diametër 45m gdhendet në shkëmb e në pjesën e lartë të saj mund të ngjitemi nga shkallë duke kaluar në crypta të mbuluar me qemer, të cilat nisin nga anët e skenës e çojnë në nivelin e mesit të shkallares.

Në Stratonicea (Azi e vogël) Bouleuterioni i shek. II e.s. i njëkohshëm me atë të Apollonisë ka një shkallare cavea në formë patkoi të brendashkruar drejtkëndëshit 24,9x 29,8m, me kapacitet 560 - 700 vetë.

Në fasadë kryesore paraprin portiku si në një pronaos tempull me 8 kollona, prej të cilit, nga dy hyrjet në ballë kalojmë në interior. Salla ka edhe dy hyrje anësore meqë nëpërmjet crypta-s , të çojnë në nivelin e sipërm të caveas. Ky plan, i ngjashëm me Bouleuterionin në Iassus, Alabanda, dhe Anemerium na kujton edhe planin e Apollonisë.

Bouleuterioni në Anemurium, (Turqi) ndërtohet në fund shek. II e.s. në një shpat kodre natyrale. Ka formë drejtkëndore 30 x 21m me shkallë gjysmërrethore që drejtohen nga lindja dhe kapacitet mjaft të madh 920-1150 vetë. Pjesa e sipërme e shkallëve të caveas ngrihet mbi një korridor crypta të mbuluar me qemer dhe vazhdon me shumë se gjysmërrethi duke arritur deri në faqen ballore e duke marrë kështu formën e një shkallareje në formë patkoi (kjo e bën të ngjashme me Bouleuterionin e Apollonisë e

³⁵ (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994), f. 28

³⁶ (Sear, 2006)

Anamurium). Salla ka një proskenë me *stage*³⁷ të ngritur që bën të interpretohet edhe si Odeon nga Russell.³⁸




Figure 29. Bouleuterioni në Stratonicea dhe hyrje anësore që te ngjisin në pjesën e prapme të caveas



Figure 30. Anemurium, Bouleuterion

Në murin e prapëm ka dy hyrje që, të paraprirë nga shkallë gjysmë rrethore, të ngjisin në nivelin e sipërm të caveas. Muri anësor në njërin krah mban akoma shenja të dritareve të hapura në lartësi, të cilat ngjajnë si ato që në rikonstrukcionin hipotetik propozon Follain³⁹. Këtu interesante është të vemë në dukje ngjashmërinë e skenës e prapaskenës me ato të Teatrit të Butrintit: e njëjta hapje treshe me nikje dekorative në muret ndërmjet. Janë pikërisht këto hapje në skenë, të cilat duke qenë më shumë se një, interpretohen nga Russell si të lidhura me karakteristika të spektaklit artistik më shumë se me ato të mbledhjeve të këshillit. Në fakt kujtojmë se edhe për Teatrin e Butrintit, duke qenë nga dimensionet e vogla të tij, është hedhur nga Meinel dhe Izenour⁴⁰ ideja se ai mund të ketë qenë edhe një odeon, sallë e mbuluar shfaqjesh, pavarësisht se parregullsia planimetrike dhe trashësia jo e madhe e mureve nuk të lënë të mendosh se ka patur mbulesë.

³⁷ Stage është një bazament në formë podiumi para skenës

³⁸ (J. Russell, 1973) f. 11–23.

³⁹ (Follain, 2009). f. 115-122

⁴⁰ (Sear, 2006) f. 451

Sipas Sear listohen Bouleuterionet sipas madhësisë e përmasave të tyre dhe numrit të këshilltarëve që akomodoheshin në brendësi. Për Apolloninë, pavarësisht se për të nuk ka një numër të saktë të radhëve që ndodheshin në brendësi, ai përcakton një kapacitet nga 250 në 315 vetë (përmasa 19,5x15m), ndërkohë që më i madhi ndër Bouleuterionet grekë ishte ai i Miletit me 1200-1400 vetë (përmasa 35x24m), e më të vegjlit ata të Acrae apo Soluntum me rreth 100 vetë (përmasa 8,5x8.2m e 11x7m). Sipas evidentimit që ai bën mund të nxjerrim që raporti i sipërfaqes së ndërtesës me numrin e këshilltarëve që zë ajo, jep një koeficient 0,6-0,7 m²/person. Nga një analogji kalkuluese mund të nisemi për të përllogaritur numrin e këshilltarëve që mund të qëndronin në ndërtesën në formë patkoi. Për një sipërfaqe të saj 128,48 m² e një koeficient mesatar 0,65m²/person, rezultojmë në 198 vetë kapacitet mbajtës të saj. Numër ky i përafërt me 230 që rezultoi nga përllogaritja me formulën që Sear propozon për objektet Teatër. Kwshtu mendojmë se kapaciteti i ndërtesës në formë patkoi ishte nga 200-230 vetë, numër ky tepër i vogël për një këshill qyteti të madh si Apollonia.

THEATRES AND RELATED BUILDINGS				
TABLE 4.3. <i>The relationship between size and capacity in bouleuteria</i>				
Bouleuterion	Date	Dimensions (m)	Rows of seats	Capacity
Acrae	?3rd cent. BC	8.65 × 8.15	5	80/100
Soluntum	2nd cent. BC	11.15 × 7.35	5	90/115
Miletus	2nd cent. BC	34.84 × 24.29	19	1,200/1,600
Priene	c.150 BC	20.00 × 21.00	9-15	550/680
Iaitas		12.85 × 11.90	9	200/250
Termessus	1st cent. BC	24.53 × 24.40	18	800/1,000
Troia	Augustan	29.50 × 25.00	14	830/1,040
Cyrene	1st cent. AD	19.80 × 8.80	2 × 11	300/420
Apollonia	2nd cent. AD	19.50 × 15.00	?5	250/315
Ariassus		14.00 × 14.50	11	350/440
Stratonicea	mid-2nd cent. AD	24.95 × 29.80	13	560/700
Alabanda	2nd cent. AD	36.00 × 26.00	11	680/850

3.5 Trajtimi e analiza tipologjike

Nga studimi i tipologjisë së Bouleuterionit mund të bëjmë klasifikim të këtyre objekteve në bazë të formave planimetrike që ato paraqesin, të mënyrës se si shkallët vendosen në interior, të mënyrës si organizohen flukset e lëvizjes dhe të mënyrës se si shkallët janë ndërtuar.

Nga ana planimetrike Bouleuterionet paraqiten gjithmonë si salla në forma katërkëndore, (përjashtim këtu përbën vetëm rasti i Korinthit i cili ka një plan në formë patkoi), lidhur kjo me faktin që ato ishin gjithmonë salla të mbuluara dhe si të tilla ato do të kishin të domosdoshme rregullsinë planimetrike. Planimetria e rregullt gjeometrikisht do të mundësonte vendosjen e një mbulese me çati e tavan të drunjte, karakteristike për

ndërtimet Greke të bazuara në llogjikën konstruktive të sistemit trilitik tra-kollonë. Kujtojmë se vetëm në periudhën helenistike e më pas Romake, do të mund të përdoren sisteme alternativë konstruktivë, por që nuk mund të përdoren në mbulesat e këtyre objekteve për vetë përmasat e mëdha që ato zakonisht kishin. Bouleuterionet edhe në periudhën Romake do mbuloreshin gjithmonë me mbulesa të drunjtë nën çati.

Si tipe planimetrikë mund të dallojmë dy grupe:

- 1) salla katërkëndëshe në formë drejtkëndëshi të zgjatur ose jo në planimetri, me ndenjësë druri: Në këtë grup dallojmë tre nëngrupe:
 - a) Salla me ose pa kollona në brendësi, të domosdoshme për të mbajtur mbulesën.
 - b) Salla me ose pa portik në pjesën e përparme.
 - c) Salla me ndenjësë të drunjëta të vendosura në formë të pacaktuar në plan (pasi nuk kanë lënë gjurmë të mënyrës së vendosjes së tyre).
- 2) Salla katërkëndëshe në formë drejtkëndëshi me shkallë guri në brendësi. Në këtë grup dallojmë tre nëngrupe:
 - a) Salla me shkallë të vendosura në linja të drejta paralele me tre brinjët e drejtkëndëshit e të orientuara rreth një ambjenti katërkëndësh në qendër.
 - b) Salla me shkallë të vendosura si në Teatër në formë gjysmërrethi e të orientuara drejt një orkestre (pa korridore *crypta* poshtë *caveas*)
 - c) Salla me shkallë të vendosura si në Teatër në formë gjysmërrethi e të orientuara drejt një orkestre (me korridore *crypta* poshtë *caveas*)

Forma më e hershme që u përdor ishte drejtkëndore më hapësirë të ndarë osë jo në nefe nga një radhë gjatësore kollonash. Këto ndërtime i përkasin shekujve VII-VI p.e.s.

Ndërkohë që në tipin e dytë të Bouleuterionëve dallojmë planimetri drejtkëndëshe apo katrore me shkallë të vendosur sipas linjave të kurbëzuara. Si fazë tranzicioni mes dy mënyrave të vendosjes së ndenjësëve, është një formë me shkallë në linja poligonale e cila është zbuluar në Bouleuterionin e ri të Athinës⁴¹ e që më pas u transformua në ndenjësë në formë të kurbëzuar.

⁴¹ (Mogens Herman Hansen, Kurt A. Raaflaub, 1995) tek "Studies in the Ancient Greek Polis", Volume 1 analizon Bouleuterionin e ri të vjetër të Athinës duke i marrë ato si shembull ilustrues të evolucionit të kësaj tipologjie. Sipas tij, në një fazë të ndërmjetme, bouleuterioni i ri ka patur shkallë në formë poligonale. Kështu, për të rritur sipërfaqen e shfrytëzueshme me shkallë - ndenjësë, arkitektët, nga forma drejtkëndore e shkallëve të vendosura në tre anë, duhet të kenë kaluar në formën poligonale dhe, pas saj për rritje edhe më tej të numrit të vendeve për ulje, kaluan në formë të kurbëzuar si në një teatron.




Figure 31. Bouleuterionet sipas tipit të parë planimetrik: sala katërkëndëshe në formë drejtkëndëshi të zgjatur ose jo në planimetri dhe me ndenjës druri




Figure 32. Tipi 2, nëngrupi a), Salla me shkallë të vendosura në linja të drejta paralele me tre brinjët e drejtkëndëshit e të orientuara rreth një ambjenti katërkëndësh në qendër




Figure 33. Tipi 2 nëngrupi b), Salla me shkallë guri të vendosura në formë Teatri, të mbështetura në kodër apo në mbushje dheu, pa korridore crypta poshtë caveas.




Figure 34. Tipi 2 nëngrupi c), Salla me shkallë guri të vendosura në formë Teatri, të mbështetura në kodër e pjesërisht mbi korridore crypta poshtë caveas.

3.6 Analizë krahasuese e Bouleuterionit të Apollonisë

Bouleuterioni i Apollonisë i përket tipit të tretë planimetrik_ sallë drejtkëndëshe më ndenjëse të vendosura në formë të kurbëzuar si Teatron.

Në planimetrinë e rievuar nga L. Rey vemë re shkallët këndore në shpinë të Teatronit të cilat të ndihmonin për tu ngjitur në vëndet e larta të tij. Një element të tillë funksional nuk e hasim në të gjithë rastet që shqyrtoam. Ai përdorej vetëm kur ngjitja nuk bëhej nga shkallët radiale në mes të Teatronit. Duke hulumtuar në rastet tipologjike dallojmë që ky element funksional do të përdoret edhe në planimetritë me shkallë në formë U edhe në ato në formë Teatroni të kurbëzuar, por jo në çdo rast.




Figure 35. cavea dhe skema e lëvizjes në brendësi të Bouleuterionit të Apollonisë

Duke studiuar skemat e lëvizjeve në brendësi që nga momenti i hyrjes e kuptojmë se në rastin e Apollonisë lëvizja në një korridor të mbuluar për tu shpërndarë në brendësi është gati një përjashtim për tipologjinë e Bouleuterionit, e haset më shumë tek Odeonet.

Duke ju referuar skemave të lëvizjes brenda Bouleuterionit, kuptojmë se në rastin e Apollonisë kishim një lëvizje komplekse që duke shtuar edhe komunikimin në korridorin anësor, duhet të ketë ndihmuar në mbushjen e zbrazjen e shpejtë të ndërtesës.

Kjo skemë do të jetë e zakonshme për rastet e Teatrove Romake, duke na bindur se influencat e arkitekturës së perandorisë po ndjeheshin në Apolloninë e shek. I p.e.s.

Duke ju referuar rasteve të objekteve të tjerë në të cilët hyrja nuk ishte vetëm ballore, mbështesim rikonstrukcionin grafik të E. Follain që pozicionon edhe një hyrje të pasme, që të ngjitet në nivelin e lartë të shkallares.




Figure 36. Skemat e lëvizjes në Miletus, , Iassos dhe Apolloni

Përsa i përket fasadave të këtyre ndërtesave kuptojmë se Tipologjia e Bouleuterioneve prezantohet me fasada me portikë, një mënyrë e ngjashme me atë të fasadave të temujve dhe që u bë si një kod dizajni për çdo objekt publik. Në Apolloni fasada ndërtohet me gur në ndryshim nga faqet anësore që prezantoheshin me ngjyrën e tullës të „*opus testaceum*“ të lënë në dukje. Ndërtimi me mure tulle mbi baza guri ishte fenomen i njohur edhe në Apolloninë e shekujve të mëparshëm.

Sallat e Bouleuterioneve, na arrijnë të dëmtuara, pa mbulesat dhe pa muret anësore (shpesh blloqet e gurit ripërdorëshin për ndërtime të mëvonshme).

Duke analizuar shembujt e rikonstrukcionet hipotetikë të tyre, evidentojmë faktin e mbulesave të drunjtë dhe të dritareve që domosdoshmërisht duhet të hapeshin në lartësi, mbi nivelin e shkallës së fundit të Teatronit. është e paqartë nëse forma e tyre, mund të ishte me hark apo edhe me arkitra të gurtë. Mund të mbështesim hipotezën e Follain për dritare me hark, (bazuar kjo në kohën e ndërtimit) por duhet të sugjerojmë se detaji arkitektonik i fasadës anësore duhet të ketë qenë më i pasur, si në raste analloge.

3.7 KONKLUSIONE DHE DISKUTIME

Si rezultat i trajtimit të të gjithë Bouleuterioneve dhe Eklesiasterioneve kuptuam llogjikën që ndiqej në kompozimin e këtyre objekteve. Të ndërtuara si ambiente për mbledhje ato diferencoheshin nga madhësia e kapaciteti mbajtës. Bouleuterionet ishin salla relativisht të vogla, zakonisht për 500 vetë por mund të arrijnë edhe në 1100-1400 vetë, ndërkohë që Eklesiasterionet ishin për shumë njerëz, deri në 7500 vetë. Prej kësaj rrjedh fakti që diferencimi kryesor në tipologji do të shfaqet në mundësinë e mbulesës: Bouleuterionet ishin salla të mbuluara, ndërsa Eklesiasterionet ishin ambiente të pambuluara.

Ato kishin si elementë të domosdoshëm një shkallare, në formë Teatroni me shkallë të vendosura në linja të drejta apo të kurbëzuara, si dhe një vend ku qëndronte oratori të cilin mund ta quajmë skenë ose “bemë” tek Eklesiasterionet, një element që e gjejmë shpesh tek Stoa të në disa qytete antikë: Korinth, Metaponto. Shkallarja vendosej në një terren të pjerrët, themi jo shkëmbor, duke patur një kënd 7-8°; për një pjerrësi më të madhe të shkallares do të duhej domosdoshmërisht terren shkëmbor për të shmangur rrëshqitjen dhe prishjen e saj.

Në rastet e njohur të Pnyx apo Metapontum, kjo pjerrësi e butë u krijua nga një mbushje dheu brenda një konturi mural të gurtë.

Në një analogji të tillë mund të kemi patur në ndërtimin në formë patkoi tek Agora helenistike në mes dy kodrave në Apoloni.




Figure 37. Bouleuterioni Apollonisë⁴², Miletus, Olympia dhe Athina,

Struktura e gurtë e gjetur vetëm në një radhë gurësh themeli, na kujton formën e ngjashme që gjejmë tek Bouleuterioni i Korinthit, i cili kishte një formë patkoi e sipas studiuesve supozohet të jetë mbuluar me çati dyujëse dhe pjesërisht konike. Nëse do të tentonim të gjenim një analogji në formë të tij me atë të Apollonisë, do të ishim të justifikuar nga fakti se dy qytetet (Apolloni, Korinth) ruanin marrdhënjet e tyre akoma në shek. V-IV p.e.s., kur ndërtimi në formë patkoi duhet të jetë ndërtuar. (kujtojmë këtu referencat e autorëve që dëshmojnë komunikimin edhe tokësor mes dy qyteteve si dhe aleancën ushtarake të tyre, të përmendura edhe më parë në këtë punim). Ndërkohë që të mendojmë se ky ndërtim mund të ketë qenë një Eklesterion, nuk na lejojnë dimensionet e vogla të tij. Kujtojmë që rastet që njohim kanë përmasa nga 45- 65m apo akoma më të mëdha në 69,9 m tek Pnyx.

Kështu duke ndjekur këtë arsyetim i vetmi funksion që mund ti vishet këtij objekti është ai i një Bouleuterioni (i periudhës helenistike). Këtë e mbështesim në faktin që për çdo qytet duhet të kishte patjetër një sallë këshilli, që në vend tjetër nuk është dëshmuar arkeologjikisht veçse tek tempulli i Agonotetëve i shek. II e.s. Po para kësaj periudhe ku duhet të jenë bërë mbledhjet e Boulesë e ato të Eklesterias? Për Eklesterian kemi një alternativë jo të panjohur (mbledhjet e asamblesë së qytetit shpesh bëheshin në Teatër). Teatri i Apollonisë dëshmohet të jetë ndërtuar në shek III p.e.s. Kështu që prej atij shekulli mbledhjet e Eklesterias duhet të jenë bërë në Teatër e nuk do të kishte nevojë për një tjetër (aq më tepër të vogël) në Agora.

⁴² Rikonstrukcion E. Follain,




Figure 38. skema indikative për të ilustruar idenë se ndërtesa në formë patkoi mund të ketë qenë një bemë e një Eklesiasterioni.

Vemë re se mbetet si një periudhë “e zbuluar”, koha nga shek. III p.e.s deri në mes të shek. II e.s. periudhë në të cilën nuk e dimë se ku duhet të ketë qenë Bouleuterioni. Gjithashtu kuptojmë se duke qenë se vetëm prej shek. III p.e.s. mund të përdorej si Eklesiasterion Teatri, natyrisht që më parë rolin e tij duhet ta ketë përmbushur ndërtimi në formë patkoi.

Mund të hipotezohet se ajo që sot gjejmë si formë patkoi të ketë qenë një *Bema* dhe të kërkonim në veri, pjerrësinë e shkallares që shihte në drejtim të Bemës, rolin e së cilës duhet ta luante vetë objekti në formë patkoi.

Raste të një Beme apo edhe të një orkestre, si një vend ku mund të qëndronin kërcimtarë apo edhe aktorë e oratorë të ceremonive civike publike hasim në Argos, në Pnyx, në Mantinea apo Korinth⁴³. Këto orkestra ishin sipërfaqe të hapura të konturuara nga një rradhë gurësh që përcaktonin një platformë gjysmërrethore.

Por për të mbështetur plotësisht këtë hipotezë do të na pengonin gjurmët e rrugëve të sistemit rrugor blu, të dëshmuara nga arkeologët në veri të ndërtesës. Ato janë një fakt i dalë nga gjurmimet e themi që është vërtetuar tashmë ekzistenca e tyre si sistemi i parë urban i vetë Apollonisë së hershme. Kujtojmë se e kemi trajtuar këtë në kapitullin e

⁴³ (Donati, 2015) f. 193-197. Duke trajtuar agoranë e Argos ai citon sipërfaqen rrethore si një orkestër që ndodhej pranë agorasë e që hasej shpesh në qytetet arkaikë të para periudhës klasike. Ai aludon që këto orkestra mund të qëndrojnë edhe në pikënisje të një piste vrapimi apo piste vrapimi kuajsh (hipodrom)

Agorave dhe e kemi quajtur si një sistem që duhet të ketë qenë i influencuar jo nga rregulla hipodamike, por nga kanale të përdorura herët në toka bujqësore, e që gjithmonë për arsye funksionale bëheshin në linja paralele e përpendikulare, të barazlanguara nga njëra tjetra. Ky sistem rrugor duhet të ketë ekzistuar para se të ndërtohej ndërtesa në formë patkoi, e cila gjerësinë në diametrin e gjysmërrethit e zgjodhi ta kishte më të madhe se distanca mes rrugëve duke ju mbivendosur atyre. Mbetet për të qartësuar nga arkeologët kohët e ndertimit të objekteve që dokumentohen nga mbetjet në këtë zonë.




Figure 39. Shembuj të Agorave të qyteteve të Argos dhe Mantinea. Vëmë re bemën në Argos, e cila ka shhbyer si një orkestër, dhe Bemën eksedër në Mantinea e cila na kujton një situatë të ngjashme me Apolloninë




Figure 40. Eklesiasterioni Pnyx në Athinë (majtas) dhe Bema në Korinth (djathtas)

Si rezultat mund të dallojmë këto periudha kohore të njëpasnjëshme të lidhura me zhvillimin e kësaj pjese të qytetit e më vonë të Agorasë, si dhe me ekzistencën në këtë vend të një Eklesiasterioni apo Bouleuterioni..

- 580 – 500 p.e.s. _trasohet sistemi i rrugëve ortogonale blu (mbledhjet bëheshin në zonën e Agorasë)
- 500 – 400 p.e.s _ndërtohet objekti në formë patkoi, shërben si bemë e Eklesiasterionit

- 400 – 300 p.e.s _bema e Eklesiasterionit kthehet në Bouleuterion dhe Eklesiasterioni transferohet në Teatër
- 300 p.e.s. - 250 p.e.s. _ndërtohet Portiku i madh, i cili i mbivendoset Bouleuterionit.
- 300p.e.s. -150 e.s. _boshllëk funksional, nuk dimë se ku ka qenë Bouleuterioni.
- 150 e.s – shek. V p.e.s _si Bouleuterion shërben tempulli i Agonotetëve.

Kuptojmë se nga vitet 300 p.e.s. apo koha kur u ndërtua Portiku i madh e deri më 150 e.s., ne nuk dimë se cila ndërtesë ka qenë Bouleuterion. A mundet të qëndrojë një qytet pa një ndërtesë për Bule? A do të ishte e arsyeshme të prishej një Bouleuterion (ndërtesa në formë patkoi) për të ndërtuar një Portik-Stoa (Portiku i madh), nëse nuk do të kishin diku tjetër një Boulé ??? Por kjo ka ndodhur e dëshmohej: portiku ju mbivendos Bouleuterionit duke na bërë të deduktojmë se patjetër, një ndërtesë tjetër Bouleuterion në këtë periudhë duhet të ketë patur. Por ku duhet ta kërkojmë atë ? Mos ndoshta tek dy objektet në krah të rrugës së gjerë në hyrje të Agorasë? Njëri prej tyre është supozuar një tempull, ndërkohë që tjetrit, atij në veri të rrugës, akoma nuk i është dhënë një funksion. Me formën drejtkëndore, ai që është quajtur si një tempull deri më tani, mbush kushtin formal të jetë një Bouleuterion, por sipërfaqja e tij është tepër e vogël (16,5x11,5m) për të na bindur se duhet këtë qenë një i tillë. Në fakt kemi raste të ngjashme, të dimensioneve të tilla të vogla në shembujt e bouleuterioneve botërore që evidentuam, veçse dyshimi lidhet me faktin në se ai me atë madhësi do të ishte apo jo i mjaftueshëm për mbledhje këshilli e kapacitetin mbajtës që duhet të siguronte. Në të vërtetë, kohën në të cilën është lokalizuar ky objekt, sh. I p.e.s. këshilli ndoshta nuk ka patur 500-700 vetë si në kohën helenistike, por mund të ketë qenë si në administratën Romake me 80 apo 100 vetë. Këtu duhet arsyetur si më lart, kur folëm për Bouleuterionin (Agonotetët) tek qendra monumentale, për të saktësuar historikisht në se Apollonia e shek. I p.e.s ishte akoma një qytet grek, apo një koloni Romake. Një tjetër dyshim nëse ai mund të ketë qenë një bouleuterion është i lidhur me kohën në të cilën sipas arkeologëve është ndërtuar, shek 1 p.e.s. Por edhe kështu, po të jetë i shek I p.e.s. përsëri ka një mospërputhje kohore me kohën e ndërtimit të Portikut të madh që duhet të ketë prishur Bouleuterionin e parë. E përsëri mbetet një boshllëk kohor (nga shek. III – I p.e.s.) dhe funksional në të cilin nuk dimë se ku mund të ketë qenë ndërtesa për mbledhjet e Boulé-së.

Ndërkohë objekti tjetër në krah të tempullit, ai në anën veriore të rrugës së madhe mund të ishte një Bouleuterion. Ai mund të ketë patur të njëjtin orientim në lidhje me sheshin e Agorasë dhe po ashtu i drejtuar nga lindja si shpesh pamë preferohej nga Bouleuterionet e rasteve të qyteteve që trajtuam. I paqartë në gjërat e bëra dhe në mbetjet arkeologjike që na prezanton, ai duhet studiuar më tej për të parë në se do të mund të ketë qenë i tillë gjatë periudhës në të cilën qendra e qytetit ishte në Agoranë mes kodrave.

Nga fakti që aty janë gjetur pjesë të kollonave të orderit korintik, është hedhur nga studiuesit hipoteza se mund të ketë qenë një ndërtesë me karakter monumental apo ceremonial, e cila rekomndojmë të mbështet në kërkime arkeologjike me qëllim lokalizimin në kohë. Zona ku ai ndodhet ka një, çisternë të shek. IV.p.e.s. dhe një magazinë të shek. I e.s. Këto objekte dhe koha e ndërtimit të tyre mbështesin hipotezën tonë, në lidhje edhe me evolucionin e ndërtimeve pranë saj.:

- çisterna ndërtohet shek V - IV dhe dokumentohet që vazhdon funksionim deri shek. III p.e.s.
- në shek.III p.e.s. prishet nga ndërtimi i Bouleuterionit në veri të rrugës së madhe, i cili funksionon për aq kohë sa qendra e qytetit ishte në Agoranë mes kodrave⁴⁴
- Nga shek. III p.e.s. – shek. II e.s. Bouleuterioni ndodhet te objekti në veri të rrugës madhe.
- Në shek II e.s. ndërtohet tempulli i Agonotetëve që shërben si Bouleuterion i qytetit deri në kohën e rënies e braktisjes së tij.

Works Cited

- Apollon Baçe, ALEksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karaiskaj, Pirro Thomo. (1976). *Historia e Arkitektures Shqiptare*. Tirane: Ministria arsimit dhe kultures.
- Bier, L. (2008). The Bouleuterion. Në C. Ratté (Re.), *Aphrodisias papers, Journal of Roman Archeology* (Vëll. i 4, fv. 145-168).
- Ceka, N. (2005). *Apollonia*. Tiranë: Migjeni.
- Crane, G. R. (Re.). (a.d.). *Persus Digital Library*. Gjetur në Tufts University, Massachusetts. : <http://www.perseus.tufts.edu/>
- Dawson Maria-Dimitra , Kamara Afroditi,. (2006). Bouleuteria in Asia Minor. *Encyclopaedia of the Hellenic World*. Gjetur qershor 2013, nga <http://www.ehw.gr/l.aspx?id=9926>
- Donald, W. A. (1943). *The political Meeting places of Greeks*. Baltimore.
- Donati, J. C. (2015). The Greek Agora in its Peloponnesian Context(s). Në C. A. edited: Donald C. Haggis, *Classical Archaeology in Context: Theory and Practice in Excavation in the Greek World*, (fv. 177-218). Walter de Gruyter.

⁴⁴ Kjo agora duhet të këtë funksionuar deri fund shek. II .e.s. . periudhë që lokalizohet sipas kohës në të cilën është prishur portiku i madh në anën veriore.

- Follain, E. (2009). La restitution du centre monumental romain d'Apollonia d'Ilyria-exemple du monument des Agonothetes". *Actes de Colloque : Virtual Retrospect 18-20 Nov.2009*, (fv. 115-122).
- Greco, E. (2000). Ekklesiasteiron di Possidonia-Paestum. Në S. Verger, *Rites et espaces en pays celte et méditerranéen : étude comparée à partir du Sanctuaire d'Acy-Romance (Ardennes, France)*. École française de Rome, 2000.
- Höcker, C. (2003). *Assembly buildings*. Boston.
- J.Russell. (1973). *Proc. of the Xth Int. Congres of Classical Archeology*,, (fv. 11-23). Ankara.
- Jean-Luc Lamboley, F. Drini, F. Quantin, S. Shpuza, S. Verger, A. Skenderaj, E. Follain, MH. Barrière, P. Lenhardt, V. Bereti, A. Islami. (123-1 | 2011). Apollonia d'Illyrie (Albanie). *Mélanges de l'École française de Rome - Antiquité [En ligne]*, 242-262. Gjetur në <http://mefra.revues.org/500>
- Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saimir Shpuza,. (2014). Apollonia d'Illyrie (Albanie) Campagne de fouilles 2012. (É. f. Rome, Re.) *Chronique des activités archéologiques de l'École française de Rome*, 33. Gjetur 1 21, 2015, nga <http://cefr.revues.org/1040>
- Martin, R. (1956). *L'urbanisme dans la Grèce antique*. Paris.
- Mogens Herman Hansen, Kurt A. Raaflaub. (1995). *Studies in the Ancient Greek Polis, Volume 1*. Franz Steiner Verlag.
- Mogens Herman Hansen,Tobias Fischer-Hansen. (1994). Monumental political architecture in archaic and classical Greek Poleis: Evidence and historical significance. Në D. Whitehead, *From Political Architecture to Stephanus Byzantius: Sources for the Ancient Greek Polis* (fv. 25-29, 23-90). Stuttgart: Steiner.
- Perseus Digital Library Image Copyright* . (a.d.).
- Sear, F. (2006). *Roman Theatres. An Architectural Study*, (Vëll. i Oxford monographs on classical archaeology). New York: Oxford University Press Inc.
- Senseney, J. R. (2011). *The Art of Building in the Classical World: Vision, Craftsmanship, and Linear Perspective in Greek and Roman Architecture*. Cambridge University Press,.
- Vangjel Dimo, Ph. Lenhard, F. Quantin. (2007). *Apollonia, Atlas archéologique et historique*. Rome: Collection de l'École française de Rome.
- Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky. (1859-1910). *10 books of architecture*. Cambridge: Harward University Pess.
- Winter, F. E. (2006). *Studies in Hellenistic Architecture*. University of Toronto Press.
- Wycherley, R. E. (1962). *How the Greeks Built Cities*. New York: Norton & Company.

TABELA E FIGURAVE

Figure 1. Gjurmë të ndërtesës në formë patkoi në Apolloni, të quajtur nga arkeologët si një Eklesiasterion	80
Figure 2. Eklesiasterioni në Metapontum.....	81
Figure 3. Eklesiasterioni në Paestum, (Poisedonia)	82
Figure 4. Eklesiasterioni në Akragas, (Agrigento, Siçili)	82
Figure 5. Eklesiasterioni Athinës i emërtuar si Pnyx, i paraqitur në të tre fazat e evolucionit vëllimor	83
Figure 6. Agoraja në Kassope e ka Eklesiasterionin të përfshirë në shesh	84
Figure 7. Bouleuterioni ose tempulli i Agonoteteve në Apolloni, plan e fasadë propozuar nga rëlvimet e L. Rey	86
Figure 8. Olympia, plani i Agorasë dhe skemë planimetrike e Bouleuterionit	88
Figure 9. Skema planimetrike të Bouleuterioneve në Delos, Delphi, e Olynthos.....	89
Figure 10, Argos, Agoraja dhe Bouleuterioni,	90
Figure 11, Bouleuterioni i vjetër në Athinë, plan dhe rikonstrukcion hipotetik i fasadës	90
Figure 13. Athinë, Bouleuterioni i ri, Planimetri dhe Planvendosja brenda Agorasë.	91
Figure 14. plan I Agorasë në Athinë. Dallohet se Bouleuterioni është propozuar me një vendosje të shkallares të orientuar nga lindja	92
Figure 15, Sycon, Bouleuterion, plan e mbetjet arkeologjike të ditëve tona.	92
Figure 16. Bouleuterionet në Mantinea, Soluntum dhe Dodona,.....	93
Figure 17. Bouleuterionet në Morgantina, Thasos dhe Miletus,	94
Figure 18. Hartë e qyteteve antike në Siçili në të cilën dallojmë ato që përmenden në studim... 95	
Figure 19. Skemë planimetrike e Bouleuterionit në Akrai.	95
Figure 20. Pamje Ajrore e grupit Teatër e Bouleuterion në Akrai në Siçili.....	95
Figure 21. Bouleuterioni në Assos, Heraklea në Lantum dhe Notium	96
Figure 22. Pamje dhe plan i Bouleuterionit në Priën dhe plan i atij në Alabanda	97
Figure 23. Eklesiasterioni i Messenës në Plan e në pamje ajrore ashtu siç paraqitet sot.	98
Figure 24. Mesenë. Bouleuterioni tregohet me kuadrat të kuq në krah të sheshit të Asklepion-it,	99
Figure 25. Iassos, Bouleuterion, vëmë re hyrjen anësore dhe kalimin poshtë caveas si në Apolloni	100
Figure 26. Bouleuterion në Sagalassos, Korinth dhe Ariassus	101
Figure 27. Bouleuterioni në Cyrene dhe në Nysa	101
Figure 28. Bouleuterioni në Scythopolis, Ptolemais, Serdica	102

Figure 29. Bouleuterion në Seleuca, Cnidus, Ephesus,	103
Figure 30. Bouleuterioni në Stratonicea dhe hyrje anësore që te ngjisin në pjesën e prapme të caveas.....	104
Figure 31. Anemurium, Bouleuterion	104
Figure 32. Bouleuterionet sipas tipit të parë planimetrik: salla katërkëndëshe në formë drejtkëndëshi të zgjatur ose jo në planimetri dhe me ndenjës druri.....	107
Figure 33. Tipi 2, nëngrupi a), Salla me shkallë të vendosura në linja të drejta paralele me tre brinjët e drejtkëndëshit e të orientuara rreth një ambjenti katërkëndësh në qendër	107
Figure 34. Tipi 2 nëngrupi b), Salla me shkallë guri të vendosura në formë Teatri, të mbështetura në kodër apo në mbushje dheu, pa korridore crypta poshtë caveas.....	108
Figure 35. Tipi 2 nëngrupi c), Salla me shkallë guri të vendosura në formë Teatri, të mbështetura në koder e pjesërisht mbi korridore crypta poshtë caveas.....	108
Figure 36. cavea dhe skema e lëvizjes në brendësi të Bouleuterionit të Apollonisë.....	109
Figure 37. Skemat e lëvizjes në Miletus, , lassos dhe Apolloni	109
Figure 38. Bouleuterioni Apollonisë , Miletus, Olympia dhe Athina,	111
Figure 39. skema indikative për të ilustruar idenë se ndërtesa në formë patkoi mund të ketë qenë një bemë e një Eklesiasterioni.	112
Figure 40. Shembuj të Agorave të qyteteve të Argos dhe Mantinea. Vemë re bemën në Argos, e cila ka shërbyer si një orkestër, dhe Bemën eksedër në Mantinea e cila na kujton një situatë të ngjashme me Apolloninë.....	113
Figure 41. Eklesiasterioni Pnyx në Athinë (majtas) dhe Bema në Korinth (djathtas)	113

4. PORTIKU I MADH NË AGORANË HELENISTIKE

Rregullsia e sistemit hipodamik dhe kërkesa për ti projektuar qytetet sipas kësaj rregullsie urbane, do të ndikojë shumë prej veprave arkitektonike që do të ndërtohen në qytetet e botës helene, qofshin ato të karakterit publik, politik, shoqëror, sportiv, apo të karakterit të kultit. Vetë rregullsia gjeometrike e Agorave apo e parcelave të shenjta do të sjellë si pasojë direkte evolucionin e strukturës konturuese të tyre, Stoaesë, e cila do të shtojë efektin vizual të kësaj rregullsie e do të rrisë impaktin monumental të arkitekturës së sheshit¹.

Stoatë, apo ato që u quajtën shëtitore, ishin kollonada ose portikë gjatësorë të mbuluar e të hapur nga tre anë ndërkohë që, në anën e katërt, mbylleshin me mur ose shpesh me një rresht dyqanesh. Ato ishin ndërtimi më i rëndësishëm jo fetar i qytetit.




Figura 1. Shembuj qytetesh të projektuar me sistem Hipodamik dhe Agoratë e tyre të rrethuara nga Stoatë. Lart djathtas, Stoja e Atalës në Athinë që ilustron formën arkitektonike të Stoave.

Funksioni i Stoave ishte i larmishëm - nga ai utilitar (vendstrehim për parcelat e shenjta), në atë tregtar (njësi tregtare në anë të portikut), në proçesional (në raste nderimesh të heronjve) ose rekreativ (si një shëtitore e mbuluar). Ato ngriheshin në anët e Agorave dhe me formën arkitektonike të shtrirë e ritmike i jepnin rregull dhe ekuilibër kompozicional sheshit.

Në Apolloninë e sotme, gjejmë të dëshmuara ‘Stoanë me nikje’ të mbështetur në kodrën e Tempullit, Stoanë përpjendikulare me të (në krah të rrugës që kalon pranë Bouleuterionit

¹ (Wycherley, 1962), f. 84

Tempullit të Agonotetëve), si dhe një Stoa në Agoranë mes dy kodrave dominuese, që arkeologët e emërtuan Portiku i madh.

4.1 Stoja me nikje

Stoja me nikje do të dëshmohej si një gjetje e qytetit të vjetër që në periudhën para Luftës së dytë botërore. Nga gërmimet e misionit arkeologjik francez të vitit 1929 në Apolloni dëshmohej se ka përfunduar zbulimi i plotë i portikut, që shtrihet në shpinë të kodrës. “Monumenti është konceptuar në një stil lokal, ekstremisht interesant e kurioz” shprehet Leon Rey para Akademisë franceze dhe paraqet një Plan të përgjithshëm të gërmimeve së bashku me Portikun, të cilin e daton në shek. I-II e.s.




Figura 2. Harte e Rilevimeve të gërmimeve arkeologjike të bëra nga L. Rey në 1927²

Nga “Historia e arkitekturës Shqiptare”³ gjejmë një tjetër përshkrim për Shëtitoren Stoa të Apollonisë. Ajo datohet si një ndërtim i shek. IV p.e.s. dhe karakterizohet si objekti që përbënte bërthamën e qendrës së qytetit. [...] Ajo kishte në shpinë një kodër 6m të lartë prej së cilës shihej një pamje e hapur mbi Adriatik dhe kodra. Para murit me nikje ndodheshin dy rradhë kollonash tetëkëndore që mbajnë tavanin e drunjtë dhe çatinë dyujëse me tjegulla. Sistemi i harqeve në shpinë ndihmonte në mbajtjen e rrëshqitjeve të kodrës me 17 nikje gjysmëcilindrike, të alternuara me pilastra të rrafshta 1,45 metroshe, që kishin gjerësi 3m dhe lartësi 2,75m. Të ndërtuara me gurë prizmatikë të vendosur në të thatë e të mbuluara me gjysmëkupola, ndihmonin në mbajtjen e skarpatit të kodrës[...] Kjo formë kompozicionale me absida, ishte e huaj për arkitekturën Greke, por shumë e përdorur në Romë dhe duket sikur është e vetmja arsye që duhet të justifikojë lokalizimin

² (Vangjel Dimo, Ph. Lenhard, F. Quantin, 2007, f. 191)

³ (Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karauskaj, Pirro Thomo, 1976), f. 121

kronologjik (shek. I-II e.s) që bën Leon Rey⁴. Nëse do të ishte një ndërtim i shek. I-II e.s. kjo Stoa do ta justifikonte influencën Romake, duke patur parasysh se në atë kohë, vetë Apollonia ishte nën Perandorinë Romake, por do ta shmangte këtë influencë nga fakti që kupolat, apo mbulesat absidale, në Romë i gjejmë të ndërtuara me *beton*.

Në hulumtimet mbi Stoa të në qytet Greke, hasim rastin e Stoa së në Mistras, Peloponez, të ashtuquajturën Stoa Romake e cila shfaq në murin fundor vërtetë një cilindrike absidale si në Apolloni, porse të ndërtuara me “opus testaceum”⁵, janë krejt të ndryshme nga ato të Apollonsë dhe tregojnë qartazi origjinën e tyre romake.



Figura 3. Një nga nikjet cilindrike në Stoa në Apollonisë, ndërsa djathtas nikje të Stoa së në Mistras, Peloponez

Në vazhdim të përshkrimit të formës që shëtitëria duhet të ketë patur, autorët, venë theksin në formën dykatëshe të saj, në të cilën kati i parë përbëhej nga dy rradhë kollonash tetëkëndëshe, ndërkohë që i dyti duhet të ketë patur gjysmë kollona jonike. [...] Kollonat e rreshtit të parë, prej gëlqerori të një cilësie të lartë, kanë trup tetëkëndor të njëjtë me atë të disa kollonave të gjetura në Bylis dhe Foinike, formë kjo e pazakontë për arkitekturën bashkëkohëse dhe kurorëzohen prej kapitelesh gjeometrikë me ehin katërkëndësh. Kollonat kanë diametër 0,44 metra dhe largësia mes tyre, aks-më-aks, është 2,2m. Ndryshe prej tyre, kollonat e katit të dytë, janë trajtuar në formë pilastri gjysëm rrethor me kanelyra e me kapitele jonikë[...]”⁶

Nga Baçe & Ceka⁷ gjejmë një analizë të hollësishme të kësaj Stojë dhe në përfundim një propozim për një rikonstrukcion hipotetik. Ai e përfytyron këtë objekt si dy katësh, me gjysëm kollona jonike në katin e dytë dhe me dyqane në faqen e prapme, ndërkohë që, në katin e parë, nikjet paraprihen nga dy rradhë kollonash tetëkëndore të mbështetura në baza kuadratike si të ishte një Cimasa Romake.⁸

⁴ (Edmond, 1930)

⁵ Tip i betonit romak, që vishej nga jashtë me tulla qeramike.

⁶ (Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karaickaj, Pirro Thomo, 1976), f. 122

⁷ (Apollon Baçe, Neritan Ceka, 1981) f. 5-54

⁸ Cimasa është një pllakë kuadratike e vendosur poshtë bazës së kollonës, në orderin e përdorur në arkitekturën Romake.



Figura 4. Stojaja me nikje, pamje e gjendjes së sotme. Muri i prapëm ruan sot nikjet cilindrike por jo mbulesat gjysmëkupolare të tyre. Kollonat tetëkndore përej guri që duken në krahun e djathtë janë ato të rradhës së mesit të Stoaës me dy rradhë kollonash.





Figura 5. Rikonstrukcioni hipotetik i Stoaës i propozuar nga Baçe & Ceka

4.2 Portiku i madh në Agoranë mes dy kodrave.

Stojaja tjetër është në Agoranë mes dy kodrave, e zbuluar vetëm pjesërisht në themelet e kollonave dhe të murit të pasëm. Informacioni i parë për këtë objekt do të merret nga hulumtimi gjeofizik - elektrik që arkeologët francezë bënë në 2005-n në zonën mes dy kodrave - kodrës 104 dhe asaj të Akropolit. Nga grafikët kompjuterike dalloheshin ndryshime të cilat hidhnin dyshimin për ekzistencën e objekteve arkeologjike nën shtresat e tokës. Në të vërtetë, që në kohën e Praschniker në 1918-n, ishin bërë sondazhe në këtë zonë, prej të cilave rezultuan fragmente nga muri i prapëm i Portikut si dhe baza e një

kollone në formën e gurëve të themelit të saj⁹. Këto gërmime ai i kishte reflektuar grafikisht në një plan-rilevim të gërmimeve të asaj kohe.



Figurë 6. Plan rilevimi i gërmimeve të Praschniker dhe mbivendosja në të e plan-rilevimit të zonës së Portikut sot¹⁰. Dallohet që, pjesët e gjetura nga arkeologu austriak, i korrespondojnë vërtetë pjesëve të portikut veçse ai nuk arriti asnjëherë të kuptonte që objekti që kishte zbuluar ishte një Stoa e një tjetër Agoraje të qytetit.

Në vitet pas 2005-s, në gërmimet arkeologjike do të saktësohen të dhënat për këtë Portik duke arritur vit pas viti të krijohet nga arkeologët, ideja se si ka qenë ky objekt.

Në fakt, ne e kemi trajtuar këtë sektor të Agorasë mes kodrave, në kapitullin e Bouleuterionit dhe Eklesiasterionit, në të cilin kemi trajtuar ndërtesën në formë patkoi, të quajtur një ish-Eklesiasterion.

Në këtë zonë janë gjetur një seri mbetjesh arkeologjike të shekujve V-II p.e.s. që i takojnë objekteve që i janë mbivendosur njëri - tjetrit, në faza të ndryshme të zhvillimit të kësaj Agoraje. Një sistem rrugor i periudhës së shek. VI-V p.e.s. është evidentuar si sistemi i parë i rregullt i qytetit të sipërm. Duhet të ketë qenë shekulli i parë i jetës në qytetin e Apollonisë koha kur është trasuar ky sistem dhe shtëpitë e banorëve u ngritën në insulat drejtkëndore - prej të cilave gjejmë pak mbetje arkeologjike. Në fund të shek. V ose IV p.e.s. u ndërtua objekti në formë patkoi i cili më vonë u prish nga ndërtimi mbi të i Portikut të madh¹¹. Arkeologët e kanë evidentuar këtë Portik si një objekt i shek. III p.e.s.¹² në formë “U”-je me një rradhë prej 23 kolonash në ballë. Nga mbetjet, sot, gjejmë bazat e kollonave të cilat kanë sipërfaqe katrore 1,90 x 1,90 ose 2 x 2 m, të ndërtuara me blloqe të rregullt drejtkëndorë, si dhe murin e prapëm të Stoa së të zbuluar gati në të gjithë gjatësinë e tij. Bazat e kollonave ndodhen 5,80 m aks-më-aks dhe, sipas arkeologëve, duhet të kenë qenë themelet e rradhës së vetme të kollonave në Portik i cili në total

⁹ Kollona që Praschniker kishte gjetur ishte interpretuar prej tij gabimisht si një altar. Në të vërtetë ajo është baza e kollonës 19 të Portikut të madh. ref. (S. Verger, 2014) f. 211-221.

¹⁰ ibidem

¹¹ (Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj, 1-2, 2003-2004) f. 180

¹² (Jean-Luc Lamboley, F. Drini, F. Quantin, S. Shpuza, S. Verger, A. Skenderaj, E. Follain, MH. Barrière, P. Lenhardt, V. Bereti, A. Islami, 123-1 | 2011) f. 242-262

shtrihej në 128 m gjatësi¹³. Për të studiuar këtë objekt bazohemi në hulumtimin e mbetjeve në vend si dhe të planimetrisë që arkeologët kanë propozuar si formë të cilën duhet të ketë patur objekti në kohën e ndërtimit. Ajo që na tërheq vëmendjen që në fillim si një faktor anomalik dhe i pamundur teknikisht për kohën, është distanca e madhe mes kollonave aks-më-aks, si një hapësirë drite që nuk mund të mbulohet me një arkitra të gurtë. Nga studimi dhe njohja e arkitekturës Greke, dimë se sistemi trilitik, ose tra-kollonë, është një sistem struktural që bën të mundur mbajtjen e mbulesave të objekteve. Ai është i thjeshtë dhe mjaft efektiv. Ai u ndërtua prej guri sipas një rregulli të caktuar që, në terminologjinë e kohës, tilin e njohim si “order arkitektonik”. Ai përbëhet nga kollona prej guri që mbajnë peshën e trarëve prej guri monolit mbi të cilët mbështeten strukturat e drunjta të çatisë. Një sistem i tillë konstruktiv përballon me sukses peshën e mbulesës relativisht të lehtë duke patur të vetmin kufizim përmasor atë të largësisë mes kollonave, që kushtëzohet nga gjatësia e arkitraut monolit të gurtë që mbështetet mbi to. Kështu, distanca 5,80 m e përcaktuar si distancë aks-më-aks, do të jetë e pamundur të mbulohet me një arkitra të gurtë monolit: një gjatësi e tillë do të ishte e perealizueshme ekonomikisht dhe shumë e vështirë teknikisht, pasi arkitrau do të duhej të ishte të paktën shumë herë më voluminoz sesa arkitrau që do mbulonte gjysmën e distancës ose 2.90m. Kujtojmë se në gjithë eksperiencën ndërtimore në Greqi, ndërtuesit kanë mundur të realizojnë gjatësi të traute të gurtë monolit vetëm deri në 4-4,2 m.



Figura 7. Plane të rievimeve të gërmimeve arkeologjike në zonë dhe pamje e gërmimeve dhe mbetjeve arkeologjike në pjesën fundore të Portikut nga ana lindore. Planimetria me të kuqe është forma që ka objekti sipas arkeologëve francezë.

Ndërkohë mund të mendojmë alternativën e drurit si material për arkitraun (mënyrë që përdoret në interieret e objekteve), por që do të ishte i papërshtatshëm për një eksterier objekti, si nga ana estetike por edhe nga pamundësia për të rezistuar ndaj agentëve atmosferikë. Ky fakt pra, distanca e madhe e kollonave aks-më-aks, u bë shkak kryesor për të hedhur dyshime mbi planimetrinë hipotetike të propozuar nga arkeologët francezë,

¹³ (Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saimir Shpuza,, 2014) f. 33

dhe për të hulumtuar më tej nëpërmjet studimit tipologjik të Stoaës, drejt gjetjes së formës që ky objekt duhet të ketë patur.

4.3 Studimi tipologjik

4.3.1 Analiza teorike e tipologjisë.

Stoa ishte një shpikje tërësisht greke, relativisht e thjeshtë por shumë influencuese në arkitekturën e mëvonshme. Ajo merrte parimin e traut dhe kollonës e, duke i lidhur me njëri-tjetrin në mënyrë të vazhdueshme, krijonte një kollonadë të gjatë me funksione të ndryshme. Kjo ishte mënyra për të lidhur bashkë dyqane e magazina që përndryshe do të ishin të shpërndara andej këndeje, si kioska të veçanta në parregullsi kompozicionale, por që, nëpërmjet Stoaës, do të fitonin rregullsi e dinjitet ¹⁴. Ato ofronin hapësira ku mund të qëndrohej ulur e në shoqëri, ose ku mund të shëtitej duke biseduar e filozofuar mbi çështjet politiko-sociale.

Nuttgens e quan Stoaën si fragmenti më unifikuues i të gjithë Agorasë. Stoa-ja e Atalës (150 p.e.s) ndërtuar në Athinë i ilustron më së miri këto veti. Në parcelën që nuk kishte rregull gjeometrik kompozicional ajo kishte vendosur, nëpërmjet ritmit të kollonadës me një shtrirje gjatësore 100 metroshe, ekuilibër e qetësi kompozicionale duke unifikuuar vëllimet e objekteve të veçantë në një kompleks arkitektonik monumental¹⁵. Autorë ndryshëm na mësojnë se Stoa-ja ishte një tip arkitektonik publik dhe institucion politik. Ajo vendosej shpesh në Agora ose përgjatë anëve të saj dhe ndonjëherë strehonte në ambjentet e saj një ose më shumë trupa gjykuese të qytetit. Praktikisht, çdo Polis me madhësi të arsyeshme, duhet të ketë pasur të paktën një Stoa ndërsa ata më të mëdhenjtë, disa syresh. Kështu, rasti konkret i Apollonisë na prezanton 3 Stoa, ndërkohë që, edhe qytete të tjerë si Bylis, Antigoneja, Butrinti, Dimali, bëhen dëshmitarë të kësaj tipologjie me më shumë se një të tillë në secilin prej tyre. Duket sikur fakti se zbulojmë apo jo një Stoa, bëhet një faktor bindës për studiuesit, për të përcaktuar se në një vend kishte apo jo qytet të strukturuar si formacion urban.

Vërtetë Wycherley¹⁶ na mëson se strukturat e para publike që ndërttoheshin në qytet ishin Stoaët, të cilat, ndoshta edhe fillimisht prej druri e më vonë prej guri, do të ndërttoheshin në qendra qytetesh, që s'kishin marrë akoma forma sheshesh të mirëformuar por që ishin thjesht një vend ku bëhej tregëti, ku qëndrohej për të kryer operacione shkëmbimi e për të diskutuar e zgjidhur edhe çështje sociale, konfliktuale apo jo, e më vonë edhe çështje politike. Në qytetet arkaikë, na mëson ai, strukturat e para në një shesh të tillë ishin një

¹⁴ (Nuttgens, 2001), f.99

¹⁵ (Mogens Herman Hansen, Tobias Fischer-Hansen, 1994) Monumental political architecture in archaic and classical Greek Poleis: Evidence and historical significance, në From Political Architecture to Stephanus Byzantius: Sources for the Ancient Greek Polis, (ed. Whitehead, David), Steiner, Stuttgart.

¹⁶ (Wycherley, 1962)

Heeron, një Altar hyjnie e domosdoshmërisht një Stoa. Duket sikur Stoa të kanë qenë të frymëzuara fillimisht nga kollonadat që Egjiptianët përdornin në oborre peristilë e tempuj apo nga Persët në rezidenca¹⁷, por është e qartë tashmë që vetëm si ide mund të ketë nisur e huazuar, por zhvillimi i mëvonshëm, si një objekt që qëndron më vete, i palidhur nga struktura të tjera, është një risi vetëm greke. Ata e përdorën atë për shumë qëllime: si Portik hyrës, si Fasadë, si dy anë të një oborri, si Peristil i jashtëm, apo Peristil i brendshëm dhe që nga shek. V p.e.s. i gjejmë në çdo qytet grek.



Figura 8. Agoraja e Athinës në fazën e fundit të zhvillimit të saj na jep shembullin e përdorimit të ndryshëm të Stoa-së, si një parahyrje, fasadë e objekteve të rëndësishme si Bouleuterion apo Odeon. Në foton djathtas paraqitet një Stoa e drunjtë e cila, edhe pse në fazat më të hershme të evolucionit të saj, na ilustron preferencën e Grekëve për ta përdorur Stoa-në si një objekt më vete.

Stoa të patën rëndësi të dorës së parë si ndërtim në qytet dhe shoqëruan çdo Agora të vogël apo të madhe, si dhe çdo parcelë të shenjtë në të. Ky fakt u favorizua edhe nga klima e butë e Greqisë e cila ndikoi dhe influencoi format e hapura e gati transparente që haim në arkitekturën e Stoa-së. Wycherley na thotë se, që prej Shek V p.e.s., Stoa gjendeshin pranë çdo Agoraje¹⁸. Përdorimi i Stoave është i ndryshëm, ashtu si ai i Agorave, por ato nuk kufizoheshin në Agora – ato i gjen përgjatë rrugëve, (veçanërisht në anë të rrugëve të shenjta apo në ato që të çonin në Agora) si Dromos në Athinë, në të gjithë Tempujt që shpesh vendoseshin në mes të një parcele me Stoa rretheqark apo edhe në Gjimnaze. Në Aegium u ndërtua një Stoa vetëm për Straton (një atlet i shquar) që të stërvitej. Pistat e mbuluara shpesh merrnin formën e Stoave. Teatrot kishin Stoa pranë për raste kur fillonte shiu. Në Agora, Stoa të kishin lloj-lloj funksionesh politike, tregtare, e të përgjithshme. Dhomat nëpër Stoa ishin dyqane, zyra, ose depo. Në Korint, Stoa-ja ishte treg peshku (janë gjetur vaska uji të izoluar me çimento)¹⁹

4.3.2. Evidentimi i rasteve më të njohur.

Nga sa më lart, kuptojmë që rastet e përdorimit të Stoave janë të shumta, pasi çdo qytet pati minimalisht dy apo tre të tilla. Kështu që, evidentimi i të gjithë rasteve, bëhet i pa-arsyeshëm dhe i tepërt. Në këtë rast, me të njëjtën mënyrë krahasimore të trajtimit nga tipi

¹⁷ ibidem

¹⁸ (Wycherley, 1962)

¹⁹ ibidem

në tip, që tashmë përdorëm edhe në kapitujt e tjerë, mundëm të rezultojmë në fazat evolutive të formës morfologjike të kësaj tipologjie, të shprehura në tipe planimetrikë. Duhet të theksojmë këtu se, për mënyrën me të cilën ndërtonte Greqia, i rëndësishëm është kompozimi planimetrik. Ai është i studiuar deri në detaj e perfeksion dhe mjafton ngritja altimetrike, për të patur një pamje të objektit me vëllimet që impononte orderi arkitektonik. Ata do të respektojnë këtë order ashtu si ai u vendos që në ndërtimet e para të drunjta e do të përpunojnë vetëm raportet proporcionale të elementëve të tij, edhe këto të kushtëzuara nga rregullat e orderave të veçantë. Pra, nëse shohim një planimetri greke, jemi gjithmonë të qartë si duhet të jetë fasada e objektit. Brenda kësaj “thjeshtësie” kompozicionale do të qëndrojë fryma racionale dhe e thjeshtë e arkitekturës greke që u bë baza e antikitetit në arkitekturë, e më vonë baza për çdo arkitekturë funksionaliste, racionaliste, moderne, apo postmoderne.

1. **Tipi i parë më i thjeshtë planimetrik** është ai i Stoaës gjatësore me një radhë kollonash e me një mur apo një varg kollonash në njërën anë.

Këtë tip e hasim shpesh si një Stoa në sheshet e vegjël të parcelave të shenjta apo të Palestrave e të Gjymnazeve si në rastin e Olimpias. Wycherley na mëson se Stoa të hershme duhet të kenë qenë prej druri, ashtu si edhe tempujt para shek.VII p.e.s. ishin ndërtuar tërësisht në dru. Pesha, relativisht e lehtë, e strukturave të mbulesës shkarkohej mbi arkitrarë druri (që mund të mbulojnë distanca më të mëdha se sa një arkitra i gurtë) dhe më pas mbi kollona të larta e elegante.




Figura 9. Stoa Jugore në Athinë, plan dhe fasadë ilustron rastin e Stoaës me një rradhë kollonash.

Kemi, pra, më shumë mundësi të mendojmë që këto faza të para të zhvillimit të kësaj tipologjie kanë influencuar atë të mëvonëshme edhe kur ndërtimi bëhej tërësisht në gur. Mund të shpjegojmë kështu edhe pse proporcionet e stoave ishin shumë më elegante, të lehta e me hapësira mes kollonave më të mëdha se në çdo tipologji tjetër. Vitruvi na shpjegon se për të proporcionuar orderin e këtyre ndërtimeve nuk merren për bazë proporcionet që përdoren në Tempull pasi, për vetë natyrën që kishin ato ndërtime, duhet të prezantoheshin hijerëndë, monumentalë e me theksim të aspektit ceremonial.²⁰

²⁰ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910)




Figura 10. Palestra e Olympias dhe Qendra e Prienës, në të cilat shohim shembullin e Stoaës me një rradhë kollonash në anët e sheshit,




Figura 11. Agoratë e Miletit, dhe Stoja jonike me një radhë kolonash. Kjo Stoa që paraqitet në foto në gjendjen e sotme, është shënuar me të verdhë në planin e qytetit.

Ndërkohë, Stoa të si ndërtime të karakterit shoqëror, të vendosur në sheshe e hapësira ku shpesh organizoheshin edhe festa, do të preferoheshin të ndërtoheshin me të gjithë elegancën që një order mund të ketë,²¹ qoftë në lartësi e proporcione kollone e, qoftë

²¹ Ordererat do të karakterizohen nga lartësi kollonash që përcaktohen si një raport mes gjerësisë së bazës e lartësisë. Në fazat arkaike ky raport do të jetë 1:4, më vonë do të rritet e do të arrijë në fazën klasike në 1:5,5 e në fazën helenistike në 1:6 e 1:7. Për pasojë kollonat e orderit vijnë duke u rritur në lartësi, sa më shumë i afrohem periudhës klasike të mes shekullit V p.e.s. e asaj helenistike të shek IV – III p.e.s. Në figurën pasardhëse janë reflektuar në një skicë proporcionet e orderit dorik, në faza e parë të zhvillimit në gur (rasti tempullit të Poseidonit në Paestum) dhe në fazën klasike të tij. (në tempullin Partenon në Akropolin e Athinës)

edhe, në distancat mes tyre. Hapësira mes kollonave, na mëson ai, do të jetë shpesh sa 2,5 deri 3 herë gjerësia e kollonave.

Vetëm kështu ato do të bëhen ambjente të shfrytëzueshëm lehtësisht në të gjithë sipërfaqen. Në këtë shfrytëzim të mirë të hapësirave, të penguar sa më pak nga prezenca e kollonave, do të gjejmë edhe shpjegimin e faktit që, shpesh, në Stoa të tipeve të tjerë, në brendësi, do të përdoren kollona jonike, me lartësi më të mëdha e me distanca mes kollonave sa dyfishi i atyre të jashtme. Rasti i Stoa së Miletit na jep sot një shembull të bukur, ende pjesërisht në këmbë, të këtij tipi në të cilën rrada e kollonave shfaqet me elegancën e orderit Jonik për të paraprirë si një strehë-shëtitore dyqanet në pjesën e prapme.

2. Tipi i dytë planimetrik është ai i Stoaëve me dy rradhë kollonash. Këto janë tipi më i përhapur e gjenden thuajse në çdo qytet të rëndësishëm. Qytete si Priena, Miletus, Athina, planet e të cilave i gjejmë në figurat më lart, do të jenë qytetet më të studiuar nga ana urbane e sot na dokumentojnë rastet më të përdorur të këtyre Stoaëve. Ato kanë dy rreshta kollonash (shumica e tyre) me kollonat e jashtme në stilin Dorik ndërsa të brendshmet jonike (dy herë më të rralla se të jashtmet sepse mbi to mbajnë një arkitra të drunjtë). Në shumë raste këto Stoa mund të kenë një mur fundor të verbër duke u kthyer në shëtitore të mirëfillta që rrethonin Agoranë. Shpesh ato mund të kenë një rradhë dyqanesh apo ambjentesh tregtare në një anë duke luajtur rolin e ambjenteve me funksion tregtar. Ndërkohë që nuk përjashtohen edhe rastet kur, si në Korinthis, do të ndërtohen si një kollonadë që përmbledh në një fasadë të vetme disa prej objekteve funksionale të rëndësishëm që shohin në Agora. Për të ilustruar këtë mund ti referohemi figurës së Agorasë së Korinthis në kapitullin e Agorave.



Figura 12. Stoja e Atalës në Athinë na ilustron fasadën me order të mbivendosur por me lartësi të ndryshme. Vëmë re në interior mënyrën e mbulimit të Stoaës me tavan të pjerrët në kat të dytë ndërsa me tavan të drejtë në kat të parë.

Nëse i shohim në prerje kuptojmë se kur Stoa të janë një katëshe ato do të kenë kollonat jonike në brendësi, që të mund të shfrytëzojnë lartësinë e këtij orderi më të gjatë për të arritur të mbajnë traun e kulmit të çatisë dyujëse.²² Kjo do të thotë që, në interior, këto

²² (Wycherley, 1962)

Stoa një katëshe do të kenë tavane të pjerrët të drunjtë. Ndërkohë, për Stoa të dy katëshe, tavani i katit të parë do të jetë i sheshtë dhe me pjerrësi do të bëhet tavani i katit të dytë.

Këto Stoa mund të jenë një katëshe ose dykatëshe, duke rritur kështu kapacitetin e ambjenteve tregtare. Nga Vitruvi²³ mësojmë se në të dy katet, eksterieri do të bëhet me order të ndryshëm arkitektonik. Në katin e parë do të përdoret orderi dorik, më i rëndë, lakonik e i zhveshur nga dekoracionet, ndërkohë që në katin e dytë do të përdoret orderi jonik, më elegant, më i dekoruar e plastikisht më i lehtë. Por [...] *si në degët e një peme në natyrë, që vijnë duke u zvogëluar e holluar drejt lartësisë, edhe kollonat e orderit do të vijnë duke u shkurtuar në katin e dytë [...]*²⁴ pavarësisht se kollonat jonike janë më të larta se ato dorike, kur vendosen në katin e dytë të Stoa së, do të jenë me të shkurtra se doriket poshtë tyre.




Figura 13. Raste të prerjeve tërthore të Stoa me dy rradhë kollonash, kur lartësia e tyre është një katëshe, dhe kur lartësia e tyre është dy katëshe e me dyqane në njërën anë. Vejmë re mënyrën e ndërtimit të tavanit e të çatisë me pjerrësi apo pa pjerrësi.




Figura 14. Stoa me dy rradhë kollonash, në rastin kur nuk ka dyqane në njërën anë. Stoa në Asklepionin në Pergamo




Figura 15. Stoa me dy rradhë kollonash, në rastin kur ka dyqane në njërën anë. Stoa jugore në Korinth.

Nga Vitruvi mësojmë se edhe distancat mes kollonave do të jenë të ndryshme. Në rradhën e jashtme kollonat do të vendosen dyfish më të dendura se në rradhën e brendshme pra - në çdo dy kollona jonike do të kemi një kollonë dorike shtesë. Kuptojmë, siç trajtuam

²³ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910)

²⁴ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910) f.132

edhe më lart, që ky proces i alternimit do të jetë edhe në dobi të mirë-funksionimit të kësaj hapësire që duhet të ketë sa më pak kollona për të rritur efikasitetin e përdorimit publik të pa shqetësuar prej tyre. Kuptojmë që kollonat e rradhës jonike mund të vendosen kaq të rralla e kaq larg njëra tjetrës vetëm nëse mbi to vendoset një tra druri e jo një tra monolit guri²⁵. Pra, siç na e ilustron edhe rasti i Stoa së Atalës, i rikonstruktuar në vitet 1960, arkitra të gurtë do të ketë vetëm mbi kollonat dorike të fasadës dhe vetëm në fasadë do të kemi imazhin e një objekti në gur apo mermer, ndërkohë që në brendësi do të kemi trarë të drunjtë që shkarkojnë mbi kollona guri. Ky hulumtim na ndihmon të kuptojmë edhe formën që mund të ketë patur stoaja Portik i madh i Apollonisë. Hapi i madh i kollonave të gjetura do të jetë vetëm një rradhë e brendshme e portikut, (ajo jonike) që në distanca 5,8 m aks-më-aks do të mund të mbanin vetëm një arkitra të drunjtë. Përderisa në fasadë orderi nuk mund të jetë me arkitra të drunjtë, pra jo një fasadë me gur mermeri, si Grekët do të donin, deduktojmë se kjo rradhë kollonash e zbuluar nuk ka si të jetë rradhë e jashtme, pra rradhë në fasadë. Pra, ky Portik, nuk mund të jetë i tipit me një rradhë kollonash, por duhet të jetë i tipit me dy rradhë kollonash.

3. **Tipi i tretë planimetrik**, por që haset më rrallë, është i Portikut me tre rradhë kollonash, duke krijuar kështu tre korridore gjatësorë-nefe. (Elis, Philip në Megalopolis, Smyrna). Këto Stoa do të bëhen ambjentet më të gjerë ndër tipet e Stoave e do të ofrojnë një sipërfaqe më të madhe për të qëndruar²⁶. Këto raste që njohim, pa dyqane në njërin anë janë vetëm shëtitore e jo ambjente tregtare.



Figura 16. Smyrna dhe Megalopolis përdorin Stoa me tre rradhë kollonash. Vëmë re se Agoraja në Smyrna (majtas), ka arritur konturimin e sheshit duke bashkuar mekanikisht në kënd dy Stoa.




Figura 17. Stoa në Smyrna dhe Stoa në Megalopolis na ilustrojnë tipin me tre rradhë kollonash.

²⁵ (Coulton, 1976)

²⁶ (Donati, 2015) f. 177-212

Edhe në këtë tip, në rastin e Smyrnas, vëmë re të njëjtin ligj të vendosjes së kollonave në fasadë: çdo dy kollona te brendshme shtohet një kollonë në fasadë. Ndërkohë që, në Stoa në Megalopolis, vëmë re një rregull tjetër: çdo dy kollona të rradhës së brendshme shtohen dy kollona në fasadë. Perceptojmë prej këtij fakti se, problem në rritjen e sipërfaqeve të Stoave, duhet të ketë qenë mënyra se si do të përballohej pesha e mbulesës dyujëse. Duhet të ketë qenë kjo arsyeja që evolucioni i kësaj tipologjie ndaloi këtu, në rastin më të madh në sipërfaqe, në Stoa në me tre rradhë kollonash. Ndërkohë që njohim nga arkitektura romake një mënyrë tjetër të organizimit të ambjenteve tregtare, në Bazilikat romake, që shtuan rradhë kollonash për të rritur sipërfaqen, por menduan edhe si të baraz-shpërndanin peshën e çatisë duke kombinuar kompozimin gjatësor të Stoave me sistemin e diferencimit bazilikal në lartësi.

4. Tipi i katërt planimetrik është stoaja në formë “L” ose në formë “U”

Evolucioni më i madh i tyre i shërbeu dhe u përshtat me Agoratë në forma katërkëndëshe të qyteteve me sistem të rregullt hipodamik (Magnesia, Miletus, Mantinea, Priena). Nga rasti i qytetit Smyrna, në të cilën bashkimi në kënd është bërë mekanikisht, kuptojmë se Stoaja në formë “L” apo edhe në formë “U” do të lindë si domosdoshmëri për t’ju përshtatur rolit që Stoaja tashmë ka marrë, atë të konturimit arkitektonik të sheshit-Agora.




Figure 18. Stoa veriore në Argos ka formë L me dy rradhë kollonash e me një kënd të mbyllur në tre anë me mur.

Për parregullsinë planimetrike e për mungesën e simetrisë ideale që grekët e deshën absolutisht, Wycherley do ta përcaktojë si arkaike këtë Agora, por ne e shohim si një mënyrë për të reflektuar dëshirën për zmadhim të Agorasë përtej shtrirjes gjatësore të saj.




Figura 19. Royal Stoa në Athinë dhe Stoa në Delos ja dy prej tipeve më të njohur të Stoasë me formë “U”. Vëmë re ndryshimin e distancës (më të madhe) të kollonave në kënd e në krahët që kthehen.

Krahët anësorë që zgjaten përpjendikular fund të Stoasë krijojnë edhe mundësinë për të vendosur në fasadë frontone dekorativë mbi kollona, duke kënaqur kështu edhe dëshirën estetike të Grekëve për të patur të tërë elementët e orderit, nga bazamenti-*Stereobat* deri në mbulesen trekëndore-*Fronton*




Figura 20. Qyteti i Mantinea na dëshmon rastin e Stoaë me tre rradhë kollonash por që vazhdon në kënde duke u kthyer në formë “L” për të konturuar rregullisht Agoranë. Të tillë e gjejmë edhe në qytete të tjerë të projektuar me sistem Hipodamik.




Figura 21. Stoa Zeus Eleutherios në Agoranë e Athinës përfundon në fasadë me dy portikë-pronaos si në tempujt grekë.



Figura 22. Megalopolis Stoa na ilustron mënyrën e përfundimit në kënde të Stoaë në formë “U”.

5. Tipi i i pestë planimetrik do të përfshijë Stoaë me dy anë apo me dy kollonada, atë që në fillim e quajtmë si zhvillim të kollonadës si një pertistil i jashtëm. Me fjalë të tjera mund të themi se ky tip është evolucion i tipit të parë, me një rradhë kollonash që, për domosdoshmërinë e shfrytëzimit në të dy anët, do të vendosë dy Stoa shpinë më shpinë. Rastin më të studiuar të këtyre Stoaëve e gjejmë në Assos apo në Tharos.




Figura 23. Agoraja në Assos mban në një krah një Stoa me mure anësore deri edhe fasadë dhe në krahun tjetër një Stoa me dy anë.




Figura 24. Stoa Diptera në Tharos, me një radhë kollonash në qendër e me dy fasada gjatësore.




Figura 25. Stojaja përfundon me mure anësore në dukje në fasadë. Rikonstrukcion i Stoasë së Poikle në Athinë na ilustron këtë rast.

Duke trajtuar këtë tipologji duhet të përcaktojmë edhe mënyrat me të cilat u bë mbyllja me mur e Stoave. Të gjitha Stoatë do të mbyllën me mure anësorë përpandikular me aksin e kollonadës, të cilët mund të shkojnë deri në fund në aks të kollonadës së jashtme duke shfaqur pjesën fundore në fasadë; mund të jenë më të shkurtër e pamja e tyre të mbulohet nga një kollonë në fasadë ose mund të vazhdojnë në kënde përgjatë 4-6 kollonave duke krijuar një pjesë të mbyllur në fund të shëtitores.




Figura 26. Muret anësorë mbulohen nga një kollonë dhe fasada shfaqet si një rradhë kollonash uniforme nga skaji në skaj.



Figura 27. Muret fundorë vazhdojnë edhe në këndet e fasadës duke kufizuar vizalisht kollonadën e fasadës. Stoja në Thermon na ilustron këtë rast.

Pra, në fasadën kryesore në kënde, Stoja mund të mbyllet me pilastër ose me kollonën që mbulon murin anësor duke shfaqur tërësisht kollonadën nga fillimi në fund.

Kjo mbyllje me mur shfaqet shpesh e në të tre mënyrat duhet të jetë përdorur për të shmangur korrentet gjatësorë të ajrit, të cilat, me sa mësojmë nga Vitruvi, grekët i merrnin gjithmone parasysh si një fenomen klimaterik e natyral që në disa raste mund të jetë i dëmshëm. Kujtojmë këtu që edhe drejtimi apo gjerësia e rrugëve në sistemin hipodamik ishin kushtëzuar nga korrentet e erërat e ngrohta apo të ftohta, me lagështirë apo të thata. Mbyllja me mur fundor do të krijonte kështu tek stoate ambjentin e përshtatshëm për të qëndruar. Kujtojmë që këtë mbyllje me mur në formë “L” e kemi të dëshmuar nga mbetjet arkeologjike edhe në rastin e Portikut të madh të Apollonisë.

4.3.3 Formulimi proporcional i Stoave

Për të arritur në rezultate të sakta edhe nga ana dimensionale u desh të shqyrtojmë burimet e shkruara që trajtojnë formulimin proporcional të tyre.

Ndër burimet më të hershme që e trajton arkitekturën greke nga ana arkitektonike e inxhinjerie janë 10 librat e Vitruvit mbi arkitekturën. Si pjesë e ndërtimeve shoqërore të qytetit grek, ai do të trajtojë e analizojë gjerësisht Stoa të.

[...] Mënyra e miratuar për ndërtimin e tyre kërkon që ato duhet të jenë dyshe dhe të kenë kollona Dorike në rradhën e jashtme me arkitrarë dhe ornamentet e të përfunduar sipas ligjit të proporcioneve modulare. Thellësia e miratuar për to kërkon që thellësia prej pjesës së poshtme të kollonave të jashtme deri tek kollonat në mes, dhe nga kollona e mesit deri tek muri përmyllës i kollonadës, duhet të jetë e barabartë me lartësinë e

*kollonave të jashtme. Kollonat e rreshtit të brendshëm le të bëhen një të pestën më të larta se ato të jashtmet dhe të jenë të stilit Jonik ose Korintik [...]*²⁷

Kështu, për objektin tonë, duke qenë se kemi të zbuluara bazat e kollonave dhe distancën e tyre nga muri fundor, deduktojmë se lartësia e kollonës duhet të ketë qenë 5,80 m dhe, duke ditur raportet që ai propozon, mund të nxjerrim dimensionet në altimetri të Portikut.

Vitruvi vazhdon: [...] *Kollonat nuk do t'i nënshtrohen të njëjta rregullave të simetrisë dhe proporcioneve që kam përshkruar në rastet e tempujve; sepse dinjiteti, që duhet t'i dallojë ata si tempuj të perëndive, është një gjë, por eleganca e tyre në kollonada dhe punë të tjera publike, është një gjë krejt tjetër. Kështu që, nëse kollonat duhet të jenë të orderit Dorik, le të jetë lartësia e tyre bashkë me kapitelin e matshme në pjesë të pesëmbëdhjeta. Prej këtyre pjesëve, le të fiksohet njëra për të formuar modulën, dhe në përputhje me këtë modul, duhet të zhvillohet e gjithë puna. Le të jetë trashësia e kollonës në fund të jetë dy module; largësia mes kollonave – pesë e gjysëm module; lartësia e kollonës (pa kapitelin) – katërmbëdhjetë module; kapiteli – një modul në lartësi dhe dy e një të gjashtën në gjerësi [...]*

4.4. Përlogaritja proporcionale e Stoasë – Portiku i madh

Për të gjetur lartësinë e kollonave të Portikut të madh nisemi nga një hipotezë në të cilën pranohej se Portiku përbëhej nga dy rradhë kollonash ku, kollonat e rradhës së jashtme, duhet të kenë qenë të orderit dorik, ndërsa kollonat e rradhës së brendshme, të orderit Jonik. Deri më sot (Janar, 2016) janë zbuluar fragmente të themelit të murit mbyllës dhe themelet e kollonave të orderit Jonik. Nuk janë bërë gjurmime në rradhën e jashtme të kollonave të orderit Dorik, prandaj gjendja e tyre mbetet hipotezë. Për të bërë një rikonstrukcion hipotetik të Portikut nevojitet njohja e lartësisë së kollonës së orderit dorik dhe më pas, duke ndjekur udhëzimet e Vitruvit në lidhje me përmasimin e kollonadave, mund të përcaktojmë të gjitha përmasat që na mungojnë. Për të gjetur këtë lartësi nisemi nga përcaktimi se në një kollonadë të orderit Dorik hapësira mes kollonave është sa $5 \frac{1}{2}$ njësi ku 1 njësi është sa lartësia e kapitelit. Gjithashtu diametri i kollonës është sa 2 njësi dhe lartësia e kollonës (bashkë me kapitelin) është 15 njësi. Për kollonat e orderit Jonik Vitruvi thotë se ato janë 1.2 herë më të larta se ato Dorike pra sa 18 njësi dorike. Gjithashtu nga studimi i Stoave greke shohim se, përgjithësisht, numri i kollonave dorike (në rradhën e jashtme të Stoasë), është dyfishi i atyre Jonike, të cilat ndodhen në rradhën e brendshme të Stoasë.

Kaq informacion mjafton për të përcaktuar lartësinë e kollonave të rreshtit të parë. Duke u nisur nga largësia aksiale ndërmjet themeleve të kollonadës Jonike (e faktuar 580cm nga matjet në vend (gjenden sot të zbuluara nga gjurmimet themelet e kollonave jonike) dhe

²⁷ (Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky, 1859-1910, f. 154), f. 132

duke pranuar që kollonada dorike në rreshtin e parë do ta ketë respektuar këtë aksialitet por duke i shtuar një kollonë në mesin e largësisë për arsye strukturale të arkitraut prej guri që nuk mund të mbulojë hapsira rreth 5.80 metra por që sigurisht mund të mbulojë gjysmën e saj, atëherë kemi llogaritjen e ekuacionit ku (x) është sa njësia bazë dorike, $5\frac{1}{2}x$ është hapsira mes kollonave dorike, $2x$ është diametri dhe $1x$ është gjysma e diametrit të kollonës.

$$5.80m = x + 5\frac{1}{2}x + 2x + 5\frac{1}{2}x + x$$

$$x = \frac{5.80m}{15}$$

$$x = 0.387m$$

Nga njësia bazë rrjedhin përmasat kryesore në vijim:

Kollonat dorike: Lartësia (bashkë me kapitelein) = $15x = 15 \cdot 0.387 = 5,80m$

Diametri në bazë = $2x = 2 \cdot 0.387 = 0.77m$

Kapiteli dorik: Lartësia = $1x = 0.387m$

Baza = $2\frac{1}{6}x = 2\frac{1}{6} \cdot 0.387 = 0,84m$

Kollonat Jonike 1,2 herë më të larta se ato dorike. Lartësia = $1.2 \cdot 5.80m = 6,96m$.

Kollona dorike ka përmasa elegante, ajo me diametrin e vogël na surprizon por, po ta krahasojmë me çfarë nga kollonat dorike gjejmë sot në Apolloni, kuptojmë se këto proporcione duhet të kenë qenë të zakonshme për shek. III p.e.s. kur Portiku mendohet të jetë ndërtuar.

Duke parë kollonat e teatrit, dallojmë $D = 59cm$ në bazë e duke ju referuar Fontanës kemi $D = 44cm$ në bazë.

Evidentohen kështu, gjerësi të vogla të kollonës dorike, që justifikojnë edhe rezultatet që dolën nga përlllogaritja e dimensioneve të Portikut sipas Vitruvit. Në fakt, në librat e tij, duke folur për Teatrot, ai na përmend proporcionet e tyre si dhe mënyrën si dimensionoheshin kollonadat prapa skenave, duke na vënë në dukje faktin që rregullat proporcionale të tyre mund të përdreshin edhe në Stoa. Kujtojmë se si Teatri edhe Portiku i madh janë objekte të lokalizuar në shek. III p.e.s.; kujtojmë këtu që edhe tek Fontana orderi dorik ishte me diametër të vogël, vetëm 44 cm në bazë.

Për të justifikuar këto përmasa të vogla mund ti referohemi edhe Stoa së Jugore të Korinthit që, e studiuar në dimensionet më të vogla, na tregon po përsëri kollona relativisht të holla, 96 cm në bazën e poshtme dhe 79 cm në bazën e sipërme, ndërkohë që gjatësia e arkitraut të gurtë mbi doriket është 234 cm.

Përmasa të tjera të rëndësishme: lartësitë e stereobatit, stilobatit, bazës së kollonave jonike, arkitraut dorik, frizës dorike, kornizës dorike, llogariten sipas rregullave proporcionale të orderit që sipas Vitruvit janë të njëjta me ato që grekët përdorën tek tempujt. (përshkruar tek libri i katërt)




Figure 28, Ndërtim hipotetik mbi prerjen tërthore të Porikut të madh

4.5. Konkluzione

Nga llojet e Stoave që trajtuam arrijmë të deduktojmë edhe mbi tipin të cilit duhet ti takojë Portiku i madh i Apollonisë. S'ka asnjë dyshim që ai i takon tipit me dy krahë anësore ose në formë U-je, pasi këta krahë dhe kollonat anësore janë dokumentuar në vend. Veçse, nga arkeologët, ai është përcaktuar si Stoa me një rradhë kollonash, që do të thotë me një nef. Ajo që na bën të dyshojmë për vërtetësinë e këtij kompozimi është distanca e madhe (5,8 m) nga aksi në aksi i kollonave. Po qe se do të ishte i jashtëm ky varg kollonash do ta kishte të pamundur realizimin prej peshës vehtiake ciklopike të arkitrarëve të gurtë (50 ton). Një arkitra 5,80 m i gjatë, sipas njohurive mbi materialet e ndërtimit dhe teknikës së kohës, mund të jetë vetëm i drunjtë, pasi po të ishte i gurtë do të sillte probleme të jashtëzakonshme teknike dhe ekonomike të realizimit. Kujtojmë se në fazat arkaike të zhvillimit të arkitekturës Greke në gur, distanca mes kollonave ishte 1 ose 1,5 gjerësi kollone (a) vetëm për frikën e sforcimit dhe thyerjes së arkitraut mbi to. Në periudhën klasike ajo do të rritet, por vështirësisht do të arrijë në 2,5a apo 3a. Vitruvi na thote se distanca 3a do të ishte e preferueshme në hapësira publike, për efektin e lehtësisë së kalimit, por nuk rekomandohet sepse arkitrau mund të thyhet. Kujtojmë që edhe në rastin e tempujve më elegantë si Partenoni, kemi një gjatësi arkitrau të gurtë 4,2- 4,5m

Kjo distancë, pra 5,8 m aks më aks, mund të gjendet vetëm në kollonadën e mesit të një Stojaje, aty ku trau mbi kollona është i drunjte e mund të arrijë edhe gjatësi të tilla për vetë cilësitë e materialit.

Idenë e një rradhe të dytë kollonash e mbështesim edhe në restitucionin elektrik të vitit 2005 i cili na lë të dallojmë gjurmë anomalike aty ku kjo radhë duhej të ishte, gjurmë pikësore që duhen hulumtuar mes sondazheve për të vërtetuar hipotezën tonë.




Figura 29. Planimetria e propozuar e portikut i cili përveç 23 kollonave të rradhes së zbuluar, ka edhe një rradhë përpara me ritëm dyfish më të dendur si në Stoa të me dy rradhë kollonash të tipit të dyte planimetrik.




Figura 30. Restitucioni elektrik i zonës së Agorasë mes kodrave. Dallojmë gjurmët kollonave të rradhes së zbuluar e mund të vemë re edhe në radhën paralele para tyre, ndryshim të dendësisë së figurës që i korrespondon vendit ku ka patur kollona të tjera.

Për të vërtetuar nëse kjo rradhë kollonash i korrespondon këtyre anomalive grafike në restitucion, mbivendosëm planimetrinë e ndërtuar mbi imazh dhe kuptuam se linja e tyre përputhet në të njëjtin vend. Si rezultat i këtij studimi rekomandojmë të kryhen gërmime

në këtë trakt gjatësor për të gjetur mbetje të radhës së dytë të kollonave apo edhe të *sterobatit* apo *stilobatit*.




Figura 31. Restitucioni elektrik i zonës së Agorasë mes kodrave dhe mbivendosja e planimetrisë së Portikut. Gjurma e kollonave të jashtme ka mbuluar ndryshimet anomali te imazhit.

Duke shqyrtuar edhe fundin e kollonadës në kënde dhe murin fundor arrijmë në rezultatin se ajo duhet të ketë patur planimetri në formë “U”-je; kjo, për arsye se, edhe në fund kollonat kanë po të njëjtën largësi të madhe nga njëra tjetra, largësi që sjell po të njëjtën vështirësi të vendosjes së arkitraut. Pra, nëse do të mendonim se muri fundor i kthyer në kënd do të ishte edhe fundi i Stoaës si në rastin e murit fundor në dukje (fig. Stoa Poikle në Athinë), do të duhej të kishim dy arkitrarë të gurtë me gjatësi të pamundur, një nga muri tek kollona e parë e një nga kollona e para tek e dyta. Ndërkohë përjashtojmë rastin që ato mund të ishin të drunjtë duke qenë trarë në fasadë, pasi një fasadë me arkitra të drunjtë do të ishte e papranueshme.

Por jemi të sigurt që trau ka qenë i drunjtë e jo në fasadë, për pasojë detyrimisht duhet të kemi patur nga një radhë të jashtme kollonash në kënde, si në tipin e Stoaës në formë “U”-je, të ngjashme në panimetri me Stoaën e Delos apo në Stoaën e Zeus Eleutherios në Athinë.

E rindërtuar virtualisht, Stoa - Portik i madh do të paraqitej në formën e mëposhtme. Ajo ndërtohet në shek. III. p.e.s. duke ju mbivendosur objektit në formë patkoi - Bouleuterion dhe duke konturuar Agoranë me formë të rregullt drejtkëndore. Orderi i jashtëm i kollonave ishte dorik, ndërsa i brendshmi jonik.



Figure 32. Ndërtim hipotetik mbi formën që duhet të ketë patur Portiku i madh në Agoranë mes kodrave në Apolloni




Figure 33, Ndërtim hipotetik mbi formën që duhet të ketë patur hapësira e brendshme në Portikun e madh, në Agoranë mes kodrave në Apolloni

Works Cited

- Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karauskaj, Pirro Thomo. (1976). *Historia e Arkitektures Shqiptare*. Tirane: Ministria arsimit dhe kultures.
- Apollon Baçe, Neritan Ceka. (1981). Stoate e periudhes urbane nw Iliri. *Monumentet XXII*, 5-54.
- Coulton, J. J. (1976). *The Architectural Development of the Greek stoa*. Oxford.

- Donati, J. C. (2015). The Greek Agora in its Peloponnesian Context(s). Në C. A. edited: Donald C. Haggis, *Classical Archaeology in Context: Theory and Practice in Excavation in the Greek World*, (fv. 177-218). Walter de Gruyter.
- Edmond, P. (1930, 4). Lettres de M. Léon Rey sur les fouilles d'Apollonie d'Illyrie (Albanie). *Comptes rendus des séances de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres*, 74/4 . Gjetur mars 2012, nga <http://www.persee.fr/collection/crai>
- Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj. (1-2,2003-2004). les Fouilles franco-albanaises d'Apollonia: 1994-2004. *Iliria*, 180.
- Jean-Luc Lamboley, F. Drini, F. Quantin, S. Shpuza, S. Verger, A. Skenderaj, E. Follain, MH. Barrière, P. Lenhardt, V. Bereti, A. Islami. (123-1 | 2011). Apollonia d'Illyrie (Albanie). *Mélanges de l'École française de Rome - Antiquité [En ligne]*, 242-262. Gjetur në <http://mefra.revues.org/500>
- Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saïmir Shpuza,. (2014). Apollonia d'Illyrie (Albanie) Campagne de fouilles 2012. (É. f. Rome, Re.) *Chronique des activités archéologiques de l'École française de Rome*, 33. Gjetur 1 21, 2015, nga <http://cefr.revues.org/1040>
- Mogens Herman Hansen,Tobias Fischer-Hansen. (1994). Monumental political architecture in archaic and classical Greek Poleis: Evidence and historical significance. Në D. Whitehead, *From Political Architecture to Stephanus Byzantius: Sources for the Ancient Greek Polis* (fv. 23-90). Stuttgart : Steiner .
- Nuttgens, P. (2001). *Storia dell'architettura*. (C. Rodriguez, Përkth.) Milano: Bruno Mondadori.
- S. Verger, S. S. (2014). Qyteti i sipërm i Apolonise, Portiku i madh dhe agoraja helenistike- gërmimet e viteve 2013-2014. *Illyria*, XXXVIII, fv. 211-221.
- Vangjel Dimo, Ph. Lenhard, F. Quantin. (2007). *Apollonia, Atlas archéologique et historique*. Rome: Collection de l'École française de Rome.
- Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky. (1859-1910). *10 books of architecture*. Cambridge: Harward University Press.
- Wycherley, R. E. (1962). *How the Greeks Built Cities*. New York: Norton & Company.

TABELA E FIGURAVE

- Figura 1. Shembuj qytetesh të projektuar me sistem Hipodamik dhe Agoratë e tyre të rrethuara nga Stoa të. Lart djathtas, Stoja e Atalës në Athinë që ilustron formën arkitektonike të Stoave.....119
- Figura 2. Harte e Rëlvimeve të gërmimeve arkeologjike të bëra nga L. Rey në 1927 ...120
- Figura 3. Një nga nikjet cilindrike në Stoa të Apollonisë, ndërsa djathtas nikje të Stoasë në Mistra, Peloponez.....121

- Figura 4. Stoja me nikje, pamje e gjendjes së sotme. Muri i prapëm ruan sot nikjet cilindrike por jo mbulesat gjysmëkupolare të tyre. Kollonat tetëkndore përej guri që duken në krahun e djathtë janë ato të rradhës së mesit të Stoaës me dy rradhë kollonash.122
- Figura 5. Rikonstrukcioni hipotetik i Stoaës i propozuar nga Baçe & Ceka122
- Figurë 6. Plan rilevimi i gjurmëve të Praschniker dhe mbivendosja në të e plan-rilevimit të zonës së Portikut sot. Dallohet që, pjesët e gjetura nga arkeologu austriak, i korrespondojnë vërtetë pjesëve të portikut veçse ai nuk arriti asnjëherë të kuptonte që objekti që kishte zbuluar ishte një Stoa e një tjetër Agoraje të qytetit.123
- Figura 7. Plane të rilevimeve të gjurmëve arkeologjike në zonë dhe pamje e gjurmëve dhe mbetjeve arkeologjike në pjesën fundore të Portikut nga ana lindore. Planimetria me të kuqe është forma që ka objekti sipas arkeologëve francezë.124
- Figura 8. Agoraja e Athinës në fazën e fundit të zhvillimit të saj na jep shembullin e përdorimit të ndryshëm të Stoaës, si një parahyrje, fasadë e objekteve të rëndësishme si Bouleuterion apo Odeon. Në foton djathtas paraqitet një Stoa e drunjtë e cila, edhe pse në fazat më të hershme të evolucionit të saj, na ilustron preferencën e Grekëve për ta përdorur Stoaën si një objekt më vete.126
- Figura 9. Stoa Jugore në Athinë, plan dhe fasadë ilustron rastin e Stoaës me një rradhë kollonash.127
- Figura 10. Palestra e Olympias dhe Qendra e Prienës, në të cilat shohim shembullin e Stoaës me një rradhë kollonash në anët e sheshit,128
- Figura 11. Agoratë e Miletit, dhe Stoja jonike me një rradhë kolonash. Kjo Stoa që paraqitet në foto në gjendjen e sotme, është shënuar me të verdhë në planin e qytetit. ..128
- Figura 12. Stoja e Atalës në Athinë na ilustron fasadën me order të mbivendosur por me lartësi të ndryshme. Vëmë re në interior mënyrën e mbulimit të Stoaës me tavan të pjerrët në kat të dytë ndërsa me tavan të drejtë në kat të parë.129
- Figura 13. Raste të prerjeve tërthore të Stoaëve me dy rradhë kollonash, kur lartësia e tyre është një katëshe, dhe kur lartësia e tyre është dy katëshe e me dyqane në njërën anë. Vëmë re mënyrën e ndërtimit të tavanit e të çatisë me pjerrësi apo pa pjerrësi.130
- Figura 14. Stoa me dy rradhë kollonash, në rastin kur nuk ka dyqane në njërën anë. Stoa në Asklepionin në Pergamo130
- Figura 15. Stoa me dy rradhë kollonash, në rastin kur ka dyqane në njërën anë. Stoa jugore në Korinth.130
- Figura 16. Smyrna dhe Megalopolis përdorin Stoa me tre rradhë kollonash. Vëmë re se Agoraja në Smyrna (majtas), ka arritur konturimin e sheshit duke bashkuar mekanikisht në kënd dy Stoa.131
- Figura 17. Stoa në Smyrna dhe Stoa në Megalopolis na ilustrojnë tipin me tre rradhë kollonash.131

- Figura 19. Royal Stoa në Athinë dhe Stoa në Delos ja dy prej tipeve më të njohur të Stoasë me formë “U”. Vëmë re ndryshimin e distancës (më të madhe) të kollonave në kënd e në krahët që kthehen.....132
- Figure 18. Stoa veriore në Argos ka formë L me dy rradhë kollonash e me një kënd të mbyllur në tre anë me mur.132
- Figura 20. Qyteti i Mantinea na dëshmon rastin e Stoasë me tre rradhë kollonash por që vazhdon në kënde duke u kthyer në formë “L” për të konturuar rregullisht Agoranë. Të tillë e gjejmë edhe në qytete të tjerë të projektuar me sistem Hipodamik.133
- Figura 21. Stoa Zeus Eleutherios në Agoranë e Athinës përfundon në fasadë me dy portikë-pronaos si në tempujt grekë.133
- Figura 22. Megalopolis Stoa na ilustron mënyrën e përfundimit në kënde të Stoasë në formë “U”.....133
- Figura 23. Agoraja në Assos mban në një krah një Stoa me mure anësore deri edhe fasadë dhe në krahun tjetër një Stoa me dy anë.134
- Figura 24. Stoa Dipte në Tharos, me një radhë kollonash në qendër e me dy fasada gjatësore.134
- Figura 25. Stojaja përfundon me mure anësore në dukje në fasadë. Rikonstrukcion i Stoasë së Poikle në Athinë na ilustron këtë rast.134
- Figura 26. Muret anësorë mbulohen nga një kollonë dhe fasada shfaqet si një rradhë kollonash uniforme nga skaji në skaj.135
- Figura 27. Muret fundorë vazhdojnë edhe në këndet e fasadës duke kufizuar vizalisht kollonadën e fasadës. Stojaja në Thermon na ilustron këtë rast.135
- Figure 28, Ndërtim hipotetik mbi prerjen tërthore të Porikut të madh138
- Figura 29. Planimetria e propozuar e portikut i cili përveç 23 kollonave të rradhes së zbuluar, ka edhe një rradhë përpara me ritëm dyfish më të dendur si në Stoa të me dy rradhë kollonash të tipit të dyte planimetrik.139
- Figura 30. Restitucioni elektrik i zonës së Agorasë mes kodrave. Dallojmë gjurmët kollonave të rradhës së zbuluar e mund të vëmë re edhe në radhën paralele para tyre, ndryshim të dendësisë së figurës që i korrespondon vendit ku ka patur kollona të tjera. 139
- Figura 31. Restitucioni elektrik i zonës së Agorasë mes kodrave dhe mbivendosja e planimetrisë së Portikut. Gjurma e kollonave të jashtme ka mbuluar ndryshimet anomalike të imazhit.140
- Figure 32. Ndërtim hipotetik mbi formën që duhet të ketë patur Portiku i madh në Agoranë mes kodrave në Apolloni141
- Figure 33, Ndërtim hipotetik mbi formën që duhet të ketë patur hapësira e brendshme në Portikun e madh, në Agoranë mes kodrave në Apolloni142

5. FONTANA E APOLLONISË

Fontanat ishin struktura arkitektonike që u ndërtuan në qytetet e Greqisë së lashtë. Ato u bënë të domosdoshme për të mirëadministruar ujin e burimeve apo të reshjeve e par ta përdorur për nevojat e qytetarëve. Si struktura komplekse arkitektonike e hidrike ato përbëheshin nga basene dekantues e ujëmbledhës të ndërtuar me gure izodomikë, që shpesh mbuloheshin nga mbulesa të mbështetura mbi portikë. Kapitulli merr persiper studimin tipologjik të fontanës në qytetin e Apollonisë në Iliri, duke e seleksionuar këtë objekt si një prej ndërtimeve që ka pësuar një anastilozë të pjesëshme, duke tentuar të deduktojmë nëse ajo ka qenë e saktë. Ky studim do të na shërbejë edhe për të kuptuar nëpërmjet tij nëse ajo ka patur një formë të veçantë, si shpesh studiuesit e quajnë, apo ka qenë e influencuar dhe e ngjashme me ndonjë fontanë tjetër.

Duhet të theksojmë se në literaturën e shkruar këtë objekt e gjejmë të përshkruar herë si fontanë e he si Nymphaeum, një term që përdorej për ndërtimë të tipit të kultit në antikitet. Për të bërë diferencën mes dy termave, hulumtuam në domethënien e tyre që herët në periudhat archaïke apo klasike Greke.

Në origjinë të fjalës latine Nymphaeum do të jetë fjala greke nimphe- *νυμφαῶν*¹ që tregon një vend ku kryheshin rite ceremoniale të shenjta të lidhura me martesën. Duke qenë se këto rite kryheshin në prezencë të ujit të një burimi të shenjtë, si dhe për arsye të funksionit të lidhur me shëndetin që shpesh këto ujra do të marrin, u arrit në një simbiozë të të dyjave - në një interpretim si fontanë monumentale të Nymphaeum-eve të hershëm grekë. Autorët bëjnë një analizë të gjërë të prejardhjes së fjalës, duke rezultuar që ajo nuk ishte përdorur para shek. V p.e.s. Vetëm e kësaj kohe lokalizohet struktura e ndërtuar në skarpatin e akropolit të Athinës, që pranë burimit të Clessidra, bënte rregullimin e burimit e të sheshit para tij si një Fountain-house, si dhe ninfeu apo Fontana e burimit Minoa në Delos e gdhendur në një shkëmb natyral dhe e sistemuar më vonë si një fontanë.

Të dy këto ndërtime do të bëhen paraardhëse të hershme të tipit të nimfeut të mëvonshëm, si ai pranë tempullit të Apollonit në Cyrene. Sipas Gruyter² ujërat e shenjtë, për komoditetin e besimtarëve, mbledheshin në një basen para paretit shkëmbor, duke e lënë të rrjedhë në një apo më shumë gryka dalje.

Një tjetër fontanë e shek. V p.e.s. ishte ajo e Kastalia në Delfi, njëra prej tre Fontanave rreth së cilave organizohej faltarja e Apollonit. Fillimisht ajo u gdhend në shkëmb por më

¹ (Giovanni Pugliese Carratelli; Ida Baldassarre, 1963)

² (Gruyter, Rise and decline of Roman world, 1997, f. 698)

vonë ju shtuan një seri strukturash murale e basenesh që duhet ta kenë kthyer në një nimphé të mbuluar, në një strukturë të bukur e dinjitoze arkitektonike.

Fontana Pyrene e Korinthit do të përdoret fillimisht si një burim i zakonshëm që kishte vetëm daljet e ujit të modeluara si koka kafshësh, por pa prekje të madhe arkitektonike.

5. 1 Burime literature për fontanën e Apollonisë

Por duhet për rastin tonë të Apollonisë të ndajmë pikërisht këtë funksion ritual të Nymphaeum nga ai i një fontane të zakonshme qyteti. Nga autorë të ndryshëm ajo, që prej kohës së zbulimit në vitet 1960, do të quhet herë Fontanë e herë Nymphaeum.

Praschniker ³ e lokalizon për herë të parë në 1918, ndërkohë që Straboni i cituar nga Ceka ⁴ do të na thotë se në krahinën e Apollinate është një vend i quajtur Nimfé: një shkëmb aty nxjerr zjarr dhe nën këtë rrjedhin burime të vakta dhe asfalt.

Cabannes tek “Recherches archeologiques 1945-85”⁵ pasi bën një përshkrim formal e quan atë një Nymphaion të shek. IV p.e.s., ashtu si njëkohësisht edhe tek botimi „Harta arkeologjike e Shqipërisë”⁶ do të gjejmë përshkrimin për të, përsëri si një Nimfé por të lokalizuar kronologjikisht prej autorëve si një ndërtim të mesit të shek III p.e.s. Ata e cilësojnë atë si monumentin më të madh të Apollonisë, të shtrirë në shpatin e një kodre në rreth 1500m² sipërfaqe.

Në pjesën e sipërme të kodrës një rrjet kanalesh mbledhin ujin e burimeve në një depozitë qëndrore. Depozita trajtohet si në objekt monumental me një basen drejtkëndor të ndarë në dy pjesë, e para e kullonte ujin, e dyta shërbente për mbushje. Një kollonatë dorike me lartësi 2,95m në ballë, me 5 ose 6 kolona do të bëhet fasada kryesore e objektit. Përmendim një ndryshim të numrit të tyre nga 5 në 6 sepse këtu gjejmë një kontradiktë përshkimore të fontanës në rikonstrukcionin hipotetik të paraqitur në “Historia e arkitekturës Shqiptare” i cili na e prezanton portikun me 6 kollona dhe gjendjes aktuale pas anastilozës së viteve ’70 në të cilën portiku ka veçse 5 kollona. Kujtojmë se sipas ligjeve estetike të greqisë antike kolonat në fasadën kryesore duhet te jene përherë në numër çift: një rregull ky që hasej në ndërtimet e tipit tempull, tek të cilët aksi i simetrisë kthehet në aks kalimi. Duke patur 5 kollona në fasadë, aksi i simetrisë bie në kollonë e jo në hapësirën mes tyre, por duke llogjikuar që në fontanë nuk do të kishte kalim poshtë portikut e ai shërbente vetëm për të mbajtur mbulesën e baseneve, mund të tolerohet një anomali e tillë. Mbetet të shohim nëse raste të tilla i gjejmë në shembuj botërorë apo ky ishte një përjashtim vetëm për Apolloninë.

³ (Praschniker, 1922) f. 23-57

⁴ (Ceka, Apollonia, 2005) f.82

⁵ (Cabannes, 1/1986, f. 133)

⁶ (Pierres Cabanes, Myzafer Korkuti, Apollon Baçe, Neritan Ceka, 2008, f. 152)

Ndërkohë, për të njëjtin objekt gjejmë emërtimin si Fontana e Apollonisë tek “Historia e Arkitekturës Shqiptare”⁷. Autorët e lokalizojnë atë si një ndërtim të shek IV p.e.s. e duke përfutur edhe nga një anastilozë e pjesëshme e bërë në pjesën ballorë⁸, do të bëjnë edhe saktësimin përshkrimor të saj për funksionin e formën që duhet të ketë patur.



Figure 1. Fontana e Apollonisë, pamje të ditëve të sotme.

Në veri perendim të akropolit, burimet natyrore e ato që shtoheshin për arsye të pjerrësisë së terrenit e të shirave, do të bëhen arsyeja e nërtimit të strukturës që kërkon ti shfrytëzojë ato për qëllime jetësore. Një mur i lartë 1,6m e i gjatë rreth 70m do ti mblihdë e drejtojë ujërat tek 5 kanale të pjerrët tërthorë. Këto kanale të mbuluar e në distanca gati 11m larg njëri-tjetrit do ta orientojnë ujin në një tjetër kanal horizontal në një kuotë gati 17m më të ulët, që ndodhej mbi murin masiv mbështetës të kodrës. Prej këtij kanali uji do të rridhte në basenin drejtkëndor, të kufizuar nga mure me blloqe të rregullt guri, e të paraprirë nga një portikat kollonash Dorike të ngritura në stereobat. Baseni drejtkëndor do të ketë një ndarje gjatësore me një mur të brendshëm që i vendosur jo paralelisht me muret perimetralë, duhet të ketë patur funksionin e ekuilibritit e uljes së presionit të ujit në basen, gjatë stinëve me shumë reshje e prurje atmosferike.

Kanali i poshtëm hapej anash në pjesën mbi basen, që si një tepërplotës të linte ujin e tepërt të rridhte aty. Uji që rridhte në anë të mureve anësorë do të drejtohej përmes kanaleve të gurta deri në pjesën para portikut. Kur mbushej baseni, uji i pastër dilte në mes të dy kolonave të qendrës, rridhte mes një kanali të gurtë që pjesërisht akoma ndodhet aty. I shtruar me rrasa të mëdha guri pjesa para portikut ruan edhe sot pjerrësinë e madhe, favorizuese të largimit të ujërave që derdheshin nga baseni. Në fund të kësaj pjerrësie do të ketë një kanal që vazhdon paralelisht me portikun dhe bëhet vendi ku do të mblihdet uji që mund të dalë jashtë basenit si dhe uji që derdhej nga tepërplotësat anësorë.

E përshkruar kështu, imagjinojmë që ajo duhet të ketë qenë një strukturë e mirëfilltë hidrike, që edhe pse e bazuar në parimet e rrjedhjes së lirë, duhet të ketë funksionuar në mënyrë perfekte si pasojë e parashikimit të hollësishëm të të gjithë fazave të mbledhjes, shfrytëzimit e largimit të ujërave.

⁷ (Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karaickaj, Pirro Thomo, 1976, f. 121)

⁸ Informacion për restaurimin e viteve 1974-75 e gjejmë tek (Zhegu, 1975), f.21-24



Figure 2. Fontana e Apollonisë në gjendjen e sotme në një shikim nga maja e kodrës, pamje e tepërplotësive të basenit

Duke qenë se shpesh Nimfetë do të jenë pjesë e një kompleksi faltore apo do të ndërtohen pranë një tempulli, e duke mos patur gjurmë të tilla të ndërtimeve të shenjta pranë Fontanës së Apollonisë, duhet të theksojmë se për qytetin ajo duhet të ketë qenë një Fontanë e zakonshme si shpesh poliset greke të kohës kishin. Këtë ide na e përforcon edhe fakti që ajo ndodhet në një pozicion tepër periferik të tij, gati e veçuar nga monumentet e tjerë.

5. 2. Studimi tipologjik kronologjik.

Duhet theksuar se Fontanat u bënë të domosdoshme në Greqinë e atëhershme për vetë mungesën e reshjeve që kishte ky vend. Ato u ndërtuan për të mirëadministruar ujërat e burimeve të paktë e për ti përdorur ato për nevojat jetësore të qytetarëve. Kur niveli i burimit ishte poshtë nivelit urban, basenet e tyre parapriheshin nga shkallë që të ndihmonin për të zbritur poshtë. Kur niveli i burimeve ishte pranë nivelit të vetë qytetit, këto Fontana mund të përfaqësoheshin nga një basen i vetëm që grumbullonte ujin, ndërkohë që kur burimi ndodhej në lartësi të paarrtshme nga qytetarët, ndërhyej duke bërë një ose disa kanale që mblidhnin ujin dhe e drejtonin në një apo më shumë basene.

Këto basene mund të ishin hapësira të pambuluara, por shpesh për arsye të ruajtjes së ujit nga nxehësia e papastërtitë, ato u mbuluan nga struktura çatish që kërkonin për rrjellojë mbajtje nga mure kufizues e kolona, apo nga stuktura ndihmëse ndërtimore.

Duke studiuar Dunkley⁹, mësojmë ti trajtomë ato në mënyrë kronologjike, sipas shekujve kur u ndërtuan.

Informacionet e para mbi këto ndëtime vijnë në pikturat e enëve prej qeramike që paraqesin vashat duke mbushur ujë në struktura të thjeshta që kanë vetëm elementë skulpturalë, të cilat të punuara në gur paraqesin kokë kafshësh me gojë të hapur, që marrin funksionin e çesmave prej të cilave rrjedh uji.

⁹ (Dunkley, Greek Fountain-Buildings before 300 B.C., 1936) f. 142-204

Nga imazhet dallojme se vërtetë ato duhet ti kenë takuar një faze të hershme të zhvillimit të Fontanave. Për të konkluduar kështu na ndihmon forma e kapitelit dorik në njërin nga imazhet, i cili tek ehini ka forma të kurbëzuara si të një kapiteli arkaik karakteristik për shek. VII-VI p.e.s.

Të tjera Fontana arkaike mund të ishin edhe të tipit thollos që shërbenin si puse për të marrë ujin nga thellësi të mëdha.




Figure 3. Shembuj nga vazot me piktura që paraqesin Fontana dhe koka luanësh të skulpturuara që përdorehin për dalje të ujit. Djathtas poshtë, objekti në muzeun e Apollonisë

Me kalimin e dekadave, kërkesa të jetës së përditshme do të kushtëzojnë transformimin e Fontanave-çesma, në Fontana-ndërtesë, term ky i përdorur si një përkthim „mot a mot“ i fjalës *fountain-house* që nënkupton një tipologji të veçantë arkitektonike të kompletuar me basene, çisterna e portikë.

Ky evolucion do të ndodhë në mënyrë kronologjike shumë shpejt dhe që në shek. VII p.e.s. do të gjejnë zgjidhje të gjithë problemet teknike, funksionale e hidraulike që shoqërojnë këto ndërtime. Prej viteve 600 e prapa do të hasen tipe të ndryshme Fontanash që fillimish deri në vitet 350 p.e.s do të ndjekin të njëjtat skema funksionale, e më pas do të fillojnë të përpunohen e pasurohen me një seri elementësh arkitektonikë që do ta ndryshojnë atë stilistikisht në formë. Dunkley na mëson se edhe pse në faza kronologjike të njëjta, mund të rastisë që format që paraqesin Fontanat mund të jenë të ndryshme, pasi një herë që u krye ky evolucion tipologjik e u zgjidhën problemet që një vepër hidrike parashtronte, ndërtimet do të kushtëzohen nga pozicioni i burimit, terreni natyral apo edhe teknikat e materialet e ndërtimit.

Kështu për të kuptuar mirë formën e Fontanës të Apollonisë u desh të ndjekim të gjithë rrjedhën evolutive kronologjike të ndarë sipas shekujve, e më pas të shohim ngjashmëritë me ato të shekujve që paraprijnë kohën e ndërtimit të saj, apo të hulumtojmë edhe nëse forma e zgjidhjet e saj kanë influencuar të mëvonshmet kronologjikisht.

5.2.1 Shembuj botërorë para dhe gjatë shek. VI p.e.s.

Kështu para viteve 600 p.e.s. dëshmohen të parat struktura me basene, mure e portikë që bënë grumbullimin e shfrytëzimin e ujërave. Përshkrimet e para të këtyre Fontanave na vijnë nga Pausania¹⁰ që na i përmend ato, krahas strukturave të tjera arkitektonike.



Figure 4. Burimi Perseia në Mikenë, Burim në akropoln e Athinës, Fontana e Megarës

Burimi Perseia në Mikenë, burimet-guva të Akropolit të Athinës si dhe burimi që identifikohet si Kallirhoe në pjesën JugLindore të Agorasë së Athinës¹¹ ishin struktura që thjesht kishin sitemuar hapësirën pranë burimit për ta bërë atë lehtësisht të arritshëm nga korridore të mbuluar e shkallë që ndihmonin zbritjen apo ngjitjen në varësi të nivelit të burimit. Të këtij lloji në vendin tonë hasim burimet e Butrintit të cilat hapen në shkëmb, dekorohen me një qemer e parapeti që u vendoset para shërben për tu mbështetur gjatë marrjes së ujit në pus.

Përshkrimet e mëpasëshme do ti korrespondojnë fontanës së Megara-s¹² dhe burimeve Pirene e Glaukia të Korinthit të cilat fillimisht ishin thjesht dalje uji e shpejt do të bëhen struktura Fontanash arkitektonike. Dunkley na thekson se Fontanat e Korinthit duhet të kenë patur ngjashmëri me atë të Megara-s dhe na jep, për këtë të fundit planin e rlevuar nga Elderkin.

¹⁰ Pausania ishte një udhëtar e gjeograf I shek. II e.s. që udhëtoi në vendet e greqisë helenistike e ato të Romës, e duke i përshkruar shkroi 10 libra, dedikuar nga një secilit qytet të rëndësishëm. Njëri prej tyre i dedikohet Korinthit.

¹¹ Ky burim do të sistemohet në gjysmën e dytë të shek. VI p.e.s. në atë që do të njihet si Fontana e Enneakrounos, (e nëntë burimeve)

¹² Kujtojmë se Megara ishte një prej kolonive të Korinthit të lashtë, e formuar thuajse njëkohësisht me Apolloninë.

Fontana e Megara-s e cila datohet në kapërcyell të shek. VII-VI p.e.s., ka dy basene-çisternë që shërbejnë për mbledhjen e ujit dhe që duhet të kenë qenë të mbuluar, duke qenë se brenda tyre gjenden rradhë kollonash të vendosura sigurisht për të mbajtur mbulesën. Dunkley i përshkruan çisternat si hapësira të mbuluara me rrasa guri që mbaheshin nga 2 rradhë kollonash 8 këndore. Të vendosura në drejtim gjatësor, çisternat do të ndaheshin nga një mur që nuk shkonte deri na mbulesë, por vazhdonte me kollona pjesërisht të inkasuara në të. Çisternat parapriheshin nga dy basenet ku merrej ujë, tek të cilat arrihej nëpërmjet një portiku me kollona që ngrihej në katër këmbë shkallë. Një kanal gjatësor grumbullues i ujit të burimit, kalonte në pjesën e prapme të çisternave dhe furnizonte me ujë ato, ndërkohë që dy kanale poshtë bazamentit të portikut largonin ujin e tepërt.

E të njëjtës periudhë më Megarën, fund shekulli VII p.e.s. është edhe Fontana pranë tempullit të Herës ne agoranë e ishullit Samos¹³ në të cilën hasim një formë të veçantë e të ndryshme. Baseni kryesor është hapur në toke, rrethohet me mure mbajtës të bërë me gur dhe nga një shirit me kalldrëm rretheqark, e në nivelin e poshtëm të tij hapen grykëderdhjet me koka luani të skulpturuara në bronz. Furnizimi e shkarkimi bëhej nëpërmjet një kanali që i vinte rretheqark basenit e komunikonte nëpërmjet vrimave të hapura në dy faqet anësore të tij.

I njëkohshëm është edhe tuneli Eupalinos¹⁴ që me gjatësi mbi 1km ishte gdhendur në shkëmb me një përpikmëri mahnitëse që në messhekullin VI p.e.s.

Fontana Glauké në Korinth e ndërtuar në fundshekullin VII p.e.s. do të shfrytëzonte ujëra që vinin nga larg dhe që arrinin në Fontanë nëpërmjet një kanali anësor të kurbëzuar. Në brendësi të shkëmbit u gdhendën çisternat ku mblidhej uji. Këto çisterna në formë drejtkëndore u vendosën paralel me njëra tjetrën dhe u paraprinë nga baseni që shërbente si vend mbushje. Struktura shkëmbore e gërryer dhe e paraprirë nga portiku me kollona shërbente si një strehë për basenin. Vëmë re se këtu hasim të njëjtin sistem kompozicional si në fontanën e Megarës, me ndryshmin që çisternat ngushta e të gjata nuk do të kenë domosdoshmërinë e përdorimit të kollonave për të mbajtur mbulesën. Kuptojmë që kollonat e portikut kanë luajtur thjesht rolin e një ritmi të bukur arkitektonik në fasadë.

E njëkohshme me të Fontana Pirene¹⁵ e Korinthit do të ketë formë të thjeshtë në shek. VI p.e.s por do të rimodelohet në formën e një fontane romake në kohën e Augustit.

¹³ (Dunkley, Greek Fountain-Buildings before 300 B.C., 1936) f.151

¹⁴ Eupalinos, emrin e të cilit mori edhe Tuneli që ai projektoi, ishte një arkitekt nga Megara. Ky fakt mund të influencojë në ngjashmëritë tipologjike midis strukturave të Megarës, Apollonisë e Siracuzës, të cilat ishin të gjitha qytete të themeluar nga Korinthi. Kujtojmë këtu se në Apolloni, në murin e bastionit lindor, kemi rastin e përdorimit të një kanali të ngjashëm me atë të ujit në tunelin Eupalinos. Në të dy rastet hasim të njëjtën lartësi kanali dhe të njëjtën strukturë harku të rremë në mbulimin e tyre.



Figure 5. Fontana Glauké (Plan, prerje, fasadë), dhe në fund djathtas - plan i Fontanës Pirene në Korinth

Duke hulumtuar për formën e parë trajtojmë planin e skicuar nga Fowler¹⁶ nga i cili kuptojmë se ajo kishte katër çisterna gjatësore që mblidhnin ujin e burimeve nga shkëmbi argjilor. Të gdhendura në shkëmb ato shfrytëzoni atë si mbulesë dhe parapriheshin nga 3 vaskat ku mblidhej uji. Fasada duhet të ketë patur pilastra apo fragmente murale shkëmborë që mbanin mbulesën e parahyrjes, vëndit portik ku qëndrohej për të marrë ujë. Nga Dunkley¹⁷ marrim gjykimin sipas së cilit ky ndërtim duhet ti ketë korresponduar kohës së Periander¹⁸ pra fundshekullit VII p.e.s, shumë para kohës së ndërtimit të Fontanës së Apollonisë.

Jo shumë larg Korinthit në juglindje të Agorasë së Athinës gjejmë Fontanën Enneakrounos që daton në mesin e shek. VI. p.e.s. e që shfrytëzonte ujin e një burimi natyral. Ajo kishte dy basene të vendosur simetrikisht në të dy anët e një ambjenti të paraprirë nga një portik me 3 kollona që shërbente si vendi ku qëndrohej për të marrë ujë. Kanalet me tuba qeramike do të kalojnë poshtë saj duke e furnizuar me ujë. Përsëri përdoren forma të thjeshta të baseneve drejtkëndorë e portiku me kollona dorike që shërben si fasadë. Ndërtesa mbulohej me çati dyujëse të mbështetur në struktura druri.

Një formë të ndryshme kompozicionale paraqet Fontana e tarracës pranë tempullit në Delphi e datuar në mesin e shek. VI p.e.s. Ajo është më e hershmja e një tip Fontane që kompozohet thjesht, me një basen kudratik në të cilin arrihet nga shkallë që të zbresin në drejtim të tij¹⁹.

¹⁵ Besohej se Pirene ishte një vashë e transformuar në ujë, mamaja Nimfa e një djali të vvarë gabimisht nga Artemis. Pausania na e përshkruan këtë burim si një vend ku poetët vinin për të pirë, e frymëzoheshin për veprat e tyre.

¹⁶ (Dunkley, Greek Fountain-Buildings before 300 B.C., 1936, f. 147)

¹⁷ ibidem

¹⁸ Periander ishte sundimtar i Korinthit nga 627-587 p.e.s. nën sundimin e tij Korinthi njohu një periudhë ndërtimesh intensive. Për të zhvilluar e mbrojtur tregëtinë Korinthiane ai vendosi koloni në Apolloni në Iliri dhe në Potidaea në Chalcidice.

¹⁹ (Dunkley, Greek Fountain-Buildings before 300 B.C., 1936, f. 175)




Figure 6. Fontana në tarracën pranë tempullit në Delphi, në Agoranë e Korinthis, Enneakrounos në Athinë,

Ndërkohë një fontanë në Agoranë e Korinthis që mendohet të jetë e viteve të fundit të shek. VI p.e.s.²⁰ do të na prezantohet me një tjetër kompozim të thjeshtë. Një guvë në të cilën duhet të ketë patur dalje burimi edhe më parë, u sistemua me mure në të tre anët e u la e hapur në faqen e parme. Daljet e ujit u modeluan me koka luanësh prej metali, që lenin ujin të rrjedhë nëpërmjet gojës së hapur. Dyshemeja e guvës u shtrua me blloqe të mëdhenj guri që në pjesët poshtë daljeve të ujit ishin gdhendur në forma rrethore për të favorizuar vendosjen e vazove që do të mbusheshin. Interesante është të shohim format e kokave të luanëve që sot ruajnë akoma finesën e punimit të metalit e që na sjellin konkretisht forma që shfaqen në vizatimet e amforave dekorative e që do të perdoren gjerësisht edhe në Fontana të tjera. Kujtojmë se një formë të tillë të ngjashme, veçse të punuar në gur, e hasim edhe në Apolloni, të ruajtur sot në muzeun arkeologjik.

5.2.2 Shembuj botërorë në shek. V p.e.s.

Gjatë shekullit të V p.e.s do të duhet të kemi evolucion të këtyre objekteve, pavarësisht se Dunkley²¹ nuk ka evidentuar shumë mbetje nga Fontana të kësaj periudhe, përveçse prej atyre që janë të tipit me basen në tokë. Ai përmend këtu Fontanën e Agorasë në Olinto²², e cila ushqej nga një tub qeramike që sillte ujin nga largësitë e vedosej 6 metra nën tokë. Sot fasada e saj na arrin e transformuar në periudhë Romake me harkada e nikje dekorative, në një gjuhë arkitektonike që nuk përputhet me mënyrat e ndërtimit të periudhës që po trajtojmë e për këtë arsye nuk mund të bëhet pjesë e trajtimit tonë tipologjik.

²⁰ Ibidem, f.174

²¹ (Dunkley, Greek Fountain-Buildings before 300 B.C., 1936, f. 177)

²² Olynthos ishte qyteti i lashtë që u formua në shek.VII p.e.s. e ndodhej pranë Selanikut në gadishullin Halkidiki, në Greqinë veriore.

Të tipit me basen në tokë mund të përmendim , nga mes shek. V p.e.s., edhe Fontanën e Delos të ngjashme me atë të Delphit. Shkallët të zbresin në një basen që furnizohej direkt nga burimi brenda tij, ndërkohë që e gjitha rrethohej nga një ndërtesë drejtkëndore që hapej me kollona në faqen balllore dhe në këndet e mbulohej me çati, ndoshta 4 ujëse. Kollonat fillimisht të drunjta duhet të jenë zëvendësuar me të gurta rreth shek. I p.e.s.



Figure 7. Fontana në Delos në plan e në pamje. Djathtas, baseni në çisternën e Bylisit

Një kompozim i tillë na kujton basenin në çisternën e Bylisit, të ndërtuar diku nga shek. III p.e.s. i cili duke paraprirë vetë vëllimin e çisternës së mbuluar me qemer, duhet të ketë qenë vendi ku merrej uji me kova si në një pus, veçse edhe pse i thellë, ai ka parete me gurë izodomikë që arrijnë deri në lartësinë e terrenit. Ndoshta mund të supozohet që ky basen kuadratik të ketë patur parapet kufizues e mbështetës me ortostate në të katër anët i cili duhet të evidentohet nga studimet arkeologjike e të hulumtohet në gurët e radhës së sipërme të mureve të basenit. Duhet theksuar se pranë tij gjejmë edhe sot një mori tamburësh kollonash dorike dhe elementë të tjetër të orderit arkitektonik që nëse ndodhen në vendin e origjinës e nuk janë spostuar më vonë, mund të jenë pjesë e dekorimit të Fontanës.

Duke qëndruar në shembujt e ndodhur në vendin tonë, sot mund të përmendim si të ngjashme me çisternën e bylisit, edhe një çisternë në Apolloni. Nga zbulimet arkeologjike, në anë të Agorasë helenistike, në hyrje të saj, është evidentuar një çisternë e përbërë nga dy basene kuadratikë që mbështeten në një anë në pjerrësinë e terrenit që fillon të ngjitet në kodrën e Akropolit. Ky ndërtim i ngjashëm me tipin me basen nën tokë u ndërtua me mure të trashë tulle e suvatim të brendshëm llaçi izolues, dhe u përcaktuar si një ndërtim që është përdorur deri në shek. III p.e.s.²³, por që vështirësisht e datueshme, s'duhet të ketë qenë më e hershme se shek V p.e.s. E veçantë për të është mënyra e ndërtimit të mureve, me tullë kuadratike 38x38 cm, që ishte prodhim lokal e që ishte përdorur edhe në muret rrethues të qytetit. Duke gërmuar më thellë arkeologët kanë zbuluar bazat e këtyre mureve, që si në rastin e rrethimit të qytetit janë me gurë të rregullt izodomikë.

²³ (Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj, 1-2,2003-2004) f. 180




Figure 8. majtas, Fontana Klepsydra në Athinë, djathtas, Fontana e Asklepiion në Akropol të Athinës

Të ngjashme paraqiten Fontana në faltoren Asklepiion të Korinthit dhe ajo në Asklepiion të Akropolit të Athinës. Shkallët të zbresin poshtë drejt një platforme ku mund të qëndrosh për të mbushur ujë në basenin e ngushtë e të vogël. Në Fontanën e Athinës Uji i tepërt mblidhet në një rezervuar më të vogël në anë, i cili kur mbushet, shkarkohet nga një vrimë poshtë shkallës së katërt. Ndërkohë që në skemën në krah, e vila është e Fontanës Asklepiion te Athines dallojmë një vaskë dekantimi me formë rrethore në fund të basenit..




Figure 9. Akragas, Fontana e mbështetur në anë të kodrës, dhe dy basenet që distancohen prej saj.

I këtij shekulli është edhe Fontana e Klesydra në Akropolin e Athinës që mendohet të jetë ndërtuar rreth 470-460 p.e.s. Në krah të portikut që shërben si fasadë improvizohen përsëri shkallë të cilat zbresin poshtë drejt basenit ujëmbledhës që ndodhet 5-6m poshtë nivelit të tokës.

Në fundshekullin e V p.e.s. datohet edhe Fontana e Akgros²⁴ në Siçili, që paraqet dy basene të vendosur buzë shkëmbit e që në mënyrë gjatësore komunikojnë me njëri-tjetrin²⁵.

Në muret izodomikë të baseneve dallohen hapje drejtkendore të gdhendura në gur për të lejuar rrjedhje uji apo për të lejuar kalimin e tubave prej qeramike që i furnizonin me ujë. Uji merrej nga tre çarje në formë dritarësh në fasadën nga sheshi e cila paraprihej nga një portik me pilastra drejtkëndore, i shtuar ndoshta në shek IV-III p.e.s. Interesante është të theksohet se këtu ndodhet edhe vaska e dekantimit që gjendet në të dy basenet e që e ngjashme edhe me atë të Fontanës së Delfit, duhet të ketë qenë një mënyrë e zakonshme ndërtimi për të ndihmuar ujin të pastrohet në basenet ujëmbledhës. Do të ishte me interes të gërmohet në Fontanën e Apollonisë apo edhe në çisternën e Bylisit brenda basenit, për të arritur fundin e tij e për të parë nëse ato i kanë patur të tilla vaska dekantimi.

5.2.3 Shembuj botërorë në shek. IV p.e.s.

Fontana jugperëndimore e Agorasë së Athinës shfaq një kompozim të pazakontë deri më tani. Një planimetri në formë „L“ kushtëzohej nga vendi i ngushtë ku u vendos si dhe mund të ishte një zgjidhje origjinale për të ekonomizuar shpenzimet e ndërtesës që duhet të mbulonte një basen të madh. (fotot marrë nga

Kollonada dorike këndore do të bëhej fasada e bukur arkitektonike e denjë për monumentalitetin e Agorasë duke krijuar parahyrjen drejt basenit me formë këndore që kufizohej nga rrasa guri të vendosura mes kollonave që shkonin deri në tavan.




Figure 10. Fontana jugperëndimore e Agorasë së Athinës dhe parapeti në basenin ujëmarrës (Lang, 1968, f. 20)

E këtij shekulli datohet edhe Fontana e Dipylon gate në Athinë, e ndërtuar në një sipërfaqe të vogël pranë portës, e cila kushtëzoi edhe kompozimin e saj në formë këndore.

²⁴ Akgros është emri antik i qytetit të mëvonshëm romak të njohur si Agrigento. Në citime të ndryshme këtë fontanë e gjejmë të përmendur si nimfe (Portale 2012), apo si fontanë

²⁵ (Fino, 2014) f. 67-91




Figure 11. Fontana e Dipylon gate në Athinë dhe Fontana e gjimnazit në Sicyon

Këtu haset një basen këndor ujëmbledhës i cili furnizon basenin ujëmarrës me formë kuadratoke dhe paraprihet në kënd nga një portik me tre kollona. Parapete të ulët qëndronin mes kollonave, duke lënë të hapur vetëm hapësirën mes dy kryesoreve për të lejuar hyrjen poshtë portikut. Si rrallë raste të tjera këtu na bie në sy kompozimi asimetrik i fasadës kryesore në të cilën portiku zë pozicion këndor. Duhet të përmendim këtu edhe një detaj të çarjes që lihej për të dalë uji që sipas Dunkley²⁶ kishte parete të pjerrët për të favorizuar daljen e ujit kur ai kishte presion, pa shkaktuar spërkatje rreth e qark. Mesa duket prurja e ujit duhet të ketë qenë më e madhe sesa *hydrat*²⁷ mund të përballonin, pasi edhe në dyshtemenë para parapetit kemi shenja të lëmimit të gurit nga uji, çfarë tregon se aty ai duhet të ketë rrjedhur vazhdimisht. Një detaj të hapjes prizmatike me faqe të pjerrëta gjejmë edhe në dy prej faqeve të mureve izodomikë të basenit të Bylisit, që na lejojnë të theksojmë hipotezën se ai basen duhet të ketë qenë vendi i mbledhjes së ujit për Fontanën e qytetit

Një prej Fontanave të gjimnazit në Sicyon²⁸ apo e njohur si Fontana Krene do të ketë pozicion të ngjashëm me atë të Apollonisë. E mbështetur në shpat kodre, ajo kishte një basen që rrethohet në të tre anët me mur izodomik e hapet në anën e katërt, në fasadë me një portik të thjeshtë me dy kollona dorike. Mbushja e tij bëhet nga hapjet në mur që duhet të kenë patur dalje me koka të gurta luanësh.

Ndërkohë edhe Fontana e Phigalea do të ketë të njëjtën formë të një baseni në shpat të kodrës, ashtu si edhe Fontana Krene. Përsëri uji do të mblidhet në një basen të vogël me mure izodomikë e do të hapet nga njëra anë me kollona e parapet të ulët mes tyre. Baseni që furnizohej nga kanale në kodër do të paraprihej nga një portik me 4 kollona. Interesante është të theksojmë se një formë e tillë planimetrike duket se ishte nga më të suksesshmet, e në kushtet e kufizimit financiar mund të ketë plotësuar minimumin e kërkesave estetike. Një analogji mund të bëjmë me format fillestare evolutive të

²⁶ (Dunkley, Greek Fountain-Buildings before 300 B.C., 1936) f.187

²⁷ Hydra ishte një enë qeramike më dy veshë anësorë, që përdorej për të mbushur e mbajtur ujë. Në pikturat e vazovekorinthase e gjejmë shpesh të rafiguruar në skenat pranë Fontanave.

²⁸ Sicyon ishte një prej qytet-shteteve më të vjetër pranë Korinthit, vetëm 17 km larg prej tij. Kjo afërsi gjeografike na justifikon ngjashmëritë tipologjike të Fontanave të tyre me ato të Apollonisë

tipologjisë së tempullit, ndër të cilat haset tipi i tempullit prostil, si një naos që minimalisht paraprihet nga një pronaos me kollona. Në të njëjtën mënyrë edhe Fontana do të ketë minimalisht një basen me kollona në njërën faqe e me portik në fasadë kryesore.

Fontana në Ialysos në ishullin Rodit, përbëhet nga një basen i gdhendur në shkëmb dhe i hapur në faqen ballore me pilastra dhe blloqe të ulët guri në mes tyre. Ai mbushet nga katër dalje uji në formë koka luanësh dhe paraprihet nga një portik me gjashtë kollona dorike që krijojnë strehën ku qëndrohet për të marrë uje. Koka luanësh vendoseshin edhe në parapetin e ulët mes pilastrave e shërbenin si dalje ku mund të mbushej ujë me *Hydra*. Dallojmë këtu përsëri një ngashmëri të madhe me formën e Fontanës së Apollonisë në formë kompozicionale e në fasadë, veçse kollonat prizmatike të fasadës do të transformohen në dorike në Apolloni.




Figure 12. Fontana në Phigalea, dhe Fontana Ialysos në ishullin e Rodit. (Dunkley)




Figure 13. Fontana Arsinoe në Messene, pamja në ditët e sotme dhe prerje tërthore

5.2.4 Shembuj botërorë në shek. III p.e.s.

Shekulli III p.e.s. do të jetë koha e evolucionit të mëtejshëm të formave për këtë tipologji. Duket se varianti më i suksesshëm për kohën ishte ai i objektit që e mbështeste basenin në shpat kodre për të shfrytëzuar edhe ujin e burimit por edhe atë të mbledhur nga pjerrësia e terrenit. Rast i tillë i përmasave të mëdha është Fontana Arsinoe në Messene që ka përsëri dy basene gjatësorë në vazhdim të njëri-tjetrit, të cilët mbështeten në kodër

për të shfrytëzuar ujërat e saj. E paraprirë nga një portik ajo u shtua më vonë edhe me dy basene të tjerë në sheshin para portikut.

5.3. Trajtimi e analiza tipologjike

Si përfundim mund të themi se Fontanat e ndërtuara nga shek.VII-III p.e.s. mund ti ndajmë në dy tipe:

1. Me basen nën nivelin e tokës, të hapur si një çisternë nën tokë. Në këto raste shpesh duhen shkallë për të na zbritur nën nivelin e tokës e për të na ndihmuar të arrijmë pranë basenit ujëmarrës.
2. Me basen në nivelin e tokës. Në këto raste Fontana paraqitet si një objekt i zakonshëm që paraprihet nga një stereobat i ulët me 3 apo 4 shkallë dhe ka nevojë për mbulesë me dru e tjegulla si çdo objekt tjetër.




Figure 14. Fontana të ndërtuara në vende të sheshta, ku të gjitha faqet e objektit janë të jashtme.

Një klasifikim tjetër i Fontanave mund të bëhet sipas pozicionimit në lidhje me vendin ku ndërtohen. Këtu dallojmë dy grupe:

1. Fontana të ndërtuara në vende të sheshta, ku të gjitha faqet e objektit janë të jashtme

Për të krijuar çisternën apo basenin ujëmbledhës këtu ndërtohen mure izodomikë të cilët janë vazhdimisht nën presionine ujit e për ta lënë atë të depërtojë në basen, hapen vrima në vendet ku bashkohën gurët.

2. Fontana që mbështeten në kodër duke shfrytëzuar edhe ujërat e mbledhura nga terreni, ku vetëm 3 nga faqet e objektit janë të jashtme.

Në këto raste muri i prapëm i basenit shërben si mur mbajtës për kodrën prapa tij e mund të ketë edhe tubacione qeramike apo kanale me rrasa guri që furnizojnë atë me ujë.




Figure 15. Fontana që mbështeten në kodër duke shfrytëzuar edhe ujërat e mbledhura nga terreni, ku vetëm 3 nga faqet e objektit janë të jashtme



Figure 16. shembull nga tipi i dytë planimetrik me basen në mbështetje të kodrës. Pamje e Fontanës në Arsinoe dhe asaj në Ialysos në ishullin Rhodes.

Ajo që është e përbashkët për këto tipe është trajtimi arkitektonik i jashtëm. Të gjitha, sidomos ato nga shek. VI p.e.s. do të paraprihen nga portiku me kollona që përcakton fasadën e bukur me order arkitektonik, e cila me sa duket ishte kthyer në një fasadë universale për çdo objekt të çdo tipologjie.

5. 4 Analizë krahasuese e Fontanës së Apollonisë

Fontana jonë e Apollonisë do të bëjë pjesë në grupin e dytë të Fontanave të mbështetura në kodër dhe fare mirë mund të krahasohet me të ngjashmet e kësaj tipologjie, për të mundur të deduktojmë se si është influencuar apo jo prej tyre.

E fillojmë këtë krahasim tipologjik nga Fontanat e Korinthis e Megarës, duke qenë se të dy qytetet që i patën u banuan nga Korinthis e ka shumë shanse, që edhe ndërtimi të jetë bërë nga të njëjtët mjeshtrë apo arkitektë të Korinthis.²⁹ Na e përforcon këtë hipotezë fakti që qytetet janë fare pranë njëri tjetrit. Kuptohet që Fontanat e Korinthis e Megarës mund të shërbenin si shembuj të bukur për tu ndjekur edhe nga ndërtuesit e Fontanës së Apollonisë, pavarësisht se ky qytet do të ndodhej në një distancë të madhe gjeografike prej të parëve³⁰.

²⁹ Kujtojmë se Megara ishte koloni e krijuar nga Korinthisit ashtu si do të jetë pak më vonë edhe Apollonia.

³⁰ Në arkitekturë distancat gjeografike perktehen në ndryshime stilistike apo tipologjike, por për të mos pritur që në Apolloni të kemi një rast të tillë na ndihmon një shkrim i (Beaumont, 1952, f. 66) i cili na mëson se Korinthis vazhdonte të ruante marrëdhënie intensive e të mira me Apolloninë e që prej mesit të shek V p.e.s., do të ketë një rrugë tokësore që lidhte dy qytetet. Kjo rrugë u ndërtua si një domososhmëri e Korinthis për të patur ndihmën ushtarake të Apollonisë në luftë ndaj Athinës, por natyrshëm do të jetë

Është interesante të shohim se e njëjta strukturë morfologjike e ngjashme me Fontanën e Apollonisë, do të ishte për Fontanën e Megara-s e cila datohet në shek. VII p.e.s. Ajo ka dy basene-çisternë që shërbejnë për mbledhjen e ujit dhe që duhet të kenë qenë të mbuluar me rrasa guri që mbaheshin nga kollona 8 këndore. Jo të panjohura për sfondin e antikitetit Grek ato do të përdoren në vende të ndryshme si një formë që rrjedh nga latimi i këndeve të një pilastre drejtkëndore. Kujtojmë që kollona të tilla gjenden përveç Apollonisë edhe në Bylis e Nikaia-Klos, por nuk kemi prova se janë përdorur në Fontanën e Apollonisë. Në fakt baseni ndahet në dy pjesë e mund të deduktojmë se muri i brendshëm duhet të ketë shkuar deri në lartësinë e tavanit, si në fontanën Arsinoe, duke ndihmuar kështu edhe në mbajtjen e peshës.

Nuk mund të deduktojmë nëse mbulesa ka qenë druri apo me rrasa guri, pasi në vend mungojnë arkitrarë apo elementë të antablementit, por duke parë gjerësinë e basenit mund të hipotezojmë se ajo ka qenë e drunjte si në çdo objekt tjetër Grek.




Figure 17. majtas, Fontana Arsinoe, dhe në mes e djathtas, Fontana në Appolloni, prerje dhe plan

Sot në murin ndarës të basenit të apollonisë dallojmë 3 vrima (në total duhet të kenë qenë 4), që duhet të kenë shërbyer si gryka dalje të ujit, e duke qenë se ndodhen pak mbi nivelin maksimal që duhet të ketë patur uji në vaskën e përparëme, duhet të kenë shërbyer për furnizimin e saj. Nuk jemi në gjendje të themi nëse uji dilte nga grykat kokëluani e nëse aty ishin montuar kokat e luanëve si në rastet analloge. Në fakt, në muzeun e Apollonisë gjendet dhe sot një kokë e luani, por në vend mungojnë shenja metalike apo kanale të ganxhave që duhet të shërbenin për montim.

Përsa i përket baseneve të ujit, mund të hipotezojmë se muri ndarës në mes tyre është ndërtuar në një fazë të mëvonshme se muret anësore pasi mungon elementi i kthesës së gurëve, apo ajo që do të duhej për ti lidhur në mënyrë të qëndrueshme të dy muret përpjndikularë. Prej kësaj deduktojmë se baseni i dytë nuk duhet të jetë mbushur plot e se niveli i ujit duhet të ketë qenë deri në lartësinë e vrimave që përmendëm, të cilat duhet të kenë shërbyer si tepërplotës.

edhe një rrugë komunikimi arkitektonik, nëse mund ta quajmë kështu këmbimin e eksperiencave apo të risive arkitektonike që merreshin nga qyteti "mëmë". Dëshmohej që Apollonia ishte e "Sjellshme" ndaj Korinthit, e Korinthi e ndihmonte atë që të mos binte në pushtetin e Korkirës.



Figure 18. Fontana e Apollonisë sot, dallohen daljet e ujit në basenin e parë ujëmarrës

Ndërkohë edhe për basenin e parë mund të njohim lartësinë maksimale të mbushjes (që duhet thënë se është larg nga kuota e lartesisë maksimale të tij), si një lartësi që i korrespondon tepërplotësive në dy këndet e jashtëm anësorë të tij, të cilët e derdhnin ujin e tepërt jashtë në një kanal të hapur në anë të anteve kryesore. Këto lartësi relativisht të ulëta të nivelit të ujit mund të justifikojnë edhe mungesën e lidhjes këndore të murit ndarës, i cili nuk do të kishte mundësi të përballonte forcën shtytëse të ujit, por i ngritur në lartësi ndihmonte për tu bërë mbështetës i mbulesës së të gjithë fontanës.




Figure 19. Fontana në Megara, dhe Glauké, djathtas në plan e prerje.

Dy basenet në Megara paraprihen nga një portik me 5 kollona e dy pilastra drejtkëndore, në të njëjtën mënyrë si në Fontanën e Apollonisë. Kollonat përbëjnë fasadën e bukur arkitektonike e ndodhen pak para parapetit pas saj, që ishte vendi ku qëndrohej për të marrë ujë.

Gati identike do të jetë forma e fontanës Glauké të Korinthis: përsëri çisterna që paraprihen nga portiku me një numër tek kollonash e me dy pilastra drejtkëndore, orthostate, në antet anësore.

Ashtu si edhe në Apolloni, edhe Megara e Korinthis, hasim një numër tek kollonash, pra një kollonë në aksin e simetrisë së fasadës dhe të njëjtën skemë funksionale hidrike. Kuptojmë që eksperiencia e mirë në ndërtimin e këtyre objekteve duhet ti ketë shërbyer, si një shkollë praktike për tu respektuar, edhe mjeshtrave Apollinatë.

Duhet të theksojmë se shpesh në literaturën e studiuesve shqiptarë, Fontana e Apollonisë cilësohet si një objekt monumental³¹, “formë e veçantë, e pazakontë e vepër unike në gjininë e vet”³², apo “një monument i veçantë i botës antike”³³. A qenë të saktë në këtë përcaktim ata?

Në krahasimin e këtyre objekteve kronologjikisht paraardhës, të ndërtuar nga arkitektë (nëse ato ishin të tillë) të ardhur nga e njëjta origjinë-Korinthis, lehtësisht dalluam ngjashmëritë planimetrike e në fasadë, por duhet të jemi të kujdesshëm të theksojmë se në altimetri gjërat ndryshojnë. Në rastin e Apollonisë kemi një sistemim të Fontanës si një burim uji që mbledh ujin e ardhur nga lart, ndërsa në rastet e Glauké-së dhe ndoshta të Pirene-s, kemi shfrytëzimin e ujit të mbledhur nga poshtë, nga burime apo nga prurje të tubacioneve poshtë nivelit të tokës.

Kështu tek Fontana Glauké, nga prerja e detajuar kuptojmë se ngjitja në shkallë, tashmë më të shumta në numër sesa shkallët tipike të stereobatit, do të duhet për të krijuar diznivele në favor të lartësisë në të cilën duhet të ngjitemi për të mbushur ujë. Edhe Fontana Pirene ka po të njëjtën situatë, basene që marrin ujë nga një lartësi e ulët e që pasi e grumbullojnë në çisterna e bëjnë të arritshëm nëpërmjet portikut ballor. Ndërkohë që ajo që do të ngjajë pothuaj identikisht në altimetri me Fontanën e Apollonisë do të jetë Fontana në Ialysos e ndërtuar në shek.IV p.e.s.

Interesante është të shohim ngjashmëritë morfologjike stilistike me rastet e tjera të ndërtimit të Fontanave kronologjikisht të njëkohshme apo më të mëvonshme se ajo e Apollonisë.

Në hulumtimin tonë ndalemi tek Fontana Arsinoe në Messene³⁴. E ndërtuar në shek III p.e.s. ajo si dhe e Apollonisë do të mbeshtetet në kodër, do të marrë ujrë e saj nëpërmjet daljeve në murin fundor mbështetës, do të mbledhë në basenin grumbullues e precipitues 40 m të gjatë, e do të lokalizojë më pas në dy basenet e përparmë të cilët vendosen në të

³¹ (Zhegu, 1975)

³² (Riza, 1997), f. 83

³³ (Ceka, La fontaine d'Apollonia) f.503-515

³⁴ Qyteti i vjetër Messene u formua e ndërtua në 369 p.e.s. prej Epameinondas nga Thebes. Gjurmët arkeologjike të tij sot ndodhen pranë qytetit të sotëm Messini në Peloponesin jugperëndimor, Greqi.

dy anët e hyrjes e shërbejnë për mbushje. Vëmë re se ngjashmërisht me Apolloninë³⁵: kemi po përsëri basene gjatësorë paralel me fasadën, të kufizuar nga mure izodomikë e të mbuluar me çati dyujëse. Përsëri një kollonadë, veçse tashmë Jonike, do të mbajë mbulesën e do të bëhet fasadë e të gjithë objektit. Në rikonstrukcionin grafik, supozohet që objekti të jetë mbuluar me mbulesë druri, një formë që na le të supozojmë se e tillë mund të ketë qenë mbulesa edhe në Apolloni. Në fakt, duke studiuar Dunkley mësojmë se shpesh Fontanat mbuloheshin me rrasa guri, por që për peshën e distancat e ngushta që mbulojnë kanë kërkuar gjithmonë domosdoshmërinë e vendosjes së kollonave në brendësi të baseneve, si në Megarë. Basenet e Apollonisë nuk kanë kollona e për këtë mund të hipotezojmë një mbulesë të drunjtë të ngjashme me ato që përdorshin në tempujt grekë.

Duke përmendur kohën e krijimit të Messene-s messhekulli IV p.e.s. kujtojmë se Fontana Arsinoe mund ti përkasë të njëjtës periudhë të ndërtimit të fontanës së Apollonisë, ose pak më të mëvonshme se ajo.

Në ngjashmëri morfologjike gjejmë edhe fontanën e Ialysos në ishullin Rhodes, duhet thënë shumë larg gjeografikisht por afër kronologjikisht. Edhe aty baseni mbështetej në një mur mbajtës të kodrës dhe mbledhja e ujit bëhej nga kanalet që rridhnin edhe në muret anësorë të basenit.

Tek Dunkley mësojmë se këto kanale anësorë, përpindikular me izoipset, ndërpriteshin në antet e portikut e ujin që kishin grumbulluar e kalonin në basen nëpërmjet distancimit të gurëve në një rradhë, apo e derdhnin në hapësirën para basenit nëpërmjet gojëvë të kokave të luanëve. Të tillë kanale që zbresin nga kodra deri në antet e portikut i gjejmë edhe në Apolloni dhe po të jemi të vemendshëm mund të edhe shohim hapjet në mur, të clat janë krijuar thjesht nga distancimi i gurëve në një rradhë. në periudhat me prurje të mëdha reshjesh, sasia e ujit në Fontanë duhet të jetë rritur e duhet të jetë derdhur në sasi të konsiderueshme në pjesën para portikut, që ndryshe nga rastet e Ialissos apo të Arsinoes, ka një pjerrësi të madhe të dyshemesë, gati 20°. Prurja e madhe e ujit mund të justifikojë edhe zgjatimin e një prej pesë kanaleve, edhe përtej kanalit në kodër.

Vëmë re se nga 5 kanalet që ndjekin pjerrësinë e kodrës, jo vetëm 2 që krijojnë basenin zbresin deri poshtë, por edhe një i tretë, i cili vazhdon si një kanal që duhet të ketë derdhur ujin në fushën përpara. Fillimisht të krijohet ideja se ai mund të ketë kufizuar një tjetër basen ujëmbledhës që mund të kishte një tjetër portik kollonash në ballë, si duke dublikuar fontanën që gjejmë sot. Një formë e tillë nuk do të ishte e pamundur të realizohej, e mund të kishte qenë edhe një fazë evolutive e kronologjikisht e mëvonshme që do ta bënte tepër të veçantë e madhështor objektin.

³⁵ Përmendim këtu edhe ngjashmërinë me Fontanën në Akgros-Agrigento, përse i përket mënyrës së vendosjes së baseneve përgjatë njëri-tjetrit




Figure 20, Foto të vjetra të para anastilozës së fontanës së Apollonisë, dallohen daljet e ujit në muret anësore dhe suvatimi që ka akoma baseni pranë kollonadës. Pas restaurimi ky suvatim gabimisht është hequr.



Dy basene e dy portikë në krah të njëri tjetrit ose ndoshta në krah të portikut të parë mund të ndodhej një vaskë ujëmbledhëse me një nivel uji më të ulët e ndoshta edhe pa portik me kollona. Megjithatë gjatë hulumtimit të mëtejshëm për të parë se a ka qenë e tillë kjo formë, kuptojmë se ajo ishte e pamundur të realizohej, pasi në të dy anët e jashtme të basenit gjenden dalje tepërplotësa dhe kanalet e rrjedhjes së ujit të tepërt në pjesën e përparme. Rrasat e gurit edhe para portikut janë mjaft të distancuara nga njëra tjetra në mënyrë që të lejojnë ujin të thithet edhe nga toka poshtë kalldrëmit. Mund të mendojme se ato tepërplotësa mund të kishin hedhur ujë në një basen-vaskë që mund të shërbente për të pirë ujë kafshët.

Duke hulumtuar një foto të vjetër të kohës kur Fontana ishte e sapozbuluar e nuk ishte bërë restaurimi, mund të dallojmë gjurmë të rrjedhjes së ujit në paretet anësore të basenit

pranë kodrës, si dhe një gjurmë në suva që duket si një gjurmë e lënë nga një çati mbuluesë e basenit-vaskë pranë portikut. Baseni pranë portikut ruan gjurmë suvatimi, ndërsa i pari pranë kodrës nuk ka suvatim.

Nga kjo mund të hedhim idenë se baseni i dytë mund të ketë qenë i pambuluar e në të të mblidhej edhe shiu i çatisë së basenit të parë. Për ta shprehur këtë formë na ndihmon rikonstrukcioni 3D.

Duket pra se kjo tipologji e fontanës ka marrë në këto kohë forma të studjuara e thellësisht të përpunuara artistikisht, të cilat mundësojnë jo vetëm zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë por edhe atë krijimit të një objekti të mirëfilltë arkitektonik që luante rol esencial në imazhin monumental të qytetit e të Agorasë së tij.



Figure 21. Pamje dhe propozime hipotetike të formës që Fontana mund të ketë patur.

Nga autorë të ndryshëm qoftë të epokës³⁶, apo edhe të mëvonshëm mësojmë se uji ishte problemi kryesor që duhej të zgjidhej për një qytet, që duhet krahas orientimit të mirë natyror të zgjidhte edhe sistemin e furnizimit me ujë, për të patur kështu një jetë të

³⁶ Këto argumente të trajtuar nga Aristotele, Platone apo Hipokrati i sjell Jouanna Jacques (Jouanna, 1996)

shëndetshme. Për pasojë Fontana ishte një objekt me rëndësi gati strategjike, por edhe shënonte e kushtëzonte organizimin urban të tij³⁷.



Figure 22. . plan i Apollonisë me objektet e zbuluar, dallohet në pjesën sipër, Fontana duke na evidentuar largësinë e saj nga qendra publike e qytetit

³⁷ (Caliò, 2009) f. 111-115,

Thënë kjo duhet të prisnim që Fontana e Apollonisë të kishte një rëndësi primare për qytetin edhe si një pikë e rëndësishme urbane e tij. Çuditërisht, ajo që na bie në sy është pozicioni tepër periferik që ajo ka në lidhje me qytetin, e sidomos me atë pjesë të qytetit të zhvilluar në shekujt e vonshëm e që më së shumti është bërë sot objekt i studimeve arkeologjike. Duke parë pozicionin e saj verior, dallojmë afërsinë me Akropolin, që prej arkeologëve është saktësuar si vendi ku kanë qenë vendbanimet e para, kështu arsyeshëm Fontana do të afrohej pranë tyre por edhe do të kushtëzohej në vendosje nga vendndodhja e burimeve që me sa duket aty ishin të shumtë. Por duke vazhduar më tej arsyetimin, sidomos të lidhur me kronologjinë do të hedhim dyshimin nëse një ndërtim i tillë u bë vetëm në shek. IV apo të III si arkeologët kanë saktësuar, apo më herët, që prej kapërcyellit të shek VI siç qytetit do ti duhej për ta furnizuar me ujë. Në fakt të nisur nga format e Fontanave që trajtuam më lart mund të shohim se objekte të tillë si Megara apo Pirene me një morfologji të ngjashme njiheshin që në shek. VI p.e.s., pavarësisht se forma identike me atë të Apollonisë, pra me pozicionim në kodër, do të haset vetëm në shek. IV p.e.s. tek Ialysos në Rhodes.

Një element që na bën ta mendojmë fontanën e Apollonisë si një ndërtim jo më të hershëm se messhekulli V p.e.s. janë kollonat dorike të saj, të cilat shfaqen me kapitël konik me brinjë të drejta, formë që u has vetëm në periudhën klasike të Greqisë së lashtë, (mesi shek. V p.e.s.). A na ndihmojnë këto të dhëna ti qëndrojmë kohës së ndërtimit të saj në shek. IV- III p.e.s.? Mos ndoshta është ndërtuar më herët e ka patur një rimodelim të saj në periudhën klasike duke i shtuar portikatin? Raste të tilla të rikonstrukcioneve të Fontanave, si një objekt që duhet të vazhdojë të jetojë bashkë me qytetin, hasen shpesh³⁸.

Ajo që bie në sy është mungesa përmendjes së Fontanës së Apollonisë në librat e studiuesve bashkëkohorë, as tek Dunkley³⁹, as tek Wycherley⁴⁰ apo botime të tjera të dedikuara kësaj tipologjie nuk gjejmë përmendje e aq më pak analizë të këtij objekti.

5.5 Analizë krahasuese e çisternës në Apolloni dhe Bylis.

Për të kompletuar kuadrin e kësaj tipologjie na duhet të anlizojmë edhe çisternën pranë agorasë së vjetër mes kodrave në Apolloni.

Ajo u ndërtua shek. V-IV p.e.s. dhe u përdor deri në shek. III p.e.s., kohë në të cilën u ndërtuan magazinat mbi të. Ajo përbëhej nga 2 basene, ndër të cilët, ai lindor ruhet më mirë. Në formë katërkëndore 3,1 x 2,3 m i madh ai duhet të ketë qenë në të njëjtin madhësi me tjetrin që sot arrin i prishur e të dy, në total mbanin rreth 25m³. Në këndin

³⁸ përmendim rastet e Fontanave të Pirene, Arsinoe, si raste të njohur për shtesa e rikonstrukcione të të njëjtit objekt në periudha të ndryshme.

³⁹ (Dunkley, Greek Fountain-Buildings before 300 B.C., 1936), f. 142-204

⁴⁰ (Wycherley R. E., 1951)

veriperëndimor ka një hapje në mur që duhet të ketë shërbyer për furnizim me ujë, ndërkohë që muri i jashtëm i basenit zgjatet si një ante, më shumë se sa këndi.




Figure 23. Çisterna e Apollonisë në plan e pamje të pjesës që ka mbetur sot pas ndërtimit të magazinave.



Figure 24. majtas, Çisterna Loutraki; në mes, cisterna e Teatrit të Delos; djathtas Çisterna e Bylisit në pjesën fundorë të mbuluar me qemer guri.

Rruga e zbuluar në brinjën lindore të saj, është fare pranë dhe, edhe nëse do të kishte vend për një portikat të vogël si fasadë, hapësira që do të mbetej para saj, do të ishte e pamjaftueshme për të lejuar shfrytëzimin e objektit nga shumë njerëz. Kujtojmë gjithashtu se para Fontanave, në të gjitha rastet hasen sheshe të vegjël të cilët edhe me sipërfaqe të pjerrët do të ndihmonin largimin e ujërave. Natyrshëm pra na vjen ideja se hyrja për në çisternë duhet të ketë qenë nga ana perëndimore në të cilën po të jemi të vëmendshëm, dallojmë edhe një fragment të vogël mural si filimin e një ante-je ndoshta në anë të portikatit.

Në fakt mbetet për të diskutuar se si do të merrej uji nga kjo çisternë, si nga një pus me hapje në pjesën e sipërme (model për këtë mund të bëheshin rastet e çisternave të hershme të kohës minoike apo mikenase që funksiononin si një pus ku uji mblidhej në një

ambjent poshtë tij); apo si në një fontanë, që paraprinte një çisternë si në Megara e Korinth ku baseni para çisternës bëhej vaska ku do të merrej uji.



Figure 25. Çisterna në Bylis, baseni dhe shkallët e stadiumit në krah të saj.

Pa ditur se si ishte mbuluar kjo çisternë, kujtojmë raste analloge të qyteteve të tjerë helenë. Çisternat, që ishin struktura shpesh të gdhendura në shkëmb apo në tokë të ngjeshur do të shërbenin si depozita për të mbledhur e shfrytëzuar ujin e shiut⁴¹. Me përmasa të vogla apo edhe me kapacitete që arrinin deri në disa qindra m³, ato do të ndërtoheshin private apo edhe publike. Nga koha e shek VI-II p.e.s. si çisterna të mbuluara njihen cisterna e teatrit të Delos dhe ajo e Heraion-it të Loutrakit. Të dyja me përmasa të një drejtkëndëshi të zgjatur, do të mbuloreshin, me harqe guri në Delos (vitet 300 p.e.s.) apo me pllaka guri të mbajtura nga një radhë kollonash në brendësi në Loutraki.

Mund të dallojmë një ngjashmëri mes mënyrave se si mbulohej çisterna e Delos me atë të mbulimit të çisternës së Bylisit. Harqet në Bylis mbanin pllakat e gurit që mbulonin sipërfaqen. I ngjashëm është edhe pozicioni i ndodhjes së çisternave - pranë Teatrit në Loutraki dhe pranë shkallëve të Stadiumit në Bylis – në të dyja rastet do të mbledhë ujrat e shiut nga shkallaret e këtyre objekteve publike. Kujtojmë që çisterna e Bylisit ka një vëllim të zgjatur drejtkëndor 4,2 x 50,9m të hapur në tokë me një thellësi e cila mendohet të ketë arritur 6 m. Ajo paraprihej nga një Basen si në çisternën e Latos, i cili ruan edhe sot shtresën e suvasë hidroizoluese.

Në basenin që e paraprin derdheshin ujërat e shiut që mblihdeshin nga hapësira e Agorasë, të kanalizuar në një kanal të punuar me pllaka guri. Kanale të ngjashëm dokumentohen në Agoranë e Athinës apo të qyteteve të tjerë: çdo polis do të shfrytëzonte ujërat e shiut në agora për të plotësuar nevojat e banorëve për ujë. Ndërkohë që rasti Çisternës së Loutrakit na jep alternativën e mbulimit me gurë që duhet të jetë përdorur edhe në çisternën e Agorasë së Apollonisë, meqë përmasat e saj ishin më të ngushta. Në të nuk kemi kollona por muret anësore të baseneve duhet të kenë mbajtur mbulesën.

⁴¹Mbi historinë e çisternave mësojmë nga (Larry Mays, George P. Antoniou, Andreas N. Angelakis, 2013), në një artikull në revistën Water.



Figure 26. Pus për mbledhje e marrje uji në Athinë; kanal ujëmbledhës në Agoranë e Athinës; kanal ujëmbledhës në Agoranë e Bylis i cili çon ujë tek Çisterna

5.6 Konkluzione

Në krahasimin e Fontanës së Apollonisë me ato të Pirene-s e Glauké-s dhe Megarës, lehtësisht dalluam ngjashmëritë planimetrike e në fasadë, por duhet të jemi të kujdesshëm të theksojmë se në altimetri gjërat ndryshojnë. Në rastin e Apollonisë kemi një sistemim të Fontanës si një burim uji që mbledh ujin e ardhur nga lart, ndërsa në rastet e Glauké-së dhe ndoshta të Pirene-s uji mbledhet nga poshtë e do të duhej të ngjiteshim me disa këmbë shkallë për të arritur tek portiku.

Basenet në Megara, Glauké dhe Pirene paraprihen nga një portik me 5 kollona e dy pilastra drejtkëndore, në të njëjtën mënyrë si në fontanën e Apollonisë, pra me një numër tek kollonash që vendos një kollonë në aksin e simetrisë së fasadës.

Ajo ka forma të studjuara e thellësisht të përpunuara artistikisht, të cilat mundësojnë jo vetëm zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë por edhe atë krijimit të një objekti të mirëfilltë arkitektonik që luante rol esencial në imazhin monumental të qytetit. Dyshimet mbi formën që duhet të ketë patur, mbi rolin e baseneve të zbuluar dhe nëse ato kanë qenë të mbuluar apo jo, u qartësuan nëpërmjet analizës tipologjike të Fontanave në botën Greke e cila deduktoi e konkludoi formën përfundimtare e saj.

Dy basenet do të kishin secili rolin e tij, ai tek portiku për të marrë ujin, dhe tjetri tek kodra për të shërbyer si basen ujëmbledhës e dekantues. Forma drejtkëndore e rregullt e basenit ujëmarres flet për faktin se ai ka qenë i mbuluar, duke qenë se forma e rregullt bëhet domosdoshmëri për të mundësuar mbulesën me trarë. Fakti se baseni pranë kodrës ka patur rol dekantues e ka qenë i pa mbuluar, u mbështet në analizën e rasteve analoge dhe në hulumtimin e fotove të vjetra në të cilat gjejmë gjurmët e lagështirës që uji kishte lënë në suva, e që provojnë faktin se uji rridhte nga mbulesa e basenit ujëmbledhës drejt basenit dekantues pranë kodrës. Një tjetër ndërhyrje e gabuar ka qenë heqja e suvasë në basenin pranë portikut. Ky proces ka zhdukur dallimin e vrimave që krijoheshin në muret

anësorë nëpërmjet spostimit të gurëve, vrima që shërbenin për të derdhur në basen ujin e kanaleve anësorë, duke bërë kështu të paqartë mënyrën se si mbushej ky basen.

Fontana e Apollonisë na rezultoi gati e njëjtë në skemë hidrike si dhe në paraqitje arkitektonike me Fontanën Ialysos në ishullin Rhodes, me atë të Arsinoe në Messene e me atë të Akragas në Sicili. Duke qenë se këto shembuj ruhen në gjendje të mirë në ditët e sotme dhe janë nga rastet më të studiuar të tipologjisë, mund të na shpjegojnë shumë pikepyetje të lidhura me formën origjinale të saj.

Duhet të theksojmë se shpesh në literaturën e studiuesve shqiptarë, Fontana e Apollonisë cilësohet si një objekt monumental, “formë e veçantë, e pazakontë e vepër unike në gjininë e vet”, apo “një monument i veçantë i botës antike”. A qenë të saktë në këtë përcaktim ata?

Analiza na tregoi se ajo që Apollinatët ndërtuan ishte një formë e ngjashme me simotrat e saj të shek IV-II p.e.s. por sigurisht ajo që një prej më të bukurve shembuj. Ajo që bie në sy sot, është mungesa përmendjes së Fontanës së Apollonisë në librat që merren me trajtimin e kësaj tipologjie - ky studim shërben edhe për të kthyer vëmendjen në këtë objekt. Sot ai duhet studiuar edhe më shumë me synimin për të kuptuar edhe formën origjinale të tij, që gabimisht është ndryshuar gjatë anastilozës së vitit 1974.

E mbyllim këtë trajtim të Fontanës së Apollonisë me një citim të Cabannes⁴² sipas të cilit [...]Ajo reflekton një farë megallomanie në ndërtuesit Apollinatë e sidomos në ata që e financonin ndërtimin e saj. Cilat burime do ta siguronin furnizimin e saj me ujë vazhdimisht ? A e kishin llogaritur ato shtytjen e kodrës që duhej të mbahej nga muret izodomikë të baseneve? [...] Megjithatë vazhdon ai: duhet të vlerësojmë këtë guxim të konstruktorëve e të imagjinojmë shkëlqimin e monumentalitetin e saj, që duhet të ketë lënë një impakt të pashlyer të gjithë vizitorëve që arrinin në Apolloninë e atëhershme përmes fushës në anën përëndimore.

Works Cited

- Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karaickaj, Pirro Thomo. (1976). *Historia e Arkitektures Shqiptare*. Tirane: Ministria arsimit dhe kultures.
- Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karaickaj, Pirro Thomo. (1976). *Historia e Arkitektures Shqiptare*. Tirane: Ministria arsimit dhe kultures.

⁴² (Vangjel Dimo, Ph. Lenhard, F. Quantin, 2007)

- Beaumont, R. L. (1952). Corinth, Ambracia, Apollonia. *The Journal of Hellenic Studies*, Vol. 72, 62-73. Gjetur korrik 2014, nga <http://www.jstor.org/stable/627994>
- Cabannes, P. (1/1986). Recherche archeologique en Albanie 1945-1985. *Revue Archéologique, Nouvelle Série*, 107-142.
- Caliò, L. M. (2009). Cultura medica e urbanizzazione in Grecia tra età classica ed ellenismo, in PP 64,. (G. M. Editore, Re.) *La Parola del Passato, Rivista di studi antichi*, 94-127.
- Ceka, N. (2005). *Apollonia*. Tiranë: Migjeni.
- Ceka, N. (a.d.). La fontaine d'Apollonia. *Deuxieme conference des Etudes albanologiques*, (fv. 503-513).
- Dunkley, B. (1936). Greek Fountain-Buildings before 300 B.C. *The Annual of the British School at Athens*, Vol. 36, 142-204. Gjetur në <http://www.jstor.org/stable/30096876>
- Fino, A. (2014, 2). La fontana arcaica di San Biagio ad Agrigento. *Thiasos, rivista di archeologia e architettura antica*, 67-91.
- Giovanni Pugliese Carratelli; Ida Baldassarre. (1963). *Enciclopedia dell'arte antica classica e orientale*. Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana.
- Gruyter, W. d. (1973). *Aufstieg und Niedergang der römischen Welt*. Berlin: Hildegard Temporini.
- Gruyter, W. d. (1997). *Rise and decline of Roman world*. Berlin: Hildegard Temporini.
- Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj. (1-2,2003-2004). les Fouilles franco-albanaises d'Apollonia: 1994-2004. *Iliria*, 180.
- Jouanna, J. (1996). Hippocrate, Airs, eaux, lieux. *Les Belles Lettres*, 52(52-2).
- Lang, M. (1968). *Waterworks in the athenian agora*. Princeton, New Jersey: American school of classical studies at Athens.
- Larry Mays, George P. Antoniou, Andreas N. Angelakis. (2013, 5). History of Water Cisterns: Legacies and Lessons. *Water*. Gjetur 6 2014, nga <http://www.mdpi.com/>
- Petri S. Juuti, Georgios P. Antoniou, Walter Dragoni, Fatma El-Gohary, Giovanni De Feo, Tapio S. Katko, Riikka P. Rajala, Xiao Yun Zheng, Renato Drusiani, Andreas N. Angelakis. (2015). Short global history of fountains. *Water*. Gjetur në <http://www.mdpi.com/2073-4441/7/5/2314>
- Pierres Cabanes, Myzafer Korkuti, Apollon Baçe, Neritan Ceka. (2008). *Harta arkeologjike e Shqipërisë*. Pegi.
- Praschniker, C. (1922). Muzakhia aus Malakastra: Archäologische Untersuchungen in Mittelalbanien. *JCEAI*, vol.21-22, 23-57.
- Riza, E. (1997). *Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri*. Tiranw: Dituria.
- Vangjel Dimo, Ph. Lenhard, F. Quantin. (2007). *Apollonia, Atlas archéologique et historique*. Rome: Collection de l'École française de Rome.
- Wycherley, R. E. (1951). How the Greeks Built Cities. *The American Journal of Philology*, vol.72/1. Gjetur në <http://www.jstor.org/stable/291981>

Wycherley, R. E. (1962). *How the Greeks Built Cities*. New York: Norton & Company.

Zhegu, K. (1975). Punimet e restaurimit nw fontanën e Apollonisë. *Monumente të kulturës në Shqipëri 1, 1975*.

TABELA E FIGURAVE

Figure 1. Fontana e Apollonisë, pamje të ditëve të sotme.	148
Figure 2. Fontana e Apollonisë në gjendjen e sotme në një shikim nga maja e kodrës, pamje e tepërplotësive të basenit.....	149
Figure 3. Shembuj nga vazot me piktura që paraqesin Fontana dhe koka luanësh të skulpturuara që përdorshin për dalje të ujit. Djathtas poshtë, objekti në muzeun e Apollonisë.....	150
Figure 4. Burimi Perseia në Mikenë, Burim në akropoln e Athinës, Fontana e Megarës	151
Figure 5. Fontana Glauké (Plan, prerje, fasadë), dhe në fund djathtas - plan i Fontanës Pirene në Korinth	153
Figure 6. Fontana në tarracën pranë tempullit në Delphi, në Agoranë e Korinthis, Enneakrounos në Athinë,	154
Figure 7. Fontana në Delos në plan e në pamje. Djathtas, baseni në çisternën e Bylisit	155
Figure 8. majtas, Fontana Klepsydra në Athinë, djathtas, Fontana e Asklepion në Akropol të Athinës	156
Figure 9. Akragas, Fontana e mbështetur në anë të kodrës,dhe dy basenet që distancohen prej saj.	156
Figure 10. Fontana jugperëndimore e Agorasë së Athinës dhe parapeti në basenin ujëmarrës (Lang, 1968, f. 20).....	157
Figure 11. Fontana e Dipylon gate në Athinë dhe Fontana e gjimnazit në Sicyon	158
Figure 12. Fontana në Phigalea, dhe Fontana lalysos në ishullin e Rodit. (Dunkley)	159
Figure 13. Fontana Arsinoe në Messene, pamja në ditët e sotme dhe prerje tërthore.....	159
Figure 14. Fontana të ndërtuara në vende të sheshta, ku të gjitha faqet e objektit janë të jashtme.....	160
Figure 15. Fontana që mbështeten në kodër duke shfrytëzuar edhe ujërat e mbledhura nga terreni, ku vetëm 3 nga faqet e objektit janë të jashtme	161
Figure 16. shembull nga tipi i dytë planimetrik me basen në mbështetje të kodrës. Pamje e Fontanës në Arsinoe dhe asaj në lalysos në ishullin Rhodes.	161
Figure 17. majtas, Fontana Arsinoe, dhe në mes e djathtas, Fontana në Appolloni, prerje dhe plan	162
Figure 18. Fontana e Apollonisë sot, dallohen daljet e ujit në basenin e parë ujëmarrës	163
Figure 19. Fontana në Megara, dhe Glauké, djathtas në plan e prerje.	163

Figure 20, Foto të vjetra të para anastilozës së fontanës së Apollonisë, dallohen daljet e ujit në muret anësorë dhe suvatimi që ka akoma baseni pranë kollonadës. Pas restaurimi ky suvatim gabimisht është hequr.....	166
Figure 21. Pamje dhe propozime hipotetike të formës që Fontana mund të ketë patur.	167
Figure 22. . plan i Apollonisë me objektet e zbuluar, dallohet në pjesën sipër, Fontana duke na evidentuar largësinë e saj nga qendra publike e qytetit.....	168
Figure 23. Çisterna e Apollonisë në plan e pamje të pjesës që ka mbetur sot pas ndërtimit të magazinave.....	170
Figure 24. majtas, Çisterna Loutraki; në mes, cisterna e Teatrit të Delos; djathtas Çisterna e Bylisit në pjesën fundorë të mbuluar me qemer guri.	170
Figure 25. Çisterna në Bylis, baseni dhe shkallët e stadiumit në krah të saj.	171
Figure 26. Pus për mbledhje e marrje uji në Athinë; kanal ujëmbledhës në Agoranë e Athinës; kanal ujëmbledhës në Agoranë e Bylis i cili çon ujë tek Çisterna.....	172

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në fund të kësaj pune studimore kemi krijuar një tablo të qartë të ndërtimeve monumentale në Agoratë e Apollonisë, duke i parë ato në raport me tipologjitë respektive të qyteteve të tjerë helene por edhe të hapësirave Agora të tyre.

- Periudha e ndërtimit të Agorave është në shek IV-III p.e.s. e vazhdon deri në shek. I - II e.s. Ato u ndërfuten në një sistem urban hipodamik (Apolloni, Antigone, Bylis), apo në sisteme të lirë (Butrint e Phoinike) duke u ndërtuar në zonën më të sheshtë të qytetit.
- Fakti i terrenit shpesh të pjerrët të qytetit dhe sipërfaqja e vogël e tyre, nuk ka lejuar të krijohen Agora kuadratike si në Agoratë helene, por me shtrirje të theksuar gjatësore.
- Nga analiza e objekteve që përfshin një Agora dhe e pozicionit që ato kanë në lidhje me të kuptuam se Teatri kërkon të bëhet pjesë e Agorasë duke kërkuar një lidhje direkte me të. Përgjithësisht këtu bën Apollonia që e ka Teatrin larg sheshit, (me sa duket sipërfaqja e madhe e qytetit influencon), ndërsa në qytete të tjerë, fakti që janë të ndërtuar në terrene të pjerrët, do të krijojë mundësinë që pranë Agorasë të gjendet një shpat shkëmbor për të gdhendur shkallaren si në tipologjinë e Teatrit grek. Në Greqi, një nga karakteristikat që sistemi hipodamik impononte, ishte pamundësia që Teatri të bëhej pjesë e Agorasë e cila duke qenë e sheshtë duhej të zgjidhte zonën me të rrafshët të qytetit duke qëndruar larg Teatrit. E vetmja ndërtesë publike që nuk mund të bashkohej me të tjerat në një qendër të vërtetë publike apo civike në Greqi ishte Teatri, ndërkohë që këtu ai do të bëhet pjesë e qendrave të qyteteve.

Reflektojmë se madhësia relativisht e vogël e qyteteve do të influencojë e do të kushtëzojë prezencën e Teatrit pranë Agorasë. Duket sikur mendohej fillimisht ku mund të ndërtohej Teatri, me morfologjinë e tij të gdhendjes në shkëmb e më pas planifikohej edhe sheshi pranë tij. Kjo karakteristikë e vendosjes së Teatrit pranë Agorasë në qytetet ilire mund të ndihmojë arkeologët për të lokalizuar Agoranë, aty ku ato nuk janë zbuluar ende, si në Hadrianopoli e Dimal ku teatrot janë zbuluar, apo të ndihmojë për të lokalizuar Teatrin aty ku ai nuk është zbuluar ende si në Antigone e Amantia ku është zbuluar Agora apo Stoa dhe ai do të ketë shumë shanse të gjendet në afërsi të saj apo të një Stoaqe.

- Gjatë analizës u ndalëm edhe në faktin e Stoaës me njëqindë në Apolloni e Dimal. Duke i krahasuar me raste Stoaash në vendet helene konstatuam se atje ato janë inekzistente (mbisundon këndi i drejtë në planimetri) ndërsa duke kthyer sytë nga

eksperienca romake, këto nikje mund ti krahasojmë me absidat. Të jetë influencë romake?!...

Duke qenë të shek. IV p.e.s. para kohës kur Roma pushtoi Ilirinë, e duke parë format e ndërtimit në gur edhe të mbulesës absidale, (Roma ndërtonte me beton), e përjashtojmë këtë mundësi. Mendojmë se këto forma, gati megalitike, që mund të na kujtojnë fasadën shkëmbore të varrit të Selcës, janë një zgjidhje origjinale lokale.

- Absidat influencohen përsëri nga terreni – pa pasur lluksin e krijimit të Agorave të mëdha por vetëm me shtrirje gjatësore, ato u detyruan të afrohen maksimalisht me skarpatin e kodrës e të përdorin absidat si kundraforca për të penguar rrëshqitjen e saj. Një zgjidhje të tillë të ngjashme, në të cilën një kodër mund të sistemohet e të parandalohet rrëshqitja nëpërmjet ndërtimit pranë saj, do ta gjejmë në arkitekturën e Forumit të Trajanit në Romën e shek. II, në të cilin dyqanet, si një Stoa e kurbëzuar sipas trajektores së një harku të madh do ti afrohen kodrës duke u mbështetur e mbajtur atë.
- Elementi tjetër që studimi evidenton është përdorimi i Harkut të Triumfit në Agoranë e Apollonisë si dhe pozicionimi i tij në lidhje me kompleksin e Agorasë. Kjo tipologji romake do të ndërtohet vërtet në kohën e perandorisë, por ajo që duhet vlerësuar është fakti i përdorimit të saj brenda një Agoraje helenistike.

A ka Agora greke që e kanë pranuar një tipologji të tillë brenda tyre?

Nuk ndeshet në asnjë rast, as edhe në qytete të tillë si Pergamon që do rikonstruktohen në periudhën romake. Një tipologji e mirëformuar, si Agoraja, nuk pranon influenca, e aq më tepër, një demokraci si ajo greke e shprehur edhe në arkitekturë, nuk mund të pajtohet me një Hark Triumfi, simbol i hierarkisë perandorake.

Në lidhje me pozicionimin e harkut të triumfit në raport me objektet e tjerë, si një pozicion anormal e pa lidhje aksiale apo proporcionale me to, studimi shtroi që në fillim disa pikëpyetje. Duke analizuar po përsëri tipologjikisht mënyrat e kompozimit të shesheve në Greqinë e lashtë, u arrit të kuptohet anomalia kompozicionale e të konkludohet në arsyet që duhet të kenë justifikur zgjedhjen e projektuesit për ta vendosur këtë objekt krejt pranë një objekti të rëndësishëm siç është Bouleuterioni.

Nga analiza që bëmë në lidhje me të kuptuam se edhe pse në një shesh te transformuar në kohë Romake, akoma vazhdojnë të ruhen rregullat e projektimit apo kompozimit polar që grekët kishin përdorur, e që do të favorizonin perceptimin arkitektonik të Harkut të Triumfit. Por ndërkohë edhe do të respektoheshin parimet e

mbylljes së perspektivë e vendosjes së objekteve në fund të akseve vizualë, që arkitektura Romake aplikonte.

Ndërtimi në formë patkoi tek Agora helenistike në mes dy kodrave në Apolloni , është gjetur vetëm në një radhë gurësh themeli e na kujton në formë të ngjashme që gjejmë tek Bouleuterioni i Korinthis, i cili kishte një formë patkoi e sipas studiuesve supozohet të jetë mbuluar me çati dyujëse dhe pjesërisht konike. Nëse do të tentonim të gjenim një analogji në formë të tij me atë të Apollonisë, do të ishim të justifikuar nga fakti se dy qytetet (Apolloni, Korinth) ruanin marrdhënjet e tyre akoma në shek. V-IV p.e.s., kur objekti në formë patkoi duhet të jetë ndërtuar. (kujtojmë këtu referencat e autorëve që dëshmojnë komunikimin edhe tokësor mes dy qyteteve si dhe aleancën ushtarake të tyre, të përmendura edhe më parë në këtë punim). Ndërkohë që të mendojmë se ky ndërtim mund të ketë qenë një Eklesiasterion, nuk na lejojnë dimensionet e vogla të tij. Kujtojmë që rastet që njohim kane përmasa nga 45- 65m apo 69,9 m tek Pnyx.

Kështu duke ndjekur këtë arsyetim funksioni që mund ti vishet këtij objekti është ai i një Bouleuterioni (i periudhës helenistike). Këtë e mbështesim në faktin që për çdo qytet duhet të kishte patjetër një sallë këshilli, që në vend tjetër nuk është dëshmuar arkeologjikisht veçse tek tempulli i Agonotetëve i shek. II e.s. po para kësaj periudhe ku duhet të jenë bërë mbledhjet e Boulesë e ato të Eklesias? Për Eklesian kemi një alternativë jo të panjohur (mbledhjet e asamblesë së qytetit shpesh bëheshin në Teatër). Teatri i Apollonisë dëshmohet të jetë ndërtuar në shek III p.e.s. Kështu që prej atij shekulli mbledhjet e eklesias duhet të jenë bërë në Teatër e nuk do të kishte nevojë për një tjetër (aa më tepër të vogël) në Agora.

Nëpërmjet analizës kronologjike të ndërtimeve në të dy sheshet e Apollonisë, studimi dedukton se mbetet si një periudhë “e zbuluar”, koha nga shek.III p.e.s deri në mes të shek. II e.s, periudhë në të cilën nuk e dimë se ku duhet të ketë qenë Bouleuterioni. Gjithashtu kuptojmë se duke qenë se vetëm prej shek. III p.e.s. mund të përdorej si Eklesiasterion Teatri, natyrisht që më parë rolin e tij duhet ta ketë përmbushur ndërtimi në formë patkoi.

Mund të hipotezohet se ajo që sot gjejmë si formë patkoi, të ketë qenë një Bema dhe të kërkonim në veri, pjerrësinë e shkallares që shihte në drejtim të Bemës, rolin e së cilës duhet ta luante vetë objekti në formë patkoi.

Kuptojmë se nga vitet 300 p.e.s. apo koha kur u ndërtua portiku i madh e deri më 150 e.s., nuk dihet se cila ndërtesë ka qenë Bouleuterion. A mundet të qëndrojë një qytet pa një ndërtesë për Bule? A do të ishte e arsyeshme të prishej një Bouleuterion (ndërtesa në formë patkoi) për të ndërtuar një Portik-Stoa (portiku i madh), nëse nuk do të kishin diku tjetër një Boule? Por kjo ka ndodhur e dëshmohet: portiku ju mbivendos Bouleuterionit duke na bërë të deduktojmë se patjetër, një ndërtesë tjetër Bouleuterion në këtë periudhë

duhet të ketë patur. Por ku duhet ta kërkojmë atë ? Studimi dedukton se njëri nga tek dy objektet në krah të rrugës së gjerë në hyrje të Agorasë mund të ketë qenë një Bouleuterion. Njëri prej tyre është interpretuar si një tempull nga arkeologët, ndërkohë që tjetrit, atij në veri të rrugës, akoma nuk i është dhënë një funksion. Ky objekt tjetër në krah të tempullit, i vendosur në anën veriore të rrugës së madhe mund të ishte një Bouleuterion. Ai mund të ketë patur të njëjtin orientim në lidhje me sheshin e Agorasë dhe po ashtu i drejtuar nga lindja si shpesh pamë se preferohej nga Bouleuterionet e rasteve të qyteteve që trajtuam. I paqartë në gjësimet e bëra dhe në mbetjet arkeologjike që na prezanton, ai duhet studiuar më tej për të parë në se do të mund të ketë qenë i tillë, gjatë periudhës në të cilën qendra e qytetit ishte në Agoranë mes kodrave. Nga fakti që aty janë gjetur pjesë të kollonave të orderit, është hedhur nga studiuesit hipoteza se mund të ketë qenë një ndërtesë me karakter monumental apo ceremonial, e cila rekomandojmë të mbështet në kërkime arkeologjike me qëllim lokalizimin në kohë dhe verifikimin e hipotezës teorike se ajo mund të ketë qenë një Bouleuterion. Zona ku ai ndodhet ka një çisternë të shek. IV.p.e.s. dhe një magazinë të shek. I e.s. Këto objekte dhe koha e ndërtimit të tyre mbështesin hipotezën e studimit në lidhje me Bouleuterionin dhe se ku ai ka qenë nga shekulli në shekull.

- Në shek. V-IV p.e.s. Eklesiasterioni e Bouleuterioni ndodhen te ndërtesa në formë patkoi.
- Në shek V- IV p.e.s. ndërtohet çisterna dhe dokumentohet se vazhdon funksionim deri shek. III p.e.s.
- Në shek. III p.e.s. çisterna prishet nga ndërtimi mbi të i Bouleuterionit në veri të rrugës së madhe, i cili funksionon për aq kohë sa qendra e qytetit ishte në Agoranë mes kodrave¹
- Nga shek .III p.e.s. – shek. II e.s. Bouleuterioni ndodhet te objekti në veri të rrugës madhe.
- Në shek II e.s. ndërtohet tempulli i Agonotetëve që shërben si Bouleuterion i qytetit deri në kohën e rënies e braktisjes së tij.

Në lidhje me objektin tjetër të trajtuar, studimi arrin në konkluzione po përsëri të rëndësishme.

Portiku i madh është studiuar nga arkeologet të cilët kanë përcaktuar planimetrinë e tij. Veçse nga ata ai është përcaktuar si Stoa me një rradhe kolonash, do të thotë me një nef. Ajo që na bën të dyshojmë për vërtetësinë e këtij kompozimi është distanca e madhe (5,8 m) nga aksi në aks i kollonave. Po që se do të ishte i jashtëm ky varg kollonash do ta

¹ Kjo Agora duhet të ketë funksionuar deri fund shek. II .e.s. . periudhë që lokalizohet sipas kohës në të cilën është prishur portiku i madh në anën veriore.

kishte të pamundur të mbante peshën e arkitraut të gurtë. Një arkitra 5,8m mund të jetë vetëm i drunjtë, pasi po të ishte i gurtë do të thyhej menjëherë. Kujtojmë se në fazat arkaike të zhvillimit të arkitekturës Greke në gur, distanca mes kollonave ishte 1 ose 1,5 gjerësi kollone (a) vetëm për frikën e sforcimit e thyerjes së arkitraut mbi to. Në periudhën klasike ajo do të rritet po vështirësisht do të arrijë në 2,5a apo 3a. Vitruvi na thote se distanca 3a do të ishte e preferueshme në hapësira publike, për efektin e lehtësisë së kalimit, por nuk rekomandohet se arkitrau mund të thyhet. Kujtojmë që edhe në rastin e tempujve më elegantë si Partenoni, kemi një gjatësi arkitraut të gurtë 4,2- 4,5m

Kjo distancë, pra 5,8 m aks më aks, mund të gjendet vetëm në kollonaden e mesit të një Stojë, aty ku trau mbi kollona është i drunjtë e mund të arrijë edhe gjatësi të tilla për vetë elasticitetin e materialit. Idenë e një radhe të dytë kollonash e mbështesim edhe në restituconin elektrik të vitit 2005 i cili na lë të dallojmë gjurmë anomalike aty ku kjo radhë duhet të ishte, gjurmë pikësore që duhen hulumtuar mes sondazheve për të vërtetuar hipotezën tonë.

Për të vërtetuar nëse kjo radhë kollonash i korrespondon këtyre anomalive grafike në restitution, mbivendosëm planimetrinë e ndërtuar mbi imazh dhe kuptuam se linja e tyre koinçidon të njëjtin vend.

Si rezultat, studimi rekomandon të kryhen gërmime në këtë trakt gjatësor për të gjetur mbetje të radhës së dytë të kollonave apo edhe të *sterobatit* apo *stilobatit*.

Duke shqyrtuar edhe fundin e kollonades në kënde dhe murin fundor arrijmë në rezultatin se ajo duhet të ketë patur planimetri në formë U. Kjo për arsye se edhe në fund kollonat kanë po të njëjtën largësi të madhe nga njëra tjetra, largësi që sjell po të njëjtën vështirësi të vendosjes së arkitraut. Pra nëse do të mendonim se muri fundor i kthyer në kënd do të ishte edhe fundi i Stojës si në rastin e murit fundor në dukje (fig.Stoa Poikle në Athinë), do të duhej të kishim dy arkitrarë të gurtë me gjatësi të pamundur, një nga muri tek kollona e parë e një nga kollona e para tek e dyta. Ndërkohë përjashtojmë rastin që ato mund të ishin të drunjtë duke qenë trarë në fasadë, pasi një fasadë me arkitra të drunjtë do të ishte e papranueshme. POR... jemi të sigurt që trau ka qenë i drunjtë e jo në fasadë, për pasojë detyrimisht duhet të kemi patur nga një radhë të jashtme kollonash në kënde, si në tipin e Stojës në formë U, të ngjashme në panimetri me Stojën e Delos apo në Stojën e Zeus Eleutherios në Athinë.

Studimi propozon edhe rindërtimin virtual të objektit Stoa-Portik i madh i cili do të paraqitet me Order të jashtëm të kollonave në Dorik, ndërsa në brendësi me order Jonik.

Rasti tjetër në shqyrtim të plotë deri në rikonstrukcion hipotetik që studimi trajtoi është ai i Fontanës monumentale, që njihet si Fontana e Apollonisë.

Ajo ka forma të studjuara e thellësisht të përpunuara artistikisht, të cilat mundësojnë jo vetëm zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë por edhe atë krijimit të një objekti të mirëfilltë arkitektonik që luante rol esencial në imazhin monumental të qytetit. Dyshimet mbi formën që duhet të ketë patur, mbi rolin e baseneve të zbuluar dhe nëse ato kanë qenë të mbuluar apo jo, u qartësuan nëpërmjet analizës tipologjike të Fontanave në botën Greke e cila deduktoi e konkludoi formën përfundimtare e saj.

Dy basenet do të kishin secili rolin e tij, ai tek portiku për të marrë ujin, dhe tjetri tek kodra për të shërbyer si basen ujëmbledhës e dekantues. Forma drejtkëndore e rregullt e basenit ujëmarres flet për faktin se ai ka qenë i mbuluar, duke qenë se forma e rregullt bëhet domosdoshmëri për të mundësuar mbulesën me trarë. Fakti se baseni pranë kodrës ka patur rol dekantues e ka qenë i pa mbuluar, u mbështet në analizën e rasteve analloge dhe në hulumtimin e fotove të vjetra në të cilat gjejmë gjurmët e lagështirës që uji kishte lënë në suva, e që provojnë faktin se uji rridhte nga mbulesa e basenit ujëmbledhës drejt basenit dekantues pranë kodrës. Gjatë analizës u evidentua një ndërhyrje e gabuar gjatë procesit të restaurimit: heqja e suvasë në basenin pranë portikut. Ky proces ka zhdukur dallimin e vrimave që krijoheshin në muret anësorë nëpërmjet spostimit të gurëve, vrima që shërbenin për të derdhur në basen ujin e kanaleve anësorë, duke bërë kështu të paqartë mënyrën se si mbushej ky basen.

Kjo Fontanë rezultoi e ngjashme me Fontanen Ialysos në ishullin Rhode, me atë të Arsinoe në Messene e me atë të Akragas në Sicili.

Dizertacioni mori përsipër të provojë se Studimi historik e arkitektonik i tipologjive ndërtimore, duhet të bëhet baza e një interpretimi e rikonstrukcioni virtual 3D.

Vërtetë që rastet e marrë në studim na bindën për këtë. Edhe në rastin e portikut të madh, edhe në rastin e Bouleuterionit si edhe në atë të Fontanës, pas studimit tipologjik konkludua në rezultate e forma pak, apo tërësisht të ndryshme nga ato që deri më tani hipotezoheshin.

Portiku i madh konkludoi krejt i ndryshëm me atë që arkeologët kanë propozuar duke dhënë edhe indikacione për të vazhduar studim e gërmime të mëtejshme të pjesëve të pazbuluara.

Ndërtesa në formë Patkoi e supozuar si Eklesiasterion nuk mund të jetë e tillë, por vetëm një Bemë apo një Bouleuterion i para shekullit III p.e.s. duke na dhënë edhe indiciet për të kërkuar Bouleuterionin e shek. III p.e.s. – II e.s. në një vend tjetër.

Fontana monumentale mori formë të plotë arkitektonike e sqaroi edhe fragmente të pasqaruara nga studimet e mëparshme e sidomos edhe gabime të anastilozës së dikurshme.

Bibliography

- Apollon Baçe, Aleksander Meksi; Emin Riza, Gjerak Karauskaj, Pirro Thomo. (1976). *Historia e Arkitekture Shqiptare*. Tirane: Ministria arsimit dhe kulture.
- Apollon Baçe, Neritan Ceka. (1981). Stoa e periudhes urbane në Iliri. *Monumentet XXII*, 5-54.
- Beaumont, R. L. (1952). Corinth, Ambracia, Apollonia. *The Journal of Hellenic Studies*, Vol. 72, 62-73. Gjetur korrik 2014, nga <http://www.jstor.org/stable/627994>
- Bier, L. (2008). The Bouleuterion. Në C. Ratté (Re.), *Aphrodisias papers, Journal of Roman Archeology* (Vëll. i 4, fv. 145-168).
- Brandi, C. (2000). *Il restauro, teoria e pratica*. Torino: Einaudi.
- Cabannes, P. (1/1986). Recherche archeologique en Albanie 1945-1985. *Revue Archéologique, Nouvelle Série*, 107-142.
- Cabannes, P. (1993). L'aport des sources littéraires à l'onomastique d'Epidamne-Dyrrhachion et Apollonia d'Illyrie. *Greks et Illyriens dans les inscriptions en langue grecque d'Epidamne-Dyrrachion et d'Apollonia d'Illyrie. Actes de la table ronde internationale (Clermont-Ferrand 19-21 octobre 1989, (f. 17)*. Paris.
- Caliò, L. M. (2009). Cultura medica e urbanizzazione in Grecia tra età classica ed ellenismo, in PP 64,. (G. M. Editore, Re.) *La Parola del Passato, Rivista di studi antichi*, 94-127.
- Ceka, N. (1985, 1). La civilisation proto-urbaine illyrienne. *Iliria*, 111-150.
- Ceka, N. (1993). La koiné illyro-épirote dans la domaine de l'architecture. Në P. Cabanes, *L'Illyrie meridionale et l'Epire dans l'antiquité* (fv. 123-133). Paris.
- Ceka, N. (2005). *Apollonia*. Tiranë: Migjeni.
- Ceka, N. (a.d.). La fontaine d'Apollonia. *Deuxieme conference des Etudes albanologiques*, (fv. 503-513).
- Coulton, J. J. (1976). *The Architectural Development of the Greek stoa*. Oxford.
- Crane, G. R. (Re.). (a.d.). *Persus Digital Library*. Gjetur në Tufts University, Massachusetts. : <http://www.perseus.tufts.edu/>
- Daë son Maria-Dimitra , Kamara Afroditi,. (2006). Bouleuteria in Asia Minor. *Encyclopaedia of the Hellenic World*. Gjetur qershor 2013, nga <http://www.ehw.gr/l.aspx?id=9926>

- Donald, W. A. (1943). *The political Meeting places of Greeks*. Baltimore.
- Donati, J. C. (2015). The Greek Agora in its Peloponnesian Context(s). Në C. A. edited: Donald C. Haggis, *Classical Archaeology in Context: Theory and Practice in Excavation in the Greek World*, (fv. 177-218). Walter de Gruyter.
- Dunkley, B. (1936). Greek Fountain-Buildings before 300 B.C. *The Annual of the British School at Athens*, Vol. 36, 142-204.
- Edmond, P. (1930, 4). Lettres de M. Léon Rey sur les fouilles d'Apollonie d'Illyrie (Albanie). *Comptes rendus des séances de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres*, 74/4 . Gjetur mars 2012, nga <http://www.persee.fr/collection/crai>
- Fino, A. (2014, 2). La fontana arcaica di San Biagio ad Agrigento. *Thiasos, rivista di archeologia e architettura antica*, 67-91.
- Follain, E. (2009). La restitution du centre monumental romain d'Apollonia d'Ilyria-exemple du monument des Agonothetes". *Actes de Colloque : Virtual Retrospect 18-20 Nov.2009*, (fv. 115-122).
- Gabellone, F. (2011,1(1)). The reconstructive study in arcaheology: case histories in the communication issues. *SCIRES-IT: SCientific RESearch and Information Technology*, 53-78.
- Gabellone, F. (2013, 4(9)). Il santuario di Giove Anxur a Terracina: Una ricostruzione tipologica come ausilio alla visita in situ. *Virtual Archaeology Review* , 108-115.
- Giovanni Pugliese Carratelli; Ida Baldassarre. (1963). *Enciclopedia dell'arte antica classica e orientale*. Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana.
- Greco, E. (1999). *La citta greca antica: istituzioni, societa e forme urbane*. Roma: Donzelli Editore.
- Greco, E. (2000). Eekklesiasteiron di Possidonia-Paestum. Në S. Verger, *Rites et espaces en pays celte et méditerranéen : étude comparée à partir du Sanctuaire d'Acy-Romance (Ardennes, France)*. École française de Rome, 2000.
- Grupico, T. M. (2008). *The Influence of Urban Planning on Temple Design in West Greece*. New Jersey: ProQuest LLC.
- Gruyter, W. d. (1997). *Rise and vecline of Roman World*. Berlin: Hildegard Temporini.
- Hellner, N. (2/2011). Remarks on octagonal supports in greek Architecture. *Revue archeologique*, 227-262. Gjetur 7 21, 2013, nga cairn.info/revue-archeologique.htm
- Höcker, C. (2003). *Assembly buildings*. Boston.
- Hodges, R. (2006). *Butrinti i përjetshëm*. Tiranë: Toena.

- Inge Lyse Hansen, Richard Hodges, Sarah Leppard. (2013). *Butrint 4: The Archaeology and Histories of an Ionian Town*. Oxford, UK: Oxbow Books.
- J.Russell. (1973). *Proc. of the Xth Int. Congres of Classical Archeology*,, (fv. 11-23). Ankara.
- Jean Luc Lamboley, Bashkim Vrekaj. (1-2,2003-2004). les Fouilles franco-albanaises d'Apollonia: 1994-2004. *Iliria*, 180.
- Jean-Luc Lamboley, F. Drini, F. Quantin, S. Shpuza, S. Verger, A. Skenderaj, E. Follain, MH. Barrière, P. Lenhardt, V. Bereti, A. Islami. (123-1 | 2011). Apollonia d'Illyrie (Albanie). *Mélanges de l'École française de Rome - Antiquité [En ligne]*, 242-262. Gjetur në <http://mefra.revues.org/500>
- Jean-Luc Lamboley, Faik Drini, François Quantin, Stéphane Verger, Altin Skenderaj et Saïmir Shpuza,. (2014). Apollonia d'Illyrie (Albanie) Campagne de fouilles 2012. (É. f. Rome, Re.) *Chronique des activités archéologiques de l'École française de Rome*, 33. Gjetur 1 21, 2015, nga <http://cefr.revues.org/1040>
- Jouanna, J. (1996). Hippocrate, Airs, eaux, lieux. *Les Belles Lettres*, 52(52-2).
- Lang, M. (1968). *Water works in the athenian agora*. Princeton, New Jersey: American school of classical studies at Athens.
- Larry Mays, George P. Antoniou, Andreas N. Angelakis. (2013, 5). History of Water Cisterns: Legacies and Lessons. *Water*. Gjetur 6 2014, nga <http://www.mdpi.com/>
- Maria Ananiadou-Tzimopoulou, Alexandra Yérolympos et Athina Vitopoulou. (14/2007). L'espace public et le rôle de la place. (A. P. Belon, Re.) Gjetur në <http://etudesbalkaniques.revues.org/227>
- Martin, R. (1951). *recherches sur l'agorà grecque*. Paris.
- Martin, R. (1956). *L'urbanisme dans la Grèce antique*. Paris.
- Martin, R. (1983). L'espace civique, religieux et profane dans les cités grecques de l'archaïsme à l'époque hellénistique. *Architecture et société*, fv. 9-41. Gjetur 4 2013, nga http://www.persee.fr/web/ouvrages/home/prescript/article/efr_0000-0000_1983_act_66_1_3195
- Mertens, D. (2006). *Città e monumenti dei greci d'occidente: dalla colonizzazione alla crisi di fine V secolo a.C.* L'ERMA di BRETSCHNEIDER.
- Mogens Herman Hansen, Kurt A. Raaflaub. (1995). *Studies in the Ancient Greek Polis, Volume 1*. Franz Steiner Verlag.
- Mogens Herman Hansen,Tobias Fischer-Hansen. (1994). Monumental political architecture in archaic and classical Greek Poleis: Evidence and historical

- significance. Në D. Whitehead, *From Political Architecture to Stephanus Byzantius: Sources for the Ancient Greek Polis* (fv. 23-90). Stuttgart : Steiner .
- Neritan Ceka, Skender Muçaj. (2004). *Bylisi : historia dhe monumentet*. Migjeni.
- Nuttgens, P. (2001). *Storia dell'architettura*. (C. Rodriguez, Përkth.) Milano: Bruno Mondadori.
- Olgita Ceka, Neritan Ceka. (2015). L'Illyrie méridionale et l'épire dans l'antiquité. Në A. L. classique (Re.), *Actes du VIe colloque international de Tirana, 20-23 mai 2015*.
- Paolo e Laura Mora, Paul Philipot. (2003). *La conservazione delle pitture murali*. ICCROM.
- Perseus Digital Library Image Copyright* . (a.d.).
- Petri S. Juuti, Georgios P. Antoniou, Walter Dragoni, Fatma El-Gohary, Giovanni De Feo, Tapio S. Katko, Riikka P. Rajala, Xiao Yun Zheng, Renato Drusiani, Andreas N. Angelakis. (2015). Short global history of fountains. *Water*. Gjetur në <http://www.mdpi.com/2073-4441/7/5/2314>
- Pierres Cabanes, M. K. (2008). *Harta arkeologjike e Shqipërisë*. Pegi.
- Praschniker, C. (1922). Muzakhia aus Malakstra: Archäologische Untersuchungen in Mittelalbanien. *JCEAI*, vol.21-22, 23-57.
- Riza, E. (1997). *Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve ne Shqiperi*. Tirane: Dituria.
- S. Verger, S. S. (2014). Qyteti i sipërm i Apolonise, Portiku i madh dhe agoraja helenistike- gërmimet e viteve 2013-2014. *Illyria*, XXXVIII, fv. 211-221.
- Sear, F. (2006). *Roman Theatres. An Architectural Study*, (Vëll. i Oxford monographs on classical archaeology). New York: Oxford University Press Inc.
- Senseney, J. R. (2011). *The Art of Building in the Classical World: Vision, Craftsmanship, and Linear Perspective in Greek and Roman Architecture*. Cambridge University Press,.
- Urma, M. (2008-09). The perspective in ancient greece. An original way of constituting the spatial composition. *Anistoriton Journal In Situ*, 4-8. Gjetur shtator 2014, nga www.anistor.gr/index.html
- Vangjel Dimo, Ph. Lenhard, F. Quantin. (2007). *Apollonia, Atlas archéologique et historique*. Rome: Collection de l'École française de Rome.
- Vitruvius Pollo, Morgan, Morris Hicky. (1859-1910). *10 books of architecture*. Cambridge: Harward University Pess.
- Ward-Perkins, J. B. (1974). *Cities of ancient Greece and Italy, Planning in classical antiquity*. (C. U. George R. Collings, Re.) Neë York.

- Winter, F. E. (2006). *Studies in Hellenistic Architecture*. University of Toronto Press.
- Wycherley, R. E. (1962). *How the Greeks Built Cities*. New York: Norton & Company.
- Zevi, B. (2000). *Saper vedere l'architettura*. Torino: Einaudi.
- Zhegu, K. (1975). Punimet e restaurimit ne fontanen e Apollonise. *Monumente te kultures ne Shqiperi* , 1975.